

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32
A64

SOTIR ANDONI

*Tregime
nga
Voskopoja*



311-32

764

SOTIR ANDONI



**Tregime
nga
Voskopoja**



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

THE SOUTH AFRICAN



Treatise
on
the
History of the



THE SOUTH AFRICAN

RRËFIMI I NJË NDERLIDHËSI PARTIZAN

Toka ishte krejt e mbuluar me dëborë.

Sikur të ishte vetëm dëborë! Mund ta quaje atë si një masë të butë, të lëngshme e gati të ngrohtë... Por ç't'i bëje të ftohtit të mprehtë e cingërimës që doli kushedi nga dhe e kallajisi botën me një copë okite aq të ftohtë e aq të ngrirë, sa, kur e kapje, të dukej se dora të ngjitej pas saj.

Në këtë kohë të ashpër e të rëndë gjenerali gjerman lëshoi hordhitë mbi malet tona, duke shpresuar se me ndihmën e dimrit dhe të larove të Ballit do të zhdukte lëvizjen partizane.

Italia kishte rënë në prag të vjeshtës. Ne u tu-

rrëm asaj kohe e mblodhëm sa mundëm materiale lufte, midis të tjerash edhe linja të gjata e të gjata telefoni, që bashkë me centrale e nëncentrale, i dhënë dorë luftës sonë.

Kisha punuar pak kohë si centralist në qytetin tim. Gfatë punës kisha humbur dritën e njërit sy. Ndonjë shëmtim nuk e kam as tashti prej kësaj fatkeqësie dhe dallohem vetëm po të më vërej në kujdes. Kështu, unë isha teknik dhe punonjës i centralit telefonik aty në majë të malit, në lartësinë «Korona». Ditën dhe natën ngulja e shkulja fishe e jepja lidhje dhe, për t'u siguruar se linja u lidh, dëgjoja vetëm parullën e çeljes së çdo bisede: Vdekje fashizmit! Liri popullit!

Një ditë më flet në telefon komandanti partizan i çarkut. I nxituara dhe me një zë të ashpër, më dha një urdhër që më befasoi:

— Gjermanët nuk i ke më larg se një kilometër... s'pret koha, vëru zjarr minave, centrali të hidhet në erë!

Urdhër i prerë. Kështu e ka lufta!

U vërsula pas punës që duhej të kryeja. Ndërsa po shkulja telat e po kontrolloja kandelet, më hipi në kokë një mendim: Po sikur gjermanët të mos kalojnë këtu? Si ta hedh në erë kot së koti? Po nëse ata vijnë dhe s'gjejnë, nuk bien në gjurmë... do të gëzohen që e zhdukën centralin tonë, se, sa për materialet që mund të kapin, nuk do të kenë ndonjë fitim kushedi çë.

Dhe kështu, vendosa të luftoja gjër në fund dhe dhëmb për dhëmb. Tani mbetej të mendohesha për të kryer planin që do të më dukej më i mirë. Vendosa në çast: Kundrejt ishte një kodër, që i kishte a

s'i kishte të pesëqind metrat. Andej duhej të tërhiqesha... por unë tel kisha, dinamitin të vendosur... Nëse gjermani hynte në guvën tonë... le të hidhej në erë bashkë me centralin!

Lidha dy tela bakri prej transformatori të vjetër, i shtrëngova pas dinamitit, vështrova njëherë anembanë dhe nisa shtrirjen e tij. Ik e ik nja pesëqind çape, u ngula në tumbat e pishave dhe prita...

Zhurmat e gjermanëve tashmë u bënë krejt të qarta. «Me të hyrë ata në shpellë, unë bashkoj telat me baterinë elektrike dhe... dinamiti atje tej ka për t'u ndezur në çast...»

Hyrjen e shpellës e kisha ballë për ballë dhe e kontrolloja fare lirshëm me sy. Më në fund, i pashë gjermanët.

Ata u dukën te bishti i pyllit, në një radhë të shtrembër si bisht qeni. Ishin nja dhjetë veta. Një patrullë e plotë, pararojë. Përpara ata kishin një qen, por në atë ngricë ai nuk u hynte fare në punë; hidhej dhe nuhaste drejt qiellit. Midis armiqve dallova dy xixëllime gjyzlykësh, automatikët të hedhur krahaqafë dhe në fund të tyre, i njëmbëdhjeti ishte një ndërlydhës, që mbante në shpinë një radiotransmetuese; dalloheshin mirë edhe antena e nikeluar, edhe shpina e kërrusur e gjermanit.

Pas pak vargani i tyre e zbuloi brimën e spilesë sonë dhe një rreshter, duke u kërrusur, hyri i pari, të tjerët pas tij. Një dridhje e lehtë më kaloi nëpër duar sikur hyrja e guvës ta kishte telin të lidhur me gishtat e mi.

Kur gryka e spilesë e përpiu atë vargan, mu në hyrje të saj, gjermani që mbante aparatën marrës e dhënës, u ul galiç dhe filloi të transmetonte, duke folur në gjuhën e vet të ashpër. Atëherë mendova

që ai qëndroi përjashta si me porosi; pas shpërthimit ai nuk do të dëmtohej, aparati i tij nuk do të prishej dhe unë do t'ia merrja fare të rregullt...

Sa bashkova të dy telat, matanë, brenda në shpellë, u dëgjua një shungullimë sa u tund vendi. Jehona oshëtiu majë më majë e grykë më grykë... Nga shpella nuk u duk të dilte asnjëri, ndërsa ndërlihdësi diku do të qe goditur edhe ai, sepse e pashë që qe përplasur përtokë, pastaj shkau tatëpjetë pllajës me okitë, duke lënë pas, në atë bardhësi të virgjër, një çerkë të kuqe gjaku që shquhej fare qartë. Në çast e mblodha veten dhe u vërsula drejt tij... Nga gryka e shpellës vijonte të dilte një tym i zi dhe asgjë tjetër, as thirrje, as kurrgjë. Zbrita tatëpjetë jo duke rendur, por duke rrëshqitur aq shpejt, saqë, po të desha të qëndroja për një çast, do ta kisha krejt të pamundur. Dhe... gjermani ishte vërtet i goditur, por ende i gjallë. Ai, me gjithë lemerinë që kishte pësuar, e mblodhi mendjen dhe ashtu si ishte shtrirë, ngriti armën dhe në ajrin e thatë të atij dimri u dëgjua një krismë. Por unë isha në lëvizje dhe gjermani nuk më qëlloi dot. Sakaq i drejtova automatikun dhe shtiva mbi të me breshëri. Gjermani u kruspulloi e s'lëvizi më. Iu afrova ngadalë, duke e përgjuar me vëmendje. Më ndihmoi bardhësia e dëborës. Atje ku gjermani ishte përmbysur e tashmë dukej si një shuk me lecka, anembanë dëbora ishte skuqur e po skuqej gjithnjë e më shumë.

Më në fund i lëviza kokën për t'i parë fytyrën. Ishte djalë i ri, flokëverdhë, me buzë fare të holla. Ia shkula aparatën nga shpina. Me aq sa dija, bëra të dëgjoja zhurmën e një aparati të çelur, po nuk

dëgjohej asgjë. Ndonjë plumb s'kishte marrë, pra do të ishte prishur nga përplasja.

* * *

Komisari më nisi për në qytet. «Një djalë me një pincë në dorë të pret tek akaciet». Më lanë në një bazë e më porositën të mos dilja jashtë. Vonë, pas mesdite, erdhën sërish. Më thanë: Aparati është i një tipi të panjohur dhe i prishur. Mund të ndreqet vetëm në Tiranë. Të qëndrosh këtu, nuk bën, sepse njihesh, më mirë në lëvizje. Do të të nisim për në Tiranë me lidhjet e duhura. Nesër në mëngjes... Gjatë natës që vjen do marrësh udhëzime të tjera.

Isha tepër i lodhur dhe, sa rashë, gjumi më zuri menjëherë.

* * *

Në qytetin tonë ishte një tregtar që kishte një dyqan, të vetmin në gjithë tregun për mallin që mbante. Quhej Najdo Kockëmadhi dhe tregtonte armë. Nuk e kishte mbiemrin kështu, por ky vigan burrë vuante nga një sëmundje e rrallë e rritjes së kockës dhe kështu ia patën ngjitur. Kockat i kërcenin edhe përmbi supet. Në fytyrë ishte i ngrysur. Rritja e kockave e shëmtonte nga të gjitha anët, në trup e në fytyrë. Që në fillim të luftës shokët e Partisë në qytet i kishin shkuar e i patën thënë me të urtë e me të butë se armët duheshin për të luftuar okupatorin, por ai, kapadai e nopran, qe ndezur e qe tërbuar, duke bërëtitur se ishte më i nder-

shmi i firmës «Beneli»... «Ju qërohuni e mos ju shoh sytë», kishte thënë e papritur kishte hapur kasafortën dhe rrëmbeu revolverin. Kur kishte kthyer kryet, kishte parë tri gryka revolverësh drejt e në ballë.

— Najdo Kockëmadhi! Ne s'bëjmë shakara!

Kockat e tij të kërcyera te supet sikur u vaisën tatëpjetë, nofullat iu drodhën, revolveri i pikoi nga dora dhe ngriti duart lart.

Fundi i fjalës, shokët tërhoqën barutin, revolverët, ciftet e gjahut, nja pesë kërabina që i gjetën në bodrumet e dyqanit dhe, pasi e porositën të rrinte mbi vezë, se kishte edhe më keq, ikën në punë të tyre.

Kjo kishte ndodhur në kohën e italianëve dhe e kishte bërë Najdon të tërbohej.

Pasi ngeli pa mall dhe fabrika «Beneli» mbeti matanë detit, Najdo Kockëmadhi u lidh me «Farben Industrie» dhe tregtonte bojëra. Por dihet që pas lidhjeve tregtare, kur shijet janë të njëjta, vijnë edhe lidhje të tjera.

Ky njeri i gjermanëve nisej ato ditë për në Tiranë me kamionin e tij që transportonte kuti me bojëra, si përfaqësues i «Farben Industrie». Shokët e Partisë në qytet i kishin thurur fijet dhe më treguan planin.

«Do të udhëtosh me këtë njeri, por duhet kujdes i madh. Shofer është shoku Guri, njeri yni, ai punon bashkë me ne. Ti do të hiqesh se e ke syrin të sëmurë dhe shkon te mjeku në Tiranë. Kështu janë rregulluar punët. Kur të mbërrish në Tiranë, do të të dalin para dy shokë, që do të mbajnë në duar një telegram nga nëna jote, që kujdeset për udhëtimin dhe mbërritjen tënde»...

Pastaj erdhi edhe shoku Guri, më tha se ra-

diotransmetuesen e kishte mbërthyer nën karrocërinë e kamionit dhe lamë fjalë për të nesërmen.

Disa drejtime e parulla duhej t'i mbaja në mend; më dhanë edhe letërnjoftim fals, lëshuar nga komanda gjermane.

Më në fund, ditë e hënë në mëngjes, nëpër një të ftohtë dhe nëpër patrullat e gjermanëve dhe ballistëve, duke mbajtur një shami mbi syrin e djathtë, dola te banka e qytetit. Nga larg shokët venin e vinin sikur mërreshin me punë të tjera dhe përgjonnin nisjen tonë. Kamioni u duk që doli nga Hani i Shules. Nëpërmjet xhamit të përparmë dallova sytë e shoferit Guri, që dukej vërtet i shqetësuar, pastaj në krah të tij Najdo Kockëmadhin, mbështjellë me një pallto të trashë, të rëndë e tepër të madhe. Tregtari nuk qëndronte dot në kabinë, aq shumë vend zinte, prandaj ishte ulur gjysmë shtrembër. Ai më hodhi një sy shkarazi, më bëri shenjë me kokë dhe unë hipa në karrocërinë e mbuluar me mushama. Doli Guri, më ra njëherë supeve fshehurazi dhe u nisëm. Por fare papritur, mu te sheshi para bankës, kamioni nuk mori rrugën e Tiranës, por xhadenë drejt Bilishtit... Aty për aty, Najdo Kockëmadhi kishte urdhëruar Gurin që të venim për Tiranë nga ana e Follorinës. Nuk kishte vend e as rast për lëvizjen më të vogël. Do të ecnim nëpër linjën Follorinë, Strugë, Qafë-Thanë... Najdoja ishte dhëlparak dhe në këto ditë lufte lëvizte me kujdes dhe me drejtime të papritura.

Po tashti? Po të na dalë ndonjë ngatërrësë apo rrezik kësaj rruge të papritur? Epo, luftë pa rrezik nuk ka!

Gjatë rrugës isha krejt vetëm në karrocëri. Isha kruspullosur nga të ftohtët, era frynte e ulërinte në-

për brimat e mushamasë, makina tundej e lëkundej, kurse unë kërceja si esh aty në mes të kutirave me bojë dhe fërkoja këmbët nga ngrica. Shaminë nuk e hiqja nga syri. Gjithnjë e më shumë ndieja troshitjen e zorrëve, ngrihesha më këmbë, vija syrin në ndonjë brimë dhe vështroja nga malet. Andej ishin shokët, andej dukeshin mullarë të lartë tymi e mbi malet e bardha me retë e dendura mbi kresh-ta, pështjellohej tufani i dëborës. Kohë luftime.

Gjatë rrugës patëm vetëm një ndalesë të detyruar, në Kapshticë, por pasaporta gjermane e Najdo Kockëmadhit bëri punën e vet.

Kur mbërritëm në Follorinë, e ndjeva veten ngushtë. Gjermanët na zbritën nga kamioni. Najdo Kockëmadhi e fliste gjermanishten mjaft mirë, por në një çast e vura re se si u ngritën edhe më lart supet e tij të shtrembra dhe mua me Gurin nisën të na kontrollonin. Por, megjithatë, nuk ishte një kontroll prej mjeshtri. Hija e atij goxha Najdoje, si duket, bënte punë. Këtë mendova në Follorinë, por nuk doli kështu gjer në fund...

Jashtë Follorinës, nëpër të çarat e mushamasë, dallova një kamp përqendrimi, rrethuar me tela me gjembë. Njeri i gjallë nuk dukej gjekundi; si duket ishte koha kur të internuarit i mbanin mbyllur nëpër barakat.

Pas disa orësh, më në fund mbërritëm në një vend me shumë shtëpi e me disa kazerma të gjata. Makina qëndroi dhe përjashta dëgjova të flitej një gjuhë tjetër. Pas një çasti e kuptova se ndodheshim në qytetin e vogël të Gjevgjelisë, një zonë okupacioni e bullgarëve. Na zbritën, na hoqën mënjanë dhe pasaportës gjermane të Najdos nuk ia varën shumë. Ai deshi të protestonte, por i vetmi lëshim

që i bënë, ishte se atë nuk e kontrolluan në trup, kurse ne...

Së pari futën Gurin në një barakë; mua më qëndroi pranë një bullgar barkmadh, me ca mustaqe të ngritura përjetë.

Prit e prit e më në fund Gurin e nxorën nga baraka e kontrollit. Palltoja leckamane e tij ishte shqepur e shqyer e tëra dhe vatat e bardha prej pambuku i qenë shpërndarë nëpër trup, sikur aty do ta kishte mbuluar dëbora... Hunda i pikonte djersë.

Kur më futën edhe mua në barakë, as më pyetën fare, po nisën të më shqepnin andej e këtej dhe nuk lanë vend pa më futur duart. Kur më nxorën jashtë, edhe unë isha bërë më keq se Guri. Kontrollë më kishin bërë edhe herë tjetër, zogistë, italianë, gjermanë, po si këtë herë as kisha parë e as kisha dëgjuar. Për fat makinën as nuk u vajti në mend ta kontrollonin imtësisht.

Më në fund, u nisëm. Përjetë e tatëpjetë, gjer sa atë natë bujtëm në një han të Strugës. Nëpër errësirë dëgjoja buçimën e ujërave të Drinit dhe zëra grash që flitnin në gjuhën tonë.

Në mëngjes përsëri në udhë. Ngjitëm të përjetën e Qafë-Thanës, zbritëm në Përrenjas, pastaj hymë në grykat e Pishkashit. Gjithnjë me syrin në brimat e mushamasë, numëroja gurët e kilometrazhit. Papritur, në një kthesë tej Pishkashit, kamioni ynë frenoi, gomat u fërkuan dhe u zvarritën me zor. Thirrje në gjuhën tonë nga zëra të rinjsh.

Na kishin kapur partizanët!

U hodha nga karrocERIA. Para meje pashë Najdon dhe Gurin dhe disa partizanë me tytat e pushkëve drejtuar nga ata. Desha t'u hidhesha shokëve në qafë, t'i puthja, t'i përqafoja, t'i përshëndetja me

parullën tonë të luftës por... u përmbajta, çdo hap i hedhur gabim, më prishte krejt planin e punës. Zemra më hidhej nga hovi i dashurisë për shokët e mi, por u shtiva si i sëndisur. Nga të dhjetë partizanët që kisha përpara, nuk njihja asnjërin. Edhe ata nuk më njihnin, por Najdon ama na e njihnin fare mirë. Njëri iu kërcënua:

— Gjysmën e lekut, qen bir qeni, dhe të vesh në...

Një komisar kompanie po na kontrollonte dhe në një çast, kur sytë tanë u takuan, unë i shkela syrin. Ai më pa drejt në bebe, kafshoi buzën e poshtme, pastaj mustaqen e majtë, më vështroi edhe një herë dhe urdhëroi:

— T'i ndajmë veçmas dhe t'i marrim në pyetje.

Kur u ndodha vetëm, i pëshpërita:

— Shoku komisar, unë jam partizan, fshehur në karrocëri kam lidhjet e posaçme për në Tiranë, këtu kam dhe një dokument gjerman dhe një lehtënjofitim fals...

Ai më vështroi mirë e mirë dhe ma ktheu:

— Unë nuk i ha kollaj këto që thua ti!

Nga xhepi nxora dokumentin gjerman.

Komisari e vështroi me vëmendje, kur një partizan që e kisha fare ngjitur, ma dha me bërryl në ije...

— Ore shok!

— Ç'shok, mór qen bir qeni! Më vjen me pasaportë gjermani dhe më thua shok...

— Ore shok, mos u nxito, unë...

— Ehu, sa të tillë kemi parë ne...

Komisari u hoq mënjanë dhe nisi të vështronte më nge dokumentin tim.

— Është fals, shoku komisar.

— Do ta shohim, se mos je fals ti vetë...

Rreth meje u bënë tre partizanë. Më shihnin me mosbesim. Njëri më tha:

— Po të na kesh gënjyer, do ta hash plumbin...
thuj të vërtetën, kush je, ku vete dhe përse?

— Ore shokë...

— S'jemi shokët e tu ne, kalon nëpër gjithë këto kontrole të armikut dhe na del kaq i mençëm...

Hej, ç'gjeta belanë.

Komisari po vriste mendjen, pastaj më tha:

— Ta zëmë se ti je ai që thua, po sikur ti të ishe në vendin tim, si do të veproje?

— Shoku komisar, e kuptoj, por besomë, shoferi është yni, pyeteni e do të shihni. Nájdo Kockëmadhin e ka futur njësi ynë në valle, dhe ai, pa kuptuar gjë, na shërben neve, le ta lozim gjer në fund këtë valle... — Ngaqë nuk kisha më argumente të tjera, thashë: — Të largohen dy partizanët e tjerë se kam diçka tjetër për të thënë. — Të dy partizanët mblodhën buzët, megjithatë bënë disa çape më tej. Atëherë, i fola komisarit: — Ja, po hedh gurin e fundit: nën karrocerinë e kamionit kemi një radio transmetuese, e kanë maskuar atje shokët e Partisë në qytet, unë jam partizan ndërlidhës dhe më nisën me shërbim. Zbrit në xhade dhe heto nën kamion, veçse Najdoja mos pikasë gjë.

Komisari më vështroi edhe një herë dhe, si duket, më besoi. Më rrahu supin, u përqaftua dhe pas disa minutash u nisëm.

Najdo Kockëmadhi ishte tepër i trembur, por nuk mësoi kurrgjë. Kur qëndruam te një çesmë, më tha:

— Mirë e vërtite me ata të malit, por edhe ty syri nuk të dhemb aq sa thua...

* * *

Gjatë rrugës për në Tiranë, Guri dhe Najdoja seç bisedonin, por unë s'merrja vesh asgjë. Isha tulatur në mes të kutive me bojë.

Kur mbërritëm në kryeqytet, vura re që atje na prisnin. Isha shumë i lodhur, më merreshin mendtë. Sapo zbritëm, zoti Najdo, me atë goxha trup, i kënaqur, më rrahu supet e më tha:

— Djalë i zoti! Më të lumtë!

M'u afruan shokët. As që i njihja fare, por e mora me mend se ata ishin. Njëri mbante në dorë një telegram.

— Mirë se erdhe, kushëri! Morëm telegram nga nëna dhe dolëm të të presim. Si dukesh me syrin?

Anëmbanë patrulla me ballistë e gjermanë. Në bisedën tonë hyri edhe Guri, që, duke ngritur zërin, tha:

— Kemi pësuar një çarje në balestrën e djathtë, makina duhet domosdo të hyjë në oficinë.

Dhe u nis «për oficinë», kurse pas pak shokët e njësitit të Tiranës sollën në bazën tonë radio-transmetuesen.

Tashti bisedoja si i njohur i vjetër me një shok krejt të panjohur... Ai ishte flokëverdhe dhe pinte shumë duhan.

Tërë atë natë fjeta si i vdekur. Në mëngjes erdhi përsëri ai flokëverdhi dhe më njoftoi se tekni-kuq që mund të na rregullonte aparatën, një inxhinier italian, i kishte humbur fare adresa.

Flokëverdhi më solli rroba të tjera dhe dolëm në rrugë. Ai ishte moshatar me mua.

Nëpër rrugët e mbushura plot me njerëz, kalonin shumë llandonë, buçitnin tanke e autobllinda, që zvarriteshin me ulërimë, duke trembur kuajt ngor-dhalaqë të karrocave. Poshtë e përpjetë ecnin duke u kapardisur ballistë e xhandarë me kobure në brez, me vëzme e bomba dore që u tundeshin e u lëkundeshin. Pak më tej pamë gjermanë me uniformat e murme. Njëri syreshi kishte një monokël në sy dhe një pelerinë tepër të gjatë mbi trup.

Më në fund mësuam se inxhinieri italian që na duhej, që fshehur në një «strehim», që zor se na shkonte ndër mend. Për të shpëtuar, ai që ngulur në një shtëpi murgeshash.

Ik këtu e ik atje dhe ramë në gjurmë. Italiani që strukur atje në kundërshtim me të gjitha rregullat fetare, për të mos i shkuar mendja kurrkujt.

Nëpër Tiranë bënte një të ftohtë therës, një të ftohtë i lagësht që na ngjethte e sikur na e tkurrtë cipën e barkut.

E shoshitëm punën mirë e mirë, pastaj morëm lidhjet e duhura dhe u nisëm për në Durrës. Edhe qyteti-pört paraqiste thujtë atë pamje të kryeqytetit. Ne duhej të shkonim në një mbledhje të organizatës së rinisë komuniste, me vajzat e fabrikës së cigareve. Atje duhej të takonim dhe të zgjidhnim një shoqe punëtore që do të na ndihnte më tej. Përpunuam një plan dhe na dukej se nuk e kishim keq.

Më në fund ia dolëm mbanë. Pas mbledhjes shkua në një bazë bashkë me një vajzë punëtore që quhej Luçia. Ajo ishte një leshverdhe në moshën tonë, me ca sy të bukur e gazmorë, me një palë vëthë të vegjël argjendi, me flokë të prerë shkurt dhe

e veshun fare thjesht. Luçia pati qenë dy vjet në një shkollë murgeshash. Kjo ishte vërtet vajza që na duhej. Ajo na shihte në të dy me njëfarë lakmie dhe admirimi, ashtu si shiheshin asaj kohe partizanët e zbritur nga mali. Na tregoi se ishte e ardhur me gjithë familje nga Prizreni dhe mbi të gjitha na pyeti nëse kishte dalë ndonjë këngë e re partizane.

— Treguam atë sa mundëm dhe të gjitha këto biseda bëheshin në karrocerinë e një kamioni. Anëmbanë vinte era det, peshk e kripë. Të ftohtët na mundonte shumë.

— Në bazën e re, në Tiranë, shtruam përsëri planet e punës. Unë i kërkova Luçies që të hynte në shtëpinë e murgeshave, si një vajzë e mjerë, që, e gënjer nga një dashuri fatkeq, përplasej atje...

— Ajo pranoi, por bëri këtë ndërhyrje:

— Jo nga një dashuri fatkeq por... më janë vrarë prindët nga bombardimi dhe s'kam rrugë tjetër; të tjerat... ato i ndreq unë vetë... Mirë?

— Mirë!

Dy ditë më vonë Luçia u kthye në bazën tonë. Kjo ishte një provë e rëndë për vajzën. Ajo nuk kishte fjetur fare. Lodhja e pagjumësia i dalloheshin fare mirë në sy, megjithatë ishte shend e verë. Na tregoi:

— Hyra te murgeshat pikë e vrer. Ato më pri-tën shumë mirë. Vajtja ime atje, me arsyet që u tregova, nuk krijoi ndonjë dyshim. Veçse e ndieja veten keq, se nuk dija si t'u përgjigjesha kur më ngushëllonin... Në mbrëmjen e ditës së parë munda të nuhatja se ku ndodhej sinjor Feruçioja. Pa e zgja-

tur shumë, i shkova drejt e në dhomë... Kur më pa, u tmerrua! Erdhi e u zbardh e u zbardh, pastaj u zverdh e u katos në dysHEME. Duke u dridhur, më tha:

«Ti je ajo murgesha e re?»

Ja ktheva:

SinJOR FERUÇIO, unë jam murgeshë aq sa je edhe ti murg. Le të flasim hapur. Unë e di kush je ti dhe pikërisht për ty më kanë dërguar shokët këtu... puna jote na duhet, na vlen...

Atëherë ai ra përtokë dhe zuri të dridhej. Filloi të më lutej, i përgjunjur para meje:

«Unë dua të jem i qetë, s'dua ngatërresa, dua që vetëm pas lufte të kthehem gjallë e shëndoshë te fëmijët e mi...»

Ashtu vërtet, ia ktheva, ti ke të drejtë, por mos harro se ke detyrime kundrejt këtij vendi...

«Unë? Po unë askujt s'i kam bërë keq!»


Përderisa ke ardhur këtu me ushtritë e pushtimit, ke mbajtur ndërlidhjen e fashistëve kur digjeshin fshatrat tona... ke qenë në Korçë, në Vithkuq, në Pezë, në Labëri... tashti, sinJOR FERUÇIO, zgjidh e merr...

I shpjegova ç'kërkoni prej tij. Ai më dëgjoi gjer në fund me kryet ulur, pastaj rrahu gjunjët, psherëtiu thellë dhe ma ktheu:

«S'kam ç'bëj! Vetëm prej këtej mos kërkoni të dal, sillmani aparatën këtu...»

Ky ishte tregimi i Luçies. Dhe, kur mbaroi aksionin, shoqja jonë më e re u kujtua se palloja ime ishte e grisur, e shqepur dhe krejt pa kanavacë e pa vata. Atëherë kërkoi pe e gjilpërë...

Pas dy javësh unë isha përsëri në majë të malit në lartësinë «Korona» dhe centralit tone telefonikë shtuam edhe një radiotransmetues.



NJERIU ME DY SHTATA

Begatia e kësaj vjeshte të artë s'mbahet mend në anët tona.

Rrushi i uruar u rrit dhe u rëndua aq fort, sa kërcelli i bishtit u trash-tej mase e me dorë s'këputej. (S'mbetën më gërshërë në dyqanet e zonës.)

Dhe ata miqtë qejflinj të dasmave (të tillë në anët tona ka sa të duash) fërkojnë duart dhe i shkelin syrin njëri-tjetrit, sepse, domosdo, rakia e vera do të derdhen si ai Kroj i Çobanëve në mes të Moravës, që ngop me ujë tetë copë fshatra.

Po bashkë me lëmin e rrushit na është edhe lëmi i mollëve. Dhe ky lëmi i dytë na u bë i parë. Lëshohen kamionë që nga Shkodra e Saranda, të tje-

rë, që i thërresin mauna, lëshohen nga Fieri e Vlora, na vijnë fshatrave automjete me të gjitha targat e republikës dhe ngarkojnë e ngarkojnë e s'kanë të sosur. Lëngu si mjaltë që lëshon Devolli, ëmbëlson gjithë Shqipërinë.

Shoferët sarandiotë, të velur nga lëngu i portokalleve e mandarinave, e bëjnë syrin na... kaq, kur shohin fushave e depove tona kodra me mollë, që, të ndara, si janë, në tridhjetë e ca farë e fise, bashkojnë aromat e tyre, i lëshojnë nëpër fshat dhe vetëm këto erëra e kundërmime të dehin, të velin e të mahnitin.

Atje ku sot ngarkohen maunat e Fierzës e të Fierit, afër një kodre me mollë është ulur një plak, veshur me shajak ngjyrë piperi, me leshra të bardha, me dy sy të gëzuar e të qeshur. Plaku zgjedh mollët ylli, ato më të mëdhatë, më të bukurat dhe i mbështjell me një letër të butë, të bardhë e laral-lara. Shoferët e nderojnë për moshën, shkëmbejnë me të cigarët dhe e dinë që plaku është mjeshtër i parë, nga i cili mund të mësosh shumë për mollët dhe shijet e tyre.

— Tungjatjeta, xha Bardho!

— Tungjatjeta e me nder, o bir!

Plaku i ka mbushur të shtatëdhjetë e shtatë vjeçët dhe për shaka e për nder bashkë djemtë e fshatit, këtë vit, e thërresin «njeriu me dy shtata». Ai u tregon atyre ngjarje të lashta e më të reja, u tregon e u tregon e s'ka të mbaruar dhe, kur harron (domosdo mosha këto i ka) e përsërit, atëherë djemtë qeshin me mirësi e ia kthejnë:

— Këtë na e ke treguar, xha Bardho, ky është «ribotim», ne duam ndonjë të padëgjuar, të pabotuar.

Bardho Kalami në të ri të vet ka pasur fare pak tokë, dy copë ngastra që i punonte «vendçe» me një ka e me tri palë kazma. Me tokën ai ishte marrë gjithë jetën dhe atje ku lumi u shkonte mbi kokë e nën kokë, ai gjithnjë mbillte shelgje e plepa, sepse kështu ishte zakoni i asaj kohe. Edhe ndonjë kumbull të egër e kishte Bardhoja te mezhda, po jo të mbjellë me dorë. Punë kumbulle ajo, mbin vetë, ku të duash e ku të mos duash.

Për mallin e kokrrave të pemëve Bardho Kalami kishte pasur një brengë e një turp që në kohë të vegjëlisë së tij, që atëherë kur mbante llastiqe në xhëp dhe lege prej komi në krah.

U tregonte djemve:

— Kur isha çunak i vogël, nuk gjeje një kokërr mollë as për ilaç. Po mu në krye të fshatit kryeplaku kishte një dru molle, që ishte i madh e i gjerë, sa degët e tij prireshin edhe gjer në rrugën e fshatit ku venin e vinin njerëzia. Një mëngjes ngrihem që herët dhe shkoj nën mollën e kryeplakut. Ca kokrra verdhashe me fejza të kuqe nëpër faqe ma bënë me sy. Ç'e do, isha kalama dhe m'u prish mendja fare. Shoh anëmbanë të gjej ndonjë gur a ndonjë koçkor, po nuk gjej. Atëherë nxjerr opingën time prej llastiku dhe e hedh fluturim, me sa forcë pata, përmbi degët e mollës. Rrëzohen që andej dy kokrra, për opinga ime e varfër se ku u kap në ndonjë krep dege dhe mbeti atje lart. Tundej e lëkundej si për inatin tim e as kishte ndër mend të zbriste poshtë. Lemerinë e asaj dite s'mbaj mend ta kem hequr ndonjëherë. Si do t'u thosha në shtëpi! Të kishe asaj kohe opingë në këmbë e të mos ishe fare zbathur, ishte një gjë e madhe në jetën e

njerëzve të dorës sonë, ca më shumë në jetën e një Kalamani si unë.

Ja, kështu mbeta, me një këmbë mbathur e me një zbatthur.

Më tej, kur u rrita, në mezhidë të arës më mbiu vetiu një mollë e egër. Me kohë dha shtat dhe rriti kokrra. Por ato kokrra, në ishe burrë, hajdë t'i vije në gojë. Ishin të tharta e të hidhura si afratë. Ato kohë, në të gjithë trevën tonë ishte vetëm një bahçe me mollë. Ishte pronë e Hasan bej Kosturit dhe kishte plot pesëqind rrënjë. Beu e mbante dhe e punonte për tregti. E shiste kokrrën e mollës si frëngu pulën. Dhe bahçen e kishte të rrethuar me tela me gjemba.

Kaloj një ditë unë atje. Ishte pranverë, po çoja në pazar një barrë gomari me roshka të thata, kur shoh beun vetë i dytë që po krasitnin pemët. Hedh një sy në rrugën e gjerë, ku shoh një bisk mollë që kishte fluturuar nga forca e gërshërës.

Kërrusem, e marr dhe pasdite, ashtu si kisha dëgjuar e ashtu si dija, e shartova mollën time të egër. Por sa shkuan ca vite e doli fjala se molla ime u rrit dhe dha kokrra, alarm! Hasan bej Kosturi u ngrit dhe bërtiti:

— Ky më ka vjedhur biskun në bahçe, kurse unë fidanët i kam sjellë me gjithë ato haxhe që nga Misiri.

U habitën njerëzia. E ku rriten e ku ka mollë Misiri. Po për beun tonë ja që edhe Misiri kishte mollë. Fundi i fjalës, një ditë mollën e gjeta të prerë.

Ja kështu më ka ndodhur dhe më ka mbetur peng, por... krisi lufta kundër të huajve. Pa u ngrit edhe Hasan bej Kosturi të mbronte çifligun dhe bah-

çen me mollë dhe dha kokën. Erdhi viti dyzet e katër. Hekurat e gjermanit i kishim akoma nëpër këmbë, gjemba nëpër male, tela me gjemba nëpër fusha dhe bomba e barut fshehur ferrave. Na ngjante koha si e asaj lehonës, që sapo ka lindur djalin dhe i ka zorrët nëpër këmbë. Po edhe se me brenga e punëra shumë, djemtë që morën punën në shtet, na dërgojnë fshatrave karvanë me fidanë mollësh. Fidanët erdhën, po puna nuk shkoi si në vaj. Se u ngritën miqtë e Hasan beut me shokë dhe ia nisën të hidhnin fjalë e thumba: «Ç'na duhen mollët! Do mbelemi pa bukë. Ne s'jemi kalamaj të hamë mollë, do ngordhim urie për bereqet».

Por sidoqoftë, nëpër sherr e nëpër thirrje, këtej këngë e andej britma, nëpër fijet e litarëve të Reformës mollët u mbollën për bukuri. U ngritën disa e thanë se duheshin mbjellë me hënë të plotë, ca thanë me hënë të ngrënë e të ngritur sus, ca me hënë të rrëzuar e ku ta di unë çfarë tjetër u tha. Prej gjithë këtyre veç një porosi u mbajt: Kur fidanët kalleshin në dhe, ata i vendosnin duart e kalamajve tanë.

* * *

Asaj dite, kur maunat dhe kamionët e ngarkuar me mollët e Devollit hynin në xhadenë e madhe me plepa anës dhe merrnin rrugët e gjata të atdheut, natyra anëmbanë ishte plot me ngjyra e fletë. Ato pak fletë të rrëzuara plepash, nga përzierja e ajrit të vakur, frushullonin, ngriheshin në erë e rendnin pas rrotave të makinave sikur përgëzoeshin me to, sikur i përcillnin një copëz rrugë.

Kjo ndodhte një ditë përpara, sepse natës që afrohej... e kujt do t'i shkonte mendja?

Të lodhur nga puna në «dy lëmenj» së bashku, njerëzit kishin rënë në gjumë. Kishte kaluar mesnata, kur fare papritur e pakujtuar, dritat elektrike u prenë, pastaj u dëgjuan tri krisma pushke. Shënjë alarmi. Një dritare nisën të dukeshin fytyra, qirinj të ndezur, gazanikë me dritë... Jashtë frynte erë e binte dëborë. Telat e tensionit ishin këputur.

Dhe dëbora, e papritur si një pjellë shtatanike, nuk kishte ndër mend të pushonte. Ajo binte e shtrohej me flokë të trashë e të ngjeshur. E keqja ishte se drurët, në këtë tetor të begatë, nuk ishin përgatitur për dimër. Drurët e mollëve, së pari, nuk i kishin hedhur fletët fare. Ato i kishin të gjelbra e të forta, kurse vjeljet nëpër to edhe s'ishin mbaruar. Le pastaj rrushi... Vjelja e tij ishte thujse në fillim.

Kurse dëbora e rëndë dhe e trashë nisi të bënte hatanë. Një gjëmë e tillë nuk mbahej mend ndonjëherë. Thyerjen e nisën degët kreko të plepave të mëdhenj. Ato nisën të kërcitnin e të përplaseshin përtokë nën peshën e dëborës, që binte e binte gjithnjë. Pastaj nisën të kërcitnin e të çapëloheshin degët e mollëve, më pas (kjo s'kishte ndodhur kurrë) nisën të këputeshin e të përplaseshin përtokë edhe degë arrash të forta. Te centrali i fshatit zilja e telefonit ulërinte e s'kishte të pushuar: Alarm! Alarm! Alarm!

Të parët u turrën përjashta rinia, djem e vajza bashkë, me shkopinj e vastangare në duar. U dërdhën nëpër parcelat e mollëve dhe rend e qëllo degët e rënduara. Nga qëllesat dëbora përplasej me zhurmë përdhe, po përsëri dëbora e re binte e binte; degë ishin thyer plot, po duhej nxituar, duhej rëndur, duheshin shpëtuar drurët me domosdo. Njëpër

zhurmën e rrëmetit dëgjoheshin edhe zhurma të largëta. Vinin nga arat e fshatrave fqinjë. Edhe andej ndodhte si këtu. Këputja e degëve ishte e keqja më e vogël; e keqja që rëndonte ishte çapëlimi i trungjeve të mollës. Dhe, me t'u këputur më dysh trungu, edhe molla mbaronte përgjithnjë. Raste të tilla kishin ndodhur dhe po ndodhnin, por duhej shpejtuar, duhej vrapuar, sepse çdo dru që këputej e binte përtokë, ishte një vlerë e madhe që humbiste e s'vinte më. Bardho Kalami nuk e kishte jetuar kurrë këtë, edhe pse mbi supet e tij rëndonin dy shtata. Njëpër turmën që harbonte dhe qëllonte fuqishës, dëgjoheshin zëra:

— Burra! Djema! Të shpëtojmë drurët e mollëve! Edhe t'i vjelim!

Po Bardho Kalami bërtiti:

— S'kemi kohë për vjelje tani! Nuk prishen kokrrat nga dëborë e butë, se janë plot me lëng e sheqer.

— Po rrushi?

— As rrushi nuk priset.

— Po pishat e parkut, o xha Bardho?!

Bardho Kalami u shkreh me inat:

— Ti, moj çamarroke, te pishat e parkut e ke mendjen. Pisha nuk do t'ia dijë.

Njëpër zhurmën e përgjithshme të goditjeve e të thirrjeve u dëgjuan motorët e rëndë të traktorëve. Ata gulçuan e u derdhën rrugëve, duke lëshuar arave dritat e tyre të forta. Dritat binin pjerrtazi e kryq e tërthor parcelave me mollë, nëpër njerëzit që nxitonin e thërritnin, nëpër dëborën që shtrohej dendur e shpejt dhe dukej kështu një bukuri fantastike. Dhe këtë bukuri, në këtë natë të përzishme, askush nuk e kishte mendjen ta vështronte.

— Ju, traktoristë, na bëni dritë. Këtej, ore, këtej!

Agronomët e kooperativës, më shumë të qullur nga djersa sesa nga dëbora, vraponin nga një grup në tjetrin. Udhëzonin, mësonin dhe qëllonin edhe vetë.

Drurët e mollëve në fillim zinin të kërcitnin lehtë e lehtë sikur të jepnin shenjën e parë, sikur lëshonin alarmin, sikur lajmëronin çapëlimin dhe përmbysjen e tyre të plotë. Nëpër ato kërcëllima njerëzit mbanin vesh, i mbështetnin me stëngëza, bile edhe me supet e tyre, shkundnin degët, kërkonin forca të tjera, krahë të tjerë; rendnin këtej djem që kërkonin stëngëza e litarë.

— Këtu, ore, këtu, — thërriste zëri i mprehtë i një vajze, — nxito!ni, se i kam vënë shpinën një molle.

Dhe puna e ethshme vijonte pa ndalim. E, me gjithë këtë, dëgjoreshin mollë që thyheshin, drurë që përmbyseshin e prisheshin përgjithnjë.

Gratë që punonin në mënsë, dolën edhe ato me katër bidona mbushur me çaj të nxehtë. Dëbora binte gjithnjë e trashë dhe e rëndë.

Dikush thirri:

— Jepini një çaj plakut Bardho, se u kapit duke qëlluar.

— Ashtu vërtet, u lodhëm në që jemi të rinj, po ai që ka dy shtata në kurriz!

— Bardho, o Bardho! O xha Bardho! O shoku Bardho!

Po plakut nuk jepte asnjë përgjigje.

— Ndofta ka shkuar të ngrohë këmbët te plaka.

— S'është fjalë ajo, në këtë batërdi ai nuk ikën që këndeje.

— O Bardho! O xha Bardho!

U ndje një shqetësim i përgjithshëm. Kryetari i kooperativës, që u dha aty, foli edhe ai duke bër-titur:

— Duke qëlluar degët, kërkoni edhe Bardhon, mos është rrëzuar në ndonjë hendek e s'ngrihet dot.

— O Bardho! O xha Bardho!

Po plaku nuk jepte asnjë përgjigje.

— Do ta ketë mbuluar dëborë.

— Oburra ta gjejmë me shpirt!

Po dëborë nuk e kishte mbuluar plakun Bar-dho... Papritur u dëgjua një zë si piskamë e fortë, e thekshme, e mprehtë. Aq e mprehtë, sa u dëgjua edhe nëpër buçimat e motorëve. Ishte zëri i një vajze:

— Këtu, këtu! Rendni, xha Bardhoja po kër-kon ndihmë.

Njerëzit u lëshuan andej. Nëpër truallin e mbu-luar me dëborën e lagësht lllapashiteshin hapat. Fusha rënkonte gjithnjë nga kërcëllima e trungjeve, që, me atë zhurmë, dukej sikur gjithnjë kërkonin ndihmën e njerëzve.

Plaku Bardho i kishte vënë supin një molle të madhe në fund të një parcele, diku anës lumit. Zhurma e ujërave e kërcëllitjet e drurëve i patën mbytur thirrjet e tij.

— Djema, o djema, sillni këtu një stëngëz të ma-dhe.

Ata u vërsulën sakaq.

— Ti, dil këtej, xha Bardho.

Ai ishte aq i rënduar nga pesha, sa mezi fliste, por edhe kështu mundi të përgjigjej:

— Vërinë stëngëzën, se është gati të përmbysset, pastaj dal unë.

RRUGËS ANËS LUMIT

Dy gra zbritën nga kamioni te kilometri pesëdhjetë e gjashtë; ato vështruan anëmbanë për ndonjë automjet tjetër, por nuk kishte. Atëherë, si ta kishin bërë me fjalë, u nisën xhadesë që merrte përpjetë, me shpresë se gjatë rrugës do t'i arrinte ndonjë makinë nga ato që mbartnin çimento dhe hekur.

Të dy gratë nuk njiheshin fare me njëra-tjetrën. E para ishte nënë Nafija, një fshatare që kthehej nga qyteti me një trastë në krah. Ishte afër të gjashtëdhjetave, po s'dukej aq. Kishte një si shqetësim mbi ballë, sepse me lëvizje të befta vinte do-

rën te syzet, i ndreqte, i fërkonte, i shtynte pas ballit.

Tjetra, nënë Sofija nga qyteti, nja pesëdhjetë e pesë vjeçe, me flokë gjysmë të thinjur, kishte një fytyrë të hequr dhe në të folur dukej që ishte tepër nervoze. Ajo kishte veshur një fustan të zi dhe mbante një çantë të vjetër meshini nga ato që mbahen nën sjetull. Çanta e kishte humbur ngjyrën që pati pasur në të ri të vet, ishte kruar e brejtur te qoshezat. Në kopsitje, çanta kishte dy këndesa prej hekuri që ishin fërkuar e ngrënë fort e, sa herë hapej e mbyllej ajo, të dy këndesat sikur ngucnin njëri-tjetrin dhe lëshonin atë zhurmën metalike që ka hekuri kur kafshohet.

— Për në Zelan, moj motër? — e pyeti Sofija nënë Nafijen.

— Prej andej jam.

— E bëjmë bashkë këtë rrugë?

— Me gjithë qejf, — ia ktheu nëna fshatare, — duket që nuk jeni nga këto anë.

— E, ashtu, jam nga qyteti.

— E shoh.

Nënë Nafija e vështroi nga koka te këmbët dhe e kuptoi që shoqja e saj e rrugës kishte një shqetësim. Ajo ia pa sytë tepër të menduar, e hetoi që orë e çast hapte e mbyllte çantën, merrte që andej shaminë, fshinte djersët, sytë, faqet e hequra dhe përsëri e fuste shaminë në vend.

— Ç'fëmijë keni?

— Kam gjashtë djem, — tha Nafija, — të martuar e me nga një karvan fëmijë.

— Të të rrojnë, po vajza nuk ke?

— Meqë kam gjashtë djem, domosdo kam edhe gjashtë vajza, po ti?

Sofija vuri re të folurën krenare të gruas nga fshati dhe iu duk si një grua mashkullore, që është tepër e shkathët nga goja.

— Unë kam tre djem e dy vajza.

— Të të rrojnë e me nder!

— Më rrofsh edhe ti. Kishe ditë në qytet?

— Ja, ashtu... nja dy javë, isha në dasmën e një mbese e, një rrugë e dy punë, mora edhe një palë gjyzlykë, si më shihni, më ishte turbulluar syri...

— Ti mbash me shëndet... ishe edhe në dasmë domethënë, të të trashëgohet!

— Të falem nderit, gaz paç!

«Vallë, kush të jetë kjo grua e përse vjen në anët tona?»

Nënë Nafija as e merrte dot me mend e as i binte dot në të. Si për të shtyrë bisëdën më tej, e pyeti:

— Keni ndonjë punë të ngutshme këtej nga ne?

Po, Sofija ia preu shkurt:

— Ashtu kam një hall.

Celi çantën dhe e mbylli në çast. Të dy këndesat e hekurt kafshuan njëri-tjetrin e pastaj heshtje. Zhurma e këmbëve përmbi rrugë, halica të vegjël që rrokulliseshin tatëpjetë, një pluhur i hollë që davaritej pas tyre e asgjë tjetër.

— Mos kenë ndonjë vajzë a djalë mësues në fshatin tonë?

— Jo, jo, — ia ktheu Sofija dhe përsëri e përsëri nisi të merrej me çantën e vet.

Nënë Nafija po habitej. Hodhi edhe një gur të fundit:

— Atëherë, ndofta vini në dyqanin e fshatit tonë?!

Asnjë përgjigje. Kaluan edhe nja njëzet çape, kur Sofija foli:

— Pse?! Keni ndonjë dyqan të madh në fshat?

— E si nuk kemi... tashti beharit vijnë këtu njerëz nga qyteti, shitet mjaltë i mirë.

Por, në vend që biseda të ngrohej, fjala u mek dhe u dëgjuan edhe një herë të dy këndesat e hekurt tek kafshuan njëri-tjetrin.

Kur rruga mban përpjetë, vështirë se mban gjatë edhe biseda. Të dyja gratë ecnin në heshtje, duke dihatur gjithnjë e më fort. Nënë Nafija mendoj se, kur të merrnin tatëpjetën, domosdo edhe biseda do të rridhte vetiu.

Dhe vërtet, kur dolën në majë të qafës dhe u duk fshati kundrejt, nënë Sofija pyeti:

— Ai është Zelani?

— Ai është, s'keni genë herë tjetër?

— Në të ri kam shkuar këtu e po habitem. Unë e mbaj mend një fshat të thatë, me shumë gurë.

Nafijes i erdhi më të djathtë të hapte bisedën:

— Ashtu ka genë vërtet, fshat i thatë, pa ujë, po tashti ka ndërruar, na shkon mbi kokë kanali i madh i liqenit... Uji bëkërka çudira, moj motër.

Sofija i ndali çapet një çast dhe vështroi.

Me emrin e këtij fshati ishte marrë dy vjet me radhë. Tashti ai dukej i mbytur në një gjelbërim të dendur. Trojet dhe livadhet, poshtë nga qyteti, ishin tharë e trokuar me kohë nga vapa, kurse këtu gjelbërimi ishte fare i freskët, ashtu si ndodh kur ujëra të shumta shpërthejnë në një tokë të zhuritur.

— Domëthënë... edhe këto grunjëra kaq të mbara i keni ujitur...

— Jo... gruri nuk ujitet në malësi, por është bërë det nga plehu kimik e nga hundëmadhi.

— Hëndëmadhi!

— Hëëë... kur e fut hundën ai, nuk lëron, por hap hendeqe. Ia shkuli dheut koren dhe vajti e ia nxori gjakun drejt e nga zemra.

— Hë, hë...

Por me gjithë bisedën që rrodhi, Nafija nuk po i binte dot në të: «Ç'është kjo grua e përse vjen në Zelan? Unë e pyes, ajo përgjigjet duke mbyllur cantën...»

Ç'është e drejta, edhe nënë Sofija deshi të hapte bisedë, por vetëm të blinte prej Nafijes dhe jo që ajo të mësonte hallin e saj. Filloi të hapte fjalën duke kërcyer tra më tra e hendek më hendek:

— Paskeni vend të bukur. Më duket sikur atje në mes të fshatit shoh shumë gra të mbledhura... do jenë në çezmë, kërcet muhabeti.

Nënë Nafija mblodhi buzët: «E ç'kërkon të nxjerrë kjo me muhabetet në fshat?»

— A, jo, moj motër, ne nuk kemi çezmë në mes të fshatit.

— Por ti the se keni ujë boll...

— Tashti e kemi marrë ujin shtëpi më shtëpi.

Poshtë një zabeli nënë Nafija sikur u gjallërua më shumë. Treste vështrimin dhe diç murmurinte me vete.

Tej një hendeku u dëgjuan britma fëmijësh:

— Erdhi nëna! Erdhi nëna! Erdhi...

— Ua... nëna me gjyzlykë! Nëna me gjyzlykë...

Nja pesë fëmijë nxorën kryet që pas manaferrave. Të dyja gratë qëndruan. Nënë Nafijen e rrethuan anëmbanë dhe Sofija po habitej: kjo, me atë zë të trashë e me ato sjellje si mashkullorë, nisi të lotonte.

— O, bijtë e mëmës, dale t'ju puth më mirë! Po ju qenkeni më të bukur sesa ju dija unë! — Vështroi nga Sofija: — Shoh më mirë tashti. Këta gjzylykë mbrëmë i mora, i kisha sytë të mjegulluar, tashti... sa mirë shoh... — I hoqi ata dhe nisi të fshinte lotët. Syzet i mbante lart që të mos i përplaseshin pas kokave të fëmijëve. I tha Sofijes:

— Provoji edhe ti...

Nënë Sofijes i erdhi zor t'ia kthente dhe ia mori e i provoi, por i hoqi shpejt, duke shprehur një mospëlqim. Në të vërtetë me syzet ajo vështroi më mirë.

— Merr edhe ti një palë, se janë të mira.

Në vend të përgjigjes Sofija vështroi nga ledhet prej çimentoje që kalonin atje dhe tha me vete:

«Këtu kalokërka lumi i ri...»

U ulën për t'u çlodhur. Më i rrituri i fëmijëve kishte mbledhur një vandak bar për lepujt dhe e lëshoi përtokë. Të dyja gratë e morën në mes barin dhe Nafija mbështeti krahun në të. Sofija lëshoi çantën, po pastaj u pendua dhe e hoqi shpejt. Ajo vetëm e shihte barin e njomë, por nuk deshi ta prekte. Një ndjenjë e çuditshme e mbante larg tij.

Nafija hapi torbën dhe u ndau fëmijëve karamelë, maja pene, lapsa. Më i madhi tha:

— Nënë, unë gjeta një fole harabeli!

— Mos e prishe?

— Jo, nënë, jo, kishte brenda pesë gollogushë... Po përse, o nënë, ai harabeli e bën folenë në brimat që hap qukapiku?

— Së atje i pëlqen, biro.

Nënë Sofija e hapi dhe e mbylli aq shpejt çantën, sa të dy këndësat e hekurt gërvishtën me shumë inat njëri-tjetrin.

— Nënë, — foli një fëmijë tjetër, — unë do marr çiften e babaplakut dhe do ta rrëzoj atë folenë e sqifterit.

— Po pse, o t'u bëftë nëna...

— Se ai sqifteri, nënë, prishi një fole gushkuqi. Në i thirrëm hya e hya, por ai të tijën.

Kur iu afruan fshatit, më në fund Sofija e hapi gojën. Ajo e dinte se, sapo të pyeste për shtëpinë e Shabanit, gruaja nga fshati do t'i binte në të brengës së saj. Prandaj e shtyu me qëllim gjer në hyrje të Zelanit.

— Tashti do ndahemi, moj motër, por, meqenëse u njohëm, do më japësh një nga këta fëmijët të më çojë gjer te shtëpia e një Shaban... Shaban Krastës.

Nafijes iu hapën e iu hapën sytë brenda rrathëve ngjyrë gështenjë të syzeve të reja. Brengën që kishte Sofija e dinte gjithë Zelani.

— Po ti sonte do mbetesh në fshatin tonë, apo do ikësh? Unë s'e di si e ke pënë, por të pres të më vish, ja ku e kam shtëpinë...

Nënë Sofija nuk e shihte në sy.

— Në qoftë se do mbetem, do vij dhe ta dish, se ti je vetë nënë dhe më kupton, do të ta qaj hallin... djali ka dy javë që më ka ikur nga shtëpia...

Shaban Krasta, burrë rija pesëdhjetë e ca vjeç, i fortë e njeri i shtruar, punonte asaj dite në barazinë e lëqenit. Me dy shokë ai ngulte në tokë ca qysqia çeliku duke hapur brima. Qysqitë nguleshin përgjysmë në dhë, po Shabani në një kohë s'e kishte mendjen dhe vijonte të qëllonte më duf. Qysqia e tij

po ngulej e tëra në tokë e ai s'e shihte këtë. Një shok i tij i foli:

— Shaban, ore, ç'po bën ashtu?

Vetëm atëherë Shabani vuri re. Ishte vërtet i lodhur e s'e ndiente. Lëshoi varenë përtokë e ngriti duart si për të fshirë djersët. Duart e tij të ashpra i kaloi me ngut disa herë mbi fytyrë jo sikur të fshinte djersët, por sikur i kishte të dyja pëllëmbët të bashkuara e të mbushura me ujë. Sikur lante fytyrën dhe e fërkonte fort...

Ai e kishte brengën në shtëpi. Vajza e tij e vogël pati lidhur fjalën me një djalë qyteti që kreu në Zelan shërbimin ushtarak. Djali ishte i mirë. Kur mbaroi shërbimin, u mbërthye keqas me nënën. Në në Sofija nuk e pranonte martesën e të birit. Shabanit iu prish qetësia dhe i hipi në kokë merak për fatin e Donikës. Vajza e deshi fort atë djalë dhe ai vinte e vinte dendur në fshat, kishte biseduar kaq herë edhe me Shabanin, por ai nuk gjente dot një zgjidhje. Babait i shkante mendja keq, sepse vajza dita-ditës po zbehej dhe nuk e kishte gjallërinë e parë.

Kur djali vinte në Zelan dhe Shabani punonte atje te barazhi, ai i shkante drejt e në shtëpi. Atëherë edhe babai nisej për në shtëpi me një druajtje të çuditshme, me disa mendime të mbrapshta, të cilave kurrë nuk u shpëtonte dot. Nuk hynte si gjithnjë drejt e brenda në shtëpi, por vinte e vinte nëpër oborr duke zhurmuar, duke ndrequr shtratin e pjergullës, ose duke rrëmuar me krepalle fuçitë prej bakeliti, ku vajzat e tij kishin mbjellë fidanë limoni, që dimrit i mbanin brenda në treme.

Por ditën e fundit, atëherë kur atij iu duk se

me atë djalin nga qyteti i kishte gjetur një shteg çështjes, tamam atë ditë dikush e thirri:

— Shaban, o Shaban, një grua, ore, ka ardhur nga qyteti e të kërkon.

Ai e mori me mend që do të ishte nëna e Gjer-gjit.

E la punën dhe, duke fshirë në xhaketë duart e djersitura, i doli gruas përpara e i dha dorën me njerëzi, duke e përmbajtur shqetësimin. Ajo i foli ngadalë, sa mezi u dëgjua:

— Desha të bisedoja me ju...

— Ja shtëpia, pesë çape më tej, urdhëro e bisedojmë, — ia ktheu Shabani ngadalë.

Gruaja nuk hodhi çap po foli përsëri:

— Meqenëse e merrni me mend se kush jam dhe jeni edhe vetë prind, më thoni që tashti... ka dy javë që djalin s'e shoh më... këtu është?

— Gjer dhe në drekë këtu ishte.

Ajo nxori frymën me psherëtimë dhe të dy u vunë në rrugë.

Sofija shihte fshatin e panjohur dhe mendohej: «Këtu erdhi im bir mirë e bukur si ushtar, si gjithë shokët, dhe më ngatërrohët për martesë, që të më prishë mua edhe mendjen edhe shtëpinë...»

Kur Shabani shtyu kanatin e madh të portës së shtëpisë, i dha shenjë Sofijes të bënte përpara. Të dy vunë re që Donika nuk i ndjeu fare. Vajza ishte vetëm, mu të çezma e oborrit, duke hedhur faqeve grushtë me ujë.

— Donika!

Ajo u përngrit dhe hapi sytë. Në atë çastin e shkurtër të hutimit, asaj i ngelën pikëla uji në vetullat e holla, në mollëzat e faqeve, sa edhe në kurorën e kaçurrelavë. U drodh gjer në fund të këm-

bëve. Nënë Sofijen e njohu në çast, sepse e kishte parë dikur në qytet, në një festival, kur ia kishte treguar Gjergji.

Sofija e mati vajzën nga koka te këmbët dhe nuk i erdhi mirë që ajo ishte e bukur dhe aq e shkathët. Ajo gati u xhindos kur vuri re në fytyrën e vajzës një shprehje të butë dëlirësie dhe dashurie.

«A, kjo qene, kjo qene, që m'i prishi mendjen djalit! Aaa, qeni, ai qeni, që m'i vuri zjarr kokës dhe shtëpisë!»

Vajza e mirëseardhi, i puthi edhe dorën, po Sofija e tërhoqi shpejt pëllëmbën, u gëlltit dhe vështroi anëmbanë. Oborri ishte i pastër dritë, trema ishte e shtruar me rrasa të lyera rreth e qark me gëlqere të freskët. Nuk ia mernte mendja që në fshat të mbaheshin kaq mirë një shtëpi e një oborr.

Kur shtruan fjalë, Shabani dëgjoi se burri i Sofijes kishte vdekur i nderuar si punëtor rrobagespës, se tashti në shtëpi kishte dy vajza, njëra nëntëmbëdhjetë e tjetra njëzet vjeçe, kishte edhe dy djem të tjerë (ajo e theksoi fjalën «të tjerë»), njëri njëzet e shtatë e tjetri njëzet e nëntë, të gjithë të pamtuar dhe...

«Ky, më i vogli i djemve, kërkon të martohet kur dy nuse i ka në shtëpi për t'i nxjerrë. Zotrote, Shaban, ke të drejtë, vajzën e ke për të martuar, ashtu të bëhet mirë, po, pa më pyet mua, kush do t'u afrohet vajzave të mia kur i vëllai i la në baltë? Si, pastaj, u martoka ky djalë, kur dy më të mëdhenjtë akoma nuk janë fejuar?»

Sofija fliste me nderim e me zjarr dhe e dinte që Donika nuk përgjonte. Për këtë u bind kur dë-

gjoj zhurmenë rrëndë të një avlëmendi që kërciste dikë në shtëpi.

— Punon çupë në avlëmend, dhe siguroi Shabani, ka punën natën, ujitin misrin dhe... gjen kohë dhe end vajzën...

Sofijes nuk i pëlqeu që nga ngjeshja e krehrit të avlëmendit tundeshin gjithë kthinat e shtëpisë.

Ajo kishte qenë vetë endëse dikur dhe e dinte se, që të buçiste shtëpia ashtu, dühëshin krahi të fortë.

— Ky djalë, — vijoi Sofija, — ka bërë lutje të vazhdojë shkollë e por... shkollë dorëbëjë, apo nuse do marrë? Ky djalë më është fare i çakërdisur. Ti,

zoti Shaban, më dëgjon e më kupton. Gjergji është firifiu nga mendtë, s'ekal për gjë që sot të martohet e nesër.

Shabani e dëgjonte gruan nga qyteti dhe bënte çmos që asnjë shqetësim të mos shfaqte. Por më në

fund i mbeti radha të fliste rreth opozitës...

— Të them të drejtën, edhe unë nuk kam dashur që vajza të më iktë larg, sepse edhe unë prind

jam e dua ta kem pranë por... ja, kështu na qenka jeta. Ti e the edhe vetë, vajza është derë e botes...

Ashtu, shoku Shaban, ashtu, çdo gjë me mend në kokë, ti ta martosh vajzën në fshat, ta kesh afër, ti, po deshe e mbledh vajzën tëndë.

— Po dalë, moj e uruar! Ti pse nuk e mbledh djalin?

— Se ai s'më dëgjon... — E ti mendon se mua vajza më dëgjon?

— Ajo është vajzë, ta shtrëngosh, t'ia përsheshesh hundët...

— Aaa, dëgjo, Sofije. Unë, këtu në fshat, jam njeri i punës dhe i nderuar, jam i Partisë dhe triskër e Partisë, në xhep e kam. E Partia nuk na më

son të bëjmë kështu si thua ti. Vajzën e kam të mirë, me djalin tënd u njoh në punë. Ti djalin e ke gjeometër, e lidhi puna në tunelet e malit..

— Tamam, tunele të bukura paskan bërë...

Sofija e tundi çantën si për të bërë fresk, pastaj e çeli, nxori që andej shaminë dhe fshiu ballin e skuqur. Kur mbylli çantën, u tund edhe një herë kthina nga përplasja e krehrit të avlëmendit.

— Edhe unë, Sofije, kam pirë kupa të hidhura, se jam baba. Unë nuk i hyj në hak vajzës, se e kam të mirë e të shtruar, të mençur, vajza s'më ka ndonjë faj. Kam tre djem të pamartuar, një vajzë më të madhe se Donika, të pamartuar, por nuk bëj kështu si ti... Dhe djalin tënd mos e shaj, unë e njoh dhe jo vetëm unë. Ushtar ishte dhe kaq familjeve këtu u bëri planet për shtëpitë. E'nderojnë të gjithë. Edhe oficerët e tij e nderonin. Unë s'u gjej ndonjë të keqe këtyre të dyve, ti, në ke ndonjë hall tjetër, ma thuaj...

— Kam, e pse ta fsheh, shoku Shaban. Ne, në fisin tonë, brez pas brezi, domethënë ju keni disa zakone të tjera, ne ndryshe, ne...

Shabanit i zmadhuan bebëzat e syve dhe padashur i shpëtoi një «bah!».

— Ama, këtu e paske hallin ti? Epo dëgjo, shoqja Sofije, ti vjen e më thua se burri yt i ndjerë ka vdekur si një punëtor i nderuar e pastaj më hap ca defterë të mykur...

— Jo, jo, por gaz i botës unë nuk bëhem. Ti, po deshe, ia gjen melhemin kësaj pune, se e ke çupë...

Ai e ndërpreu:

— Dëgjo, Sofije, dëgjo... Kur unë flas me ty, bëj çmos që të mos nxitohem, dua të jem sa më i drejtë. Nga sa kuptoj unë, ti ke ardhur që t'i ndash

këta dy të rinj. E unë ta them hapur: një ligësi të tillë nuk më mban zemra, ata duhen shumë dhe...

Sofija u lëkund në karrige dhe këndesat e metaltë kërcitën edhe një herë në çantë.

— Dëgjo, në qoftë se ti nuk e mbledh vajzën, unë ta them troç, nuk i qas në shtëpi, le të venë ku të duan...

Shabani hapi anash krahët dhe u gëlltit.

— Dëgjo, moj motër: të përzësh gjakun tënd nga shtëpia, nuk është punë e mirë. Meqë ti ma the troç, edhe unë po ashtu kam për të ta thënë: Në qoftë se ti i përzë dhe ata vijnë këtu, megjithëse jam edhe ca ngushtë, unë s'kam për t'i përzënë.

Nënë Sofija kërcëu përpjetë e u përpelit në karrige. Bëri të çelte çantën, por ajo s'i çelej. Më në fund e tërhoqi me forcë sa e shkuli, e hapi dhe nxori shaminë. Goja i mori për shtrembër sikur e kafshoi grerëza.

— Aaa, këtu e paske qëllimin ti, Shaban, të më rrëmbesh djalin, ta marrësh dhëndër në shtëpi, se të pëlqeu...

— Dale, moj e uruar, si dashkam unë me qejf ta marr në shtëpi djalin tënd, kur kam edhe gjithë këta djem! Mos fol kështu, se bëhesh gaz i botës!

— Turp, turp! — vijonte të thërriste Sofija. — Djali mirë e bukur në mes të qytetit, të vijë në një fshat të...

— Mos, Sofije, mos u rrëmbe kështu. Ne në fshat rrojmë për bukuri. Pale tashti që erdhi lumi...

— Ou... ju të gjithë te lumi e paskeni mendjen.

Ajo u xhindos më keq e më s'e mbante vendi. Deshi të bërtiste, të thërriste, deshi të shpërthente keq e ashpër.

«Ky njeri kërkon të më pëlcasë, ai avlëmendi

që buçet e i tund muret, më tërboi, këta një e dy e të nxjerrin përpara lumin, sikur e shohin dynjanë që nga mesi i lumit...»

Trokitje në portën e jashtme. Donika u sul ta hapte, por i ati i foli:

— Mos e hap!

Vajza u zbraps, rrotulloi njëherë sytë, sikur shihte në pjergullën e oborrit, pastaj, sikur të mos dinte gjë, sikur të mos kishte dëgjuar asgjë, u ngrit në majë të gishtave dhe i përkëdheli me duar veshulët e rëndë... Sofijes i erdhi të pëlciste. Në ato çaste njëri kanat i portës u shty për këtej, tjetri u tërhoq, pastaj, gjithnjë nga jashtë, një dorë e shkathtë u fut midis dy kanateve, e kapi llozin dhe...

Nënë Sofija njohu atje dorën e të birit. Dhe Shabani e shihte atë sikur deshi t'i thoshte:

«E sheh, moj motër Sofije, unë s'po e hap portën, kurse ai e çel vetë...»

Pastaj, edhe pse porta u hap, fytyra e Gjergjit nuk po dukej. Ai kishte hedhur mbi vete një dyshek të ri e të madh dhe me të po hynte në oborrin e shtëpisë.

...në të cilën...

...në të cilën...

...në të cilën...

KUR PIKONIN MOLLET

...në të cilën...

Ja më në fund...

Unë, «studenti plak» i Fakultetit të Agronomisë, po kthehesha në vendlindje!

Them «studenti plak», sepse në institut kështu ma patën ngjitur, ngaqë jam tridhjetë vjeç e shkova në Tiranë nga brazdat e arave.

Ka vetëm gjashtë ditë që mbarova studimet, kurse pardje u botua në shtyp një pjesë nga tema ime e diplomës. Pastaj, intervistë në radio e në televizion.

Në kryeqytet, në tren, në autobus, kaq të njohur, me gazetën në dorë e me gaz në buzë më ndaluan, më uruan dhe më folën me mirëdashje.

Po në fshatin tim, a e kanë lexuar gazetën? Me siguri.

Në kabinën e trenit mbarova së lexuari një studim për bletët. Ishte shkruar bukur! E lexova me një frymë, më rrëmbeu të tërin dhe në disa faqe më kapi frymëzimi; mbyllja sytë për një çast dhe më bëhej se shihja mijëra e mijëra zgjoje bletësh nëpër verandat e nëpër vetullore e kooperativës sonë. Plan më vete ky i bletëve. Pasi të mbaroj ndërmarrjen e ujitjeve, oburra për shtimin e bletëve!

Ishte një ditë e ngrohtë vere dhe dielli e mbyste dhomën me një dritë të gjelbër, ngaqë rrezet e tij kalonin nëpër lastarët e harlisur të pjergullës që, falë kujdesit e krasitjes, kishte shpërthyer dhe ishte bërë zhigër.

Medoemos, në shtëpi, përqafile, puthje e mallëngjime, kurse im gjysh, i rëndë si gjithnjë, i mbështetur në këlcën e vet prej çobani, rënkoi:

— ... e dëgjova ç'kishe shkruar në gazetë... plane të mira, punë të mbara, ujëra për vaditje, bukën në vend, ta bëjmë tokën më pjellore, po... shtëpia jonë ama... shterpë!

Gjyshit nuk i del e keqja. Më thotë: «Shokët e tu kanë nga një karvan fëmijë, kurse ty tashti... s'të marton dot as nëna, as gjyshi, as shtëpia e as fshati i tërë!»

Me time motër, im gjysh i ka punët edhe më keq. Ai shahet se motra shkon shumë nëpër festivalet, nëpër mbremje... Unë e di se motra e gjyshi nuk ia çojnë shumë mirë, po ç't'i bësh!

Që këto marrëdhënie s'janë shumë të ngrohta, e vura re edhe në çastet e para sapo mbërrita. Time motër e gjeta në qoshe të dhomës, te hyrja, duke

furcosur këpucët e të gjithëve, bile edhe të miat, sepse më prisnin.

Tri palë këpucë ishin vendosur drejt me majat nga dera, kurse këpucët e gjyshit, së prapi, me thembrat përpara.

Nëpër gjithë ato fjalë, pyetje e përshëndetje, gjeta kohë e shkova prapa derës dhe i ktheva së mbari edhe këpucët e babaplakut. Ai e kapi këtë, u krekos, po përsëri m'u kthye:

— E, o bir, unë prisja të na ktheheshe vetë i dytë... Më thoshin ca miq se të kishin parë me një çupë në kinema, më thoshin se të kishin parë me tri çupa atje ku lozin top... me dy të tjera në Kamëz... Por... fjalë paskëshin qenë. Prit ndonjë natë kur të na vijë kukuvajka e të na ngrejë folenë majë oxhakut!

Nëpër grinjat e gjyshit e duke përfituar nga veshtë e tij të rënduar, nëna që pastronte xhepat e mi, më foli ngadalë:

— Jot motër mirë i ka punët, por të priste ty. Plaku nuk di gjë. — Dhe duke e ngritur zërin: — E, mirë të thotë babai, more bir, ja... të gjitha nënat u marrin djemve shamitë që nga xhepat për t'i larë, pa u gjejnë atje edhe letra, edhe fotografi çupash, kurse nënëgjora ty të gjen vetëm kartëra me numra...

Në oborr cicëronin zogëzat dhe nëna u hodhi një dorë gëzhuta nga dritarja. Mua më hëngrën duart ngaqë vura re se molla jonë e lashtë, këtë pranverë, nga erërat e forta paskësh pësuar një çapëlim në krye të tringut.

Gjyshi frynte e shfrynte çibukun me sy të tretur tej fushës. U koll e sërish foli:

— Mirë, xhanëm... mirë, po përse kishe shkruar

në gazetë që të mos ngremë «rezervar», po kishe shkruar që t'i futemi Kodrës — Gështenjë e ta gërmojmë, se, vallaha, gjejmë ujë... Rezervuarin e bën shteti, e pse ti...?

Në këto e sipër dikush hyri në oborr e u ndje nëpër shkallë një çap i lehtë dhe i shpejtë. Këto lloj çapesh mua m'i kapi veshi dhe i dalloj aq mirë, pa çka se në Kamëz më thërritnin «studenti plak».

Që nga mesi i shkallës një zë i shkrifur vajzë nisi të fliste e pastaj të këndonte pa të keq.

*Blegërin delja rudë, blegërin,
Tringëllin këmbor' e saj, tringëllin...*

Por... sapo vajza këngëtare u dha te dera e çelur e më pa mua, ngeci atje në prag dhe u bë lulëkuqe në fytyrë, fjala i mbeti në grykë, sytë i xixëlluan, buzët iu flakëruan dhe s'po i mbante dot... Megjithatë foli:

— Ooo, kush na paska ardhur!

U përshëndetëm, e, kur vura re se sa shpejt qeritur kjo vajzë e lagjes sonë, menjëherë m'u kujtua ai bishti që më kishin ngjitur në institut.

— Pa hë, Shpresa, — i fola, — ç'ishte ajo këngë aq gazmore?

Ajo kafshoi buzët, ngriti supet dhe futi duart diku nën gushën e saj, kur... i erdhi në ndihmë ime motër:

— Aaa... ti, vëlla, s'e di! Në festivalin e zonës, Shpresa me këtë këngë zuri vendin e parë!

(Me këto që thuheshin, Shpresa nuk po gjente vend ku të qëndronte, kurse sytë e saj me xixa veinin e vinin sa andej-këndej.)

— Vendin e parë e zuri, po pastaj ç'na gjeti sel Kënga është e bukur, vargu ca më i bukur dhe Shpresa e këndonte duke trokitur dy filxhanë kafeje.. Dhe e rrëmbyen edhe kalamajtë atë këngë, pa u rrëmbyen edhe vetë, merrnin filxhanë kafeje nëpër shtëpitë e këndo e bot rrugëve e arave... Sa filxhanë u thyen, aq të mira qofshin...

Im gjysh edhe një herë u koll rëndë-rëndë e përsëri ma hodhi një xip:

— Moj po kafënë me xhezve do ta pija, filxhan pa thyer të mos më linin, po vetëm të kishte fëmijë edhe shtëpia ime!

— Mbrëmë në dasmë, — e mori fjalën Shpresa, — të gjithë flitnin për diplomën tënde. Ta dëgjuam edhe zërin në radio. Plani i mirë është, të shohim tashti kur të kryhet, ti vetë...

— Me ndihmën e të gjithëve, Shpresa!

— Të them të drejtën, kur lexoja gazetën, s'di sesi më mbështolli një gezim... s'di si të them, kur lexoja emrat e kodrave tona, të arave tona...

— E, ti, Shpresa, ku punon tashti? — e pyeta vajzën.

— Unë?!

Ajo pyeti kështu, sytë iu bënë më të mëdhenj dhe vetullat iu shtrinë edhe një herë më shumë. Në një çast pashë se si iu drodhën buzët, sikur diçka e largët iu kujtua, por m'u përgjigj:

— Gjithnjë në qendrën e zogjve, me shokun zooteknik te koka.

Por unë nuk pata rast ta pyesja Shpresën më shumë. Nuk arrita ta pyesja as për qendrën e zogjve, sepse asaj dite ajo ishte dallëndyshja e parë. Në oborr u dëgjuan shumë zhurma e shumë zëra.

Po vinin njerëz për mirëseardhje. Vajza na la shëndetin, i ra dhomës tejpertej e shkoi te gjyshi ta përshëndeste. M'u bë sikur la diçka nga rinia e saj e bëri përjashta e përcjellë nga ime motër.

— Hë, more bir, çupë për kokë të çupës është. në prag të portës e kemi, si lum kush ta ketë kësmet, — më foli nëna.

Kur, për çudi, më doli krahu babagjyshi që, duke rënkuar mbi këlicën e vet, i tha nënës:

— E ç'flet, moj ti! Yt bir me shkollë të madhe, kjo me një shkollë të fshatit! Unë do të t'i mësoj ty këto? E pse, moj, nuk ia dhe tët bijë çobanit të fshatit, po, kur të trokasim në derë, zë e kapardisesh... «E kam çupën me shkollë, e kam mësuese...» Ky... le të marrë kë të dojë, shkolla e fshatit tonë tridhjetë e ca mësuese ka...

Nëna përsëri u kthye nga unë:

— Atje, në festival, kur këndonte Shpresa, o bir, s'di sesi, po qava me lot e pastaj, ç'është e drejta, s'e ndaja dot cilët ishin më të mëdhenj, sytë e fqinjës Shpresë, apo filxhanët e kafesë!

Në dhomë hynë gjithë ata njerëz. Që nga kryetari i kooperativës e gjer te rojtarët e arave. Kryetari, një trupvigan, veshur gjysmë civil e gjysmë ushtarak, me gazetën në dorë, është gazmend e i kënaqur që në shtypin qendror shkruhej aq mirë e me aq hollësi për tokat tona, për çukat e për përrrenjtë, për sistemin e ujitjes e për pemëtoret tona të dëgjuara. Por ai, si e shoh, e vë theksin dhe brohorit për atë që është shkruar aq: «Prodhimi i mollëve në këtë kooperativë është aq i madh, sa në çdo shtëpi të atdheut tonë kanë hyrë mollë nga këto tonat...»

E, duke ngritur gotën dhe duke uruar, tha:

— Më pëlqeu mbrojtja e diplomës... Janë disa djem që merren me gjëra të vogla: «Si shartohen mollët», ose «Si bëhet gëlqerimi i tokave». Nuk them që këto punë janë fare pa bukë, po... kjo jotja më kënaqi, se i ka rrënjët në tokën e vet. Punë konkrete: «Sistemi i ujitjes në kooperativën e Mbula-kut». Shkova edhe në komitet, po a e di ç'më thamë? «Lëri të kapardisurat me gazetë në dorë. Me të ardhur agronomi, futjuni punës.» Dhe vërtet, babagjysh, — shtoi ai, duke iu kthyer plakut, — s'kemi nge të pimë as ujë, u rrit shumë Shqipëria, edhe fshati ynë. Duhet bukë që të mos varemi nga të tjerët, se, e di, babagjysh, u mbush Evropa e më tutje me ujë, me hambarxhinj e me fajdexhinj...

Plaku mblodhi buzët aq sa bigat e mustaqeve i vështruan përpjetë:

— Mos e tepro de... fajdexhinjve ne ua vumë festen pas kokës!

— Jo, jo, — ia ktheu kryetari, — tashti janë disa më të rrezikshëm, po jo këtu; ata kapardisen Evropës, po nuk të presin ty e mua t'u shkojmë me nga një thes në dorë... Presin t'u shkojnë ambasadorët e ministrat tanë, t'u vënë nga një firmë e pastaj të na rrjepin lëkurën. Më kuptove tashti? Ta kesh hambarin plot, domethënë të mos varesh nga të tjerët.

Plaku tundi kryet, duke dhënë të kuptohet se e mori vesh, po kryetari s'kishte mbaruar:

— U shtuam shumë, babagjysh, sivjet do t'i hedhim shkollës edhe një kat tjetër, fëmijë dynjaja... ngado që të shkosh...

Por edhe një herë plaku rënkoi:

— U mbush fshati plot... po u mbushën shtëpitë e botës ama... se imja mbeti qyqe!

Po kryetari s'i ndahej!
Mos e thuar atë fjalë, babagiysh! E sheh këtë birkon!? Ky do të ta mbushë shtëpinë e oborrit plot me qurrashë, sa të gjesh belanë. Në dasmën e tyre bashkë do ta dredhim vallen.

Plaku ishte kërrusur dhe rrihte çibukun mbi një guackë kungulli, që shkoi e vate e nuk e ndërroi me një taketukë prej qelqi.

Kaluan muaj me punë të ethshme e të rëndë. Nuk më dalin nga mendja fjalët e profesorit të pedagogjisë. Kur mbarova shkollën, ai më hodhi krashur e më tha: «Eja të dalim tashti si shokë dhe të bisedojmë. Nga unë të kujtosh gjithnjë këto që do të të them: «Nëse këto që shkrove për diplomën, mbeten vetëm fjalë, nëse nuk i mbrojt këto me punë atje në vendlindje, nëse fjalët me veprat e tua nuk i gatuan bashkë, atëherë nuk ke mësuar gjë nga skolla. Unë pres shumë nga ti. Pres edhe shkrime që të mbajnë erë djersë fushe, naftë traktori e përvojë jete... Unë pres!»

Gjatë punimeve për sistemin e ujitjes futa duart e këmbët në gëlqere, gdhenda gurë, mbarta hekur, gatova llaç e çimento. Dhe një ditë...

Isha bërë gati të nisesha për në qytet, por ashtu e deshi puna dhe u ktheva prapë te muret e sifonit gjigant, kur... kalon atje Shpresa, ajo fqinja ime, që punon në qendrën e zogjve dhe, pasi na hodhi një «puna mbarë», i foli kryetarit:

— O shoku Rako... atje poshtë e ke kalin me kapistër varur, do ta shkelë e do pengohet...

Unë e hëngra, duke menduar se kali... po m'u

afrua shoku Rako e më tha ngadalë: «E more vesh se si na thumboi ajo vajza e qendrës së zogjve?!»

— Çfarë?

— E ku kam kalë unë, që ta lë me kapistër varur... Ajo e hodhi atë thumb për ty, që ke ardhur në punë me gravatë varur në qafë.

Pleqtë e fshatit vinin radhazi atje ku punohej, shikonin, hidhnin ndonjë fjalë, se nuk u mabushej mendja që uji i sifonit të madh do të ngjitej përpjetë. Por njëri prej tyre më tha diçka që s'kam për ta harruar kurrë: «Dëgjo, biro: Endrra jonë ka qenë gjithnjë që të kishim një ngastër tokë nën ujë. Po nuk e patëm. Se dheu, po t'i ketë damanët të hapur, po të laget, të punohet e të mbushet me lëng, të jep sa të duash. Toka do ujë, sepse: një shoshë me diell në behar, than e trokon një lumë me shi, kurse një lumë me diell në dimër, nuk than dot as një shoshë me shi.»

Një plak tjetër më tha:

— Punëni, djem, se e keni më të lehtë, tashti do li ditoria mbi tokë, atëherë, në kohën tonë, ishte nën dhe. Tashfi ju ndihin mashinat. Se ti nuk e di ç'do të thotë të korrësh grurin me drapër në korrik dhe mbi kokë të kesh aganë e përmbi kokë të kesh diellin si saç... orë, të hapet një vrimë në kurriz sikur atje të kanë futur thikën.

Dhe më në fund puna më e madhe u krye. Sistemi i ujitjes shkoll përpara. Ngeli vetëm gjurmimi i ujërave te Kodra — Gështenjë.

Ishte një ditë e nxehtë shtatori, me një vapë të tillë, që prej veti, pa e pasur mendjen fare, sikur t'i shtyn këmbët tatëpjetë, andej nga ka ndonjë burim uji të ftohtë, ose andej nga vërshojnë ujërat e

lumit, nga lahen rosat e nga fluturojnë patat e bardha.

Nga bredhjet fushave e arave, këpucët e mia as e kanë më shenjën se ç'ngjyrë kanë qenë, pantallonat më janë ndragur me lubrifikant traktorësh, sytë më djegin nga djersa, kyçet e gjunjëve më koloviten, kurse mendja po më biron e zhibiron te Kodra — Gështenjë, atje ku sapo kanë filluar punimet për të gjetur e për t'u hapur rrugë ujërave, që sikur qajnë atje te faqja e pjerrët e kodrës. Ditët po kalojnë, por unë i ndiej thellë e fort edhe orët, edhe çastet; në grykë më nget një nyje, gati të më mbytë. Më djeg dhe më përvëlton në zemër një fakt i hidhur: Nën Kodrën-Gështenjë kemi parcelat me pemëtoret e mollëve. Vapa po shtrëngon dhe mollët po pikojnë rëndom nga mungesa e ujit. Shi nuk duket gjëkund. Duhej të kishim punuar më shpejt këtu. Mollët do na shkojnë për marmelatë.

Kapërceva një hendek, çava një shteg, diku m'u çor njëri sup, një bisk manaferre më rrahu në ballë e një manëz ishte aq e arrirë, sa ndjeva lëngun e saj që më pikoi në njërën faqe. Tre kuaj kullotnin pas lumit duke turfulluar e duke tundur bishtat e tyre si fshesa të murme.

Isha tej, prapa qendrës së zogjve, në atë anë ku në një kthesë të ujërave të lumit është ngritur njëfarë oazi për rritjen e patave dhe të rosave. Nëpër shkurret e nëpër trungjet e plepave u dukën tumbat e trëndafilave zvarritës që mbulojnë nga jashtë rrjetat e telave rrethues.

Brenda në oazi shpesët venë e vijnë, herë zhyten në ujë, pastaj gërgiten e përplasjin krahët. Posh-të, dritë larushe, plepa, xunkth e shelgje anembanë.

Natyra këtu ka një shkëlqim e një qartësi të

habitshme. Herë-herë më duket sikur shoh një kartolinë të ndritshme si xham a si kristal, të mbytur në dritë e në një festë ngjyrash, si një vezullim porcelani.

Fare papritur, te rrënjët e një plepi dallova një vajzë ulur, me kokën mbështetur në trung e me një libër në dorë që... flinte! Hodha edhe dy-tri çape e i dola përballë; unë në këtë anë të oazit, ajo në anën tjetër. E vështrova mirë. Ishte Shpresa, fqinjja ime. Po bënte një gjumë të lehtë e të qetë; flokët i ndritnin si pisë e shkrirë, si duket sapo i kish të larë në ujërat e lumit e pulla të vogla drite i luanin nëpër tëmtha. Lart shamatonin fletët e plepave.

Hodha sytë anëmbanë. Nuk pipëtinte njeri. Fije të gjata shavari lëkundeshin nëpër oaz, ujërat gurgullonin, bisqet e xunkthit vareshin gjithandej, por ajo nuk zgjohej.

Nuk e di se si më erdhi e u përkthila, mora një gur dhe e flakëreva në baz. Ujërat lëshuan një zhurmë të mbytur, u ravijëzuan valëza nëpër faqet e oazit, kurse vajza kërceu e trembur, duke mbledhur gjunjët e duke fshirë me mollëzat e duarve mollëzat e faqeve të spërkatūra me ujë. Ajo sygace (si thoshte Frroku në institut) më vështroi njëherë me mlllef, po përsëri u përmbajt:

— Sa tünzar që je! E pse më zgjove? Isha aq e lodhur nga puna e çudi, po shihja një ëndërr! — Puliti sytë dhe ninëzat e saj zbritën vështrimin në oaz.

— Ëndërr! — u habita unë e s'di se si më erdhi e trokita duart si guak. E ndjeva që e shkëla. E ç'më duhej ta zgjoja nga gjumi vajzën e botës! Po tani nuk dija nga ta misja e nga t'ia mbaja.

— E çfarë ëndrre shihje?

Ajo u mbush më frymë aq fort, sa kraharori i

gufoi e i shtyu më tej, bisqet e xunkthit që i përkëdhelnin edhe gushën.

— Moq më kishe zgjuar...

Picërrova sytë, u zmbrapsa një çap dhe e vështrova me ngulm. Një e folur e tillë...

— Ja, — tha ajo, duke treguar librin, — po lexoja «Bagëti e Bujqësi»-në dhe isha përhumbur e tëra pas vargjeve, pastaj nuk e di se si ngjau e më pati zënë gjumi dhe nuk di se si po shihja një ëndërr. Një ëndërr sikur këtu më patën ardhur Naimi e Çajupi bashkë. Dhe sikur ishin shtruar këtu te ledhi, anës lumit. Ishin të veshur me fustanella të bardha shqiptare e sikur më kërkonin t'u këndoja atë këngën me filxhanë, atë të deles rudë me këmborë bakri. Dhe s'di sesi e unë ua këndova atë këngë, pastaj dhe Naimi u mallëngjyc, sa i rrëshqitën lotët... edhe Çajupi ngriti palat e fustanellës e fshiu sytë e mbushur me lot...

— E më tej? — thashë unë i përhumbur pas ëndrrës së saj.

— Pastaj ti hodhe gurin në lumë dhe gjithçka m'u tret...

Krova qafën me të dyja duart, u përçapa dhe fërkova nofullat sikur të kapërceja diçka. Desha të ndërroja bisedë. I thashë:

— O Shpresa! Një proverb thotë: «Edhe shavari që i ka rrënjët në ujë, nuk rritet, po s'i ra shiu nga sipër». E si ndodh që ky shavari këtu është rritur kaq shumë sivjet, në këtë thatësi?

M'u duk sikur sytë e saj u përpëliten, sikur ajo deshi të përmbante gazin, m'u duk sikur buzët e saj morën diçka nga valëzat e oazit, më vështroi që poshtë lart e më foli:

— Po ti, a nuk e di se, kur bie nata, këtu tek oa-

zi ynë vijnë shtojzovallet?! — Ajo u çua në majë të gishtave, ngriti vetullat më lart e vijoi: — Ato këndonjë në kor e pastaj hedhin valle, në duar kanë stomna me ujë dhe me to ujitin shavarin.

Vura buzën në gaz e m'u duk se edhe mua më erdhi për mbarë ta gërgitja, Ia ktheva:

— Po mirë... po këtyre shtojzovalleve të tua, a nuk u bie pas ndonjë djalë?

— Djalë?! Është një djalë që kalon dendur këtej, por ai është ca marros dhe si i egër i mban xhepat plot me plane e me fletore; me vajza s'përzihet fare; mendon vetëm për qilizmë e për hektarë.

Hë, ç'ma bëri mirë! Për një çast m'u kujtua se ka qenë pikërisht kjo Shpresë tinzare sot, që disa vjet më parë, atëherë kur sapo kishte filluar punën në qendrën e zogjve, e kishte bërë gjithë fshatin të shkulej së qeshuri. Kishte folur në një mbledhje: «Në pularinë ku punoj unë, kemi një mijë e ca pula e njëqind gjela. Kam vënë re se këta gjelat vetëm hanë dhe veze nuk bëjnë fare, propozoj t'i therim...»

Kjo ngjarje m'u kujtua në çast dhe u bëra gati t'ia kujtoja, por, sa hapa gojën, sytë e mi ndeshën të sajët... Duket ajo e kuptoi ç'pata bluar unë në kokë, se mblodhi hundëzën si për qeshje, nxori majën e gjuhës, tërhoqi palën e fustanit nga një gjemb e bëri të ikte.

— Dale! Dale! — i bërtita unë. — Pse nxito-hesh. Unë e kam pyetjen fare serioze: Si ndodh kjo rritje shavari në këtë thatësi?

Nëpër grykën e lumit, fryu era, trazoi fletët shamatore e bisqet e xunkthit, lëvizi manaferrat lozonjare e plot me vile, u fishkëlloi në petale luleve fillikate që nusëronin nëpër gjirret, e shkurre-

vë e iu derdh oazit. Kapërceva lumin e iu afrova:
— Ç'është e mirë! Kjo aromë të përtërin gjakun
ndër deje e ta bën të të gumëzhijë si musht.

— Këtë mall e ke sjellë nga kryeqyteti, shoku
agronom. Po sivjet në pranverë unë punova ca di-
të për të kthyer barin dhe... po të kisha vdekur,
s'do ta dija...

— Hë?

— Dëgjomë mua, shoku agronom. Veçse, me
të treguar, s'kupton gjë, prandaj shko e provoje
vetë. Kosit sot një livadh me tërfil e lëre diellin
t'i japë një faqe, lëre edhe asaj nate ta mbyhtë ve-
sa dhe shkoji të nesërmen në mëngjes me sforcë në
dorë për ta kthyer... Një erëëë! Një aromëëë! Ç'të
të them! Po s'u çmende kësaj dite, s'ke për t'u
çmendur kurrë ndonjëherë!

Dhe befaz, duke vështruar diku larg, nga dë-
gjohej një zë vajze që e thërriste, ajo më tha:

— Nuk më thua, shoku agronom, kur do ke-
mi nderin edhe ne rinia e qendrës së zogjve të
vijmë atje tek aksioni i Kodrës-Gështenjë?!

M'u duk sikur ajo i mëshoi fjalës «ne» si për
të më gërgitur.

Isha gati të nisesha, kur që nga ferrat lart do-
li një injeri me xhakëtën hedhur supeve e me zha-
lonin varur në një anë. Ishte njëri nga brigadierët
e arave, djalë i ri, i gjatë si hosten e nga goja
brisk. Një ta parë, Shpresa më foli ngadalë:

— Ky po, ky i ndjek shtojzovallet edhe ditën,
edhe natën!

Duke u afruar, brigadieri hodhi një: «Tungjat-
jeta, shoku agronom. Si je, moj shoqja e qendrës
së zogjve... Mos jam i tepërt këtu?!»

— Jo, more, ulu po deshe, — i foli vetë.

Ai gëroi gurmazin e na shihte me djallëzi me sytë gjysmë të mbyllur.

— E... ku e kishit fjalën?

— Flitnim për sistemin e ujitjes, — tha Shpresa, — për aksionin e rinisë...

— Aaa... — ia bëri brigadieri, — të flasësh për aksionet e rinisë, gjë e bukur fort... — (Toni i tij ishte tallës).

Shpresa mori zjarr dhe iu vërvit:

— Ti mos më zbardh dhëmbët ashtu, se ta marr atë zhalon dhe ta përplas pas kokës!

Brigadieri bëri sikur s'dëgjoi gjë, po zuri të fërkonte gushën, pastaj buzët, gjithnjë me një nënqeshje tinzare e të shtirur. Veçse vajza nuk i ndahej:

— Ik, morë tutkun, ke sy e faqe të tallësh e të hedhësh xipa ti. Të isha unë kryetare kooperative, ty s'të jepja të kullotje as derrat e jo të të jepja zhalon në duar... I pacipë... me surratin tënd kërkon të tallësh ti...

Siç dukej, ata do të kishin llogari të vjetra, po brigadieri nuk u përfyt me vajzën dhe m'u kthye mua:

— E pse, ti, shoku agronom, nuk e lë shtetin ta ngrëjë rezervuarin sipas planit, po na dole me plane të tjera? Unë s'ha kashtë, ore, dhe ma merr mendja se krejt puna do të përmbysset atje te Kodra-Gështenjë. Ajo që ke shkruar ti (ai nxori gazetën nga xhepi), tingëlloñ më shumë si një përrallë. Ja, ta lexojmë: «Pleqtë tregojnë se dikur këtu ka qenë një qezmë me tre sulinarë, po tërmeti katastrofik i vitit 1908, që, sipas të dhënave sizmologjike, ka qenë dhjetë ballë sipas shkallës Merkali...» Këto, or shoku agronom, janë përralla...

— Mësohu të flasësh, — ndërhyri vajza, — ti nuk ke respekt për punën e tjetrit.

— Unë kam vërejtjet e mia, — tha brigadieri, — pastaj, le të përgjigjet vetë agronomi. Ç'ke ti që... Jo, fol, xhanëm, së, në fund të fundit, shqëria kështu e ka.

Nuk desha që biseda të merrte spicë dhe ndërhyra:

— Ti, brigadier, nuk ke shpresë, kursë unë kam shpresë.

Sytë e brigadierit qeshën përsëri me djallëzi.

— Mirë, xhanëm, mirë, po... shpresa është shpresë...

Sidesha ti hyja sherrit dhe hodha xhakëtën në sup e u nisa. Por edhe se ika unë, sherri atje u rrez me keq. Dëgjova brigadierin që thoshte:

— Një bisedë aq e ngrohtë... nuk ishte për sistemin e ujitjes.

E për çfarë ta marr mendja ty?!

— Dëgjomë mua, moj budallaqë, ai është agronom me shkollë të madhe, ai nuk është për dhembin tend, ti shih shokët e tu...

— Ik, ore cipëplatur, unë s'dua të të shoh as sytë!

— Moj po, dëgjomë mua ti, unë nuk kam llafë, të dua dhe të marr që sot. Ti dëmë shakatë, që këtu e në gjendjen civile..

* * *

Kurrë ndonjëherë në jetën time s'e kam parë veten më ngushtë se sot.

U bënë dhjetë ditë pëhime te Kodra-Gështenjë. U shpua një tunel i tërë. Njerëzit punuan mjaft, por

ajo që i dha zjarr hyrjes thellë në tokë, që ditën e fundit, kur nja njëgind e ca të rinj e të reja zëvendësuan punëtorët që ishin me ditë pune dhe i hynë kodrës me vrull.

Por këtu që gjithë e keqja. Dalngadalë këngët pushuan, balta nëpër tokë u zhduk fare, çerkat e ujit, si bulëza vese, një e nga një nisën të rrallo-heshin, shenjë uji nuk dukej gjëkund dhe, kur tuneli u zgjat sa kishte rrezik për ndonjë shembje, krisi furtuna.

Dola kryeulur te gryka e tunelit, goja m'u bë e hidhur fërmak dhe e ndjeva me të gjithë qenien se kisha dështuar. Duart nisën të më dridheshin e, sikur të mos ishte mjaft gjendja ime e brendshme, nga mbrapa dëgjoja zëra të tillë, që më shtynin të futesha thellë e më thellë në grykën e zezë të tokës që çelëm dhe të mos dilja më andej.

Djem e vajza, të mërzitur e duke pëshpëritur, nisën të pastronin kazmat e lopatat, kur ai brigadier i arave e tha troç:

— U mbars mali e polli një mi!

— Kot e gjithë kjo punë, — u hodh e tha një tjetër.

— Dhe për këtë u shkrua edhe në shtypin qendror, — vijoi brigadieri, — prisnim të nxirrnim ujë, kurse bëmë një vërë në ujë! Po demosdo, kur del ndonjë i mençëm dhe i bie së mirës me shqelma! Shteti këtu do të ngrinte një rezervuar, kurse ne...

Edhe im gjysh kishte ardhur atje e ishte bërë pikë e vrër; kruante me inat mjekrën dhe përplaste këmbët në truallin e kodrës. Pastaj dëgjova zërimin e Shqipërisë:

— Të bëjmë gërmime më tutje, të provojmë...
Por menjëherë i kërceu brigadieri i arave, ai gjatoja:

— Jo, xhanëm! Të bëni prova ju dhe të thyejmë krahët ne, ë! Qenkeni të mençëm... Ore, desh u përmbys tuneli atje, desh na kapi të gjallë. Turp, për besë, gënjyem gjithë vendin.

— Po Shpresa nuk iu nda. E pashë kur iu afrua dhe i tha:

— Gjithë këtë zhurmë ti nuk e bën për punën. Turp, të kesh!

— Ashtu?! — bëri brigadieri. — E kush duhet të ketë turp këtu? Unë që shoh gjithnjë punën apo ti? Oj po, vazhdo, jepi, po ta dish, ama, ti do t'i hash edhe qepët edhe shkopinjtë! Ty do të ta varin këmborën, ai...

Vajza u nxeh, bëri një lëvizje të dorës, sikur deshi t'i thoshte «nuk dua të merrem me ty» dhe bëri më tej.

Me një gjendje shpirtërore të turbulluar, kokulur, zbrita kodrës tatëpjetë e mora rrugën tutje, në një fshat nja katër orë larg, ku një shoku im punon si inxhinier ujërash. Duke ecur, mendohesha:

«Kur gatita mbrojtjen e diplomës, studiova dhe shfletova boll për dinamikën dhe lëvizjen e ujërave nën tokë. Atje pashë raste të shumta. Kur tërmeti zhvendos shtresa nëntokësore shumë poshtë sipërfaqes, atëherë ai ka prishur atë farë kanali natyror, gjatë të cilit ngjitet uji lart. Po, kur tërmeti ka zhvendosur shtresën e sipërfaqes së tokës, atëherë ujin mund ta përfitojmë përsëri. Dhe në rastin tonë ka luajtur sipërfaqja e tokës, dhe kjo dallohet në disa shkarëzime dheu, që njihen edhe sot atje rreth e qark... E mirë, po ne gërmuam sa

për një shtresë tokë... pse nuk u duk uji? Po sikur bashkë me këtë shtresë të sipërfaqshme të kë-në luajtur edhe shtresa më poshtë? Gjeologët ve-të i aprovuan punimet pasi bënë rilevimin. Dregi e merr vesh këtë punë!»

Kur mbërrita në fshatin e shokut, atë nuk e gjeta aty. I lashë fjalë të vinte tek unë dhe u nisa sërish për në fshatin tim. Rrugës përsëri më sul-muan mendimet dhe hamendjet:

«Të mbërrij në fshat natën, që të mos më shohë njeri. Të shkoj edhe një herë drejt e të tu-neli, ndofta uji ka dhënë ndonjë shenjë.»

Po shpresat e mia ishin të kota. Kur u afrova te tuneli, ai m'u duk si ndonjë qivur i zi. Vinte era myk. Dola nëpër kodër. Ishte natë e thellë, kaluar mesnata. Natë vjeshte.

Tashti nën këmbët e kodrës shtrihet krejt fu-shëza me pemëtoret. Degët e mollëve uturojnë në-për errësirë dhe aroma përhapet anembanë. Dihat dhe nuk e kuptoj dot se si përzihen gjithë ato ku-ndërmime. Por pasta j fryu era pas toke dhe erdhi tek unë era e tharë e tunelit fatzi. Te një drizë një fërfëllimë, një degë u shkund, ishte prej dë-llinjë, u kërrusa dhe dallova një goxha künel, që brënte atje bari qetë-qetë. Gjë e zakonit. Kune-lat, që gjithnjë hapin brima, ikin nga fshati dhe i biën fushës për bar të njomë. E kapë, e afrova pas vetes duke e mbajtur peshë nga veshët dhe ashtu u shtriva mbi bar. Küneli u bind dhe vijoi të brënte bar nëpër duart e mia.

Ndeza cigaren dhe futa kokën drizave e nëpër bar, i shtrirë me bërrylat ngulur pas toke e duart pas nofullave. Te veshi dëgjoja künelin endacak që gërziste.

«Po. Ky ia del hap tunelin dhe ikën nëpër fushë si ia do qejfi. Unë... hapa tunelin dhe ngela me gisht në gojë».

Nga tymosja ime kuneli nganjëherë tështinte dhe tundte veshët me inat.

«Po vallë ç'bëjnë tashti në shtëpi? Kam ikur që në mesditë dhe kaloi mesnata. Më presin? Më kërkojnë?»

Hodha sytë anembanë. Fshati flinte prapa kodrës. Por në mes të fushës qendra e zogjve, me të tri katet e saj, dukej si një vapor plot me drita në mes të detit. Një motoçikletë doli nga fshati dhe mori xhadenë. Dallova, dritën e saj të fortë. Disa traktorë nisën të gulçonin diku pas kodrave. Nëpër fushë nisën të dukeshin drita fenerësh.

«Janë punëtorët e ujitjes që nxitojnë të kapin radhën e ujit. Nxitojnë arave dhe i tundin fenerët si t'i kenë rake-trake.»

Papritur, në mendje m'u shfaqën vijat e fytyrës së Shpresës. Ishte ajo që më doli kraih këtu te gryka e zezë e tunelit. Ajo punon në qendrën e zogjve, por në këtë orë nuk është atje.

«Po sikur t'i shkoja në shtëpi dhe t'i trokitja në dritare? Jo, për gjë tjetër por... vetëm sa të shkëmbeja disa fjalë. Ta pyesja çfarë u tha e çfarë u bë kur ika unë... Sa i marrë që jam, e përse këto mendime?! E si do të vete t'i trokas në dritare?»

Ndeza një cigare tjetër. Që nga kreu i kodrës matanë shkau përketej drita e një feneri. Njeriu që e mbante atë, nxitehej tepër dhe nuk e di përse m'u duk sikur ai kalonte jo gjatë rrugës, por nëpër kanalën e ujitjes.

«Mbase është ndonjë nga rojtarët e pemëtoreve. Ku ta dish!»

Po feneri nuk mori rrugën drejt parcelës së mollëve. Ai, duke u tundur e lëkundur, kaloi me zigzage dhe më së fundi nisi të ngjitej përkëtej. Pastaj u kalamend nëpër mollët, atje poshtë...

«Mbase është ndonjë udhëtar që merr ndonjë kokërr mollë për udhë, mbase është ndonjë plak që vete në mal për dru, mund të jetë edhe ndonjë traktorist që çan nëpër pemëtoret e thotë me vete: «Rrofsh e qofsh, o shoku agronom, që na e mbase truallin plot me mollë». Por ja që feneri u vu sërish në rrugë dhe mori përpjetë.

Atje lart yjet xixëllonin në kupën më të largët të qiellit. Bulkthit lëshonin cfilmat e tyre të zakonta, këndesët e qendrës së zogjve ia buçitën në kor, pastaj një frymëmarrje e nxituar njeriu, një siltetë lavrake dhe... nuk desha t'u besoja syve. Me hapa të nxituar, drejt grykës së tunelit, po vinte Shpresa. Bëra ta mbuloja me dorë majën e ndezur të cigares, kur u dëgjua zëri i saj:

— E pse fshihesh? Unë e di që ti je atje, pastaj ti ndonjë turp nuk kë bërë!

— Ti, Shpresa, je?

— Unë jam këtu!

— E ç'erë të fryu këtej?

— Erdha për ty!

— E dije që jam këtu?

— Dukej gulshi i ndezur i cigares, xixëllonte si

farë!

(Interesant kjo vajzë, gjithnjë flet me nëntekst,

si duket ashtu e ka zakon).

M'u afrua, po nuk ma dha dorën. Dëgjova që

përtokë po lëshonte disa kokrra mollë.

— Merri dhe haji, s'do të kesh vënë gjë në

gojë, janë të ëmbla.

— Jo, nuk dua, e kam gojën të hidhur.
— Në shtëpi të janë bërë merak, shokët po të kërkojnë nga mali...

— Më kërkojnë?

— Pse, shaka të duket? U zhduke e s'le asnjë fjalë. Veç unë e dija që je këtu.

— E si mund ta dije?

— Ja, ashtu kot, e dija...

— U ul gjunjazi kundrejt meje dhe unë, ashtu si isha shtrirë, nëpër dredhat e kaçurrelave të saj shihja disa copa qielli të mugët.

— Pas ngjarjes së djeshme, gjithë fshati atë bisedë ka.

— E marr me mend.

— Po jepte agimi. Fasha të holla drite nisën të lëshoheshin tatëpjetë nga qielli. Janë ato çaste kur zë e tretët nata, kur erërat e holla të fushës çajnë nëpër gjethe e nëpër drurë, janë çastet kur aromat e barit bashkohen me avujt e tokës e të vesës e ashtu ta prishin mendjen fare.

Tashti që po hapej dita, unë munda të shihja ngjyrat dhe nuancat e holla në fytyrën e saj. Pas-taj sytë e mi nisën të dallonin një për një ngjyrat e bukura, të ëmbla e ledhatare të mollëve karapash-ka. Molla më e ëmbël, molla më e bukur, më e shij-shme, Karapashka e pashoqe, ajo e mbushura me lëng, që lëshon vaj mbi cipëzën e vet.

Tashti nuk po e gjeja dot se cilat nuanca ngjyrash ishin të përbashkëta te gusha e te faqet e saj dhe te cipëza bardhekuqe e karapashkave... Sikur këtë mendim që më shkrepri befas në kokë t'ia tho-sha asaj, me siguri që do të ngrihej e do të ikte me inat.

— Çfarë thoshin në fshat?

— Unë pyeta tim gjysh, dhe ai, si më dëgjoi, më tha: «Kur u nisët të iknit, a u shtri ndonjëri prej jush dhe t'i vinte veshin tokës? Shko ti, bjer vetë, po të ketë ujë atje poshtë, do të gurgullojë.

— Dhe ti, Shpresa, prandaj erdhe tashti?

— Jo, jo. Unë erdha që në mbrëmje njëherë.

— Dhe...

— U shtriva dhe vura veshin përtokë.

— E ke bërë ti këtë? Dhe çfarë ndjeve?

— Toka atje poshtë lëshon disa zhurma të çuditshme. Por kam edhe diçka tjetër. Atje në brigadat e arave, një shoqja ime sapo u kthye nga aksioni i hekurudhës. Ajo na tregoi se në Qafë-thanë, diku përmbi fshatin Urakë, punimet në një tunel për një kohë shkuan mirë, po pastaj... vullnetarëve minatorë u doli një shkëmb i fortë shumë. Dhe këtij shkëmbi i vunë dinamit. Pas plasjes u duk që ai kishte qenë si ajo tapa që mban mbyllur një shishe me ujë. Atje kishte shpërthyer një lumë i tërë. Gjithë udhëtarët që shkojnë për në Përrenjas e kanë parë.

Nuk e di se si u ndodha drejt e më këmbë. Sytë më venin e vinin drejt e vëngër, sa andej-këndej.

— Shpresa!

«Si nuk më shkoj ndër mend kjo?»
Por tashti s'po e ndieja veten të pagjumë, as po më shkonte ndër mend se pata qenë i lodhur. Një ndjenjë e thellë, e ëmbël e ledhatare po më përfshinte të tërin. Ja edhe dielli madhështor dhe i kuq që tej nga malet nxori vetullën e tij të përflakur. Ula sytë përdhe, gjithnjë duke menduar për ato që sapo dëgjova. Feneri i Shpresës ishte gjithnjë i ndezur, por përpara diellit gjuhëza e tij bar-

dhoshe as që vihej re fare. Vajza po më tregonte mollët.

— Ha diçka se...

Më duhej ta dëgjoja. U ula në gjunjë dhe nisa të ngulja dhëmbët në mishin e mollëve. Goja m'u mbush me lëng të ëmbël. Nuk dija ç'të bëja se lëvizjet e mia ishin të befasishme. Isha si në ethe, por edhe kunelin nuk desha ta lija mënjanë. Në një rën dorë mollën e me tjetrën përkëdhelja lepurin e butë. E dija se sytë e vajzës po më shpoinin në zverk.

— Mbetë duke përkëdhelur lepurin.

Vetëm kaq tha Shpresa e... kur ngrita kryet, ajo ishte nisur për të ikur. Unë pashë këmbët e saj nëpër barin e lagur të kodrës. Dhe ato këmbë ishin të praruara me bulëza vese që po luanin nëpër mijëra e mijëra cikërrima ylberesh.

E thirra me emër me një zë që m'u duk sikur nuk ishte imi, dhe ajo, duke mbajtur këmbët, ma ktheu:

— Sot më pret një punë e madhe, zogëzat e pranverës u rritën dhe do t'i kalojmë në oborrin e madh.

E vështrova mirë. Dukej tepër e turbulluar, sepse edhe fenerin e harroi aty. Dhe përmbi xhamin e fenerit unë dalloja gjithnjë flakën bardhoshe që mezi dukej nga drita e diellit që po ngrihej lart.

Por sikisha as kohë e as kokë e mend që të merrsha tashti me atë flakë vogëlushe.

U ngrita. Aty afër kisha një dru ahu nja dhjetë pashë i lartë. Ah i ri, i bukur, plot me pulla të bardha. Afër tij ishte një pjergull, me një trup lavrak e të lidhur. Ishte aq e hedhur, e bukur dhe

e fortë, sa i qe vërsulur ahut që ta pushtonte jo për t'u mbështetur në të, po për ta rrëzuar në tokë, aq shumë vile me rrush kishte.

* * *

Kur po gatitesha e kur po rrëmbeja dinamitin, pas m'u lëshua edhe im gjysh. Me t'i treguar, edhe ai nisi të nxitonte. Kur iu afruam kodrës dhe hymë në tunel, u kujtova se nuk kishim patentë për shpërthime dinamitesh. Atëherë i thashë plakut të thërriste ndonjë oficer, por ai, me të dëgjuar, bëri një gjest përbuzës ndaj meje dhe s'ma vari fare.

— Rrri, ore, atje, — m'u shkreh, — patentë kam vetë! — dhe rrahu me pëllëmbë koburen që mbante në brez.

Të gjitha veprimet i bëja shpejt e shpejt, por ndieja një të ngjethur që më kalonte nëpër gjithë shpinën e gjer në fund të këmbëve.

«Vallë ç'do të dalë? Po sikur edhe këtë herë të mos bëj gjë? Pastaj?»

Unë i mora masat që të veproja vetëm dhe pa marrë vesh njeri. Më në fund i vumë zjarr fitilit. Rendëm tatëpjetë dhe u strukëm në fund të përroit. Duart s'i përmbaja dot dhe ndieja zemrën që më dridhej e më rrihte aq shpejt, sa kurrë ndo-njëherë. Por ja edhe shpërthimi. Toka u drodh. Gjëmimi u ndje tejendanë. Erë baruti dhe leckë të djegur.

U vërsulëm përpjetë.

Një masë e paparë ujërash të turbullta na u vërsul nëpër këmbë. Mua po më dridhej edhe cipa e barkut.

Babagyshi diçka po më fliste, por nuk e dë-

gjoja. Nuk dija se ç'bëja, ulesha e ngrihesha, gjer-
sa e ndjeva se isha bërë qull i tëri. Pastaj u lësho-
va në një vrap të marrë.

Këmbët nuk e di se ku më shkelnin po ndjeva
se si dërrmoheshin plisat e thatë të arave. Bisqë
mollësh më rrihnin fytyrën, gushën, zverkun, ba-
llin. Sakaq u ndodha te qendra e zogjve. I dhashë
një shqelm lesës, e hodha tutje dhe u derdha në
oborr. Zogjtë u trembën, disa pula kakarisën e nuk
di se nga fluturuan. Renda nga oborri i tejme, kur
përpara meje shoh Shpresën, me dy zogëza të bar-
dha që i kishte kapur për këmbësh. I mblodhi pak-
sa vetullat e po më shihte duke më gjurmuar sytë,
duke më pyetur, duke...

Unë s'e bëra të gjatë, po u derdha drejt e tek
ajo, ia hodha duart mbi supe, e përfshiva të tërën
në krahët e mi. Një çast e ndjeva se si ajo fërgë-
lloi me supet ngjeshur në kraharorin tim. Pastaj
u ngritën edhe duart e saj dhe unë ndjeva të dy
zogëzat që po përpëliteshin mbi shpinën time e po
cicëronin. Atëherë unë e shtrëngova edhe më fort.
Ajo mbështeti kryet në supin tim, pastaj të dyja
zogëzat bardhoshe ikën duke cicëruar tutje...

COPEZA JETE

L

Isha vetëm dymbëdhjetë vjeç fëmijë atëherë kur nuk ngopesha kurrë as me bukë e as me gjumë. Kisha dëshirë të luaja me cingël a mangëre e të shkoja në shkollë. Ma kishte ënda të bridhja fushave e pyjeve, por... më thanë se shkollën mund ta bëja edhe «me të vjedhur», më thanë se në këtë botë ishte mjaft të njihje paranë, dhe supet e mia të njoma duhej të mbanin shtëpinë tonë të vjetër.

Ishte koha kur djem nga fshati iknin ku sytë këmbët, merrnin rrugët e vendit e të deteve për bukën e gojës. Iknin si krahë pune për kosarë apo loparë, iknin për druvarë e sharrëxhinj, të tjerë

shkonin si kamerierë e çirakë. Por nja dy djem nga fshati im gjetën në Tiranë një punë krejt të re: punonin si tipografë në një ndërtesë të ulët, që kutërbonte erë bojë e katran, ku vërtiteshin ca rrota dhe letra e bardhë kafshohej me përdhunë nga shkronjat metalike. Aty botohej asaj kohe gazeta «Telegraf».

Ja, në një punë të tillë shkova edhe unë. Fqinjti ynë, Shaban Këtri, që ka qenë vëllamë me të ndjerin baba, i tha nënës sime:

— Ma jep mua djalin. Ku kam çunin tim, le të kem dy, disi do t'ia dalim, tim bir e kam lënë atje...

Na u deshën pesë ditë rrugë më këmbë nga fshati ynë gjer në Tiranë. I lodhur, i vrarë, i rras-kapitur, në mbrëmjen e gjashtë...

Në një qoshe të kryeqytetit, në njëfarë hajati në fund të një zdrukthëtarie, ishte një zgavër ku flinin radhazi djem e burra nga fshatrat tona. Atje mund të uleshe shesh ose gjunjazi, po më këmbë nuk mund të qëndroje, sepse ishte e thellë dhe e ulët, plot pluhur druri e kundërmonte aromë të ëmbël pishe e ahu (nga shtresa e trashë e tallashit).

Djalin e Shabanit, që ishte moshatar me mua, nuk e takova dot që asaj nate. Të nesërmen në mëngjes desha medoemos të gjeja shokun tim dhe bashkë me të të rrëmoja e të zbuloja kryeqytetin tonë. Dola herët dhe shkova aty ku më treguan. Nuk ishte më shumë se njëqind çape. Hyra në një kthinë përdhese që s'merrej vesh ç'mund të kishte qenë; mbi kokë më dridhej një qepen teneqeje, i ndryshkur e brima-brima. E ç'të shihje! Shoku im i mjerë flinte si qengj, përmbys dhe për habinë time, me duar e këmbë të lidhura.

S'desha t'u besoja syve dhe u ktheva nga vë-

llami i babait, duke e pyetur më shumë me shprehjen e fytyrës sime.

— E ka zënë zgjebja dreqin, — më tha Shabani, — kruhet ditë e natë dhe ka rrezik ta hedhë për-tokë tërë lëkurën.

Shabani nuk mundi të më gjente punë në shtypshkronjë. Ai bisedoi gjatë e gjerë me të dy shokët e vet nga fshati ynë dhe të nesërmen, që në mëngjes heret, nisa të shitja rrugëve gazetën «Telegraf».

Në krye m'u duk gati e pamundur të rendja rrugëve dhe të bërtitja titullin e gazetës, por, pasi kaluan nja dy orë, më dukej sikur kisha kohë që merresha me atë punë.

Gazeta shitej paradite, kurse pasdite isha i lirë dhe shkoja në Fushën e Shallvares, ku luhej futboll. Kisha luajtur edhe unë në fshat, vetëm se atje luanim me një top të mbushur me lecka. Por puna ime gjysmëditëshe u pre shpejt. Kur erdhi fundi i javës, s'kisha thuarjse asgjë për t'i dërguar nënës në shtëpi. E vrava mendjen, i qava hallin Shabanit dhe që asaj së diele disa djem nga fshati im që punonin marangozë, më gatitën një arkë të vogël, pastaj bleva edhe dy furça e tri kuti bojë dhe çdo pasdite dilja rrugëve duke kërkuar klientë: Llustro! Llustro, zotërinj!

Tashti që nisa të bëja dy punë, isha pak më mirë; në fund të javës së dytë munda t'i dërgoja diçka nënës në fshat.

Kur e ndjeva kënaqësinë se më në fund isha rritur dhe po ndihmoja nënën, m'u ndez dëshira që

të gjeja edhe një punë të tretë. Dëshirën të mirë e kisha, por, kur kthehesha në mbrëmje për të fjetur në kthinën time, e ndieja trupin aq të lodhur e të rraskapitur, më digjnin aq shumë shputat e këmbëve, sa nuk isha në gjendje as të ngrija gishtin. Më flihej, më flihej aq shumë, sa që më dukej ëndërr të kisha kohë të ngopesha me gjumë.

Një muaj pasi kisha filluar punën, më thirri punëdhënësi në korridorin e shtypshkronjës dhefaqe Shabanit më tha:

— Ai djalli që çonte gazetën në pallatin mbretëror, ngatërroi dynjanë aty, paskëtaj do ta çosh ti gazetën në pallat, nga dhjetë kopje çdo mëngjes...

Dalngadalë puna m'u shtua, dalngadalë nisa edhe të mësoja. Çdo mbrëmje, kur shkoja për të fjetur, dëgjoja bisedat e çirakëve e të punëtorëve nga fshatrat tona, që mblidheshin kokë më kokë. Pastaj nisa të lexoja gazetën rresht për rresht, ndonjëherë edhe kopje librash të grirë nga makinat, gjeja edhe fletë të Gazetës Zyrtare, revista e defterë që shtypeshin në shtypshkronjë dhe i lexoja shtyllat një për një: «Taksë për gjënë e gjallë», «taksë për shtëpitë», «taksë për therjen e kafshëve», taksë për «blerje e shitje». Një ditë gjeta edhe një defter, nga i cili mësova se u merrej taksë «për kurorë» gjithë burrave të martuar dhe kjo taksë vilej nga mitropolia apo dhespoti i çdo krahine.

Jetën e bujqve dhe të fshatarëve unë e njihja, se e kisha jetuar vetë në fshat, jetën e punëtorëve e të çirakëve po e shihja ditë e përditë këtu, kurse jetën e sundimtarëve në kryeqytet nisa ta mësoja dhe ta shihja me sytë e mi tek shitja gazetën, tek lustrvoja këpuçët dhe në pallat shihja e dëgjoja ndodhi krejt të papritura e të papërfytyruara kur

shkoja për të çuar dhjetë kopjet e gazetës «Telegraf».

Një ditë në korridor, ndërsa po prisja të dilte gazeta, Shabani po më tregonte disa fashikuj të një libri që shtypej atje brenda. Papritur një njeri i panjohur hyri e, pasi më përshëndeti, pyeti:

— Ku është drejtori i gazetës?

Shabani ia ktheu se në atë orë drejtori edhe s'ishte ngritur nga gjumi.

— Më quajnë Rrok Prizreni, — tha ai, — vij nga Austria, kam ngelur rrugëve pa punë dhe dua të njoftoj me anë të gazetës se jam njeri i shkolluar dhe kërkoj të gjej njëfarë pune...

— Çfarë pune mund të bësh ti? — e pyeti Shabani.

— Kam arsim të lartë, — tha Rroku, — mund të bëj gjithçka, që fëmijë më kanë pasë marrë austriakët e më çuan në Shkodër e në Innsbruk, deshën të më bënin prift. Por unë nuk pranova. Kur më kërcënuan, rrëmbeva valixhen dhe dola në Durrës. Jam përfytur me drejtorin e shkollës, i kam thënë se Shqipëria ka më shumë nevojë për mësues, sesa për priftërinj.

Shabani u mendua një copë herë, pastaj i tha:

— Mirë, or Rrok, mirë, or vëlla, por, sa të merrren vesh këto që thua, do të ta shkruajnë emrin me bojë të kuqe, do të të quajnë mohonjës të fesë, por më mirë ti eja shiko brimën ku banoj unë dhe shokët e mi, eja shih e dëgjo ç'bëhet në mëmë-dheun tonë e pastaj përsëri flasim.

* * *

Ishte mëngjes herët. Bashkë me shitësit e tjerë po prisnim në korridorin e shtypshkronjës. Shabani

hyntë e dilte në sallën e radhitjes. Mua më pëlqente ta kisha gjithnjë afër Shabanin, që për mua, në këtë farë mërgimi, ishte një baba i dytë. Ai ishte një burrë babaxhan, me një fytyrë të gjerë, me një kurorë flokësh të dendur tej mase, aq sa i hynin edhe në pjesën e epërme të ballit e, për t'i përmbledhur, mbante në kokë një copë zemberek çeliku. Shabani kishte njëfarë zbehtësie në fytyrë si edhe fejza të kuqe gjaku në sytë. Këto ishin shenjat e pandara të profesionit të tij, që kishte të bënte gjithnjë me plumbin e shkronjave, me lagështinë e sallës dhe me të gjitha ato kushte të vështira të punës së përditshme.

Papritur hyri në korridor drejtori i gazetës. Ardhja e tij në këtë orë ishte e jashtëzakonshme. Ai ishte bullafiq, me buzë të trasha e të shpërveshura. Dukej që ishte ngritur pa qejf. Na u drejtua neve shitësve:

— Juve, çuna, po ju them... gazeta sot ka një lajm të rrallë. Me të dalë rrugëve, bërtitni: Kryegjyshata botnore në Shqipni!

Ndërsa po fliste drejtori i gazetës, nga salla doli edhe një herë Shabani dhe, duke na e bërë me shenjë, na dha të kuptonim që të mos thërritnim ashtu si na urdhëronte drejtori.

U ndjenë disa zhurma të forta brenda nga makinaria e tipografisë, pastaj thirrje, zhurma, dera u hap dhe doli një punëtor:

— Avari në rrotativë... gazeta del pasdite!
Ne dolëm përjashta.

Kur u ndodha te kreu i rrugës, dikush më thirrri me emër. Ktheva kryet dhe pashë Shabanin, nisur si për shëtitje, dhe në krah të tij një njeri që në fillim nuk e njoha. Kur u afruan edhe më, da-

llova Rrok Prizrenin. Rroku ishte nja njëzet e pesë vjeç, me një fytyrë të kuqe, me një hundë si qip shqiponje, mbante një kostum prej stofi të trashë, me pantallona flluska, siç ishte moda asaj kohe. Edhe valixhen e mbante gjithnjë në dorë. Shabani na udhëhoqi nga kinema «Nacionali», nëpër një rrugicë të ngushtë e të përdredhur dhe qëndruam te një kosaxhi dibran me emrin Basri. Aty Shabani na porositi për të ngrënë. Tashti e kisha fare pranë atë njeri që quhej Rrok, që dukej i tretur në mendime, kurse Shabani shtihej si i shkujdesur. Duke ngrënë, Shabani më tha:

— Pa na trego ti, Lelo, na trego ç'ke parë e dëgjuar kësaj Tirane që asaj dite kur erdhe së pari këtu... Rroku, miku im, ka dëshirë të dëgjojë...

Por, sa fillova unë. Rroku më vështroi thellë në sy, pastaj më vuri gishtin mbi hundë, sikur deshi të ma shtypte miqësisht dhe më pyeti:

— Ke qenë në shkollë?

— Jo, — ia ktheva, — kam mësuar ca me të vjedhur...

Rroku vuri buzën në gaz e më përkëdheli kryet. Unë nisa të tregoja ashtu si mund të tregojë një çunak i papërvojë, duke përsëritur fjalët e duke qenë disi i shqetësuar, ngaqë dy njerëz të rritur më ndiqnin dhe më shihnin në sy. Tregova për pallatin e mbretit, për gjithë ato orgjiira që bëheshin atje dhe që shkonin gojë më gojë nëpër gjithë kryeqytetin.

Në Tiranë Rroku kudo e kishte gjetur portën mbyllur për punë.

Kur biseda po mbaronte. Shabani i tha:

— Dëgjomë mua, Rrok, nisu për në fshatin tonë, hap atje shkollën... Ka për të të mbajtur e pa-

guar vetë fshati, më tutje shohim e bëjmë. Sa për lajmërimin që kërkon të botosh në gazetë, kjo është punë boshe... dëgjomë mua, Rrok!

Më vonë dolëm nëpër Tiranë. Rroku diçka i pëshpëriste Shabanit. Diku në një shesh Shabani qëndroi e tha:

— Ja, këtu kalonte Avniu, që këtej i doli vrasësi dhe shtiu mbi të.

Rroku ngeli në vend dhe shihte anembanë. Iu kujtuan ç'kishte dëgjuar dhe lexuar për Avni Rustemin.

* * *

Kishte rënë nata, kur u ktheva te zdrukthëtaria ku flija. Isha i lodhur dhe i ngjirur nga thirrjet për të shitur gazetën, që asaj dite doli vonë. Atje gjeta gjithë punëtorët që flinin në atë kthinë, gjeta edhe Shabanin e Rrokun. Të gjithë bisedonin me Rrokun dhe shkruanin nga një copë letër për ta çuar në shtëpi.

Shabani, për të mbajtur premtimin që u kishte dhënë djemve në fshat, u kishte blerë një top futboll.

— Zotni Rrok, — foli një djalë marangoz, — shpjere këtë top në fshatin tonë!

— Çoje në fshat topin, — shtoi Shabani, — dhe na i mëso fëmijët mirë, merr edhe një bilbil e, kur të lozin, ti bëhu arbitër...

— Jo, jo, — tha Rroku, — kam për të luajtur edhe vetë.

Nuk e di si shkoi biseda më tej, sepse papritur më kishte kapur gjumi. Isha i lodhur, shumë i lodhur, më digjnin shputat e këmbëve dhe i ndieja gjymty-

rët si të këputura. Por për një çast më doli gjumi dhe më zuri veshi Shabanin që fliste ngadalë. Dritën e kishin shuar.

— ... Për këta Noli thoshte: Kabineti i pykave. Po na mbytin me taksa. Në gazetë sot botohet lajmi «Kryegjyshata botnore në Shqipni». Këtyre «kryegjyshërve» turqit e rinj u vunë drunë, por del tashti mbreti ynë, hallvaxhiu, dhe na i fton në Shqipëri. Me këta merret mbreti ynë, kur ne fuqaraja vuajmë për bukën e gojës...

Pra, ata po shanin mbretin e qeverinë. Mendova se, për të hapur këtë bisedë, punëtorët kishin pritur sa të më zinte gjumi mua. Ishta ende i vogël.

Shabani vijonte të fliste dhe unë rrija strukur e dëgjoja. Përmbi ne banonte një familje. Që andej dëgjohej një lëkundje djepi dhe pastaj një ninanana që shoqëronte trokëllitjen ritmike të djepit në dërrasat e dyshemesë.

* * *

Ishte një ditë e diel. Gazetën e kisha shitur shpejt, kisha lustruar edhe nja dhjetë palë këpuçë, kur te qoshja karshi kosaxhiut Basri pashë një njeri që e njihja. Ishte vëllai i pasunarit dhe kryeplakut të fshatit tonë. Quhej Kukul Qerja. Ishte qose, me faqe si prej plake, të lëmuara e të zeshkëta si eshkë shelgu. Qëndroi dhe filloi të më fliste. Unë e dija historinë e këtij njeriu. Ishte përfytur me të vëllanë në fshat për punën e pasurisë, i kishte zhvatur pjesën e tij, disa qindra napolona ari, dhe i kishte hyrë një ndërmarrije të guximshme. Krejt paret e veta Kukuli i

kishte blerë gjizë në qytetin e krahinës sonë, e kishte futur në bute të mëdha dhe e kishte sjellë në Tiranë për ta shitur. Këtu kishte pritur të vinte dimri që ta shiste si frëngu pulën. Kështu, Kukuli mendonte të trefishonte kamjen e vet. Por habëri kishte kursyer kripën dhe, kur e hapi gjizën, vuri re që ajo kishte zënë disa gjallesa që të kallnin krupën. Edhe këtë mund ta kalonte Kukuli, duke e qeruar gjizën, por e keqja ishte se ajo ishte qelbur, zverdhur e mavijosur... Ja kështu, Kukul Qerja kishte mbetur rrugëve të Tiranës dhe e fitonte bukën duke vjedhur e gënjyer poshtë e përjetë. Unë nuk i afrohesha këtij njeriu, por njëherë ai më joshi në një mënyrë të tillë, sa nuk u përmbajta dot. Më tha:

— Sot është e diel, eja të të çoj në Durrës, ti det s'ke parë, është një hata e madhe, eja të shohësh det...

Unë, pa u menduar shumë e pa pyetur as Shabanin, u nisa me të.

Në mbrëmje arritëm dhe pashë detin. Ai m'u ndeh përpara me krejt bukurinë e kaltërsisë së tij. E lashë, nuk e di se ku, Kukulin dhe vrapova nga porti. Atje kishte vaporë. Njërin, që kishte flamurin e Italisë, po e ngarkonin me lopë e qe. Si mbaroi vargu i tyre, pashë se si po ngisnin drejt barkut të vaporit edhe një kope me kërricë të njomë. Dikush po thoshte:

— Italianët i hanë edhe gomerët.

— Ata duan të na hanë edhe ne, — tha një tjetër.

Pas meje u dha Kukul Qerja që më kapi për supesh.

Dolëm në një rrugë të gjerë. Po habitesha me

Durrësin, me këtë qytet të panjohur, që kishte si kurorë një kështjellë tepër të lashtë. Për një çast më shkoi nëpër mend që ta kisha këtu shtëpinë time, të punoja këtu qoftë edhe si hamall në port dhe të thithja erën e pastër të detit tonë. Po a do të kthehesha edhe një herë këtu? Këto hamendje po më zienin në kokë, kur hymë në një rrugë zigzage.

Kukuli ia nisi:

— Në këtë dynja, or çun, të gjithë vjedhin. Atje në Tiranë ministrat, deputetët e zyrtarët vjedhin, prandaj vjedh edhe unë me shokët e mi. Kjo dynja kështu është kurdisur, vidh të vjedhim, rrëmbe të rrëmbejmë... Sonte do të shkojmë andej nga depot e firmës «Salemi e Tufa». Aty është një penxhere e vogël, mua nuk më nxë, por ti mund të hysh fishek e brënda...

Vështrova në sytë e tij të frikshëm e tinzarë. Pa i thënë asgjë, ia mbatha vrapit. Ai u mundua të më arrinte, por unë rendja më shumë se ai. Në një vend qëndroi dhe më thirri:

— Mirë, atëherë, plaç në vend, këtu ke për të ngordhur!

Por unë isha i vendosur, në ndërmarrjen e Kukulit nuk hyja, sikur të nisesha për Tiranë edhe me këmbë.

Natën e kalova pa vënë gjë në gojë. Atëherë u kujtova se shokët dhe Shabani me siguri më kërkonin. Po më vriste ndërgjegjja dhe i thosha vetes: «Mirë t'u bë, ngordh si qen sonte dhe fli përjashta nëpër kaçubat e Durrësit».

U futa në një rrugicë të ngushtë dhe qëndrova kundrejt një derëze prej hekuri. U mbështeta në të dhe ia mora gjumit, gjersa m'u mpi shpina dhe u zgjova. Në mëngjes vendosa të nisesha. S'ki-

sha hedhur as edhe njëqind çape kur prapë shoh Kukulin. Ishte krejt ndryshe, në vend që të më shante e të më mallkonte, më tha:

— Eja këtej, hajvan, do të nisemi me makinë për në Tiranë, ruaj këtë arkën këtu, sa të kthehem unë.

Tani m'u duk se nuk po më kërkohesh gjë e keqe. Vështrova arkën. Ishte prej dërrase, tepër e madhe dhe shumë e rëndë. Pas ndonjë ore erdhi Kukuli me tre hamej dhe me një karrocë. Mezi e ngarkuan arkën e rëndë. E çuam diku jashtë qytetit. Atje me shumë zor e ngarkuam në një kamion të markës «Chevrolet». U nisëm. Pas nja dy orësh mbërritëm në Tiranë. Kukuli më la sërish për të ruajtur arkën e u kthye pas ca me tre hamej e një karrocë. Pastaj më dëboi duke më kërcënuar të heshtja. Unë desha të dija fundin, por ata hynë në një udhë qorre dhe u mbyllën në një qilar të errët.

* * *

Kështu shkonin javë, muaj... Unë rritesha e dalngadalë Shabani zuri të më mernte në mbledhjet e punëtorëve, ku fliste herë ai e herë disa djem të tjerë të panjohur për mua. Mblidheshim gjithnjë tek ajo zgavra ku flija unë me shokë. Shuhej drita, fillonte biseda, kurse përmbi ne djepi lëkundej gjithnjë, ngadalë e ritmikiisht dhe dëgjohej innulla e nënës së re.

Ishte 24 dhjetor, festa e përvjetorit të ardhjes së Zogut në fuqi me ndihmën e serbëve pas përmbysjes së qeverisë së Nolit. Nëpër rrugët e Tira-

nës xhandarë e policë ngjitën afishe me shkronja të trasha të zeza, në të cilat shkruhej: «Rroftë triumfi i Legalitetit».

Atë mbrëmje, aty nga mesnata, Shabani më mori me vete. Morëm një kuti me bojë të zezë nga shtypshkronja, morëm edhe një furçë dhe zumë t'u hiqnim nga një X të madh afisheve.

E bëmë këtë punë për disa orë rresht. Shabani më tregonte se punë të tilla do të bënim edhe pas-këtaj.

Të nesërmen që në mëngjes xhandarë e policë u lëshuan nëpër shtypshkronjat e Tiranës dhe nisën të nuhatnin ku ishte marrë ajo bojë e kush i kishte prishur afisheet. Në mesditë, ndërsa po shitja gazetën në Rrugën e Postës, që prapa ndjeva një njeri që u përkul mbi mua. Mbante erë duhan, huddhër e suxhukë. Fryma e tij më ra në fytyrë dhe, duke më tërhequr me forcë, u mundua të më shkonte një palë pranga në duart. Gazetat më pikuan përdhe. Dy xhandarë po më lidhnin duart me tel telefoni, sepse unazat e prangave ishin tepër të mëdha për mua.

Nga dyert e rrugicës së rrobaqepësve dolën gjithë ata njerëz. Njëri syresh tha:

— Shih, shih, nisën të merren edhe me çunat...

Më çuan në burg. Atje më futën në njëfarë dollapi që ishte aq i vogël, sa nuk i shtrija dot këmbët, por qëndroja i mbledhur kruspull. Nga vajtjeardhjet e xhandarëve nëpër korridor, nga fjalët që shkëmbenin, mësova se kishin arrestuar edhe njerëz të tjerë. Me siguri edhe Shabanin, mendova. Bile emrin e tij e dëgjova që e zuri në gojë një xhandar. Prita të më merrnin në pyetje, por më kot. Si duket, kishin arrestuar shumë njerëz dhe unë

duhej të isha i fundit. Vetëm aty nga mesnata më erdhi një xhandar e më hapi kanatin e dollapit. Pa më nxjerrë nga kuvlia, nisi të më pyeste. Unë mohova gjithçka, edhe kur ai më kërcënoi, edhe kur më goditi në hundë, sa më plasi gjak. «Nuk di gjë, nuk pashë gjë, kam qenë në gjumë që në mbrëmje e gjer në mëngjes.» Këto ishin fjalët e mia e asnjë më shumë. Përsëri u mbyll kanati i dollapit, për t'u hapur të nesërmen aty nga ora dhjetë. Një xhandar më shtyu dhe më çuan në oborr të burgut. Unë prisja të më mermin në pyetje, kur xhandari më tha:

— Ik atje te kapter Hasanaj e laja këmbët!

Në një qoshe të oborrit, ulur në një karrige me ndenjësë rrogozi, pashë një kapter që kishte nxjerrë dollakët e i kishte varur si zorrë në një karrige tjetër. Përpara kishte një legen me ujë që avullonte. Një gardian iu afrua e i lëshoi një peshqir mbi sup, kurse në legen hodhi një dorë kri-pë. Kapteri më shfryu:

— Hë, more dobiç, edhe ti me politikë merresh?

— S'di gjë unë, kot më keni marrë.

— Mirë, mirë, kur të të vë vezë të nxehta nën sqetulla, pastaj bisedojmë, tashti më laj këmbët, — më tha e më shau rëndë.

Gjer këtu dhe më s'durova dot. Të dalë ku të dalë, thashë dhe, një të kapur legenin, e ngrita paksa dhe ia lëshova kapterit mu mbi surrat...

— Na, qen bir qeni, ti do më shash mua...!

Pastaj s'e mora vesh se si oborri i burgut nisi të më vinte vërdallë. Shihja me qindra sy e dyer që hapeshin, mbylleshin, lëshonin xixa, tym, mje-gull, pluhur, kurse unë ndieja që eshtrat e kërci-

njve, të shpinës, të kraharorit, të kokës më kërcitnin sikur m'i shtrëngonin me mengene.

Papritur më vërshuan disa kova me ujë mbi kokë. Ashtu erdha në vete dhe vura re që më kishte lidhur me litarë pas një shtylle që mbante hajatën e burgut. Dikush thirri:

— Vërimi vezë të nxehta nën sqetulla që t'i vijne mendtë.

Një zë tjetër matanë:

— Duhet prova materiale...

Dëgjova që krisën disa hekura nga porta e madhe e burgut. U zvarritën disa zinxhirë e u dëgjuan zhurmë nëpër shkallë. Kapter Hasanaj po fshinte shpejt e shpejt surratin me një peshqir të qelbur. Këmbët i kishte gjithnjë të zbuluara, me benevrekë të shpërveshur te gjunjët. Para u dukën ca burra të veshur mirë, me dosje në duar. Ku ta dija unë se cilët ishin ata, ministra, prefektë a gjyqtarë. Njëri prej tyre, duke më treguar mua me majën e bastunit të tij të hollë, pyeti drejtorin e burgut:

— Ç'është ky?

— Një nga të dyshimtët..

— Në këtë moshë? — Papritur ai vuri re Hasanajn. — Po ti, mor qen bir qeni, ç'më je katandisur kështu? Ushtarak je ti?

Hasanaj u kruspullosoi dhe s'bëri gëk.

Pastaj ai m'u afrua edhe më, vuri majën e bastunit në barkun tim të zbuluar e pyeti:

— Përse e keni rrahur? — Pastaj m'u kanos mua: — Fol, more ti, përse të kanë arrestuar?

— Nuk e di, — ia ktheva. — Unë shitja gazetat. po shkoja nga Rruga e Postës.

— Po përse të kanë rrahur, po të pyes, çfarë të kërkonin të thoshe?

— Më rrahën se nuk desha t'i laja këmbët atij kapterit atje, ai më shau edhe nga nëna....

Në çast një zotëri, që deri atëherë pothuajse nuk qe ndier fare, kërcëu përpjetë dhe thirri:

— Zoti prokuror, ç'janë këto turpe?

— Pusho ti, gjuhëgjatë, unë s'bëhem merak se je avokat, kupton?

Mua më shkuan të ngjethurat gjer në fund të këmbëve.

* * *

Për mungesë provash më lëshuan nga burgu. Pas një jave dhe Shabani. Sapo u takuam, ai më shtrëngoi fort në krahët e tij e, duke më gjurmuar sytë, më tha:

— Kurrë nuk dyshova te ti! Je djalë i fortë, tashti je bërë tamam burrë!

Pas disa ditësh ne të dy na pushuan nga puna. Nuk kisha asnjë rrugë tjetër, veçse t'u lija shëndetin shokëve, asaj zgavrës ku flija, të mbledhja lecat e të nisesha. Pastaj, me ç'kisha mbledhur, bleva për nënën një shall të leshtë, për vete një palë rroba prej doku japonez, u vërtita dy-tri ditë rrugëve dhe m'u shkrep në një çast të ikja në Durrës, të shihja edhe një herë detin, po nuk më dëgjonte xhepi. Natën e fundit ramë të flinim në atë zgavrën ndanë zdrukthëtarisë. Gjumi nuk më zuri gjithë natën. Vritja mendjen për të ardhmen time, për fshatin, për nënën. Si do të jetoja unë, pesëmbëdhjetë vjeç djalë, me një copëz tokë fare të vogël diku përmbi lumë?! Dhe, ndërsa mendoja

kështu, lart përmbi ne, ajo nëna e panjohur lëkundte djepin dalngadalë, duke kënduar ninulla, dhe fëmija në djep herë flinte e herë këndonte edhe ai.

* * *

U ktheva në fshat bashkë me Shabanin dhe djalin e tij.

Tashti vendlindja ime më dukej më e vogël nga sa e pata lënë. Shabani shkoi disa ditë në qytet dhe, kur u kthye, më solli një lajm të mirë: Do të punonim bashkë me të nëpër kodrat e fshatit, duke djegur e bërë qymyr dëllinjash për kovaçët. Kjo ishte puna ime e parë, sepse e dyta ishte ajo copëz tokë e vogël që më duhej ta punoja edhe atë.

Në fshat ishte hapur shkolla. Atje jepte mësim Rrok Prizreni, pasi kishte marrë me shumë mundime lejen nga ministria, me kusht që atë ta paguante fshati. Ato ditë mora vesh edhe për një njeri të huaj. Ky ishte një italian ezmer, një njeri i rrumbullakosur, i trashë dhe i ngjeshur, tërë qime e leshra, si i futur në një calik. E quanin Xhakomo Kantalupi. Flokët i mbante me një kujdes të veçantë, duke i llangosur përditë me brilantinë. Ky kishte një traktor me njëfarë hunde prej çeliku. Italiani kryente disa punë fare të ndryshme nga njëra-tjetra: Blinte fshatrave dru arre. Këto i rrëzonte me sharra e sëpata. Drurët e mëdhenj e shekullorë binin përtokë duke rënkuar me një vikatje zhurmëmadhe. Ai u merrte atyre vetëm rrënjët. Traktori i shëmtuar (ishte një makinë e markës «Kaproni», me një radiator tërë brima të zeza si fole grerëzash) fuste hundën e tij të zezë

në tokë dhe shkulte rrënjë. Kantalupi nuk kishte të ngopur. Gërmonte thellë e më thellë, sa të mos i mbetej tokës asnjë fije rrënjë. Thuhej se këto rrënjë i dërgonte në Itali. Punët e tjera që kryente ai, shiheshin si të çuditshme: kishte disa litarë të gjatë e të gjatë, me të cilët maste lartësitë e maleve e të kodrave, kishte disa dylbi të gjata e disa të shkurttra dhe disa enë, me të cilat maste sasinë që nxirrnin krojet e pusët e vendit, u binte aneqark lumenjve, pastaj i binte kalemnit për të gjetur sa ujë kishte gjoli e ç'prurje kishte lumi. Italiani kishte marrë me qira shtëpinë e Mandul Kovaçit, që kishte humbur në kurbet dhe kaq vjet s'i dëgjohej as emri.

Këtë njeri të huaj gjithë tul e dhjamë, unë e shihja përditë tek dilte nga shtëpia aty nga ora dhjetë, me sy të enjtur nga rakia që pinte çdo natë.

Nganjëherë atij i vinin edhe italianë të tjerë e bashkë me ta u qepej maleve, herë gërmonin tokën, herë vinin shenja nëpër udhëkryqet, kurse radhazi ngulnin flamurë të bardhë nëpër lartësitë e shkruanin nëpër shkëmbinj disa shkronja e shenja që nuk i kuptonte njeri.

Një ditë, duke kaluar nga shtëpia e Suliotëve, atje nën blirin e madh, pashë një vajzë të veshur me rroba të zeza. Në fillim nuk e njoha. Ajo duhej të ishte nja njëzet vjeç, me një trup të hedhur, të zhvilluar bukur e me një fytyrë të bardhë e gjithë nur. E vështrova një herë e, sapo hoqa sytë, m'u ndez dëshira ta shihja edhe një herë të dytë. Kur isha gati të ikja, vajza vuri buzën në gaz dhe më përshëndeti. Pastaj më foli edhe me emër.

— Ti, Lelo, je? Mësova se je kthyer nga Tirana!

Tashti e njoha. Ishte Melina, vajza e vetme e Sulioteve.

U lëshova nga shtëpia e saj, kapërceva portën dhe hyra në oborr. Atje u përshëndetëm dhe i dhashë dorën. Unë kisha marrë vesh për gjëmën e saj dhe i thashë fjalë ngushëllimi për vdekjen e prindërve. Kur isha në Tiranë, një ditë Shabani më pati treguar se babai i saj, Stefan Sulioti, që kishte shkuar në mërgim, në Amerikën e Veriut, për të mbajtur shtëpinë me bukë, e kishte paguar me kokë. Në fabrikën e hekurit ku punonte, atje ku mpreheshin thikat për Luftën e Dytë Botërore, një të premtë pas mesnate, Stefanin e kishte fshikur rripi i gjerë i motorit. Një fishkëllimë e frikshme, një grahmë e çjerrë, pastaj një përplasje e egër. Stefan Sulioti qe shtrydhur i tëri me mish e me kocka nga ai dybeku gjigant që rrihte mbi hekur.

Pas vdekjes së Stefanit edhe e shoqja s'e kishte pasur të gjatë. Ja kështu, Melina kishte mbetur jetime dhe, sipas zakonit, ajo duhej të rrinte veshur në të zeza tre vjet me radhë dhe të mos dilte fare nga shtëpia.

Edhe fshatim e gjeta në një varfëri më të madhe. Deri edhe llambat e vajgurit ishin rralluar dhe njerëzia radhë ndritnin natën me pishë. Ishin ato kohë kur u hap lajmi se në Fier dhe në vende të tjera kishte plasur kryengritja kundër Zogut.

Atë natë nuk fjeti njeri. Të gjithë hynin e dilnin te njëri-tjetri, pyetnin, bisedonin, shpresonin. I gjithë vendi ishte në pritje e në ankth. Aty nga mesnata ishte parë që në shtëpinë e kryeplakut Pando Qerja kishte hyrë fshehurazi një njeri i panjohur, kishte ndenjor aty gjatë, pastaj ishte zhdukur nëpër errësirë. Edhe Shabani im u zhduk një ditë e

një natë. Njerëzit prisnin që nga kryengritja të përmbysesh regjimi i Zogut. Por më vonë u mor vesh se në Tiranë zogistët kishin pushkatuar trembëdhjetë veta, se kryengritësit kishin vrarë gjeneral Gjilardin. Turma xhandarësh, oficerësh e bajraktarësh iu lëshuan vendit kryq e tërthor për të shuar çdo shenjë të kryengritjes. Postat më nuk pranonin telegrame, sepse morset e vjetra ishin të zëna, natë e ditë kërcitnin e shpërndanin urdhra të frikshme.

II.

Kohët kalonin. Tashti isha rritur e bërë goxha djalë. Punoja gjithnjë me Shabanin duke djegur qymyr për kovaçët. Te mulliri i fshatit tani njerëzia vinin për të bluar vetëm me ca qese dhe torba me pak bereqet. Ata që ishin edhe më keq, e bluanin misrin me gjithë koçanë.

Në këto ditë fshati i tërë ishte si i ndërkryer e i tërbuar nga taksidari... Ndërsa Ahmet Zogu, që ishte në Vjenë, edhe se shpëtoi për një qime nga një kokërr plumbi, gjeti kohë dhe porositi numra metalikë për pontat dhe tabela për rrugët.

Tashti numrat e tabelat kishin ardhur, ato do të mbërtheheshin derë më derë e rrugë më rrugë nëpër të gjithë vendin. Fshatarët, sikur të mos u mjaftonin ato mori taksash, tani duhej të paguanin edhe nga dy lekë flori për numrat dhe tetëdhjetë e nëntë të tjerë për katër tabela.

Këto tabela i pushë edhe vetë: Rruga Prince-sha Sanije, Rruga Princesha Rukije, Rruga Princesha Maxhide dhe rruga Princi Xhelal.

Njerëz që dinin shkrim e këndim, i ranë kalemit dhe nuk pjesëtonin dot tetëdhjetë e nëntën

me katër. Vetëm Shabani e bëri llogarimë aty për aty e tha:

— Princesshat Sanije dhe Rukije, që janë të tha-ta si shkarpa, bëjnë nga njëzet e pesë lekë, Maxhi-deja që është si krapeshë, tridhjetë e tetë lekë, kurse princi Xhelal, meqë është i krisur nga mendtë, bën vetëm njëmbëdhjetë lekë!

Pas ca ditësh, në fshat plasi një lajm tjetër i papritur. Mu në mes të natës kishte ardhur nga kur-beti një i humbur prej vitesh, Mandul Kovaçi. Unë e mbaja mend kur u nis ai për në kurbet, po, kur e pashë tashti, nuk e njoha fare. Ajo fytyrë e ëm-bël prej djaloshi të njomë nuk dukej më. Në vend të saj tani ishte një fytyrë tjetër, e përzhitur nga di-elli me flokë të zinjë e kokoridhë. Në krah mbante një kitarë.

Për jetën e tij më tregonte Shabani kur puno-nim pllajave të malit.

Mandul Kovaçi iku nga fshati kur ishte tetë-mbëdhjetë vjeç djalë. Bleu një pasaportë me një emër tjetër dhe bashkë me fshatarë të tjerë u nis për në Botën e Re. I pamësuar me detin, që më përpara as e kishte njohur fare, duke mbajtur bar-kun me dorë, i leqendisur, i uritur dhe i dërrmuar, pas dy muajsh vozitjeje në fund të hambarëve të vaporet, arriti në portin e Manhatanit, që priste kra-hë të lirë. Këtu zbritnin tufa-tufa që nga gojë-t e vaporeve njerëz të tretur e të ligështuar, veshur mos më keq, me opinga kau në këmbë e ta-llagane krahëve. Atje bosët u kontrollonin sytë, dhë-mbët, hundët, krahët e shpinat, u ngarkonin pesha në shpatulla, i shkundnin për supesh dhe i qëllonin befaz në bark.

— Emrin? — pyeti nëpunësi, një dorac i vëngër,

që tashti gjithë forcën e kishte të përqëndruar vetëm te dora e saktë.

— Simon, — u përgjigj Manduli.

— Emrin e babait?

— Gjerasim.

— Emrin e nënës?

Manduli shtangu. Nga zhurma, nga lodhja e pagjumësia, nga rruga e gjatë aty për aty e humbi toruan dhe harroi emrin e nënës së Simonit. Sytë i shkanë nga barku i vaporit që e nxori, i kaloi nga barakat e shtrembra përpara, vështroi lecat e veta dhe... Po doraci këtë priste. Për një të përzënë ai fuste një tjetër që do të paguante ryshfet. Doraci e kapi Mandulin për zverku, e tërhoqi zvarrë dhe e çoi drejt një vaporit brazilian.

— Këtë njeri e ke me ligj e me dorë të lirë, mbaje pesë vjet në vapor të të punojë dhe, kur të sosen të pesë vjetët, lëshoje andej nga Ballkanet.

Mandul Kovaçi u gjend befaz në një botë të panjohur për të. Marinarët që gjeti atje, ishin zezakë, mulatë e pak të bardhë. Nga gjuhët që flitnin ata, ai s'merrte vesh asgjë. I dhanë një lopatë të madhe dhe e çuan te goja e stërmadhe e një furre, ku digjej qymyr. Vapa ishte e padurueshme e brenda ditës nga djersa e pluhuri i qymyrit ai u ndrag aq fort, sa nuk merrej vesh se cilës race i përkiste. Disa marinarë, moshatarë me të, e afruan, i dhanë një lugë e një gavetë, disa lecka për të fjetur e asgjë më shumë. Ai gjeti atje djelmosha që këndonin bukur dhe u binin kitarave, gjeti edhe disa italianë vocërrakë që e thërritnin «nostro viçino».

Shëtiti dete e botë Mandul Kovaçi. I ra mes për mes Atlantikut e Paqësorit, zbriti në Zelandën e Re

e në Australi, qëndroi ditë në ishujt e Polinezisë, i ra qark Tokës së Zjarrtë, vërejti i habitur ata miliona e miliona zogj që fluturonin mbi brigjet e Kilit, i pa shkëmbinjtë e bardhë në ishujt e Shën Helenës. Kur e merrte malli për mëmëdhenë, Manduli ikte e fshihej natën në turrat e mëdha të litarëve e ashtu kthehej në vendlindje, shkonte shtëpi me shtëpi, puthte pragjet, portat e dritaret e fshatit. Dalmgadalë ai nisi të këndonte. Zërin e tij e pëlqyen dhe këngët e tij u bënë të njohura në atë «Harapelin» e stërgjatë, ku këndoheshin këngë nga të gjitha kontinentet.

Një ditë e ftuan në një mbledhje të sindikatës. Manduli u habit. Nga këto gjëra ai nuk dinte asgjë.

Në atë marrament shtegtimesh të gjata, kurrë ndonjëherë «Harapeli» nuk e kaloi as Gjibraltarin e as Suezin. Sikur të ndodhte një gjë e tillë, Manduli e kishte mbushur kokën, t'i thërriste vrapit...

Më në fund, një ditë prej ditësh, pas pesë vjet shtegtimesh e jete prej skllavi, vetëm me një kitarë në dorë, atij i zunë këmbët tokë në breg të Himarës dhe ia mori vrapit për në shtëpi. Në bark të kitarës kishte tela dhe në kokë këngë.

Kishte rënë mesnata. Fshati flinte. Xhakomo Kantalupi atë natë kishte lënë mbi tryezë dy shishe rakie të zbrazura. Traktori i tij çlodhte gjymtyrët dhe hundën e shëmtuar në oborr. Italiani ishte i pirë e i bërë tapë e gërhiste si derr. Llamba me vajguri ndriste gjithnjë atje lart, e kapur në një gozhdë. Porta e jashtme u shty, llozi i shkuar tejmatanë s'kishte ndër mend të thyhej.

Ja, kështu e gjeti portën e tij Mandul Kovaçi. I lodhur nga rendja e shqetësimi, mbështeti llërën mbi portë dhe ballin e vuri përmbi atë llërë. Iu dro-

dhën gjunjët, u përkul edhe më, puthi pragun e gurtë, ndërsa bishti i kitarës u godit mbi dërrasat e vjetra dhe telat lëshuan ca tinguj të mbytur. Rendi nga avllitë, i kapërceu si dikur, dalloi atë farë përbindshi të hekurt në oborr dhe s'po i binte dot në të... Nga dritarja, nëpër rrjetën e telit, ai pa kundrejt një burrë të panjohur. S'po u besonte syve të vet. U kacavar pas pjergullës, u hodh në ballkon dhe kërceu brenda. Zbriti shkallët dhe shtyu derën... Para syve i doli shpina e të panjohurit. U kthye mbrapsht dhe i mori një për një kthinat. Zbriti edhe në qilar. Qypat, poçet dhe kadet e vogla qenë kthyer përmbys. «Pra na qenka qiraxhi këtu. E kush e ka futur?» Hyri sërish në sobë.

Ndanë tryezës ishte lënë një letër e shkruar përgjysmë. Manduli i hodhi një sy. Letra ishte shkruar italisht. Ai e përpiu me sy:

«Al centro della società anonima di Bari Palese...»

Pra na qenka italian.

Manduli, që s'po kuptonte gjë, u drodh. E kapi për supesh dhe e shkundi. Italiani s'përmendej. Pas derës, Mandulit i kapi syri një kovë me ujë të ndenjtur, e rrëmbeu dhe ia lëshoi mu në fytyrë...

Italiani u përmend dhe nisi të fshinte surratin me të dyja duart. Pastaj fare papritur erdhi në vete, ngriti kokën, e pa që një i panjohur e sulmoi dhe vuri dorën në brez. Manduli iu vërsul sipër, ia kapi dorën në noçkë, ia shtrëngoi fort e më fort, revolveri i italianit ra përtokë dhe Manduli ia dha me një grusht hundëve...

Kantalupi ra si një thes me kashtë, nga hundët i teptisi gjaku dhe lëshoi një thirrme qaramane. Manduli s'e bëri të gjatë, e kapi për sqetullash

dhe e zvarrisi përjashta, ia vuri prapanicën mbi zinxhirët e traktorit, kokën ia futi te hyrja e kabinës dhe e la aty.

Në mëngjes gjithë fshati mësoi për ardhjen e Mandulit. Kantalupit i kishte dalë rakia dhe kishte nisur të thërriste e të bërtiste, gjersa kryeplaku Pando Qerja, me pojakun pas, u derdh për andej. Aty qenë mbledhur mizëri. Renda dhe unë e pas meje edhe gjithë moshatarët e mi. Aty gjeta edhe Shaban Tipografin. (Tashti kështu e thërritnin në fshat). Nga ditaret e shtëpive gratë vështronin grinjat e Kantalupit, dëgjonin kur ai bërtiste se qiranë e shtëpisë ia kishte paguar në dorë Pando Qeres, kurse vetë kryeplaku thoshte se s'kishte marrë asnjë pesësh.

— A solle ndoca para, o Mandul? — e pyeti njëri nga shokët e tij pastaj.

— Ja, solla vetëm këtë kitarë, kam sjellë edhe këngë nga bota e tërë, të lejuara e të ndaluara...

— Këngë të ndaluara!

— Po për të jetuar si do të bësh? — e pyeti me ngut një tjetër.

— Do ta nis nga e para, do të punoj si kalë, do të hap tokë të re tek ajo pllaja kundrejt fshatit.

— Po atje toka është e varfër, ka shumë gurë e gropa.

— Le të ketë, i sheshoj unë gropat dhe i qëroj gurët. Kazma, or vëllezër, më duket më e lehtë, si pendë, përpara lopatës së hekurt atje në bark të «Harapelit». Ju as e dini e as e merrni dot me mend vapën e Ekuadorit dhe gojët e zjarra të furrave të vaporit. Pesë vjet skllav kam qenë, vëllezër. Ta dini ju sa herë e kam hapur unë këtë lëndinë këtu, ndër-

sa isha në bark të «Harapelit» e në mes të dallgëve,
nëpër dete e oqeane!

* * *

Të nesërmen më duhej të ujitja patatet, ndryshe do të thaheshin e do të bëheshin shkumb. Kështu edhe të tjerë, ata që kishin qoftë edhe një çerke ujë përmbi arë, do të dilnin me shata që herët. Me nja dy sahat natë unë isha tek ara ime e vetme dhe lëshova ujin e paktë të një burimi. Errësira ishte e thellë, era furshullonte nëpër gjiret e dëllinjave. Sipër, nga korijet, u dëgjua klithma e frikshme e një dreri. Në grykën e lumit, poshtë, tjetër zhurmë. Përfytyeshin dhelprat duke gjuajtur peshk nëpër rrjedhë.

Logu më i dashur për mua atëherë ishte gryka e lumit sipër nga korijet. Drurët dhe bimësinë e atij logu i kishin sjellë dhe mbjellë aty givshstërgjyshërit e mi brez pas brezi. Panja bukuroshe e shëloie të shumta, plepa të lartë e lisa lavrakë, ahe të njoma e frashre të hedhura, kishte atje edhe kumbulla të egra e thana të holla, driza e ferra, kulumbri gjembace e dëllinja të merme. Këtu vetëm drurë kreke nuk kishte.

Dola mbi mezhde dhe mbajta vesh. Edhe tek ara e Lengos kishte zhurmë. Unë isha i sigurt se edhe ajo do të ishte atje.

— Lengo! Lengo! — thirra, po s'm'u përgjigj njeri.

Shkova tek ajo. Uju gurgullonte nëpër arë dhe nëpër ato gurgullima nisën të vinin si nga nëntoka edhe qëllesat e zemrës sime.

Tek ara ime e pata zërin, këtu s'mund të flitja

fare. U nemita, gryka m'u zu, m'u tha e s'mund të më njomej, edhe sikur t'i ktheja lumin të tërë. Më në fund i thashë se duhej të kalonim nga ara ime. Ajo u nis pas meje, por, kur unë bëra ta merrja për dore, ma ktheu:

— Dale të lidh opingat.

Sa bukur i lidhte ajo oputat e gjata. I kalonte kryq mbi pulpë, si shenja shumëzimi.

— Lengo!... — Nuk më dukej si zëri im. — Lengo, unë dua të të them diçka.

— Ma thuaj.

— Nuk e di... por nuk mundem.

Kur nuk munda të hapja gojën, ua hodha fajin stërgjyshërve të mi, që, kur mbollën këtë grykë lumi, nuk u kujtuan të mbillnin edhe vlastarë kreke.

Sepse kreka i ngjet njeriut dhe shpirtit të tij. Mbin nga toka një vlastar kreke, del tri-katër pëllëmbë në erë e pasaj zë e përgjon anembanë. Kërkon të gjejë medoemos edhe një vlastar të dytë. Nuk e gjeti, ul kryet dhe thahet; e gjeti, bashkohet vlastari i dytë me të parin, pleksen, përqafohen, bëhet një gërshet i vetëm e ashtu bëjnë përpjetë.

Dhe ja, po të kishte tashti kreka këtu, do t'ia tregojta Lengos, dhe ajo do të më kuptonte. Meqenëse nuk kishte, vendosa t'ia thosha te panairi. Pas disa ditësh, në Vraninë, në mes një pylli krekash, do të bëhej panairi i madh, si bëhej mot pas moti. Atje rridhte gjithë krahina, vinin edhe nga vende të tjera. Atje do t'i tregojta Lengos krekat, pa qenë nevoja t'i flitja fare.

U ulëm duke lënë në mes një frashër të vogël. Rrinim ashtu të heshtur dhe nuk vinim re se si dalngadalë drita u derdh që nga majat e plepave e nuk e morëm vesh se si vesa u shtrua, zhurmat e lumit

u fashitën, dhe tej nga fshati erdhën zëra njerëzish.

U ktheva ngadalë nga ajo dhe e pashë me bisht të syrit. Përmbi freskinë e faqeve të saj vura re një zbehtësi të çuditshme e dy sy që xixëllonin si kurrë herë tjetër. Kishte veshur fustanin prej basme të lirë japoneze, atë të bardhin me qershi të kuqe. Por basma kishte pasur farefis barin dhe, duke u larë, kishte hyrë në ujë, qershitë kishin nisur të lëshonin ngjyrë e dukej sikur sapo kishin filluar të shtrydheshin dhe sfondi i bardhë i fustanit ishte kthyer në ngjyrë të trëndafilin të egër. U ngrita, theva disa degë frashri e ndenjëm përmbi to.

Po më dukej si në ëndërr! Pikat e vesës, që ishin përhapur nëpër flokët e saj, ishin rrokullisur përmbi qershitë e kuqe të fustanit, dhe ato që pikonin nga fletët e frashrit nëpër faqet e saj, ishin me ngjyrë blu. Asaj kohe unë nuk e dija se frashri u jep ngjyrë të kaltër bulëzave të vesës...

Vetëm kur u hap dita krejt, atëherë më erdhi zëri.

— Ja Tumba e Thanave, dua të pres një kunjëz për llastikë.

— Se mos je i vogël!

— E bëj për tèt vëlla.

Morëm tatëpjetë, por, sa hodhëm ca çape, dëgjova një zë të njohur tek më thërriste. E njoha menjëherë. Ishte Shabani. Kurora e dendur e flokëve i doli diku nëpër bisqet e drejta të thanave.

— Lelo, o Lelo, eja këtu!

E lashë Lengon të shkante në ujitje dhe vetë u nisa nga më thërritnin.

Shabani kishte dalë këtej Tumbës së Thanave dhe më priste. Tashmë fytyra e tij, dikur e zbehtë, kishte marrë atë ngjyrën e zeshkët të fshatarit. Me

atë cigaren që e mbante gjithnjë në buzë, nga ana e majtë, dhe që nuk e prekte me dorë derisa e mbaronte, e me syrin e majtë të mbyllur përgjysmë, dukej sikur gjithnjë mendohej.

Kur hyra edhe unë thellë Tumbës, gjeta atje Rrok Prizrenin e Mandul Kovaçin, të ulur te një kumale.

Më thanë të ulesha edhe unë. Pastaj nisi të fliste. Unë e kuptova se biseda e tyre kishte filluar me kohë.

— Unë e di që sonte, më shumë se gjysma e shtëpive të fshatit janë gdhirë pa bukë. Është e rëndë të të kërkojnë fëmijët bukë e ti të shtihesh sikur nuk i dëgjon...

— Gjithë ato vjete kam bredhur nëpër bibliotekat e Austrisë, për të kërkuar gjurmët e të parëve tanë. Kam hasur gjithnjë atë nderin dhe kryelartësinë e shqiptarit në shekuj... Ëndrrat e mia... vij këtu dhe gjej një qeveri anadollake me këta xhahilë e matufë, hajvanë e rrufjanë... Si do të dalë vallë vendi ynë nga ky batac? Më thoni, vëllezër, si?— thoshte Rroku.

— Mos u ligsho, Rrok, — ia priti Shabani, — në natën më të gjatë këndesat do të këndojnë në agim.

Ndërhyri Manduli:

— Kam zbritur njëherë në një skelë, më duket se isha në El Shaluf, diku nga Arabia. Atje kam takuar një hamall plak që më thoshte një fjalë të urtë: «Bir jer, bir bakar, kijamet ondan kopar». Ndofta edhe i ngatërroj fjalët; por kuptimin ua mbaj mend fare mirë. Do të thoshte: Nëse disa hanë e të tjerët bëjnë sehir, kijamet kopaçe ka për të lozur.

Heshtje. Askush s'po fliste më. Një gushëkuq erdhi e u ul te një bisk thane. Bisku u lëkund dhe

gushëkuqi zuri të kolovitej. Pastaj cicëroi, u dha këmbëve dhe mori përpjetë në fluturim. Shabani ngriti sytë andej nga fluturoi zogu.

— Hë, po ti, Lelo, ç'na thua?

U ndodha ngushtë. Nuk dija nga t'ia nisja, se për të thënë kisha boll. Në krye fjalët e mia dolën gjysma, se kisha druajtje të flitja rrjedhshëm faqe miqve të mi, që ishin burra.

— Ti, Shaban, vetë më ke thënë që ai italiani është një nepërkë, që i duhet shtypur koka, pse e lëmë të livadhisë akoma?!

Ata të tre kthyen kryet dhe më vështruan mu në sy.

— Na e mbushi vendin me vrima e gropa, na i mbushi majat e maleve me flamurë të bardhë, thotë se po bën hartën e Shqipërisë.

— Sikur të qe puna për hartën e vendit... — ma ktheu Shabani. — Jo, jo, nuk bën hartën, ai po na bën varrin. Ai mat me litarë malet, mat ujërat, ngre shenja nëpër majat e maleve, ai është gjarpër...

— Unë një dru të mirë ia dhashë, — tha Manduli, — po qe puna për ta vrarë...

* * *

Atë natë kishte një dasmë në fshat. I zoti i shtëpisë kishte marrë saze nga qyteti. Demkën me tre shokë. U nis me kaba e me gërnëtë, u hodh devolliçja, nga djem të veshur me fustanella të bardha, pastaj vallja e shtruar e grave, vallja e bukur e Isuf Arapit, gjersa Mandul Kovaçi i dha zjarr të ri dasmës me këngët dhe kitarën e tij. Zëri i tij i bukur na bëri për vete të gjithë. Unë isha shumë kuresh-

tar të dëgjoja ato «këngët e ndaluara», për të cilat kishte folur Manduli që ditën e parë të ardhjes së tij.

Por në vend të saj Manduli këndonte:

*Sot lipset me flamurë,
Malit të dalim,
Përmbi shkëmbinj e gurë
Lirinë të ngjallim!*

Sekush u ngrit dhe bëri t'i vinte Mandulit një pare në ballë. Ky s'pranoi kurrsesi dhe atëherë iu afrua Demka e i foli në vesh:

— Aman, ore vëlla, nga dole e nga erdhe ti... të kishe pritur edhe ca...

Manduli s'ia vuri veshin dhe, në kohën që unë prisja të dëgjoja këngët e ndaluara, ai përsëri ia nisi një kënge popullore:

*Mes shiu e dëbore u takuam,
Por me dallëndyshet nuk u takuam...*

Kishte shkuar mesnata kur m'u shkrep të bëja diçka. I bëra shenjë Lengos të më ndiqte pas dhe, kur u gjenda tutje nga lëmi i fshatit, Lengoja m'u afrua.

— Përse e le dasmën, Lelo?

— Eja pas meje se kam për të ta shpjeguar.

Shkuam nga kulla e pojakut, atje ku tashti bujtete Xhakomo Kantalupi. Në oborr të kullës ishte traktori i tij i zi. Nëpër errësirën e dendur të natës i shpjegova e i shpjegova Lengos të gjitha sa dija e sa kisha dëgjuar për atë të huaj nepërkë. Dritarja e kullës ishte me dritë. Kapërceva gardhin e

ngula sytë atje, por ajo kishte perde përpara. Unë hetova gjersa syri më kapi një vend të çjerrë të pëlhurës. Italiani ishte gjysmë i pirë dhe e ngrinte e e ulte kokën si ndonjë kalë teknefes. Nga buzët i rridhnin jargë dhe kruante me mërzi hundët e qafën. Në një qoshe dukeshin tre bidona të mbushur me benzinë. Ah, të ishin këtej ata bidona.

Lengoja se ku po vërtitej nga fundi i oborrit dhe diç ngatërronte. Hipa mbi traktor dhe hoqa kapakun e vogël të serbatorit. Kapaku u shkul fare lehtë. Pastaj zbrita dhe i fola ngadalë Lengos.

— Më duhet një enë..

— Vete unë marr stomnën në shtëpi.

— Shko merre, po vetëm shpejt, lepur të shkosh e langua të kthehesh, sille të mbushur me ujë!

Kur u kthye, nëpër terrin e natës dallova se, përveç stomnës, në dorën tjetër ajo mbante diçka të rëndë. Por nuk kisha as kohë e as kokë ta pyesja. Hipa sërish mbi traktor dhe stomnën e madhe me ujë e ktheva të tërën në serbator. Kur zbrita e desha të iknim, Lengoja se ç'po ngatërronte në fund të oborrit. Kur i vajta pranë, pashë që ajo u kishte hyrë litarëve të Kantalupit dhe po i grinte me thikën e çeliktë që i ati grinte duhanin.

— Hë më të lumtë, Lengo, ma kalove!

* * *

Të nesërmen fshati përsëri u ngrit nga britmat e mallkimet e Xhakomo Kantalupit. Ky që herët kishte nisur të ndizte motorin e motori s'i ishte ndezur. Pastaj kishte nisur të shante e të mallkonte në gjuhën e vet. Rendi domosdo Pando Qerja me pojakun, por italianin nuk pranonte. Bërtiste e kanosej:

— Të vijë këtu prefekti vetë, të vijë komandanti i xhandarmërisë, djalli me të birin të vijnë e të bëhen hetime! Këtu ka banditë e komunistë, këtu ka bollshevikë e rebelë! Të m'i kishin vjedhur litarët, nuk do habitësja, por nuk m'i kanë vjedhur, m'i kanë grirë e prerë me thikë... serbatorin e traktorit ma kanë mbushur me ujë... të merren masa, të bëhen hetime!

Afër mesditës, kur u ngjita lart malit për punë, i tregova Shabanit për ato që kishim bërë. Kur ai më përgëzoi e më rrahu supet, unë, nuk e di përse, s'i tregova se litarët i kishte grirë me thikë Lengoja. Kur na pa që bisedonim, Manduli erdhi afër nesh e Shabani i tregoi për ç'kishte ndodhur.

— Shaban, po na e kalon Lelua, — tha Manduli.

Mua m'u bë qejfi e hajt të më mbaje. Kaq herë u mata t'u flitja për thikën e mprehtë të Lengos, por ndërkaq vura re se diku në një arë më lart po vërtitej Pando Qerja. Shabani e vërejti me ngulm e pastaj na tha:

— Ky kot s'ka dalë kësaj ane, po ne le të shohim punën tonë.

U shpërndamë pas dëllinjave e pas flakadanëve, duke gatitur kaçavel, kur në një çast shoh Pando Qeren tek iu afrua Mandulit.

— Pa eja ta nderim njëherë, o kurbetli, — i foli Manduli e mati të tërin me sy.

— Po mirë, o , e nderim...

U ulën shesh dhe kryeplaku hapi kutinë e duhanit. Unë i rashë kodrës aneqark dhe dola në një shkurre përmbi ta.

— Me tët atë kemi qenë miq e kemi shkuar për bukuri, — tha i pari Pando Qerja, — kështu kam ndër mend të shkoj edhe me ty.

— Për të mirë qoftë!
— Por ti, o Mandul, nuk më pëlqen, se ti, ore djalë, ke sjellë farë të keqe nga detet, kushedi ç'dallgë e furtuna ziejnë në kokën tënde të krisur...

— Unë i krisur!

— Po, po. Sapo ardhe e fap zure shoqëri me Shaban Tipografin.

— Pse? Ç'të keqe ka kjo?

— Të keqe ka, se ai e ka emrin të shkruar me të kuq dhe mos mendo se ka burrë në botë që ia shkon ujët nën rrogoz Pando Qeres. Mbrëmë u hodh ujë në traktor të italianit, u prenë e u grinë litaret... gjer dje këto nuk bëheshin. Me të ardhur zotrote...

— Shiko, mbaj gojën e mos rrih ujë në havan, nga këto unë nuk di gjë...

— E megjithatë, një palë duar i kanë bërë këto gjëra. Unë nuk thashë se i bërë ti, po ja që, me të ardhur ti...

— Shiko, Pando, të thashë edhe një herë, mati fjalët kur t'i nxjerrësh.

Kryeplaku përkuli zverkun më poshtë dhe e zbuti zërin.

— Pa dëgjomë, bre Mandul, pa dëgjomë, bre bir, vëri, bre, gishtin kokës dhe eja ta shtrojmë bashkë miqësinë. Hape, bre, zemrën tënde të bardhë, se unë ta di zemrën, ti e ke tamam si të tët eti, hape, bre, dhe ke për të parë ditë të bardha e mirësi prej meje. Eja, eja, e lidhemi miq e shokë, eja.

— Unë të lidhem shok e mik me ty?! E ç'mund të më lidhë mua me një dhjetar e me një kryeplak, me një fajdexhi që për dy napolona borxh, ia rrëmbeu selishten babait? E ç'më lidh mua me ty?

— Po në s'të lidh, mund të të lidhë, bre, po ti

e di, ore, se unë kam kamje e pasuri, ti e di, ore, se unë kam katër çupa për në kalë.

Manduli më s'e përmbajti veten dhe i bërtiti:

— Hy, more zgjebanik! Më gjete mua ti të ma futësh kokën nën zgjedhë!

Pando Qerja e uli edhe më shumë kokën, por unë që isha te driza, e shihja fare mirë se si i hidhte sytë herë këtej e herë andej. Rënkoj dhe tha:

— Qenka më lehtë të mbush pusin e fshatit me gjilpëra, sesa kokën tënde me urtësi, më qafë paç veten, unë i lava duart, ty të paska marrë koka erë.

— Demek, zotrote më kërcënon me këto...

— Ta thashë një herë, ty të qenka bërë syri si i atij demit që thera vjet për pastërma.

— Mbaj gojën, se e di ç'të bëj!

— Provoje, se për të marrët ka edhe të urtë, po dora e qeverisë është më e gjatë, se qeveria e kap lepurin me qerre, se unë, ore, s'ha kashtë. unë të shpëtova një herë, kur rrahe atë italianin, por pas-këtaj mos pandehësh se ma shkon ujët nën rrogöz. E di unë se ç'bën ti. Ti me Shaban Tipografin dhe me atë gegën, me ato shoqërirat e futbollit, me atë buzukun e me ato këngët, kërkoni të lëroni tokën e pastaj të hidhni farën e keqe.

Manduli s'u përmbajt më, iu hodh në grykë dhe e shtrëngoi aq fort, sa unë, kur pashë sytë e kërcyer të kryeplakut, dola nga driza dhe lëshova britmë sulmi. Nga zënka e thirrjet Shabani u ndodh në çast atje.

— Lëshoje, — i tha Mandulit, — lëshoje.

Me t'ia hequr duart nga gryka, Pando Qerja sikur pikoi në vend. Ra përdhe e zuri të gulçonte. Pastaj foli:

— E, do më vritni? Vramëni, po ta dini, ama, do të më paguani shtrenjtë.

— Jo, jo, — ia ktheu Shabani, — ne s'vrasim njerëz kështu. Ti u zure me Mandulin, ia bëre borxh dhe ai duart vetëm për bukë s'i ka. Tashti zotrote, po deshe të hapësh defterë, gjyqe e sherre me ne, hapi. Po e nise me spiunime, kallëzime e me gënjeshtira, edhe ne, qen bir qeni, plumb për plumb e dhëmb për dhëmb...

Shabani e ndali një çast fjalën dhe vështroi nga në: Pando Qerja s'e ngrinte kryet. Atëherë Shabani hodhi edhe një gur të fundit:

— Një këshillë ta kam borxh, në daç merre, në daç hidhë.

Pandoja ngriti paksa kryet. Ca pulla të kuqe i dalloheshin në grykë, atje ku e kishte kapur Mandulin.

— Shiko më mirë atë italianin që të hyn e të del në shtëpi... pa të sjell edhe dhurata, edhe libra, edhe gazeta, edhe... ç'pandeh ti, për sytë e tu të bukur të vjen?

Pando Qeres i dogji e kafshoi buzën e poshtme me dhëmbë, por kokën e uli përsëri, këtë radhë edhe më poshtë.

— Ai i ngriti lekat nga fshati ynë dhe më ka dhënë fjalën se më e më nuk vjen te ne, por edhe një fjalë dua t'ju them.

— Fol.

— Këtë kalamanin mos e futni nëpër ato rrjetat tuaja, mosni, se është jetim e fukara...

Këtë s'mund ta duroja dot. Ia ktheva:

— Ti i qan hallin kalorësit se i varen këmbët. Ik, ore, tutje. Nuk jam katandisur unë të më qash hallin zotrote. Se ç'bëj unë e ku vete unë, ty s'të marr dorën. Ti shiko të zhvatësh sa të mundësh.

Pandoja, duke ikur, e lëshoi vrerin e fundit.

— Atëherë ky qen i vogël, kjo kone vocërrake, ka për t'u bërë qen birë qeni. Mirë, xhanëm, mirë, si ta keni për qejf.

* * *

Një të diel u zgjova shumë shpejt. Drita binte fare mugët në dritare, kurse në vatër, maçoku ynë shpironte qetë-qetë e të dy sytë i ndritnin si gaca zjarri. Kërceva përpjetë, mbatha opingat, nja dy grushte ujë në fytyrë, një krehër flokëve e bëra përjashta.

Që në darkë e kisha nuhatur se Shabani, Manduli e Rroku diku do të shkonin dhe mua nuk do të më merrnin.

Hodha në xhep një copë misërnike dhe u lëshova nëpër fshat. Agimi qe i vakur. Qëndrova te qershia e madhe në mes të fshatit. Kuqëlimi i kokrrave të qershive ishte joshës, fletët gjelbëroshe, të njoma, gjithashtu. Kërceja degë më degë si të isha shqarsh. Kur i mbusha gjiret me qersh, bashkë me kokrrat e kuqe e me gjethet e gjelbra, në kraharor më futej edhe ajri i freskët i atij agimi.

Që nga maja e qershisë fshati dukej si në pëllëmbë të dorës. Që andej i pashë fare qartë Shabanin, Rrokun dhe Mandul Kovaçin. Ishin veshur me rrobat më të mira, kishin nga një trastë në sup e duke hetuar anembanë, si të druajtur, dolën nga fshati e bënë përpjetë nga pyjet.

Atëherë zbrita e u qepa pas tyre. Ikja jo në rrugë, se mund të kthenin kryet e të më shihnin, por korijeve e pllajave, nëpër driza e bumbushera.

Pas nja dy orë udhëtimi zhigrave të pyllit si

kaçak, i gërvishtur në duar e fytyrë, i pashë ata të tre që u ulën rreth një burimi e nisën të hanin bukë. U afrova pa më pikasur, pa u shtrova edhe vetë me bukë e me qershi.

Duke dëgjuar tinëz copa bisedash, i rashë në të:

Shoqëria e punëtorëve të qytetit, që mbante emrin shoqëria «Puna», do të bënte një piknik në majë të malit Morava. Atje ishin ftuar edhe djem nga fshatrat e tjera.

Përsëri ik e ik përpjetë maleve. Herë i shihja tek çanin rrugës përpjetë, herë i humbisja nga sytë. Pas nja katër orësh udhëtimit, më në fund dëgjova zëra e këngë, goditje sëpate, thirrje e të qeshura. Bëra më tej e isha mu në buzë të asaj pllajës ku ishin mbledhur gjithë ata punëtorë, djem e vajza nga qyteti. Anash majoles kishte disa ograhe të pyllëzuara dendur me ahe të mëdha, kishte burime me shumë ujë, kurse në një majole tjetër dukeshin gërmadhat e një karakolli të kohës së turkut.

Në mes të sheshit po ngrinin një skenë, kurse anash kishin ndezur zjarre ku piqnin në hell qengja. Në fillim sikur e humba terezinë. Miqtë e mi nga fshati edhe s'kishin sosur. Unë kisha mbërritur para tyre e, ndërsa po mendohesha, ata u dhanë pas meje dhe u ndeshëm sy më sy...

— Po ti!

Shabani tundi njëherë kokën, por nuk më qortoi:

— U bë si u bë, eja me ne tashti.

Miqtë e mi u takuan me shokë nga qyteti; dukej që njiheshin që më parë se përqafoheshin dhe e thërritnin njëri-tjetrin me emër.

Grupe punëtorësh ishin mbledhur gjithandej

nën hijet e lajthishtave. Njëpër shesh kishte edhe shitës ambulante. Në një arkë birre ishte një reklamë italiane. Një goxha karton nja gjysmë metër dhe ajo pamje qenkësh gjoja në Shqipëri. Atje dukej njëfarë lokali fantastik, nën një fabrikë birre, me një kopsht plot drurë e lule. Njëpër disa disqe bojë argjendi, vajza të stisura si prej qelqi, gjysmë veshur e gjysmë zhveshur, servirin gota me birra plot shkumë të bardhë...

Ky lokal kudo mund të ishte, po në Shqipëri kurrrë.

U habita kur Shabani, shokun nga qyteti që kishte në krah, e thërriste thjesht «Hekurxhi». Ky po i thoshte:

— Në Vraninë duan të mbajnë fjalime për atë farë fushate elektorale me kërbaç që duan të bëjnë. Do të bëjmë qmos dhe planet që kanë t'ua hedhim kokëposhtë. Sot duhet kujdes, njëpër turmë ka edhe agjentë.

Para meje kalonte një djalosh ezmer, shitës ambulant, me një tezgë në duar, të zbukuruar me reklama gazetash.

Kishte edhe reklama të tjera, që mburrnin basmat japoneze, shkrepëset suedeze, bakaloron norvegjeze, penjët amerikanë e çamçakëzin holandez. Në një reklamë tjetër dukej një artiste.

Kaluan një grup të rinjsh. Nga kapelat me inicialet metalike njiheshin që ishin studentë të liceut. Këta në fillim m'u dukën ca si kapadainj. Dalloheshin nga punëtorët se flitnin me thumba dhe me fjalë frëngjisht. Njëri tha njëpër dhëmbë duke u tallur: «L'oratër mysjy Martini prononse yn diskurs...»

Nën ahishtat kishte zënë vend një orkestër e shoqërisë së rrobaqepësve. Buçiste kënga «Një ditë

shkova nga Drenova». E këndonin disa djem e vajza. Sa mbaroi kjo, erdhi e gjëmoi fort e më fort një këngë e njohur, që këndohej me një dëshirë e duf të papërmbajtur:

*Sot lipset me flamurë,
Malit të dalim,
Përmbi shkëmbinj e gurë.
Lirinë të ngjallim!*

Se mjaft në robëri...

Vargu «Se mjaft në robëri» këndohej më fort. Kur mbaroi kënga, Mandul Kovaçi zgjati dorën dhe kërkoi t'i jepnin një kitarë. Mua m'u bë zemra mal kur të gjithë po hapnin sytë që Manduli po i binte aq bukur kitarës. Në një çast Manduli më shkeli syrin. Menjëherë e kuptova. Ai po luante një këngë «të ndaluar». Hekurxhiu i shkoi pranë dhe pastaj atje u grumbulluan gjithë ata njerëz. Gojë më gojë e vesh më vesh shkoi fjala dhe ashtu e ndjeva veten në një rreth të madh punëtorësh e punëtorësh që dëgjonin me vëmendje dhe nderim atë që Hekurxhiu e quajti «Kënga e punëtorëve të të gjithë botës». Qe hera e parë në jetën time që dëgjoja «Internacionalen».

U ndje një fishkëllimë. Njerëzit nisën të përhapeshin, por kënga atëherë kishte mbaruar. Me sa dukej, do të ishte afruar ndonjë njëri i dyshimtë. Pak më tej, nën hijen e një lajthishteje, një palo burrë kishte kurditur një gramafon, prej të cilit dëgjohej një këngë e çuditshme në gjuhën tonë:

*Me automobil njëherë,
Kur udhëtoja në Shqipëri,
Zuri frynte dhe një erë,
E pastaj një vesë shi...*

Hekurxhiu i foli ngadalë Shabanit:

— Pas disa aktiviteteve do të kemi një mbledhje, thellë në pyll.

Ikëm më tej me Shabanin e me Hekurxhiun. Ky më tha:

— Po ti, do të lozësh futboll?

— Futboll! E ku ka futboll këtu!

— Ka, posi, do të të fut unë.

Te hija e një ahui po pignin një dash. E vërtitnin në hell nja dy djem të moshës sime, por, meqë u hap fjala se do të luhej futboll, ata donin të lëshonin hellin. Njëri prej tyre fshiu duart me një pece e tha:

— Mishi i dashit u poq.

Hekurxhiu ngriti supet, kurse Shabani u përkul, e përkiti mishin dhe tha:

— Po ta hiqni që tani nga helli, ka rrezik që dashi të lëshohet dhe të kullotë në lëndinë!

Hekurxhiu më vuri dorën në sup dhe më shtyu miqësisht drejt asaj fushës ku do të luhej futboll. Që pas ferrave dolën ca djem me të mbathura të shkurtra, disa kishin lidhur edhe nga një shami në kokë. Unë hyra ashtu si isha, por, sa u ndodha në mes të lojtarëve, gati m'u çapëluan sytë. E kujt mund t'i shkonte mendja! Mu në mes të fushës hyri një lojtar kokroç, që ishte prift me mjekër, me raso mbi trup e me kamillaf në kokë. Prifti ishte tepër i ri e shumë i shkathët, sepse me t'u shkëlmuar topi, u vërsul pas tij me aq vrull e me aq shpejtësi,

sa unë në fillim s'u besova syve. Eh, ç'gaz plasi anekënd. Britma e thirrje nga të gjitha anët.

— O papa Stefan, bjeri, ore, më të lumtë ajo këmbë!

— More, po ky qenka për centërfor me «Skënderbeun» e qytetit.

— Aman, ore, gjeni edhe një hoxhë dhe futeni portier!

Priftin e kisha kundërshtar. Unë u ndodha mbrojtës e ai m'u vërsul drejt me top përpara. Ishte rrezik të na shënonte gol. Unë iu vërsula t'i merrja topin. Ai më gënjeu, unë s'iu ndava e ia shkula nga këmbët. Kur, ç'të shoh, ai e harroi lojën, m'u vërsul e më puthi në ballë.

— Hë, më të lumtë!

Duke u ndodhur para një së papriture të tillë, unë ngrita duart dhe i kapa mjekrën e zezë pis, por ajo më mbeti në duar!

Të gjithë qeshën me lot. Vetëm atëherë e kuptova se Stefani qe veshur prift për t'u tallur.

Pikniku mbaroi vonë në mbrëmje.

Kur u ndamë me punëtorinë e qytetit, dëgjoja që shumëkush përshëndeteshin:

— Mirupafshim në panair!

— Mirupafshim në Vraninë!

Edhe mua m'u kujtua se kisha lënë fjalë me Lengon të shkonim bashkë në panair, por, nuk e di pse, kur dëgjoja këtu fjalët për takimet në panair, më erdhi përbrenda njëfarë turbullimi.

* * *

Sa më shumë afrohej dita e panairit, aq më shumë ndieja një shqetësim e një ankth të papër-

mbajtur. Mendoja se këtu diçka do të ndodhte, këtu diçka do të përplasej, dikush do të ndeshej. Po kush? Si? Edhe Shabani e priste me padurim këtë ditë. Kaq herë më foli për panairin dhe më këshilloi që atë ditë të isha i gatshëm për çdo të papritur.

Siç treguan ngjarjet, vajtja ime në panair u pengua dhe kaloi nëpër disa ngjarje e rrethana fare të papritura. Një ditë para panairit u hap fjala se në fshatin tonë do të vinin dy «miq» të pafuar, që do ta kalonin natën te Pando Qerja, i cili i pati gri-shur për darkë dhe se të nesërmen në mëngjes do të shkonin edhe ata në Vraninë.

Të dy «miqtë» e padëshiruar ishin prefekti i krahinës, Hasaf beu, që kishte sjellë edhe një xherah me vete dhe At Mikail Bakëri.

Kur dëgjova emrin e këtij të fundit, më shkuan të ngjethura gjer në fund të këmbëve. Me të kisha për të larë një hesap, që ishte i vjetër shtatëmbëdhjetë vjet, sa edhe moshë ime.

Kur unë edhe s'kisha sosur në këtë botë, At Bakëri (që asaj kohe ende s'ishte graduuar, por shërbente si famullitar në fshat) na takon në udhë nënën time, që ishte e rënduar me mua në bark. At Mikaili ngre dorën atërore (nëna ime ishte tërhequr një çap pas si e trembur), e uron dhe e bekon.

— Djalë e ke, por që në bark të ka tretur e të ka ligur dhe s'të paska lënë dhëmb në gojë, — shtoi pastaj. — Kur të rritet ky, mjerë ti.

Unë po erdha në jetë, kumbarja më çoi në kishë, mbështjellë me shpërgënjë, për të më pagëzuar. Engjëjt krahëdritë vërtitëshin nëpër tavanet e kishës, duke pritur me padurim se si do t'i vihej emri «atij zevzeku që s'i kish lënë s'emësh dhëmb në gojë», kur... (më thonë se ka qenë një dimër i rën-

dë, me veri e cingërima) kur në qyp ishte hedhur uji i nxehtë i pagëzimit. Mirëpo asnjë dorë s'mund ta provonte atë ujë, sepse ndotej nga duar mëkatare. Kështu që At Mikaili më lëshoi drejt e në qyp...

Edhe sot e kësaj dite, kur priset koha, dua s'dua unë, më futen në kokë disa turrjela, që më kujtojnë se ç'hata duhet të më ketë gjetur atëherë, kur isha fëmijë trijavësh...

Kur At Bakëri me Hasaf beun shkuan te Pando Qerja, mua më thirri Shabani:

— Bëj si bëj dhe futu në bahçen e Pandos, mbaj vesh ç'thonë e ç'kanë ndër mend të bëjnë.

Kur ra nata e plotë, duke kapërcyer gardh më gardh e mur më mur, u gjenda në bahçen prapa shtëpisë. Duke shkarë nëpër trapët e fasuleve, duke shkelur ca bimë domatesh që lëshonin një erë të fortë, vura syrin te dritarja e dhomës së miqve.

Ishte një dhomë e ulët dhe e gjerë, me një sërë dollapësh që kishin zënë krejt faqen e një muri. Dollapët ishin lyer me bojë çiviti e me njolla të errëta. Hasaf beu kishte një kokë të madhe shinike e mustaqe të varura poshtë si gjysmëhëna e turkut. At Mikailin e kisha parë edhe herë të tjera, por tashiti mjekra e tij si fshesë sikur ishte pudrosur e rralluar.

Nga bisedat e tyre mësova se i jepej rëndësi e madhe fjalimit të zotit Martini në panair, se duhe-shin marrë masa për të mbajtur qetësinë dhe rendin publik. Pastaj u hodh Pado Qerja:

— Kemi këtu në fshat nja tre a katër kokëkrisur, që duhen lidhur një sahat e më parë, këta janë...

— Takor, takor, — ia ktheu Hasaf beu, — por s'duhet të harrojmë se jemi mu në valë të fushatës

elektorale dhe, sa të mbarojnë votimet, nuk duhet të arrestojmë njerëz, më tutje shohim e bëjmë.

— Po dale, zoti prefekt, këtu kemi edhe njëfarë çunaku që na nixjerr shumë ngatërresa, flet kundër regjimit...

— Cilin, more? — pyeti At Bakëri.

— Të birin e Cikos, uratë.

— Atë vithedjegurin?

— Tamam, pikës i ke rënë.

— Epo çfarë?

— Është bërë i rrezikshëm. Ka qenë çirak në Tiranë, atje e kanë plasur edhe në burg.

— Jaaa!

— Po, po. Pale, po që në këtë moshë, shtatëmbëdhjetë vjeçët s'i ka mbushur, i bie më qafë edhe një vajze...

— Shiko, shiko...

E, duke u menduar një çast, lëshoi vendimin që më tërhoi:

— Ky çunaku të thirret dhe të ngarkohet që nesër të kullojë pelën time në fushë. Kështu ia presim rrugën e panairit e s'kemi kokëçarje prej tij.

— Po sikur të mos pranojë, se unë ia di kokën atij.

— Kam dy xhandarë këtu, zoti Pando, — tha prefekti.

Më tej bisedën e tyre e nxehu dollia dhe unë ika me vrap e të Shabani. Ia tregova të gjitha, edhe vendosmërinë time për të qenë domosdo në panair.

— Patjetër, — më tha ai, — nesër në panair.

Duke rendur për në shtëpi, gjeta Lengon në rrugë. Pa i thënë asgjë, ajo u shtrug pas meje dhe i shkova krahun pas belit.

— Lengo, nesër në panair, — dhe ika me vrap.

Më dukej sikur fluturoja nëpër rrugët e fshatit. Në shtëpi gjeta atë që prisja. Në të hyrë, nëna më tha:

— Dërgoi fjalë kryeplaku, nesër të kullotësh...

— Nuk vete, sikur qeni qepën të hajë, kështu thuaj.

Rashë të flija, por nuk vura gjumë në sy. Gjyshja po arnonte thesin, me të cilin do të blinim misër në panair dhe diç kuvendonte me vete për misër, për basmë, për penjë e ku ta di unë se çfarë, sepse në prag të fushatës elektorale ishin përhapur fjalë se në panair do të vinin tregtarë japonezë, që do t'i lironin basmat e tyre, pastaj thuhej edhe se do të shitej misër me të lirë.

— Do të nisem edhe unë për në panair, — tha nëna.

Shtrati nuk më mbante më dhe u ngrita. Ishte ende natë. Nëpër fshat po ndizej ndonjë gazanik. Krisi një portë, u hap një kanat, muati një lopë. Dola në oborr dhe nisa të sillesha nëpër të. Nëna flinte, dhe unë që isha shumë i shqetësuar, nuk dija nëse duhej ta zgjoja edhe atë. Dal njëherë nëpër fshat, më shkrepni në mendje.

I hoqa llozin portës dhe e hapa. Përpara kisha një xhandar që mbante për kapistre pelën e zezë të At Bakërit. Me atë kapelën me Z-në metalike, me rripin shkuar nën mjekër, me pushkën peshë në dorën tjetër e me një surrat të palarë e tërë sklepa, ai më tha:

— Ti je ai që nuk zbaton urdhaat?

— ...

— Mbath shpejt opingat dhe marsh përpara! Po s'u binde, keq për vete, unë kam urdhra të prera.

— Zoti xhandar, — ia ktheva, — kaq rëndësi të madhe i vë prefekti kullotjes së pelës?

— Jo, jo, s'është puna vetëm aty, ti je një kokë-krisur dhe duhet që domosdo autoriteti shtetëror të ta thyejë hundën. Hajde, marsh përpara!

I fola nënës duke u shtirur i qetë, i urova rrugë të mbarë, shkova nga hajati e futa në torbë një palë pranga kali. Kapa pelën për kapistre dhe u nisa për te logu im, atje tek ara me patate, atje ku kishim prerë plepin plak, meqë na kishte krisur trari i shtëpisë. Nëna po më jepte porosi, por unë i dëgjoja veresie.

Xhandari më vinte pas këmba-këmbës, pas bishtit të pelës. Koka më ziente, inati më tërbonte e mijëra e mijëra mendime e plane më vërtitëshin në kokë. Ikja përpjetë me pelën pas vetes e me xhandarin pas pelës. Njëpër errësirën e natës, kambanat e kishës ia nisën tingëllimit me të madhe. Ishte shenja se njerëzia duhej të niseshin për në panair.

Dita u hap fare, por xhandari s'më ndahej. Dëshja t'ia hidhja dhe atëherë shkova te një mezhde, ku pela gjeti bar skrips, shkula disa rrënjë lulesapuni dhe, duke hedhur çapet ngadalë, u drejtova te burimi. Atje u përkula dhe nisa të lahësja. Shkuma e lulesapunit më mbuloi krejt fytyrën. Bëra ta shihja xhandarin njëpër të, por xhandari kështu nuk dukej. Në vend të tij pashë me mijëra e mijëra ylberë të vogla.

Edhe se shtihesha si i shkujdesur dhe me mendje të fjetur, xhandari s'kishte ndër mend të largohet. Atëherë, erdha që erdha. të bëj një punë, thashë me vete: Vendosa të mbillja plepin e ri në vend të atij të vjetrit që e kishim prerë me sharrë. Gatita një degë, pastaj hipa mbi cungun e plepit të prerë,

hoqa opingat dhe çorapët. M'u njomën shputat nga lotët e plepit. Për të hapur njëfarë brime, vura thembrën e këmbës mu në zemër të cungut. Palca e tij ishte e butë dhe m'u kujtua loja e fjalëve «plepi plak i plasur pak palcë ka pasur». Duke i mëshuar trupit, nisa të rrotullohesha duke rrahur me shputën e këmbës tjetër cungun e prerë për të hapur brimën. Lëvizjet e mia u dendësuan, po vërtitesha si të isha një fugë.

Kur brima u hap sa duhej, bëra të qëndroja. Pak çape më tej po vërtitej xhandari duke kruar hundën. Kur ngula degën në zemrën e plepit plak dhe po e ngjishja fort, atëherë ai m'u afrua.

— Shih këtu, nëse e lë pelën dhe ikën, ja... — tha dhe më tregoi kamxhikun.

Por, sa ktheu ai bërrylin e udhishtes së arave, unë nxora nga torba prangat e hekurta dhe, duke e fërkuar pelën në jele, i thashë:

— Këto pranga janë për tët zot!

Ja shkova ndër këmbë dhe ia dhashë vrapit për në panair. Jo rrugës, as mezhdave, por çaireve, lëndinave, kodrave e brinjave. Vrapoja si i çmendur për në panair. Nën çapet e mia thërrmoheshin e bëheshin copë-copë ata plisat e trokuar të ugareve, vërsulesha nëpër vreshta, kapërceja përrenj e hendeqe.

Lart, në majat e kodrave, dilte ndonjë druvar e çapëlonte sytë pas këtij të ndërkryeri që ikte si i tërbuar.

Diku m'u lëshuan qentë e një kopeje. Një bari futi gishtat në gojë dhe fishkëlleu me të madhe.

Kur kalova afër tyrbes së meleqit Sadedin, te Kodra e Lajthishtes, më zuri syri diçka të pazakonitë dhe qëndrova. Oborri i madh i saj ishte i rrethuar

me avlli të lartë, vende-vende të rrëzuar e të mballosur me ca teneqe të vjetra brima-brima. Brenda në oborrin e madh kishte zhurmë e thirrje. Një avlli ishin ndehur lëkurë qengjash të posatherur, prej të cilëve ende rridhnin pika gjaku. U kujtova. Atë ditë, në oborrin e kësaj tyrbeje parësia e krahinës do të bënin synet çunat. Prandaj e kishte sjellë Hasaf beu xherahun. Darkë te Pando Qerja, festë në panair dhe domosdo orgji e qengja të pjekur për synetet e kalamajve!

U afrova edhe më dhe vura syrin në brimën e një teneqeje. Përtokë ishin shtruar nja pesëdhjetë e ca rrogoza e nja dhjetë qilima dhe përmbi ta sofëra rrumbullake, rreth të cilave ishin shtruar gjithë ata njerëz. Në krye të tyre ishte ulur vetë prefekti, zoti Hasaf beu. Në një qoshe, rreth një legeni të madh me bark të zi, shtyheshin ca njerëz të mbathur me poture. Një hoxhë diçka mërmëriste nëpër dhëmbë, kurse xherahu po përgatiste veglat. Fëmijët qanin e sokëllinin si keçerit kur u vënë thikën në grykë.

U tërhoqa dy-tri çape, pastaj vura edhe një herë syrin te brima e llamarinës së ndryshkur. Prefekti ishte tashti i rrethuar nga gjithë ata nënprefektë e kryetarë komunash, xhandarë e bejlerë, që i rrinin me dorë në zemër, i buzëqeshnin atij e ishin gati t'i puthnin dorë e këmbë e t'i bëheshin postiqe.

Erdhi e m'u mblodh një inat si lëmsh në grykë. U vërsula pas jazit. Medoemos në fund të tij do të ishte një mulli dhe aty duhej të kishte një kazmë a një shat. Ja edhe shati i mullixhiut, varur në një shelg. Një ta rrëmbyer e nisa të hapja një kanal të cekët, duke qëlluar me shat ledhin e jazit. Toka ishte e lagësht dhe punohej shpejt.... Ujërat e jazit ndë-

rruan rrugë e iu lëshuan lëndinës tatëpjetë drejt tyrbes.

Hipa në një lis me kurorë të dendur dhe prita. Tyrben dhe oborrin e saj i shihja si në pëllëmbë të dorës. Kaluan vetëm disa minuta dhe ujërat vërshuan nëpër ato avllitë e rrënuara. Në fillim askush nuk pikasi gjë, por pastaj dikush bërtiti: Hata! Ç'është kjo hata? Nga plasi ky ujë?

Nëpër oborr një pështjellim i tërë. Të gjithë zunë të dilnin turravrap. Zbrita nga lisi dhe ia mora vrapit përpjetë.

Më në fund hyra në pyllin e manastirit. Zhurma e panairit këtu dëgjohej fare qartë. Nëpër korijen e dendur, fshatarë të ardhur nga gjithë krahina kishin lidhur pas drurëve gomarët.

Edhe disa çape dhe hyra në truallin e manastirit, ku do të bëhej panairi. Oxhakë e forma nga më të ngatërruarat, copëra çatish trikëndëshe, mbuluar me qeramidhe, më tutje me dërrasa e më pak me llamarinë të vjetër brima-brima. Baxha të pluhurosura e të nxira. Ndërtesat e manastirit, të vendosura si njëra mbi tjetrën, shtrembër e dosido, pastaj oborre të gjata, hajate e labirinte, kisha e faltore, kopshte e kalldrëme. Diku ishte njëfarë pellgu, në njërën anë të të cilit gufonte një burim dhe në fundin e kulluar të ujërave me mijëra e mijëra pare, që nga mexhidet e turkut, koronat e Austrisë e deri te dhrahmitë me brima të grekut, që ishin hedhur nga besnikët kushedi që kur, për të shpëtuar nga hallet e sëmundjet.

Anembanë vinte era e temjanit dhe e blozës. Nga rrëmuja po më ziente koka e po më merreshin mendtë. Kambanat buçitnin e gjëmonin me të madhe. Kurrë ndonjëherë s'kisha dëgjuar aq zhurmë,

thirrje e britma, kurrë s'kisha parë aq sende e tregtarë, s'kisha dëgjuar të tingëllonin ashtu kambanat e, së fundi, kurrë s'kisha pasur në kokë brenga e dufe, që më bënë të mos më zinin këmbët dhë.

Nëpër njëfarë trualli ishin ngulur disa tezga të shtrembra, rreth të cilave ishin mbledhur shumë njerëz. Atje ishin llotaritë me pendë. Të zotët e tyre thërritnin e reklamonin:

— Riksi-fiksi lot Tomiksi! Roksi-foksi lot Sotir Boksi! Provoni fatin! Sahati këtu! Shishja, e berrës këtu! Vini shumë, të merrni shumë! Provoni fatin në panair...ja, penda qëndroi edhe këtu... ne trembëdhjeta, na qenka fati i ustait.

Mendoja se diku afër do të gjeja Shabanin, por jo. Veçse në çdo çap që hidhja, dalloja djem e vajza nga qyteti, midis të cilëve edhe shumë nga ata që i kisha parë e njohur në piknikun e shoqërisë «Puna». Tashmë e kisha të qartë. Këtu diçka kishte për të ndodhur. Papritur u dëgjua zhurma e një daulleje, që gjëmonte me të madhe. Renda andej... E ç'të shihje! Ishte daullja e madhe e bashkisë dhe tellalli i saj, që nisi të bërtiste: «Hej, popull e kallaballëk, sot pasdite, sahati nëntë allaturka, zotëria e tij Martini, i dërguar nga Naltmadhnia, do të mbajë një fjalim me rëndësi! Popull e kallaballëk, vini vesh e dëgjoni, mblihduni pasdite te sheshi i manastirit, se vjen zotëria e tij... vini vesh e dëgjoni, sot këtu në panair qeveria do të sjellë misër që do shitet së liri... vini vesh e dëgjoni, do vijë të lozë edhe pehlivani i Kosturit... sahati më nëntë allaturka....

Prapa meje thirri një xhandar:

— Sallaaa, hapuni! Kalon i biri i zotit prefekt!
I biri i prefektit, një djalurçinë në moshën time, me prenka në fytyrë, si i spërkatur me hashure, po

shtynte një biçikletë, që ishte një mjet i rrallë asaj kohe, me një timon të përdredhur si brirë dashi. Mbi timon kishte varur gjithë ato sende që kishte blerë në panair: kukulla kauçuku, muzika goje dhe një dardhë llastiku, nga ato që populli i quan «tollumb për klizmë».

Por në çast sekush ia preu rrugën dhe djalurçina kapi tullumbin dhe e shtrydhi. Unë prisja që prej tij të dilte ujë i ngrohtë, përzier me sapun, kur doli një si britmë grifshe. Vetëm atëherë e kuptova se ajo dardhë llastiku vlente si bori.

Më në fund e gjeta Shabanin. Më hoqi mënjanë dhe më porositi: Pasdite, kur të flasë ai Martini, do të ketë shumë njerëz që do ta kundërshtojnë. Ti zër një vend atje nën kabanat e mëdha e, kur të ta bëj unë me shenjë, nis e bëj zhurmë, duke tërhequr litarët e kabanave. Po përsëri dil këtej. Tashti shëtit poshtë e lart dhe gjurmo Pando Qeren, nga do të shkojë, me kë do të takohet dhe çfarë do të thurë me ata që do të takohet.

Ja dhe pazari i basmave. Këtu ishin grumbulluar shumë njerëz, që prisnin ardhjen e tregtarëve japonezë, të cilët, sikurse thuhej, do t'i ulnin çmimet. Por gjer tashti ata s'ishin dukur. Dola nga pazari i misrit. Këtu ishin mbledhur nja dyqind gra nga fshatrat tona, veshur me fustane të gjata të zeza, me shami edhe më të zeza në kokë, me duart lidhur në gjoks e me ca thasë të vjetër nën sqetull. Midis tyre dallova edhe nënën time. Ato nuk flitnin fare. Vetëm prisnin dhe vështronin me habi tregtarët pasticerë, që reklamonin me të madhe ca rrotullame të mëdha të verdha, që i quanin «bukë sheqeri».

Përsëri u nisa për të gjetur Pando Qeren, por më shkoi mendja te Lengoja. Nuk e kisha më mend-

jen te krekat. Ai mendim tashti më dukej i largët e gati qesharak, sepse më kishte hipur ethja e ndeshjes me Hasafët, me Martinët e me Pando Qeret! Tashti Lengon, nëse dëshiroja ta gjeja, e doja për ta vënë edhe atë në punë. Një ndjenjë e çuditshme më ngacmonte dhe më ngucte ta kisha pranë.

Isha te porta e madhe e kishës. Përsëri më ra në hundë era e temjanit dhe e qirinjve të djegur. Brenda po këndohej mesha e dëgjohej zëri prej basi i priftit:

«Për ata që udhëtojnë, lundrojnë, për të sëmurët, vuajtësit, robërit dhe për shpëtimin e tyre le t'i lutemi zotit! Për mbretin tonë. Zogun e Parë, të ndershmin dhe...»

Hyra brenda. Kisha ishte e mbushur plot e përplot. Mu në krye, në rreshtat e parë, ishin tregtarët e rëndë të qytetit, me nga një llambadhe të madhe në duar.

Mesin e kishës e kishin zënë gratë e tyre, të veshura sipas modës. Fytyrat i kishin pudrosur e llanosur me gjithfarë kremrash e parfumesesh. Në kokë mbanin kapele me pendë palloi dhe rreth qafës nga një lëkurë dhelpra, me gjithë bisht.

Çudi si i mbanin ato kunadhe e dhelpra rreth qafës më 22 të korrikut, në pisk të vapës.

Kur dola jashtë, nëpër oborr pashë disa dërrasa të zeza (si ato të shkollave) e sipër tyre libra fetarë që jepeshin falas nga një misionar amerikan. Lexoja disa tituj: «I krishteri në botën e mëkatit». «I krishteri në botën e amëshimit» dhe ika më tej, të gjeja Pando Qeren, që kushedi ku jepte fajdera e kurdiste hilerë.

Ndodhesha tashti mu prapa kishës, nga hyrja e grave. Këtë anë e kishin bllokuar për arsye tregtare

të ditës. Aty epitropi i Shëndëllisë, një burrë gjash-tëdhjetë vjeç, me kokë të zbuluar, me leshra të thijnjura, të prera karé, zevzek e dinak, që kundërmonte erë temjan, parafinë e tallash të mykur, po shiste temjan dhe kuleçë dylli, të nxjerrë nga mbeturinat e qirinjve të djegur. Shiste edhe bakëm, edhe vaj të mbetur nga kandilet, edhe qirinj të saktë. Njëpër disa kërraba të ngulura në mur ishin varur ca kazanë të vjetër të nxirë, që prisnin klientë për t'i blerë. Kur pitropi merrte paret, u thoshte klientëve:

— Ju qoftë ndihmë!

Dola nga ajo anë ku shiteshin gramafonë. Ata i kishin radhitur njëpër rafte me ngjyra të errëta e tregtarët thërritnin markat e tyre. Disa syresh ishin kurdisur dhe këndonin këngë e avaze të vetat. Këtu pashë edhe kurrizin e Pando Qeres. E nioha menjëherë nga zverku si i muzatit. Si dukej, Pando Qerja do të blinte ndonjë gramafon. Iu avita, duke pasur mendjen që të mos më shihte. Kryeplaku shihte herë gramafonët me hinkë e herë ata pa hinkë. I pëlqenin më shumë ata me hinkë, sepse ishin më të lirë. Ai hahej në pazar dhe kruante mjekrën, ndërsa gjilpërat e gramafonëve çirrnin e gërvishtnin pllakat, që nga dilte një sallatë këngësh.

*Bebi, s'ka financa, Bebi,
Jemi hollë, Bebi,
Qesatllëk i madh...*

— Pa vini një këngë turçe, — tha Pandoja, — dua të dëgjoj një këngë turçe.

Tregtari ia plotësoi dëshirën.

Nisi të dëgjohej një hanëme me një zë të dredhur e të zgjatur, tepër hundor.

Por edhe me këtë nuk u kënaq Pando Qerja.
— Pa më vini një këngë grekçe, të shohim si do ta këndojë, a do ta nxjerrë zërin mirë.

Aniksi dhen ehi
Qe dhen zestenomaste...

Prapa nesh u dëgjua një shitës gazetash që nisi të thërriste:

— Gazeta me lajmet e reja!

Dikush e nduku gazetashitësin për xhakete:

— Po misër, more, a do të vijë?

Ai ia ktheu në poezi:

— Po vjen misër me pamporë, mbani barkunë me dorë!

Pando Qerja nuk i dha karar të blente gramafon dhe u takua me kryepleqtë e dy fshatrave të tjera. Njëri prej tyre i tha:

— Shkojmë e ngremë nga një kupë, se ka meze të mirë.

U vura pas tyre. Nisën të bisedonin:

— Pasdite, në kohën që do mbajë fjalimin zoti Martini, duhen hapur sytë, mund të ketë shamata-xhinj...

Kjo më duhej. Renda të gjeja Shabanin.

Ngado që kaloja, dëgjoja copëra bisedash. Një-rëzit prisnin misrin që u kishin premtuar qeveritarët, por makinat akoma nuk po vinin.

E takova sërish Shabanin që vente e vinte nëpër panair bashkë me Hekurxhiun. Ky më dha dorën fort dhe më rrahu supin. Shabani i tha:

— E kemi djalë të mirë, veçse... nganjëherë i zien gjaku më shumë se ç'duhet...

Unë s'dija si t'i merrja këto fjalë.

Te një qoshe Mandul Kovaçi ma bëri me shenjë, tundi vetëm kokën, sepse ishte duke i rënë kitarës dhe nja njëzet e ca djem nga qyteti i ish-in mbledhur rreth. M'u duk sikur ata donin t'i «blinin» shpejtësinë me të cilën ai i binte kitarës, por pastaj vura re se ata kishin më shumë dëshirë të dëgjonin «Këngën e ndaluar». Edhe Rrok Prizreni. aty ishte, tok me të dhe djali i Shabanit.

Ai m'u afrua dhe më tha:

— Ty të kërkonin nga livadhet, nga dole në panair?

— E kush më kërkonte?

— Lengoja me dy shoqe.

— E ku i takove ti?

— Tashti po vinin në panair.

Renda te korija përbri, nga vinte udha prej fshatit tim. Atje pashë edhe një herë turmën e madhe të gomarëve, që ishin lidhur fshatçe, një grup këtu e tjetri matanë. Në një rrugë kumishte që gjarpëronte nëpër krekat, dallova vajzat. E takova Lengo dhe i thashë që atë pasdite të më vinte pas, te kambanat e manastirit.

Kur hyra sërish në panair, kalova nga pazari i litarëve. Edhe këtu më doli përballë Pando Qerja. Ishte i përhumbur pas mallit që do të blinte dhe po e maste me pashë. Shitësit mbanin në duar nga një copë litar që e ngrinin lart duke thirrur, me damarët e qafës të kërcyer.

Papritur u dëgjua një zhurmë e largët dhe në xhadenë që vinte nga qyteti po ngrihej një pluhur i dendur.

— Erdhi misri. Erdhi...

Turma e njerëzve u derdh për andej. Renda edhe vetë.

Vërtet, tej arave me misër, andej nga gjarpëronte xhadeja, tymi ngrihej përpjetë si një fjollë e gjatë dhe e dendur.

— Erdhën kamionët. Erdhën.

U ndje era e tymit që dilte nga skapamentoja dhe para nesh shkau gati me vërtik një veturë e zezë «Chevrolet», nëpër xhamat e së cilës u dukën një çast syzet me r Rathë ari të zotit Martini.

— Epo domosdo, kandidati për deputet vjen përpara, misri vjen pas, — gesëndisi dikush aty pranë.

— Ja, ja, — doli edhe një kamion të kthesa, doli!

Një kamion «Ford», i mbuluar me mushama, u duk te kthesa. Turma u lëshua në rrugë dhe kamioni frenoi në vend.

— E ç'do na bëjë neve një kamion me misër?

— Të tjerët vijnë pas.

Në krah të shoferit ishte një oficer madhor zogist, me shumë grada e nishane në gjoks e në grykë. Ky nuk donte të zbriste këtu e bënte shenja të hapej rruga, por, kur askush nuk po tundej, ai pa ç'pa dhe zbriti rëndë-rëndë. Ishte i veshur me uniformë parade, por, ngaqë ishte i shkurtër, shpatën e futur në këllëf, që i varej në gjithë ata rripa nga beli, e mbannte me dorë.

— A sollët misër, zoti kolonel?

Por koloneli, mospërfillës e vetullulur, mori rrugën më këmbë për në manastir. Atëherë njerëzia u shtynë rreth kamionit.

— Të shohim ç'ka brenda!

— E hapim dhe e ndajmë vetë misrin!

Shoferi po ngrinte supet, kur njëri e shkundi për xhakete.

— Fol, more ti, ç'ke brenda?

Në vend të përgjigjes, shoferi doli prapa kamionit, hipi në spond dhe ngriti mushamanë.

Në spondin e pasmë u dha një njeri me një valixhe të vjetër në dorë. E njoha në të parë: ishte xherahu që kishte sjellë prefekti. Pas tij doli një saze-xhi me një qemane në duar, pastaj një tjetër me dajre dhe një çengi ezmere me leshra të gjata. Nga errësira e karrocërisë së mbuluar dolën edhe ca miza të mëdha, nga ato që pështyjnë mishin... Brenda ishin lëkurët e qengjave që ishin theruar te tyrbja e melecit Sadedin. Po prefekti ku ishte? Ku kishte shkuar vallë? Përse nuk u duk në panair? Po At Bakëri ç'u bë?

Atëherë sekush doli i mençëm dhe tha:

— Kamionët me misër do të vijnë pas fjalimit të zotit Martini, sepse, ndryshe, njerëzia do të lëshoheshin pas misrit dhe askush s'do dëgjonte fjalimin.

* * *

Vonë pasdite, kur u përhap fjala se misri «do të vinte pas fjalimit», në sheshin e madh të manastirit u grumbulluan shumë njerëz, fshatarë të veshur me rroba të zeza shajaku, gra me fustane të zeza sateni, djem veshur dosido e me opinga llastiku në këmbë. Vetë shkova afër kabanave dhe me sy e gjeta Shabanin që rrinte përtej. U pamë sy më sy në heshtje. Më në fund, zoti Martini doli nga një ballkon i manastirit, pas tij koloneli e pastaj me radhë At Mikail Bakëri dhe Hasaf bej prefekti, të cilët as i pa njeri nga erdhën e nga dolën.

Martini hapi disa herë duart lart; si përsëritje, pastaj ia nisi:

— Të dashur fshatarë të atdheut tonë. Ju sjell

përshëndetje nga naltmadhnia e tij, Zogu i Parë, mbreti i shqiptarëve! Së pari, qetësohuni, kamionët me misër do të vijnë. Për këtë kam njoftim të saktë nga Tirana... Janë marrë gjithashtu masa që pas-këtaj, nëpër dyqanet të ketë me bollëk kinino, sulfato, vaj bajamesh e vaj recini, të ketë ilaç për këlbazën e dhenve dhe rrotka me penjë...

— Misër, ore! Misër, do të vijë?

Zoti Martini u shti sikur s'dëgjoi gjë.

Mes turmës u ngrit i fortë zëri i Shabanit, por fytyrën nuk ia pashë dot gjëkundi.

— Zoti Martini, na mbytët me taksa, vetëm erës s'i keni vënë taksë! Populli po vdes për bukë...

Zoti Martini edhe një herë deshi të merrte fjalën, por nga gjithë turma u dëgjua një kor i tërë thirrjesh. Unë përgjoja të shihja Shabanin dhe të dalloja shenjën e tij. Në një çast sikur pashë kryet e tij, por pastaj sërish e humba. Lengon e kisha pranë dhe ajo herë pas here më pyeste:

— Po tashti, ç'do të bëhet tashti?

Më në fund e dallova qartë shenjën e Shabanit dhe u lëshova nga litarët e kambanave. Por, sa u afrova atje, pak më larg pashë dy xhandarë që më kishin mbërthyer sytë e s'më ndaheshin. Ngeca. Nuk dija nga t'ia mbaja. Po vija vërdallë në pikë të hallit. «Si t'ia bëj, ç'do mendojë Shabani për mua?! Po Hekurxhiu që më rrahu supin dhe më sajdisi si burrë?!»

Si nëpër tym dëgjoja Martinin që ia nisi sërish fjalimit dhe filloi të numëronte «meritat qytetëruese» të regjimit, foli për suksesin e udhëtimit të prince-shave në Evropë, për kishat e xhamitë që do të ngriheshin... Vrava edhe një herë mendjen se ç'duhej të bëja. Në çast u kujtova që aty, fare pranë, njëzet

çape më tej, unë i kisha kambanat e mia edhe më të mrekullueshme. Një të thënë e një të bërë. U vër-
sula nëpër turmë dhe për Lengon as që më shkoi
ndër mend fare. Më kishte kapur ethja e luftës dhe
e hakmarrjes...

Dola në korijet me krekë. Këtu ishin turmat e
gomarëve, të lidhur fshatçe, një grup këtu e tjetri
atje. Shkula nga brezi thikën e xhepit dhe me një
shpejtësi të paparë u preva gomarëve gjithë kapis-
trat. Ata u lëshuan në ikje, kurse unë që prapa u
bërtita vetëm tri herë:

Zdër! Zdër! Zdër!

O, ç'u bë atëherë!

Gjithë zhurma e panairit të asaj dite u provua që
ishte vetëm një vërë në ujë përpara pëllitjeve të go-
marëve. Krejt Shëndëllia dhe korijet anembanë gjë-
monin, kurse turma, që s'mbahej nga gazi, dalngad-
alë u shpërnda dhe zoti Martini, i tërbuar nga inati,
hyri brenda mureve të manastirit dhe më e më as-
kush nuk e pa të dilte.

FARA E MBJELLË NGA NAIMI.

Mont Athosi, si e njeh bota, ose «Ajnor», si ka mbetur në kujtimet e nënave tona, është një gadi-shull në Kalkidiki, krahinë veriore e Greqisë, që laget nga ujërat e detit Egje.

Prej vjetësh që nuk mbahen mend, ky vend i përzishëm i banuar vetëm prej murgjish, ndaluar me ligje e kanune bizantine të shkelte atje qoftë edhe një këmbë gruaje, ka qenë një vend ku mër-gonin për punë fshatarë nga Devolli e Kolonja.

Devollinjtë denbabaden merreshin me prerje drush, djegie kaminash me qymyr, me sharra e zha-ka për qereste, jo më pak edhe me lata të mëdha, me të cilat gdhendnin trarë e makazë.

Kolonjarët, trashëgim brez pas brezi, ishin të

vetmit që me çekanë edhe mistri kryenin punën e muratorëve. Dhe të gjitha ato manastire, ngritur përmbi hone, gremina e rrëpira, që të habitnin me madhësinë e tyre, janë bërë nga duart dhe mendjet e mjeshtërve kolonjarë.

Në masën e madhe të mërgimtarëve që ndodheshin atje në vitet e para të këtij shekulli, papritur u hap një lajm me rëndësi për ta: Me urdhër të padishahut, në Ajnoro dërgohej një qeveritar i ri.

Mytesarifi i ri zbriti në tokë një ndajnatëherë dhe, pa i folur njeriu, pa dhënë dorë e pa përshëndetur, hoqi drejt e në vendin ku e prisnin katër xhandarë turq dhe dorëzuesi i mëparshëm.

Mytesarifi i vjetër kishte bërë gati shkresat dhe një inventar të saktë, për t'i dorëzuar qeveritarit të ri gjithë ato gjëra. Midis tyre ai i dorëzoi me shumë kujdes një sasi «provash materiale» për vepra të paligjshme të punëtorëve shqiptarë. Midis tyre ishin shumë abetare shqip dhe një tog procesverbalesh, me anën e të cilave faktoheshin shkelje të ligjit turk.

Fjalët u përhapën nëpër gjithë ata mijëra shqiptarë që ndodheshin atje, por askush nuk e kishte parë me sy mytesarifin e ri, sepse ai ishte mbyllur brenda në konakun e vet dhe nuk dilte jashtë.

— E çfarë bën qeveritari atje brenda?

— Ku ta dish!

— Ndofta ia ka shtruar me raki?

— Jo.

— Ndofta qan?

— Ç'është ajo fjalë!

— Po çfarë bën atëherë?

— Thonë se rri i kërrusur mbi një trapez, ka përpara një kallamar me bojë e shkruan.

Pastaj nisën të thuheshin fjalë, gojë më gojë e e vesh më vesh. U tha se njerëz të panjohur, natën, si hije dhe hafije, hynin e dilnin në zyrën e tij, u tha se qeveritari nuk vinte pikë gjumë në sy, prishte e përcillte njerëz të panjohur, disa prej të cilëve i niste me det e disa me sterc, pastaj kujdesej për llambën me vajguri e shkruante e shkruante...

Dhe atyre ditëve xhandarët e turkut dhe rojtarët e pyjeve rendnin poshtë e përpjetë duke kapur guximtarë që bënin kontrabandë me lëndë, të tjerë që gjuanin sorkadhe, të tjerë që tregtonin mushka dhe nuk paguanin taksë. Pastaj u kontrolluan dhe u kapën dyqind e ca kolonjarë muratorë pa leje pune, pastaj druvarë që prisnin dru atje ku s'duhej, dhe gjithë ato shkresa turqisht, firmosur me gishta të trashë, shkonin te mytesarifi i ri, i cili, sikurse thuhej, i vinte stivë-stivë përmbi peskunët e drunjtë të zyrës së tij.

Por nuk ishin vetëm këto... Abetaret e shqipësisë që kishte dorëzuar ai që shkoi, sa vinte e po shtoheshin. Edhe këto mytesarifi i ri, pasi u hidhte një sy, i vendoste përmbi peskunët, e nga të gjitha ato, do të pëlqiste një ditë ndonjë gjyq i hatashëm, ku do të bëhej kerdia me burgime, me gjoba, me përzënie e me kontrolle të tjera.

Një kandarxhi grek, që zbriti një ditë nga Selaniku, solli lajmin tjetër... Mytesarifi i ri më përpara na paskësh qenë në Siri me një gradë më të lartë shtetërore dhe atje na paskësh folur e vepruar rëndë e për dënim e kishin sjellë këtu.

Mërgimtarët që dëgjuan këtë lajm, e përqësuan këtë njoftim dhe dolën me mendimin se sundimtari i ri që na paskësh humbur gradën e vjetër, do t'i shtrëngonte vidhat e do të bënte hatanë në Ajnoro,

për të rifituar besimin e padishahut e gradën e humbur.

Thonë se mytesarifi i ri ka kënduar në shkollë të madhe në Evropë, thonë se është i rrezikshëm dhe inatçi, thonë se do t'u vëjë fre të gjithë atyre që s'pagojnë taksat, thonë se do të varë lisave edhe ata murgj që ikin natën dhe kthehen përsëri natën.. thonë e çfarë nuk thonë...

Një pasiguri e tillë vazhdoi në Ajnoro në ato vitet e para të shekullit tonë, për nja tre muaj me radhë.

Pastaj papritur një kolonjar nga Bezhani zbuloi dartë së qeveritari i ri kishte ngulur një rojë në një majë mali, tek ai karakolli i fshehur mes shkurreve, na kishte ngritur një trikëmbësh të madh dhe përmbi të kishte vendosur një dylbi të madhe prej bakri, të gjatë dhe të ndritur, mbi të cilën rrinin ditë e natë roja të armatosura, duke bërë sytë këter e duke pritur me ankth një maunë të zezë që pritëj të vinte nëpër Egje. U tha se ishte dëgjuar aqik qeveritari i ri tek jepte urdhra, që atje në grykën e dylbisë së madhe të mbahej syri i mprehtë, për ta njoftuar në çast ardhjen e asaj maunë të zezë.

Por një ditë, papritur e pakujtuar (ishtë e shtunë më drekë), doli një urdhër i prerë. Këtë e rrëmbyen murgj e druvarë dhe kaloi gojë më gojë:

«Nesër, ditën e diel, më një hosten diell, të gjithë mërgimtarët shqiptarë që ndodhen në malin Athos, burra, djem e pleq, të ndodhen lart te pllaja e malit përmbi manastirin Bilindar!»

Asaj nate nëpër konakët e shqiptarëve nuk pati gjumë fare: «Ç'është kjo mbledhje? Ç'kërkon mytesarifi i ri? Atje në majë të malit do të na e bëjë gjyqin? Atje do të japë dënimet?»

Kur dielli qe ngritur lart, një mijë e ca njerëz u mblodhën në pllajën e malit mbi Bilindar, lëshuan kafshët, të kullotnin anembanë dhe vetë, u shtruan këmbëkryq, grupe-grupe, duke biseduar dhe duke rrahur mendjen për ç'i priste e për ç'do të bëhej.

Nuk vonoi dhe mytesarifi i ri, i pasuar nga tre xhandarë turq, u duk te shtegu i malit. Pas tyre dukej një kafshë samari, ngarkuar me arka dërrase. Grupi i njerëzve që sapo mbërritën çanë përpara. Mërgimtarët u çuan më këmbë dhe vetëm tani mundën të vështronin qeveritarin e ri.

Ai ishte më shumë një djalosh sesa një burrë. Ishte nja tridhjetë vjeç, me një mustaqez të hollë e veshur si në Evropë, me këmishë të ngritur të jaka e me papion dhe në krejt veshjen e tij nuk dukej asnjë shenjë e shallvareve apo e brekusheve turke.

Qeveritari kishte një fytyrë të hequr e njëfarë rreptësie në vështrim. Ai shkoi përpara qetë-qetë, vështroi anembanë mërgimtarët, u bëri shenjë të uleshin shesh dhe urdhëroi që arkat e ngarkuara në kalë të silleshin mu në mes tyre, ku qëndroi edhe vetë.

Mërgimtarët u prenë...

Në ato arka ishin mbledhur abetarët e shqipes, të kapura nga xhandarët e hafijët dhe gjithë ato shkresa për faje e shkelje të ligjeve turke; ishin ato fletë që i kishin lënë pa gjumë për muaj me radhë.

I porsaardhuri akoma s'po fliste. Ai u dha të kuptonin pasuesve që të largoheshin pa hapur fare gojën, ndërsa pesë vetave prej tyre ua bëri me shenjë që t'i qëndronin pranë. Derisa xhandarët kthyen bërrylin të shtegu i malit, ai nuk foli, por vështron-te si i përhumbur mërgimtarët e shtruar shesh.

Pastaj u koll, vështroi anekënd, ngriti edhe më
ndart kokën dhe foli...

Për çudi, ai foli shqip, me një gjuhë të pastër,
me një theks të qartë e me zë të shtruar. Askush
nuk e pandehte që ai të ishte shqiptar!

Vëllezër! Jeta më solli në këtë vend të zi
ku ju punoni dhe vuani... — Njerëzia luajtën vendit,
u afruan më pranë njëri-tjetrit dhe nisën të pësh-
përitnin. — Erdhë këtu, vëllezër, bij e prindër, dhe
bashkë me farmakun që shijova kur ju pashë këtu
kaq të munduar e kaq të lodhur, m'u bë zemra mal
kur gjeta pemët e bukura nga fara e mbjellë prej
te ndriturit mëmëdhetar Naim Frashëri, që ka qe-
në midis fush disa vjet më parë... Më lanë këtu një
vandak me abetare që jua kanë kapur dhe më poro-
sitën që t'ju hedh në gjyq e t'ju zvarrit burgjeve.
Kurse unë, vëllezër, dua t'i përqafoj e t'i puth të
gjithë një për një! Ja ku janë abetaret, brenda në
këtë arkë. Unë i hapa dhe i pashë një për një! Pa-
shë emrat tuaj, shkruar nga duart tuaja mbi këto
abetare, gjeta copa letrash brenda tyre, letra që i
kishit shkruar për në shtëpi, hesape që tregojnë
shtrëngesën dhe gjendjen tuaj të vështirë... Dhe unë
solla këtu sot edhe disa dhjetëra abetare të tjera
dhe do t'ju ndaj të gjitha. Vëllezër! Ju vuani, sepse
mëmëdheun na e ka shkelur turku, këtë mëmëdhe
ne do ta çlirojmë...

Papritur, nga shtegu i malit u duk një rojtar
i panjohur. Ai po vinte duke gulçuar nëpër një rru-
gë thikë përperjetë, me leshra të lëshuara mbi ballin
e përflakur. Ai u dha te pllaja, pastaj, kur u ndodh
ballë për ballë me qeveritarin, i foli shqip:

— Po vijnë.

I panjohuri ngriti kryet edhe më lart, u mendua një çast dhe, pa u nxituar aspak, foli sërish:

— Jam vëllai juaj, punoj për mëmëdheun... Në atë anije që vjen, janë xhandarët e turkut që duan të më kapin... mua dhe dy shokët e mi.

Të gjithë punëtorët, të mëdhenj e të vegjël, u ngritën sakaq në këmbë.

— Ju fshehim ne!

— Ejani në spiletë e maleve, atje s'ka burrë që t'ju gjejë!

I panjohuri buzëqeshi i mallëngjyer dhe hapi krahët.

— Jua di për nder e për të mirë, vëllezër, por nuk presin punët, më presin shokë në mëmëdhe, më presin punë të tjera, se sot mëmëdheu ka nevojë për ne. Do të ikim, vëllezër...

S'e lanë të mbaronte fjalë, sepse me dhjetëra djem kërcyen përpara dhe filluan të bisedonin me të panjohurin dhe mytesarifin:

— Të punoni, djem! Fara e mbjellë nga Naimi genka rritur, Kjo punë është pa shtrëngesë, me dëshirë. Tani ndizni një zjarr, t'u japim një flakë të mirë gjithë shkresurinave të xhandarëve turq. Ju këtu hapni arkat dhe bëhuni grupe se dua t'i ndaj abetaret me dorën time, një për një.

Në çast ia dha flaka. Zjarri u ndez me degë pi-she e lisi, tymi iku përpjetë e pastaj flakët u ngritën lart e më lart.

Një plak u ngrit nga turma e tha:

— Të na ndjesh, zotëri, po duam të dimë kush je zotrote.

— Jam një nga ata që punojnë për çlirimin e Shqipërisë, më quajnë Shahin Kolonja.

Dhe u shpërndanë abetaret.

Trégnie rda V oskopoja

... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat janë të njohura të gjithëve dhe të cilat janë të njohura të gjithëve dhe të cilat janë të njohura të gjithëve...

... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat janë të njohura të gjithëve dhe të cilat janë të njohura të gjithëve...

DAVID SELENICASI

... të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë, të cilat janë të njohura të gjithëve dhe të cilat janë të njohura të gjithëve...

Karrocca e madhe e patrikut të Ohrit ishte duke ardhur nëpër udhën plot me kthesa këtej liqenit të Prespës. Ishte një llandon i zi, me dyer e dritare të veshura me parvaze tunxhi të verdhë. Anash dhe sipër kishte disa kryqe të mëdha e të bardha, ishte me dy çifte rrotash dhe tërhiqej nga katër kuaj arabë, të shkathët e lavrakë, me ca zverqe të ngjeshura e jete të kreshpëruara, që ngjanin si kuaj lufte, nga ata që fushave të betejave tërhiqnin topat e vjetër që mbusheshin nga gryka.

Ishte viti 1726. Brenda në llandon ishte kapardisur peshkopi Emanuel, një durrsak mjekërgjatë, i kënduar aq sa për të qenë i tillë, burrë një dyzet

vjeç, kokoroç e tërë shëndet. Nga oborri i patrikanës së Ohrit drejtonte ndërtimin e kishave dhe pajimin e tyre. Emanueli ishte një vandak njeri, kopërdak dhe ezmer, me një të ndarë në dhëmbët e parë. Ecte gjithnjë me ca çape të shkurtra, sikur bariste mbi akull. Në kokën e tij, përmbi kamillafin e zi ndehey cipa e zezë peshkopale që e dallonte nga klerikët më të ulët.

Peshkopi Emanuel po vinte në Voskopojë me dy synime: I pari ishte që t'ia mblidhte rripat piktorit David Selenicasi, të merrte masat e duhura kundër tij dhe punës së tij heretike dhe e dyta... ajo që e kishte më fort për zemër, ishte njëfarë tregtimi i çuditshëm, por që kishte shumë leverdi.

Ai e dinte se diku, afër Voskopojës, tashti kishte dalë dhe po e priste agjenti i tij, epitropi i bazilikës së Shënkollit, Bane Lica.

Karroca shkiste e vërvitej tatëpjetë, gushat e rrotave ishin lyer e ngjyer me katran, kuajt ishin hazdisur nga elbi që kishin ngrënë te hani i Selasforit e... të bekuar nga dora topolake e hirësisë së tij, ikin e ikin duke turfulluar me tërsëllëm nëpër xhadenë që të çon nga Manastiri në Voskopojë. Pluhur e duman ngrihej në xhade, kurse kockat e hekurta të karrocës, duke u përplasur nëpër gropa e gurë e duke u ngrënë me dërrasat e teneqetë e llandonit, kërcitnin e kuitnin.

Në xhep, mbi kraharor të rastos episkopale, Emanueli kishte dy letra me një shkrim prej bakalli: Ishin raporte të Bane Licës me shokë. Sa herë i lexonte dhe i rilexonte ato letra, peshkopit i dridhej një dell i faqes, kurse tek i mbante në duar, i dukej se i digjinin gishtat.

Për këtë raport, Kolin Stringari, shkollari i de-

gjuar i Voskopojes, në pleqëri, në kujtimet e veta do të shkruante: «Pati qenë një letër e gjatë e larushane me bishtra të zeza, shkruar me bojë ka-trani e me pendë bufi, spiunllëk prej spiuni me surrat prej fundtigan, me nuhatje prej dhelpre e me mend prej gomari...»

Në të parën shkruhej:

«Hirësisë së tij, peshkopit të Ohrit, Emanuel, nga Bane Lica, i përvuajturi shërbëtor i kishës dhe juaji...»

Vë në dijeni të shenjtërisë suaj, se i qofturi David Selenicasi, zograf me rrënjë prej Selenicës së Kolonjës, ka ardhur ndë Voskopoje nga shkolla e Evropës, pasi është bërë atje farmason dhe katolik. Në punën e tij përdor bojën e kuqe të fortë, rreptësisht e ndaluar. Dendur shkon te Çezma, e Pashutës dhe bën sehir çupat kur mbushin ujë. E para mbi të parat, hirësi: Kur ju dërguat pesëdhjetë ikona për bazilikën tonë të re... megjithëse këto ikona ishin punë e ndritur e xhaxhait tuaj Efthim, që është kryezograf i Agjionoros, David Selenicasi nuk i pranoi fare, lëshoi tallje e sharje e tha se nuk vlejné asnjë grosh e fare pa turp, për gjynah e mëkat, i la ikonat të flejnë përjashta në hajat.

Duke zografisur fytyrën e shpëtimtarit tonë Jezu Krisht, ka teshtitur mbi të tri herë.

Kur po zografiste verzevulin në skëterrë, ka përdorur fytyrën time, sepse unë s'e kisha mendjen; kur po rregulloja hesapet e bazilikës, ai më përgjonte e më kopjonte surratin... O hirësi, si s'më ka dalë shpirti nga sëkëlldia... Sa herë zografis, David Selenicasi mbledh këtu çupat dhe djemtë më të bukur dhe mua më nxjerr jashtë. Ka zografisur mu në ballë të altarit gjashtë vajza shumë të bukura e,

për turp, leshprera, siç është modha ndë Evropë. Çupën e gjashtë e ka zografisur duke qeshur dhe këto çupa të nisura e të stolisura! Në tre mijë e ca djem zgjodhi ata më të pashmit e më sqimatarët, ua kreu leshrat e ua preu si të Apollonit, u vuri edhe nga një feste të bardhë në duar dhe i zografisi si barinj të verbër që shërohen. Njëri prej tyre është çirak nallbani. Krishti është një djalurçinë qiraxhi, çobani i tretë është mademxhi e kështu me radhë.

Është dembel i dorës së parë, bëj hesap, para se të nisë nga puna mbi një afreskë, rri e mendohet tre sahat.

Kur i erdhi me shkrim urdhri i lartë peshkopal për t'u veshur murg, u xhindos nga inati dhe i shkrepinë sytë nga një urrejtje e tërbuar, pështyu mu në mes të bazilikës sonë, në të cilën është duke zografisur dhe thirri me inat: «Qefinin e pranoj, rason kurrë!»

Fytyrën e shën Marisë e zografisi sipas fytyrës së një çupe prej qytetit tonë, pas së cilës është agapisur.¹⁾ Por... kur e teproi me penelata mbi kraharorin e shën Marisë, sa s'më hipën në kurriz mallet e Bodësë! S'u përmbajta dot dhe i thashë: «Shën Maria nuk ka qenë mendeshë». Por ai m'u përgjigj me cinizëm dhe më inat e më tha: «Shën Maria nuk e ka ushqyer Krishtin me mëmëligë, por me sisë». Dhe... turp e batërdi... asaj vajzës voskopojare i kërkoi këtu, në sytë e mi dhe të nxënësve të tij, i kërkoi që të zbulonte kofshën e saj të djathtë.

(Kur e lexoi peshkopi Emanuel këtë frazë, i mbeti merak vetë, vallë ajo vajza e pati zbuluar kofshën apo jo?)

1) greqisht: agapi — dashuri

Kur zografisi afreskën «Farëmbjellësi», s'u mblodh tri ditë në punë, por rëndtë arave pas bujqve. Ditën e katërt nisi punën dhe përsëri mendohej si i shastisur. Dhe «Farëmbjellësi» nuk ka asnjë kryq mbi trup dhe surrati është i një bujku nga Gjonomadhi, që David Selenicasi na e stisi si shenjt vetëm e vetëm sepse ky fshataraku na doli i shenjtëruar se ka mbytur me duar një ujë të tërbuar. Një ditë dëgjova që u thoshtë nxënësve të tij që po punojnë edhe ata në bazilikë.

«E drejta e arsyes është mbi të gjitha, edhe për mbi ungjillin vetë. Ne edhe fenë, edhe të dy patrikët do t'i nxjerrim përpara gjyqit të arsyes.»

Është anëtar i shoqërisë «Vëllezërit e Ndriturisë», por prapa kësaj shoqërie fshihet edhe një e dytë, që e mbajnë të fshehtë. Ka lidhje të ngushta me të gjithë ata dhaskalë heretikë që janë të përzënë nga skollitë e Janinës.

Një ditë u pë me raki që ia sollën priftërit e Dardhës dhe të Zicishtit. Dhe puna e këtyre dy priftërve duhet shikuar, se si shumë kanë muhabet me David Selenicasin. Dhe atë ditë (q'ka barku e nxjerr bardhaku) më tregoi për një zograf katolik me emrin Orkanja, i cili tërë armiqtë e tij na i paska zografisur me fytyrë të saktë, të vendosur në skëterre, kursë veten më miqtë e vet i ka zografisur në parajsë. Kur m'i tregoi këto, shtoi e t'ha: «Do bëj edhe unë këtu një afresk skëterre dhe do vë atje surratin tend dhe të shokëve të tu rezilë e pija-nece».

Shenjtëri! Ky bojaxhi nga Kolonja po na hap shumë avaze këtu ndë Voskopojë. Në vend që të shohë punën e tij, shkon nëpër dasmat, hedh valle

pa pikë turpi, pastaj patakset e çapëlon sytë pas çupave dhe zë e këndon:

*Sapo shkrepri dielli, malet vetëtinë,
Gjynah perëndie, kush ta çkopsit gjinë...*

Unë kërkoj të merren masa shkishërimi e, po qe se të shihni të arsyeshme edhe ju, e farmakos unë vetë më lëng pelini që kam bërë hesap t'ia hedh në çorbë, ose me një lugë vaj të nxehtë në vesh, natën, në gjumë, kur flë këtu në hajat të bazilikës sonë të shenjtë. Po kështu mund të bëhet edhe për atë kuçkën, endëse shajaku, që nuk shikon të mbajë veten me bukë, por... shenjtëri! Sytë e mi s'mund t'i fuf në mëkat, se ishte errësirë dhe natë, por... me këta veshë që kam, dëgjova David Selenicasin, një natë të zezë sterrë, në qimitir të shën Kostandinut... Ky njeri i paturp po zhyhej e zhgërryhej me atë gjynataren e tij përmbi varre, duke ua prishur paqen dhe qetësinë gjithë të vdekurve që po shijojnë atje gjumin e përjetshëm.

Hirësi e shenjtëri! M'u thaftë gjuha, u preftë frymë e shenjtë për mua e më rëntë dhambllaja në dorën me të cilën po shkruaj këto fjalë këtu me poshtë... Flaka e zotit do të derdhet nga karroca qe-llorë e Shëndëlliut dhe do ta djegë Voskopojën, ashtu si dogji Sodhomën dhe Gomorën ndë Palesti- në mbi Det të Vdekur por... unë e pashë me këta sy, që më plaçin, e pashë David Selenicasin që mbante ndër duar një kadhro me bojëra, që ai vetë e kish zografisur dhe që e quante «ergos tehnis»¹⁾. Në këtë kadhro dukej një femër e zhveshur, fare

1) Ergos tehnis — vepër arti (gr.)

pa turp e për kujë, e pështetur pas njërës kolonë të bazilikës sonë; e kjo femër lakurige të shihte jo drejtë në sy, por ndënë prag të syve, me djallëzi e me ngasje, tamam ashtu si shihte Eya Adamin e gJORë, kur e gënjeu e i dha të shijonte mollën e ndaluar, që e katandisi në skëtërrë! Dhe fytyra ish e asaj voskopojares endëse që ky ia ka vënë surrat shën Marisë, që i marrtë të keqën!

Marr përsipër para shenjtërisë suaj, se do nuhas si zagar, do përgjoj si dhelpër e do të shtrihem si gjarpër, por do ta gjej atë kadhro e do ta djeg në zjarr, për ta shpëtuar Voskopojën nga flakët e zëmërimt qiellor.

Më duhet t'i dal borxhit hirësisë suaj e t'i them se për këtë bojaxhi nga Kolonja duhen marrë masa. Ky është lindur për kapistall prej zinxhiri e për hosten prej hekuri. Është shumë kokëkrisur dhe i trimëruar. Një ditë, kur ishim në mbledhjen e këshillave kishtarë, këtu ndë Voskopojë, na ra tërmet. Dhe domosdo të gjithë pitropët e priftërit, sa edhe unë vetë, u përplasën rrafsh me tokën e u bënë dyllë të verdhë, kurse bojaxhiu i Kolonjës, bëj hesap, le që s'bëri kryq, por pa pikë turpi zuri në zografiste ne që ishim shtrirë përdhe e këndonim aleluia!

Ky heretik i xhindosur ka bërë kërkesë të mar-tohet e të hapë shtëpi këtu ndë Voskopojë, se nuk i pëlqen të banojë në hajat të bazilikës, ku i ka sot lekat e furçat e tij dhe ku mund të shenjtërohet shumë e më shumë. Faj për këtë kanë edhe shkollarët më të kënduar të qytetit tonë, që ia kanë hapur syrin e pa pikë turpi e nderojnë dhe i përkëdhelin supet.

Ky palo zograf, o hirësi, s'është i zoti të zogra-

fishë asgjë pa shikuar, më parë disa qindra vajza e djem nga qyteti ynë. Janë çmendur rinia pas këtij bojaxhiu dhe ky, tamam si ndonjë xhambaz njerëzish, zë e u shikon fytyrat, sytë, faqet, gushat, flokët, sa edhe duart e këmbët. Me qindra vajza lekfishen pas tij dhe zënë be për kokë të David Selenicasit. Kjo më e më nuk durohet....»

Në kartën e dytë spiunore, pasi përsëriteshin të themat e Banë Licës, ish-psallti Kostë Eshi shkruante:

«Asnjë njeri i gjallë gjer më sot nuk është vënë me portret të plotë e madhësi natyrale në ndonjë kishë në vendet tonë. Këtë turp e ka bërë David Selenicasi, duke zografisur të gjallë, brenda në bazilikë, një paskanik që i ka lirat me shinikë... Dhe këtë e bëu jo për sytë e bukur të Haxhi Jorgjit po për ta zhvatur sepse duan që seminarin e Voskopojës ta varrosin dhe në vend të tij të ngrenë një akademi laike. Unë jua them troç, hirësi, bazilika e Shënkollit nuk është kishë, por një mejhane çifutësh!»

Edhe pazvani voskopojar Zastran Lugati (këtë mbiemër ia kishte ngjitur populli) kishte nisur një letër për në Portën e Lartë në Stamboll. Letra që plot sharje e shpifje por... këtë letër pazvani e nisi me një qiraxhi voskopojar, i cili kishte nja dy të meta: Së pari, ishte shumë kureshtar, së dyti, dinte të lexonte dhe së treti... vuante nga majasëlli.

Arsyeja e dytë që po e sillte peshkopin Emanuel në Voskopojë, ishte krejt tregtare...

Si dihet, Voskopoja ka qenë e famshme për

argjendarët e saj të mrekullueshëm. Kapakë un-
gjijsh, vëthë ari me pikla diamanti, kryqe argjendi
e ari, unaza e byzylykë dëlhin nga ky qytet në sasira
të mëdha e shpërndaheshin nëpër Evropë.

Por kryqet e Voskopojës ishin me vidë e kapak
dhe, që të ishin të ngjyer me shenjtërim, duhej që
brenda tyre të kishte disa kokrra temjani, mbësh-
tjellë me një themlë¹⁾ pëlhurë, të nxjerrë domosdo
nga një këmishë dhespoti. Ja, prandaj peshkopi Ema-
nuel mbante nga dy këmishë të gjata njëherësh dhe
në fund të çdo gjashtëmujori ia niste mikut të tij,
Bane Licës, në Voskopojë.

Artizanët voskopojarë i paguanin këto këmishë
si frëngu pulën, por krahas rritjes së kërkesave,
shtohesh edhe prodhimi. Bane Lica nganjëherë ndo-
dhej ngushtë por... peshkopi Emanuel, që kishte ven-
dosur monopol mbi këtë mall të rrallë tregtar, ishte
njeri praktik. Filloi të dërgonte në Voskopojë jo
vetëm këmishët...

Në këtë udhëtim me llandon, përveç karrocierit,
Emanueli kishte marrë edhe sekretarin e patrikanës,
një djalosh njëzetepesëvjeçar nga Voskopoja, që po
vinte me shumë qejf në vendlindje për të kaluar
disa ditë me njerëzit e vet.

Sapo kaluan Urën me hark të Kovacit e dolën
te maja kundrejt qytetit, llandoni u lëshua me vrull
tatëpjetë. Por... këtu diçka kërciti në bark të karro-
cës dhe ajo në çast u vais nga e djathta. Karrocieri
tërhoqi i lemërisur frerët e kuajve dhe...

Peshkopi Emanuel nxori një grahmë me shar-
je, bërtiti i trëmbur nga frika së mos i zinte koka
në hendek. Një bosht i llandonit, nga përplásjet

1) Thelmë — leckë

nëpër gropa, ishte shtrembëruar. Të dy udhëtarët e lanë karrocën e bënë disa çape më tej. Bane Lica ende nuk po dukej, kurse cipa e zezë mbi kamillafin peshkopal dallgëzonte e fërfërinte nga era e mbrëmjes. Peshkopi ktheu edhe një herë sytë nga llandoni, që tashti ishte vairsur edhe më keq, kurse nga gusha e njërës rrotë po derdhej katrani i djegur.

Djaloshi nga Voskopoja, duke ditur se peshkopi nuk e kishte njohur kurrë qytetin, po i jepte shpjegime:

«Ja, ky është qyteti ynë, hirësi! E gjithë perandoria otomane nuk e ka një tipografi, Voskopoja e ka. Ja tek zbardhon ajo ndërtesa matanë Përroit të Strungut. Ja biblioteka e madhe. Më këtej duket tregu me ato rrugët e gjera. Sipër janë lagjet e punëtorisë, kurse më këtej, këto shtëpitë e mëdha janë të parisë. Ja ku duket seminari, spitali, azili. Ja, afër bazilikës së Shën Marisë, ja, tek ata vidhat e mëdhenj, pikërisht atje ngrihet bazilika e re e Shënkollit, për të cilën ju keni derdhur aq djersë e mundime.. Ja Luadhi i Skolive, afër kishës së Shën Janit, ja atje më sipër lagjja «Särza». Dhe vërre, hirësi... Mu në mes të kësaj lagjeje, ajo ndërtesa madhështore... Ajo është shtëpia ku bujtin dhe kalojnë ditët e çlodhjes të gjithë bajlozët dhe ambasadorët e Evropës, që shkojnë osë kthehen nga Stambolli.

Voskopojen, hirësi, e kanë quajtur edhe Moskopolis, që, sikurse e kuptoni edhe vetë, do të thotë qytet i aromave. Ma mërr mendja se këtë emër do ta ketë marrë ngaqë këtu, dimër e verë, nuk pushojnë erërat e merme që sjellin kundërmimin e pyjeve me pisha e bredha që ka anembanë qyteti ynë. Ju e vini re që qyteti është tepër i dendur dhe,

sikurse dihet, këtu jetojnë sot afro pesëdhjetë mijë banorë... qytet jo i vogël, hirësi...»

Por hirësia as e kishte mendjen fare tek ato që dëgjonte. E brënte përbrenda shqetësimi i të dyja çështjeve për të cilat kishte ardhur.

Papritur u dëgjuan zëra që pas Kur peshkopi ktheu kryet anëj, u duk një çift të rinjsh. Dhe Emanueli, si njeri i stërvitur në këso punësh (ai dendur u vinte kurorë), e kuptoi se ata nuk ishin vëlla e motër. Vajza ishte një bardhoshe me flokë gati të verdhë, me sy tepër të mëdhenj e gati blu. Kishte veshur një fustan të gjatë të gjelbër dhe me kraharor të hapur. Mbi kraharor i varej një kryq ari. «Të tilla veshje e të tilla zakone nuk ka as në Ohër», mendoi peshkopi.

Vajza u afrua e para, u ul gati më gjunjë dhe duke i marrë dorën Emanuelit, ia puthi. Peshkopit i shkuan drithmat në trup. Duke i puthur dorën vajza kryqi i artë, që mbante ajo në kraharorin e çelur, u derdh pas zinxhirit të vet dhe ra mbi atë dorën topolake të peshkopit. Ai u kujtua: «Vallë ky kryq ari, a ka brenda thelmë nga këmisha ime?»

Po binte nata dhe karroca nuk kishte ndër mend të vihej në rrugë. Çifti i të rinjve kaloi shpejt e shpejt dhe errësira pushtoi qytetin. Peshkopi Emanuel nuk po u besonte syve.

Qyteti tashti po dukej si një copë qiell fantastik! Me miliona xixëllonja e përmbytën Voskopojën, ato vërtiteshin në një marramenth të paparë, rrotulloheshin që nga qyteti e gjer sipër drejt qiellit dhe atëherë dalloheshin edhe trajektorët e holla e fosforike si një qëndismë e artë e madhështore mbi një cohë kadife blu.

Peshkopi u mrekullua. Pastaj uli kryet, bëri një

gjyismë kthese, pastaj një të tërë, u kthye nga lin-
dja duke vështruar drejt qiellit dhe u fal: Ati ynë,
që je në qiell...»

Vendosi të mos hynte në Voskopojë asaj nate.
Mendoj: «Çfarë besimtarësh e besnikësh na qenkan
këta voskopopjarët?! Prisin që unë të hyja brenda
në qytet e të dilnin për pritje...» Dhe duke shfryrë
i tha sekretarit:

— Udhëhiqme për në manastirin e Shënprodho-
mit. Atje do ta kalojmë natën, nesër do të hyjmë
në qytet.

* * *

Ishte muaji maj i vitit 1726. Bazilika e re e
Shënkollit në Voskopojë ishte ende e mbushur plot
skela të ngritura me trarë e traversa. Aroma e pishës
kundërmonte nëpër kishë e bashkë me të edhe ato-
mat e bojërave, të cilat ishin nxjerrë prej florës
aq të pasur e të dendur të pyjeve anembanë qytetit.

Mu në majë të një skele, ngjitur me tavanin-ku-
pölë, në njëfarë saje, i shtrirë në shpinë, ndodhej
piktori David Selenicasi duke punuar. Ai kurrë nuk
mundi të gjente dot një pozicion të përshtatshëm
që e kërkonte puna e tij në ato kupola.

Davidi ishte një kolonjar shtathedhur, nja tri-
dhjetë vjeç, me ballë të lartë e me fron, flokëzi, sy-
gështenjë e njeri fjalëpak; sytë e tij zhbirues lë-
shonin gjithnjë shumë dritë.

Nëpër bazilikë po punonin edhe dy nxënës të
piktorit, kurse një shok i tij vinte e vinte para afre-
skëve e ikonave, i këqyrte ato me kujdes dhe inte-
resohej sidomos për ngjyrat. Ky quhej Kolin Strin-
gari, një shkollar tepër i hollë, që kishte mbaruar
studimet për kimi në Laipcig me bursën e paguar

nga esnafi i lëkurëpunuesve. Ai pati qenë pedagog në Kolegjin Marusian të Janinës, që nga e kishin përzënë për shkak të ideve të tij «të ndriturisë», si quheshin atëherë në Voskopojë idetë e iluminizmit.

Kolini kishte një shtat të hedhur prej atleti. Ishte dyzet vjeç, po si jepje as tridhjetë, kishte një fytyrë të pashme e të këndshme dhe ishte ballëdash¹⁾.

— Si kimist, — i thoshte Davidit, i kam provuar në shije të gjitha elementet e natyrës, por... më të hidhur e më të helmët se robëria e turkut nuk ka.

— Ashtu vërtet, — ia kthente Davidi, — por shtoj robërisë së osmanllinjve edhe robërinë me të cilën më mbërthejnë mua dinjitarët e kishës e pastaj bëji llogaritë.

Kolin Stringarin i gjithë qyteti e quante «Enciklopedia vetëtimë». Atë e nderonin të gjithë në Voskopojë. Ishte mësues i përkryer e kurrë nuk përdorte pendë pate, por shkruante me pendë pelikani, që kishin një nuancë ngjyrë pak si të kuqe. Këto pendë ia sillnin nxënësit e tij nga Prespa dhe nga Sovojan. Kolini ishte një e një si kimist e fizikant; ai fliste me dijeni të plota si për mjekësinë dhe shkencat matematike, ashtu edhe për gjuhësinë e astronominë. Kur erdhi në Voskopojë shtypshkronja, më 1720, ishte Kolin Stringari ai që hapi arkat dhe montoi makinerinë. Dhe kur një ditë punët ngelën dhe inxhinieri gjerman që shoqëronte tipografinë mbeti me gisht në gojë, Kolin Stringari ra në shtrat përmbys për njëzet e katër orë. Kur u ngrit, rendi në farkëtoren e qytetit dhe ia rrëmbeu varenë kovacit, Artam Faberi.

Të nesërmen shtypshkronja filloi nga puna.

1) Ballëdash-i — që i ka flokët si të lëpirë në ballë.

Por me gjithë cilësitë e tij të rralla, përsëri Stringari ankohej:

→ Të më kishte dhënë zoti edhe një fije delli poetik, do të isha bërë shkrimtar!

Në bazilikë kishte aq shumë qetësi, sa dëgjo-heshin zhurmat e holla të penelave përmbi afresket. Pataj papritur një psherëtimë. Ajo vinte që lart nga kupola ku punonte mjeshtri. Ai punonte dhe mendohej. Mendohej dhe përfytyrimi i tij ikte larg, nëpër trevat e mëmëdheut, ku kishte shëtitur më parë. Ai kishte qenë në Valsh, në Shelcan dhe në Berat. Atje kishte ndenjur me ditë të tëra, i mahni-tur përpara punës së mjeshtrit të madh Onu-frit.

Dhe Davidit nuk i del nga mendja vështrimi zhbirues, balli thellësisht i menduar, muskulatura e ngjeshur dhe aq e gjallë e afreskut «Profeti David» në Shënkoll të Shelcanit.

«Davidi» i Onufrit është më shumë një kaçak, një komit kryengritës. Ai është vetë Onufri, që na sheh në sot pas dyqind vjetësh. E, megjithëse ai jetoi dy-qind vjet më parë, megjithëse e patën veshur murg dhe e thërritnin asket oshënar, përsëri ai ua pati hedhur. Ai e kishte një djalë, të cilit i la penelin, kursë mua... më ndjekin këmba-këmbës dhe nuk më lenë të marr frymë...»

Nga bazilika doli Kolin Stringari. Atij iu afrua ora për të dhënë mësim në seminar dhe iku pa lënë shëndet, si njeri që hynte e dilte atje orë e çast. Për disa minuta më vonë Davidi ndjeu muzikë përjashta. Që nga dritarja e vogël, nën tavan, ai hodhi sytë përjashta.

Kishte ardhur pasditja. Që nga udha e tejme e remtarëve vinin gjer këtu zhurmat e qindra goditjeve

të, bakër xhinjve. Drejtuesi i korit të Voskopojës, muzikanti Pavlo Llosha, kishte ardhur aty tej, oborrit me violinën e vet. Pas tij ishte mbledhur një turmë e tërë djemsh e vajzash, dhe Davidi e kuptoi menjëherë: «Pavlo Llosha e ngre këtë festë për mua, më jep mundësi kështu të shoh fytyrat në lëvizje, të vërej ngjyrat dhe sytë, të frymëzohem nga këto valle të rinjsh. Ai e bën këtë sa për mua, sa edhe për veten. Sepse edhe Llosha, si ai pijaniku që nuk rri dot pa verë, edhe ky vetë nuk zë karar pa këngë e valle, pa e ngjyer harkun me nishadër dhe pa i ngatërruar telat e violinës me telat e zemrës...»

Poshtë, nëpër bazilikë nxënësit nisën të mërmëritnin dhe Davidi e kuptoi. Ai u foli:

— Dilni, djema, shkoni në valle!

Por Pavlo Llosha njihej që nuk ishte violinist. Ai dallohej në të parë që ishte një drejtues me pathos i korit, sepse, ndërsa luante veglën, lëkundej sa andej-këtej, brofte, hidhej e kërcente, sikur edhe vetë të dridhte valle. Ai luante dhe sytë nuk i ndante nga dritarja e vogël se e dinte që atje ishte Davidi, që e ndiqte nga larg.

Tashti Davidi e la penelin dhe u shtri mbi krahun e tij të djathtë... Në mes të valles kishte ardhur ajo!

Ishte vajza endëse, punëtorja Ana, ajo që i pati dhënë fjalën piktorit dhe tashti, kur Davidin e ngucin, e ndiqnin dhe e kanosnin të vishej murg, ajo nuk dinte ç'të bënte e nga t'ia mbante. E me gjithë këto, ajo erdhi në valle, sepse e dinte që Davidi kishte nevojë ta shihte duke lozur, duke qeshur, duke vallëzuar dhe duke bërë që të xixëllonin sytë e saj të grizhtë.

Tashti ai shihte vallen dhe mendja po i kthehej prapa, nëpër vjetët e shkuar...

* * *

Ai mbaroi shkëlqyeshëm Akademinë e Arteve në Venedik me bursën që e paguante esnafi i argjendarëve të Voskopojës. Dhe atje në Venedik këngëtarja Afërdita Pamperi i kishte thënë:

«Nëse do mbarosh shkëlqyeshëm... për nderin tënd do jap një pritje të madhe...!»

Por edhe shkëlqyeshëm të mos mbaronte, pritjen do ta jepte Afërdita Pamperi. Ajo ia kishte thënë këtë vetëm për ta nxitur. Por pastaj punët morën një rrugë tjetër krejt të papritur...

Këngëtarja e dëgjuar Afërdita Pamperi, e lindur në Voskopojë, ishte me emër në Venedik. Davidi hynte e dilte tek ajo si në shtëpi të vet. Kur erdhi fundi i vitit akademik, Davidit nuk ia dhanë «Penelin e artë» që i takonte. Dikush kishte thënë: «Është i huaj».

Atëherë Davidi mori inat. Dhjetë ditë me radhë, askush nuk e dinte ku ndodhej. Afërdita Pamperi dërgoi njerëz ta kërkonin në Lido, në lagunën e Rialtos, në Kanalën e Madh, në sheshin e San Markos, dërgoi njerëz edhe në Mestre e deri në Treviso... Shënjë e Davidit nuk dukej. Por më në fund ai u duk. Ishte i vrerët dhe ballin e kishte të zbehtë. Gjatë gjithë ditëve të mungesës kishte punuar tri vepra. Ishin si ishin, ai i çoi ato të mbështjella në pallatin e Pamperëve dhe i fsiehu atje.

Pastaj u dha pritja e dëshiruar.

Salloni tepër i madh i Afërditës ndriste si në një

ditë martese. Pasqyrat e rënda, polielat ca më të rënda, shandanë argjendi në format më tekanjoze, tapete leshi të butë e plot me lule, punuar në Voskopojë, e me ngjyra që nuk ngopeshe dot së vështruari... Një det i tërë me njerëz. Kavalierë dhe studentë, gjahtarë vajzash dhe gjahtarë arti, poetë që shkonin gjurmëve të Pjetër Aretinit, politikanë dhe ithtarë të iluminizmit, pastaj muzikantë e piktorë dhe ndër të gjitha grupet, një bisedë e ditës: do të largohet apo jo piktori i talentuar, për të cilin po jepet pritja!

Atje kishte shumë dama të aristokracisë me fustane të bardha, mbi supë ca më të bardha, fustanë mëndafshi që përkëdhelnin shtrojën me qilimat e bukur të Voskopojës, forma flokësh nga më të ndryshmet dhe mu në krye të sallonit Afërdita Pamperi, mbi një kolltuk venecian me përkresë ari. Afër saj ishte Davidi dhe ajo diç i pëshpëriste. Por ai e kishte syrin gjak dhe ballin të rrudhur.

Te Davidi afroheshin gjithë ato dama kur violinat luajnin minuetet e kohës. Dhe të gjitha ato e mbushnin me fjalë piktorin. Afërdita Pamperi i vështronte dhe shqetësohej. Davidin e tërhiqnin qosheve e skutave, pas perdeve e kolonave. Këngëtarja dërgoi disa herë ta thërritnin, por ai nuk kthehej, nuk e linin. E tërhiqnin për mëngë, e sulmonin me pyetje, me kërkesa. I thoshin se, me t'u kthyer në mëmëdhe, sipas rregullave bizantine, do ta vishnin murg. Ai do të humbiste nëpër trevat ca më të humbura të Perandorisë Osmane, gjithnjë nën urdhrat e dhësotëve xhahilë të Fanarit.

Më në fund, zonja e shtëpisë, duke përmbajtur me duar fustanin e saj tepër të gjatë, u ngrit dhe shkoi ta merrte vetë. Ajo i foli shqip:

— David! E kupton?! Këto joshje nuk bëhen për sytë e tu të bukur, po për penelin!

— Po, Afërditë, e kuptoj.

Ajo iu afrua dhe pranë krahavorit i ngriti dorën e saj të bardhë të rënduar nga dantellat. Davidi u bind, i shkoi krahun dhe eci pas saj.

Afërdita e tërhoqi piktorin në buduarin e vet. Atje ishte gjysmëerrësirë. Ajo u ul në kolltuk dhe fustani i saj trandafili i arrinte gjer te gishtat e këmbëve.

Tashti, te ai shiriti me dritë nën derë, lëviznin shumë hije dhe gumëzhinin gjithë ata zëra. Ajo e vështroi Davidin nga koka te këmbët.

«Ky djalë i mrekullueshëm, ky sqimatar i egër! Vallë si do të jetë jeta e këtij djali?»

— David!

— Ju dëgjoj...

— Kam frikë për ju!

— Nga banditët?

— Nga vajzat e bukura, David, ti je tepër i papërmbajtur!

— Kurse mua më pëlqen më shumë të vendos një gur në vendlindje, sesa njëqind trarë në San Marko të Venedikut!

— Kështu më pëlqen, David!

Ajo zgjati duart, ia mori atij kryet në pëllëmbë dhe e shtrëngoi pas vetes.

Djaloshi nga Kolonja ndjeu afshin e ngrohtë të krahavorit të saj. Dhe balli iu përskuq.

— David, kam këtu një letër nga Voskopoja...

— Nga Voskopoja?

— Është nga ai ballëdashi, mësuesi dhe shoku yt, Kolin Stringari, merre dhe lexoje!

Si përherë letrat e Stringarit ishin zjarr e flakë.

«Enciklopedia vetëtimë», si e thërritnin voskopoparët e Voskopojës dhe ata të mërgimit, ishte mjeshtri që mbante letërkëmbim me të gjitha kolonitë e Evropës. Letrat e tij ishin plot me thirrje pëtetike në emër të Voskopojës. Këto letra ishin herë me stil të ashpër, kanosës, nxitës, herë me stil të prerë, ngucës dhe ironik, por gjithnjë në emër të nënës e «të dheut ku ju ka rënë koka, në emër të gurëve ku keni çarë ballin, të pyjeve ku keni mbledhur luleshtrydhe, në emër të arrave të lashta ku keni hedhur kolovajzat dhe ku keni dashuruar për herë të parë... dërgoni libra sa të mundni, se ju mori dreqi, ju mori! Ata të Laipçigut e bënë fora, ata të Budapestit akoma po hanë bukëvalen e mëngjesit. Turduni, ore, ju të Gjenovës!...»

«Ti, Afërdita Pamperi, atje në Venedik, ç'po bën? Duam të hapim akademinë, vetë shkova me kalë deri në Janinë dhe e sigurova dhaskal në akademinë tonë Eugjen Vulgarin, që është nga arbëreshët e Greqisë; është mendimtar i madh, kurse ata të kolegjit të Janinës e ndjekin se është njeri i ndriturisë. Sa të çmendur që janë! Kështu pra, duhen para, libra, profesorë. Ç'pandehni ju!? Nga do t'i gjej unë të gjitha?!»

Stringari u drejtohej atyre të Gjenovës se ua kaluan ata të Vjenës, atyre të Vjenës se ua kaluan ata të Gjenovës, por edhe se kjo kuptohej, nuk zëmëronte njeri. Kolini thërriste në emër të nënës, nuk ishte mëkat.

Letrat e tij Stringari i përfundonte kështu:

«Kush nuk përpigjet për nënën, është turk, u shërbën turqve e pastë vdekjen.»

Por në rastin e fundit ai i drejtohej Afërdita Pamperit dhe letra e tij ishte thërrëse, e fortë dhe,

po të mos e njihje Kolinin, mund t'i zemëroheshe fare lehtë. Ai shkruante:

«E dashur Afërditë! Ti po shkëlqen gjithnjë e më shumë me zërin tënd atje në Republikën e San Markos. Po neve, ç'na hyn në qese kjo? Dëgjo këtu, dëgjo se ku i dhemb mëmëdheut: Në qoftë se David Selenicasi nuk kthehet në Voskopoje, fajin e ke ti. Dhe mallkimin e nënës e paç ti. Se si do bësh, punë për ty. Unë të uroj shëndet dhe... sa për Davidin, nga ana ime... asnjë fjalë.»

— Sikur të isha vajzë e re David, do vija me ty në Voskopoje, — i tha ajo piktorit. Pastaj ajo uli vështrimin mbi qilimin e madh dhe dukej sikur vërente me ngulm një lule të tij.

— Çfarë po mendon, Afërditë?

Ajo ngriti kryet me rrëmbim, sikur iu shkëput me dhunë një mendim i dashur:

— M'u kujtuan arrat e mëdha të Voskopojes, David. Në degët e tyre, kur isha e vogël, hidhja litarin e kolovitesha!

— Ty kujtuan kështu kot?...

— Jo kot, David, por sepse të shoh ty.

— Mua!?

— Pikërisht. Sepse ti do të bëhesh i madh, David. Ti më je si një pemë e madhe arre. Dhe arra nuk do as krasitje, as ujitje, as spërkatje. Asnjë shpend nuk bën fole tek arra, asnjë kandër nuk mërzen tek ajo. Dhe arra e ka aromën të mreku-lueshme dhe asnjë arrë e vogël nuk mbin nën arrën e madhe. Kur arra kërkon të shtohet, e dërgon farën e saj larg, me anën e shpendëve...

— Afërditë, çfarë po thua kështu? E nise me litarin që koloviteshe dhe...

— Jo, e kam fjalën tek arra...

— Mos vallë sërish ke mall të hedhësh litarin mbi arrë dhe të kolovitesh?!

Ajo brofi më këmbë dhe, duke nënqeshur, i përkëdheli kryet. Pastaj dolën sërish në sallën dhe këngëtarja vinte re tashti se si e ndiqnin Davidin çap pas çapi. Kur e panë që vajzat nuk bënë dot gjë, atij iu qep pas Luçio Tomasini, regjisori i atij lloj gjahu që zhvillohej atje. Ky ishte bir, doxhi dhe iluminist i njohur. Sapo shkëmbyen dy-tri fjalë, Davidi ia ktheu:

— Ç'kërkoni nga unë? Unë jam «një i huaj»!

— Dëgjo, David, — e nguci Tomasini, — ti këtu në Venedik mund të kërkosh dorën e cilës vajzë të të pëlqejë...

— Jo, i dashur, — ia preu shkurt Davidi.

Pastaj nëpër sallën u pëshpërit se erdhi çasti kur piktori i ri do t'i jepte dhuratat e fundit Afërdita Pamperit. I gjithë salloni qe ngritur më këmbë. Piktura e parë që nxori Davidi qe një kuadër i madh. Atje, në madhësi natyrale, dukej këngëtarja e dëgjuar, me një fustan mëndafshi bojë trëndafili gati të tejdukshëm, një dekolte tepër e çelur, një qiell blu e plot dritë, një palë buzë me tul, si duke kënduar; dora e djathtë qe shtrirë poshtë e gishtat e saj në lëvizje dukej sikur mbanin ritmin e një kënge... Dallohej qartë se këtu Afërdita ishte duke kënduar... Ajo ecte mbi barin e një livadhi, me kryet varur pak mënjanë, duke shikuar dikë me një vështrim pak çapkën (tepër çapkën për të tridhjetë e gjashtë vjetët e saj). Në sfond, nën disa kodrina, një qytet me shtatë lagje, me njëzet e katër bazilika e katedrale. Dalloheshin qartë kupolat e kishave dhe drurët e mëdhenj të arrave.

Por askush nga të huajt nuk kuptoi përse kë-

gëtarja, me të vështruar pikturën, mbylli sytë dhe prej atyre syve të mëdhenj e të bukur dolën lot...

Në sfond ajo kishte njohur Voskopojën.

— Asnjë vëretje për dorën time, sinjora?

Afërdita ngriti kryet dhe fshiu lotët me shami.

Sytë e saj të mëdhenj iu mbushën me fijeza gjaku.

Ajo po qante. Buzët i dridheshin. Pastaj e vështroi edhe një herë pikturën.

* * *

Ditët e para të ardhjes në Voskopojë, Davidi shëtiste rrugëve të qytetit; kërkonte të shihte fytyra e të zgjidhte tipa.

Qyteti ishte mbretëri e gurit. Shtëpitë ngritur prej guri, rrugët shtruar me gurë, çatitë e shtëpive përsëri me rrasa të trasha guri. Edhe qemeret në formë gjysmërrethi të dritareve të vogla me hekura të kryqëzuar ishin sajuar edhe ato me gurë smershi plot me brima. Nëpër dritaret e vogla, në katet e tretë dhe të katërta, pranë saksive me lule borziloku e shëngjini dukeshin plaka veshur me të zeza, që zhdridhnin e mblidhnin turra me fije leshi. Ato tregonin ëndrrat e natës e të rejat e ditës, pinin kafe dhe shihnin filxhanët. Hatujt përmbi rrugë gati çiknin njëri-tjetrin. Thuhej se njëherë një dhi kishte ndenjur tri javë pa u gjendur, sepse kalonte nga njëra çati te tjetra. Nëpër atë të çarën e ngushtë përmbi rrugë, mezi dukej pak hapësirë. Gratë i huanin njëra - tjetrës që nga ballkonet e dritaret.

Davidit i kishin thënë se Stringari që i sëmure në shtëpi dhe po i shkonte ta shihte. Qe hera e parë që do t'i hynte në banesë mikut dhe ish-mësuesit të tij.

Kur u gjend në tremën e shtëpisë së Kolinit, ngeci. Nga brenda vinte zëri i thekshëm i nuses së Stringarit. Po grindeshin:

— Ti, more burrë, nuk mblidhesh as ditë, as natë. Më mirë shko dhe martohu në daç me shtypshkronjën, në daç me bibliotekën e në daç me akademinë, dhe unë të shoh punën...

Davidi ngeci. Nuk dinte si të bënte. Të ikte apo të hynte. Kur papritur Kolini çeli derën dhe, duke hapur krahët e duke brohoritur tha:

— Ooo, kush paska ardhur! Eja, mjeshtri ynë!

Davidi hyri me një barrë druajtje dhe syri i kapi fare pak e shkarazi, vetëm supin e nuses së Kolinit, që iku me vrap që nga dera e pasme e odës.

— Të më ndjeni, Kolin, më thanë se jeni i sëmurë!

— Jooo... nuk është gjë... një grip i lehtë, po... ku kam unë kokë për shami! Ata të Kluzhit do të ma hanë kokën, s'marrin vesh e shkoi e vate. Eee, të kisha edhe nja dy shokë si ata të Vjenës! Është atje në Vjenë një Dhimitër Siná që ma kalon. Ma kalon shejtani, ma kalon. Ky tashti po u shkruan letra e thirrje edhe kolonive të tjera, ma rrëmbeu monopolin. Më i lumtë! Falë këtij Dhimitër Sinës, natën, atje në bibliotekën e Voskopojës, po përfyten mendimtarët më në zë të Evropës. Një palë flasin latinisht, një palë bërtasin gjermanisht, disa ua kthëjnë italisht e frëngjisht! Eh, David, Davidi im, gjithë ky vërshim librash dhe diturie po na çon drejt e te akademia.

Kolinit as që i kishte lënë ndonjë vragë grindja me të shoqen dhe vijonte të fliste për kolonitë e Voskopojës dhe për shkollën e mesme që duhej

celur, kur nusja e tij hyri për mirëseardhje. Pas e ndiqnin tre çuna të vegjël. Ishte një nusezë e bukur, me shumë flokë dhe me një kryq të vogël tatuazhi në ballë. Ajo e mirëseardhi Davidin, duke bërë çmos që të mos binte në sy se ishte gjakprishur. Nuk dukej aspak se kishte lindur tre fëmijë. Kur ajo doli të sillte kafet, Kolini tha:

— Tashti po grindeshim, me siguri diçka dëgjove.., ajo ka të drejtë, po... e kam të mirë, është nga fisi i Cikullit.

Hyri nusja me kafet që i kishte hedhur në disa filxhanë të verdhë porcelani holandez, pa vegël. Ajo, edhe se mundohet përsëri, dallohet që ishte gjakprishur. Dhe, sa të merrte veten, aty për aty e gjeti një rrugë. Rrëmbeu tiganin, i hodhi vaj dhe e vuri në zjarr. Pastaj mori një masë miell, e hodhi në një poçe balte dhe po e gatuante duke mbajtur fytyrën nga zjarri. Dhe ashtu foli:

— Për nderin tuaj, mjeshtër David, sot do të shijojmë bashkë petullat e Arushës, se ja, po vjen pranvera.

Brofi «Enciklopedia vetëtimë» ishte njeri shpërthyes. Ai kërcëu përpjetë dhe, duke ngritur gishtin tregues nga tavani, gazmor dhe i papërmbajtur, bërtiti:

— Nuse, megenëse po vjen pranvera e ëmbël dhe plot me lule.., ti më mirë lëri petullat dhe ngreji vetullat!

Ajo brofi më këmbë e befasuar dhe, duke mos ditur ç'të bënte e ç'të thoshte, pa Davidin në sy dhe ia dha të qeshurit.

— E kujt t'i zemërohesh, David?!

Davidi asaj dite, së bashku me Kolin Stringarin, shëtiti nëpër lagjet e Zhombrit, të Mecovës e të Xegës, zbriti në lagjen e «Pasanikëve». Ata u ranë mes për mes lagjeve të Grabovarëve e Oparakëve dhe mbërritën më në fund në lagjen «Sarza». Këtu pronari Miltiadh Gopa kishte hapur të parën punishte për endje, dhe Davidi kishte shpresë që në këtë grumbull femrash të gjente tipin që i nevojitej. Deri një vit më parë gratë dhe vajzat e qytetit, punonin nëpër shtëpitë e veta dhe endnin shajak për pronarin, por tashmë Miltiadh Gopa kishte hapur punishten e vet, duke marrë shembull nga Evropa, ku kishte qenë për shitjen e qilimave të Voskopojës.

Sapo hynë në oborrin e madh të punishtes, ata dalluan një ndërtesë tepër të ulët e tepër të gjatë. Nëpër oborr dukeshin kuzanë të mëdhenj me lëng të ngjyruar, pastaj avlëmende të thyera, sovajka të hedhura, kërra dhe qerthuj prej druri. Prapa punishtes sapo mbërriti një karvan kuajsh të ngarkuar rëndë. Qiraxhinjtë ishin të pluhurosur dhe dukeshin të lodhur.

Mbi avllitë ishin ndehur turra me fije, leshi, tapete e qilima. Davidit i ngelën sytë pikërisht te këta. Ai u përhumbe pas ngjyrave, kapi buzën e poshtme me dorë, uli pak kryet dhe mendohej duke picërruar sytë. Pas tij Kolin Stringari vinte e vinte nëpër oborr.

Miltiadh Gopa i priti si jo më mirë. Ai ishte një beqar nja pesëdhjetë vjeç, burrë shumë i pashëm, me ca faqe të mbushura, me flokë tepër kaçurrelë dhe me sy të mëdhenj e gazmorë.

— Urdhëroni, zoti zograf, — i tha ai Davidit, — urdhëroni, si në shtëpinë tuaj... — dhe, duke dëgjuar zërin e një burri që bërtiti diku thellë nga depot, ai kërkoi leje: — Të më falni, ju hyni në punishte, zoti zograf, unë po vij pak më vonë...

Hynë në sallën e gjatë dhe të ulët. Atje kishte shumë pluhur dhe vinte era lagështirë e myk. Gratë dhe vajzat punonin me një shpejtësi të habitshme. Kërcitnin sovajkat dhe motovilat. Askush nuk ngrinte kryet. Pasi i përshëndeti një për një, Davidit iu mbush mendja se në ato fytyra prehej tashmë hija e ndonjë bukurie të venitur e të largët. Dukej sikur nurin e tyre ato vajza e gra ua kishin kaluar qilimave që endnin. Fjala shkoi gojë më gojë e gratë dhe vajzat nisën të shihnin të posardhurin. Kishin dëgjuar për të, qyteti i tërë e mbante në gojë. Davidi i pyeti për pagën që merrnin dhe, kur ato i treguan, ai mblodhi buzët. Hyri Miltiadh Gopa, përsëri nxituar:

— Edhe pak më pritni, zoti zograf!

Davidi po prekte me dorë indin e një qilimi dhe i tha:

— Zoti Gopa, mos e keni përzier leshin me pambuk?

Pronari u sëndis:

— Aaa! Ç'është ajo fjalë, zoti zograf?

Miltiadhi ngeli si i habitur, po në çast e mblo dhi veten dhe iu vërsul me një breshëri fjalësh:

— E ku gjendet këtu fije pambuku, zoti zograf! Duke vështruar këta qilima, a nuk dëgjoni veti se si vijnë gjer këtu blegërimat e deleve dhe këmborët e deshve?!

Duke shkarë me ngut gjatë murit, përsëri kërkoi ndjesë të largohet. Ai vinte e vinte nëpër pu-

nishte si ndonjë sovajkë e stërmadhe që s'gjente
prehje e qetësi asnjë çast.

— Do të kthehem shpejt, zoti zograf, ja, er-
dha!

Pas shpinës, Davidi ndjeu zëra, por nuk e ktheu
kokën. Nga fjalët që dëgjonte, mësoi se pas tij
kishin ardhur pesë a gjashtë vajza që do të hynin
atje në punë për herë të parë. Davidi u kthye pas
dhe midis tyre i zunë sytë një grua punëtore rreth
pesëdhjetë vjeçe, e fortë, por e verdhë në fytyrë,
që, duke folur vllahisht e duke vështruar në sy
herë Davidin e herë dikë prapa tij, zuri në gojë
edhe emrin e piktorit. Kolini qeshi. Po ashtu edhe
Davidi, kurse vajzat ia dhanë gazit me druajtje. Ko-
lini deshi t'ia përkthente fjalët e gruas, por Davidi
i kishte kuptuar. Gruaja kishte thënë: «Moj bu-
kuroshja e nënës, moj t'u bëftë nënëza për këta
sy plot lëng që më paske, para se të hysh në
punë këtu, moj shpirti i nënës, ja ku e ke Davidin,
ky të të bëjë në kartë kaq të gjallë e të bukur, që
nesër-pasnesër ta kesh për kujtim bukurinë tën-
de.»

Ndërkaq Davidi, midis qilimave të shpalosur
anekënd, pa një palë sy... E vështroi vajzën nga
koka të këmbët: e gjatë, një trup i dërdhur...

Vajza e përballoi mu në ninëzat e syve, pastaj
një i kuq i lehtë iu ndeh në fytyrë dhe i uli qer-
pikët e gjatë, që Davidit iu duk se i arritën gjer në
mes të fageve.

Një shoqe e saj i përkëdheli supin dhe diçka
i mërmëriti. Davidi e dëgjoi që vajzën e quanin
Ana.

— Ikim, — i tha i turbulluar Kolinit, — dalim...

— Fytyra e kësaj vajze mund të vlejë, — tha Kolini, — mbaje shënim...

— I tepërt shënimi, Kolin, dalim.

Dolën te njëfarë treme ku nuk kishte dritare; atje u duk shpina e Miltiadh Gopës, ndërsa një punëtore e tij, nuse e re, po i lutej:

— Zoti Miltiadh, kërkoj leje të dal, duhet t'i jap sisë foshnjës, e kam vetëm dyjavësh.

— S'është han këtu, — ia ktheu ashpër pronari, — e ta kam thënë, ja në shtëpi, ja në punë!

— Por, zoti Miltiadh, s'mundem të qëndroj... më shtrëngojnë gjinjtë...

— Atëherë kthehu aty pas murit e shtrydhi, — tha Miltiadh Gopa.

Davidit iu drodh trupi dhe ngriti zërin:

— Zoti Gopa! — zëri i tij gjëmoi ashpër. Pronari u kthye me rrëmbim dhe në surratin e tij të egërsuar erdhi e u shkri një buzëqeshje e shtirur.

— Urdhëroni e hidhni një sy në këto ngjyrat e mia të hatashme...

— I pashë ngjyrat e tua të hatashme, zoti Gopa, në fjalët që i the kësaj gruaje.

Miltiadh Gopa në çast e humbi përzemërsinë. Iu drodh nofulla e poshtme, u egërsua dhe vetullat e tij të trasha gati ia zunë sytë.

* * *

Davidit i kujtohej gjithnjë fillimi i punës në bazilikë. Atë ditë iu desh të merrte në provë tre zo-grafë që pitropi Bane Lica, bashkë me veten e tij, i paraqiti si mjeshtër. Deshi s'deshi, Davidi i vuri në provë.

Ata nxorën që poshtë xhakëtës nga një ikonë të Agjionoros dhe nisën ta kopjonin.

— Jo, — u tha Davidi, — këtu nuk duam apografe¹⁾ të Agjionoros, na bëni diçka nga koka juaj, ose, më mirë, ja ku është kjo macja këtu në stol...

I pari që nisi të vizatonte macen ishte Kostë Eshi. Ky ishte një shok i Bane Licës, hundëkërrut, kokëmadh e kryeneç. Kur ecte rrugës, shihte vetëm përpjetë. Për gjysmë fjale kurdoherë ishte gati të përfytej me këdo. Edhe këtë, si Bane Licën, gjithë qyteti e urrente. Nuk kishte mirëmëngjes as me të vetët, ishte shërrxhi dhe mbiemrin ia kishin ngjitur qytetarët. Hiqej si mendimtar i mbaruar, por e kishin përzënë nga shoqëria e «Vëllezërve të Ndriturisë», sepse ishte shumë mendjemadh.

«Mjeshtri» i dytë na ishte Zatlan Lugati, pazvan në tregun e qytetit, spiun i njohur i derebejve dhe i hyqymetit turk. Ky ishte një gjato si stëngëz, me dy nofulla të shëmtuara, ecte gjysmë i kërrusur, sikur diç e ngacmonte në të pasmet. Ngaqë e dinte veten si burrin më të mençur, i bëhej se vetë ishte boshti rreth të cilit vërtitej në mos, bota, Voskopoja domosdo.

Kur mbaruan provimin, Davidi pa punët e tyre.

— Ju nuk jeni për këtë punë! — u tha.

Një ditë, ndërsa ishte nga mesi i punimeve, Davidi doli arave me grurë. Kallëzit gjelbëroshë fërkonin njëri-tjetrin. Davidi kishte marrë me vetë edhe nxënësirë e tij, Thanasin, i cili i mbante poçin e madh të bojës. Ai vetë mbante në duar një dërrasë borige për të punuar. Pas tyre që nisur këmbë pas këmbë edhe Bane Lica. Kur po ktheheshin, fare pa-

1) apografe — kopje (gr.)

përitur, në mes të tyre e një are me grurë, ai dalloi Anën. Bënë Licës kurrë nuk iu mbush mendja se kjo ishte vetëm një rastësi. Por Davidi nuk e kaloi rastin kot. Ai i kërkoi vajzës që t'i pozonte atje në mes të arës me grurë e pastaj, duke punuar, i dha asaj të mbante në dorë një lulëkuqe.

— Kështu edhe shën Maria, mbante një lule në dorë dhe mbeti me barrë, — tha gjithë vrer Bane Lica.

Vajzës i shpëtoi lulja nga dora dhe u bë më e kuqe se ajo. Davidit iu ndez gjaku dhe nuk u përmbajt dot. I rrëmbeu nxënësit poçin e madh të bojës dhe ia ngjeshi Bane Licës me tërë forcën mu në kokë.

Piktori vijoi të punonte aty në arë me Anën përballë e, kur në një çast ngelën vetëm, ai i tha:

— Sidoqoftë, ti sot nuk ike nga unë...

— Unë nuk iki, David, por që asaj dite, në punishten e qilimave, sa fjalë kam dëgjuar...

— Vetëm kaq?

Ajo uli sytë.

— Nuk e di ç'po më ndodh, David, më duket sikur vetiu kërkoj mbrojtjen tënde, rri e përgjoj më orë të tëra në dritare, kur kalon ti për në bazilikë dhe kur kthehesh, i hëngra gurët e rrugës së Shënkollit. Sikur të ikësh ti nga Voskopoja, unë do marr malet e do çmendem.

— E do ta mbash fjalën që më ke dhënë?

— Çfarë thua ashtu, David! Unë një vajzë fukara, ti një zograf i dëgjuar... Po dëgjoji fjalë që më dëshpërojnë. Thonë se pasanikët më të dëgjuar të qytetit janë gati të të bëjnë dhëndër me prikë të madhe, por nuk guxojnë se për ty ka ardhur urdhër të vishesh murg.

— Dëgjo, Ana, kjo është histori e vjetër. Lëkurën time e rrjep dhe rason e murgut s'e vesh e ... sa për prikat e mëdha, ta them hapur, prikën që kanë sytë dhe vështrimi yt, nuk e ka as Ylli i Afërditës!

Ana uli sytë.

* * *

Ktitori i Shënkollit, pasunari Haxhi Jorgji, pasi u përkrye portreti i tij në bazilikë, i ftoi një ditë për drekë Davidin dhe Kolin Stringarin. Shtëpia e tij ndodhej mu në mes të Lagjes së Pasanikëve; ishte tepër e madhe dhe muret e saj të trasha, si të ndonjë kështjelle, ishin veshur me mermer Polene. Oda e madhe ku i priti, ishte shtruar me qilima të trashë me push. Ndërsa kaloi mbi shtrojën, Davidit sikur i humbën kundrat në pushin e trashë. Këndet e odës ishin shtruar me velenxa shumëgjyreshe, me thekë të gjata. Tavani ishte prej pishe dhe i punuar hollë si me filigram. Në mes ishte një oxhak i lartë prej mermeri të kuq.

Plaku i priti me përzemërsi, i përqafoi e u lëshoi këndin. Gjithnjë mbante me duar kërcinjte që i dhimbnin nga përdhesi.

— Eh, djema, djema, ju jeni të fortë si lisa, unë po iki, më hëngrën të gjallë spicat e përdhesit, do ma marrin shpirtin...

Dy vajza shtronin tryezën.

Gjithë shtëpia ziente e gjëmonte nga fëmijët, nga djepet që lëkundeshin, nga zhurmat e kuzhinës dhe nga zërat e grave dhe të vajzave.

Foli Jorgji:

— U thashë djemve të vinin për drekë për nde-

rin tuaj, por ata s'më erdhën, kanë punë dyqaneve; grinden e hahen për një grosh me myshterinjtë, me qiraxhinjtë, me pazvanët e me derebejtë; kështu e ka tregtia!

Sofra qe mbushur plot e përplot. Sa ndenjen pak, miqtë e kuptuan shpejt se ku e kishte hallin plaku. Ndërsa Jorgji fliste për të këqijat e turkut, Kolini ia ktheu se, për të shpëtuar prej tij, duheshin hapur sa më shumë shkolla, duhej hapur domosdo akademia e Voskopojës, duheshin ndriçuar mendjet e njerëzve që t'i shpëtonin robërisë së turkut...

Haxhi Jorxhi i dha të drejtë, por pastaj e ktheu bisedën në çast atje ku i dhimbte... I tha Davidit:

— Kam dëgjuar, zoti David, kam dëgjuar se zotërinë tuaj duan ta veshin murg... Këto janë budallallëqe të patrikut të madh, se ky i Ohrit nuk është burrë i keq, dëgjomëni mua, se unë e njoh... Për ti, zoti David, mund të shpëtosh fare lehtë... (Dhe, duke hapur krahët e duke qeshur, u përkul drejt tij dhe uli zërin). Tetëmbëdhjetë mbesa për në kalë kam, o David, zgjidh njëren dhe agapisu pas saj, dhe ata që duan të të veshin murg, le të vijnë të merren vesh me mua...

Për t'i vënë kapak fjalës, Haxhi Jorgji qeshi me të madhe.

Por Davidi, i pamësuar me këto biseda, ia ktheu:

— Mirë, zoti Jorgji, por... e di, ajo sevdaja, që thoni ju, është si mbirja e salepit... salepi mbin vetëm atje ku do ai e jo ku duam ta mbjellim ne!

Me të thënë këto fjalë, Davidi ndjeu në gjunjë, poshtë tryezës, një goditje. Kolin Stringari ndërhyri në bisedë:

— Zoti Jorgji, fjala juaj është shumë e drejtë.

Mbesëria juaj është kaq e shumtë dhe kaq e bukur, sa edhe fara e salepit tonë diku do të mbijë!

Haxhi Jorxhi përplasi duart i kënaqur dhe në çast kërceu përpjetë, duke harruar dhimbjen e kër-cinjve.

— Do shkoj të hap me duart e mia butin me verën më të vjetër.

Sapo doli plaku, Kolini vërejti dy-tri vajza që vinin rrotull nëpër odën e madhe me sytë përdhe e duke përgjuar ç'do të thuhej. Ai i foli Davidit:

— Ti po na prish punë, mos ia pre ashtu me sëpatë plakut. Se mos do rrojë sa të martohesh ti e sa të martohen të mbesat. Mos ia prish fjalën, se na duhen para e ky ka premtuar të japë. Do hapim akademi ne... E me se do ta hapim? Me morra?!

— Po dale, se kështu nuk bën.

— Aaá, se mos ne do t'i shesim basmë Jorgjit! Se mos ky ka lindur me këmishë të artë. Paret e tij nga ky truall kanë dalë. A s'e kupton?

* * *

Punëtorja endëse Ana kishte shkuar kaq herë në bazilikën e Shënkollit dhe i pozonte Davidit. Një ditë ajo i vajti para kophe e duke u dridhur. Davidi lëshoi penelin në poç dhe rëndi drejt saj. Ajo rrinte kryeulur, kurse Kolini sapo u dha në bazilikë.

— Ç'ke kështu, Ana?

Ajo dridhej dhe sytë i mbante përdhe.

— Fol shpejt, ç'të ka ndodhur?

Ajo u përgjigj pa ngritur kryet:

— Ai nuk e ka hapur punishten vetëm për të endur qilima...

— Ashtu? E pastaj?

— I bërtita një herë «mos më prek», por nuk më dëgjoi. E pështyva në fytyrë dhe i këputa një shuplakë...

— Pastaj?

— Pastaj erdha drejt e këtu.

Ai i vuri dorën mbi sup. Ishte fare afër me të dhe kaq afër nuk e kishte parë kurrë.

— Ana, mirë bërë që erdhe drejt e këtu, po qëndro... atje, — e ai rrëmbeu një grafit, — qëndro atje, Ana, ngrije kokën, mendo se ke përpara atë djallin dhe thuaji edhe një herë: «Mos më prek», thuaj...

Vajza u bind.

Kështu, David Selenicasi pikturoi skenën «Mos më prek», që ndodhet sot e kësaj dite në bazilikë. Fytyra e Anës këtu është plot jetë, pafajësi. Ajo është njëherësh e bukur, e dëlirë dhe e rreptë, mbi fytyrën e saj lexohet si mbi një libër të çelur. Flokët e Anës, të gjatë e të derdhur përpara, i rreh fladi i Voskopojës.

Kur mbaroi skicën e parë, Davidi i tha:

— Nuk do shkosh më në punishte. Ti, Kolin, të lutem, rregulloje këtë punë, le të punojë vajza në bibliotekë...

— Në bibliotekë? Po si t'ia bëjmë, atje kemi nevojë, por duhet të dijë pak latinisht, pak...

— Patjetër, vajza ka për të mësuar. Ik, Ana!

* * *

Davidi u ngjiti shpejt në kupolën e mesit, u shtri mbi skelë dhe ia nisi punës.

Te kroi i madh me tre sulinarë, para bazilikës së Shënkollit, ishin mbledhur gjithë ato vajza e

mbushnin ujë. Stomnat e reja prej argjili të kuq e të hollë e thithnin ujin dhe gumëzhinin si mushti në varelë. Vajzat shamatonin e qeshnin, dhe Davidit i dukej se qeshjet e gazet e tyre hynin në stomnat bashkë me gurgullimën e ujit. Ai nuk e kuptoi, i pihej ujë apo kishte dëshirë të vështronte vajzat nga afër. Zbriti nga skela dhe doli te kangjellat e hekurta të oborrit. Gjithë ata sy vajzash u kthyen andej. Ai ngriti duart dhe nënqeshi:

— Vajza, kuësh do të më japë ujë?

Zhurma dhe gazi te kroi u përziën me gumëzhimën e sulinarëve. Pështjellim dhe nxitim. Drejt tij u ngritën gjithë ato stomna.

— Merre stomnën time.

— Këtë timen...

— Këtë që të jap unë...

Tridhjetë e ca vajza, tridhjetë e ca stomna të kuqe, gjithë ato duar të bardha.

Nga tërë ato stomna ai do të merrte atë që e kishte më afër, atë që gati iu ngjesh pas kraharorit, sepse atë stomnë po e ngrinte drejt tij ajo vajza gjatoshë, koka e së cilës dilte një pëllëmbë mbi të tjerat. Dhe ata sy të grizhtë ishin të Anës.

Ai e ngriti stomnën aq vrullshëm, sa uji iu derdh nëpër gushë dhe mori tatëpjetë. E iu duk se bashkë me ujin e kroit të madh, ai po merrte brenda vetes edhe këngët, edhe zërat e gëzuar të vajzave.

* * *

Rrezet e diellit të pasditës binin pjerrtazi nëpër degët e vidhave shekullorë dhe luanin mbi fytyrat e të rinjve që hidhnin valle. Dhe Davidi shihte

se si shpalosej ai vargan vajzash e djemsh, shihte fytyrat e tyre një për një, sytë e zinj, flokët kaçurrelë, tek rrihnin faqe e gusha, tek fashiteshin tufa flokësh mbi vetulla, mbi sy e mbi ato gusha farfuri.

«Ja tek është ajo, ajo, ajo...»

Dhe Ana, duke qeshur me të madhe për t'i bërë qejfin atij, dendur e më dendur shkëput duart nga vallja dhe bën sikur ndreq flokët... Kjo ishte shenja e tyre e fshehtë. Dhe ajo kujtonte gjithnjë se ai i thoshte: «Kur të shoh ty të gëzuar, kur ndiej se edhe zemra jote rreh për mua, kur mendoj se ti je imja dhe do të jesh përgjithnjë... më shket peneli e më vjen frymëzimi...»

Davidi, i shtrirë atje lart, nën kupolë, për një çast mbylli sytë e përkuli kokën; mjekra i goditi në kraharor e si prej vetiu vuri dorën në zemër. Atëherë i shkoi nëpër mendje të gjitha punimet e tij; menjëherë ndjeu një ngazëllim, një hare, një lehtësim të brendshëm të shpirtit, ndjeu një ngushëllim e gëzim të pakufi.

Papritur në sytë e Davidit u shfaq vështrimi i pakapshëm i «Profetit të Panjohur» në Valsh, vepër e Onufrit. «Ata sy aq të butë e aq të thellë, ata flokë rebelë që i rreh shqota... Me siguri, Onufri fytyrat i ka marrë nëpër vallet, nëpër dasmat dhe nëpër shtrungat e blegtorëve të mëmëdheut. Kështu do të bëj edhe unë gjithnjë...»

Por nuk mundi ta çonte gjer në fund mendimin, sepse fare papritur dëgjoji një zë aq të ëmbël e aq të ngrohtë, aq të përgjëruar...

— David! Ja ku erdha, David!

Zëri i saj i shkrifur e bëri të dridhej atje

lart, e shkundi të tërin, dhe ai, pa e kuptuar as vetë, bëri një lëvizje të beftë e të pamenduar.

Dhe nga ajo lëvizje, që ishte më shumë një si kërcim e si hedhje, u dëgjua gërvima e një druri që u thye e pastaj ai ndjeu që po binte...

Ishte thyer copëza e kunjit që mbante litarin e sajës ...Papritur supi i xhaketës së tij ishte kapur te koka e një gozhde dhe ai mbeti i varur pezull. Poshtë Ana, e tmerruar, kapi flokët, por ndërkaq Davidi u kap pas një direku. Pastaj u kap edhe me dorën tjetër, e mollëzën e dorës së majtë diku e çori...

Dhe sa zbriti Davidi poshtë, ende i përfshirë nga frika e vdekjes që gati e rrëmbeu, ajo... me lot në sy, iu derdh në krahë, vari kryet mbi supin e tij dhe i pëshpëriti:

— David... unë e kam fajin, David!

Davidi bëri t'i shihte sytë, por ata ishin pulitur e nuk dukeshin më. E lëshoi për një çast atë, rëndi nga hyrja e bazilikës, shtyu kanatin e rëndë, shkuli nga muri shulin lavrak dhe ia vuri derës nga mbrapa. U kthye turravrap te ajo. Tashti ishin mu në mes të kishës. «Këtu ku u vihet kurorë çifteve, këtu ku pagëzohen fëmijët, këtu ku vendosin arki-volet, këtu ku nis e mbaron jeta e besnikëve, dhe këtu, për inat të atyre që më ndjekin e më skërmitin dhëmbët, për inat të atyre që duan të më veshin murg, për inat të Bane Licave, këtu...»; mendoi ai dhe i pëshpëriti Anës.

— Mos ki droje, Ana, shpejt e shpejt...

Rrëmbeu grafitin. Vetëm atë, sepse për ngjyrat nuk ishte koha e as vendi. Në çast iu kujtua një venedikas që kishte kaluar ca kohë më parë në Vos-

kopojë. Ai e kishte quajtur nxënës të Ticianos dhe Davidi uroi tashti që të ishte vërtet i tillë...

Sa herë i ishte lutur asaj që t'i pozonte për një pikturë, sa herë i pati rënë më gjunjë!

— Bane Lica ka thyer qafën në Ohër, ti rri e qetë! Ana, qëndro kështu, Ana, — iu lut ai.

Kurrë në jetën e tij ai s'do të kishte një përsëdytje të tillë.

Përmbi ta ishin të pesë polielat e rënda plot me llambadha të mëdha prej dylli blete, që lëshonin aromën nëpër bazilikë; nën polielat vareshin pesë globe gjigante prej kristali të çmuar. Kristalet ishin të kuq, blu, të gjelbra, portokalli, kristale të ndritshme si pasqyra. Në cipat llamburitëse të globeve dukej profili i trupit të asaj, gjysmë e shtrirë, një bardhësi e njomë.

...Dhe ishin atje nën sytë e shenjtorëve, sytë e të cilëve sikur i shihnin ata me egërsi, kurse vetëm «Farëmbjellësi», me pamjen e tij prej rebeli e me vështrimin që i kishte dhënë Davidi, dukej sikur u bënte rojë.

Kur ajo po vishej, ai lëshoi një pasthirmë habie!

— Ana, ç'na paska ndodhur kështu?

Nga mollëza e dorës, nga ajo plagë e vogël që iu bë kur u rrëzua nga skela e lartë, kishte rrjedhur gjak dhe ata vunë re se nëpër gushën e saj kishte njollëza gjaku.

Ajo u vesh me krye të ulur, kapi me të dy duart fustanin e gjatë diku mbi gjunjë, e ngriti paksa për të mos u penguar dhe bëri të ikte. Por ai nuk e la.

— Dale, Ana, qëndro... e di, tashmë ti je gruaja ime.

Ajo uli kryet edhe më. Ishte shenjë se ajo e

pranonte këtë, por befas u drodh e, pa e vështruar në sy, ia vuri duart grusht në kraharor, sikur deshi ta qëllonte:

— David... David... ata janë të pabesë, ata ngulin këmbë që të vishesh murg, ata flasin nëpër qytet se ti je një jeremit e të ngucin të banosh këtu, në hajat të kishës... David, betohu se ti...

— Të betohem, Ana!

— Betohu edhe se do ta ruash të fshehtë tonë, përndryshe mua do të më lëshohen me gurë.

Ai e dinte këtë rrezik. Dhe ndjeu një vërshim brenda vetes. Dhe u mbush me frymë aq fort, sa i bucitën veshët. I erdhi një dëshirë e brendshme, e fortë, këmbëngulëse. Donte të ishte tani i fuqishëm, të kishte forca mbinjerëzore dhe të vërsulej me grushte kundër...

Ai e dinte kundër kujt, por një zë i brendshëm e qetoi. Çfarë mund të bënte? Të ikte mafeve me kacakët kryengritës? Bukuri. Një çetë do të kishte një martinë më shumë...

«Kurse armët e mia janë peneli, ngjyrat, frymëzimi.»

* * *

Në hyrje të Voskopojes, herët në mëngjes, gjatë udhëve të tregut u dëgjuan zhurmat e rënda të një arabaje. Fishkëlloi një kamxhik, u përplasën disa dyer, pastaj britma dhe një tellall që rrihte shkopin mbi lëkurën e daulles dhe njoftonte ardhjen në Voskopoje të peshkopit të Ohrit, Emanuelit.

Me ta dëgjuar këtë lajm, Davidi mblodhi buzët, atje në majë të skelës, e mendoi për ngatërresat më të reja që i sillte kjo ardhje. Zbriti ngadalë dhe këmbët i qëndruan para afreskut «Farëmbjellësi».

Por... sapo nisi ta përkëdhelte atë me sy... porta e bazilikës u përplas dhe Bane Lica zbriti shkallinat e mermerta të hyrjes duke ftuar hirësinë e tij, peshkopin Emanuel, që të kishte nderin të hyn-te në tempullin më të ri të Voskopojës...

Emanueli çau përpara si një dem dhe Davidi dalloi cipën e zezë të peshkopit, që preu rrezet e dritës. Ardhja e tij drejt e këtu nuk i pëlqeu aspak Davidit. Emanueli dukej me fytyrë të ngrysur, delli i ballit i kishte kërcyer dhe vështronte anembanë me mëri. Megjithëse ngriti dorën lart dhe e bekoj kishën e re, u shti sikur Davidin nuk e dalloj fare. Çapet e tij të shkurtra qëndruan pikërisht përpara «Farëmbjellësit». Ai i hodhi afreskut një vështrim të egër dhe kafshoi buzën e poshtme: «Ky na qenka ai këlyshi zograf!»

Fytyra e Emanuelit u kaltërye, të bardhat e syve iu mbushën me fijeza gjaku, kokën e skeptrit desh e shtrydhi me pëllëmbën, kurse fundi i tij gërvishhte me zemërim shtrojën e mermertë të bazilikës.

«Kushedi ç'letra e hafije kanë shkuar në Ohër», mendoj Davidi.

Një raport i gjatë kishte shkuar, këtë ai e dinte, por atë që ende nuk e kishte marrë vesh ishte mbledhja një muaj më parë midis peshkopëve të Ohrit dhe të Kostandinopolit. Këta qenë mbledhur në një përpjekje për të sheshuar sherrret midis tyre. Sheshimi kishte përfunduar në një përfytje dhe një nga mollët e sherrit na kishte qenë vetë piktori David. Kryedelegati i Fanarit kishte bërë tur:

— Përkëdheleni dhe mbajeni në Voskopojë here-tikun David Selenicasi, krihjani bishtin, po ai ka

për t'ju ngrënë kokën, ai po sfidon haptazi fenë dhe shenjtorët tanë. Ambasadori venedikas në Stamboll ka lëshuar hafijet dhe po përdor të gjitha mënyrat për ta rrëmbyer Selenicasin dhe pastaj të na për-qeshë ne edhe ju për ujin që na e ka shkuar nën rrogos...

Peshkop Emanueli po grindej me veten:

«Ky zograf qenka vërtet një heretik. Ky «Fa-rëmbjellës» me opinga lope e rroba shajaku, njëfarë bujku nga Gjonmadhi, me dy sy prej vrasësi, ky çdo gjë mund të mbjellë, po kurrë farën e fesë sonë të krishterë... Të drejtë paskan pasur ata të Kosta-ndinopolit, të drejtë ka edhe Bane Lica».

Dhe Bane Lica, që të binte më mirë në sy, hipi në një shkallare dhe përgjonte herë peshkopin e herë Davidin. Turiri iu zgjat dhe i mori një profil dhelprë dhe lëkura e faqeve iu përskuq më fort, sa iu mbush me kukunjëza. Davidi e pa ashtu dhe ajo fytyrë e shëmtuar prej pijaneci, ato mollëza mavi iu ngulën në kokë: model më i përsosur për një Judë...

Epitropi Bane Lica ishte nja dyzet vjeç. Me gjithëse gdhihej mejhaneve të qytetit, falë dallave-reve të tij, kishte shtënë në dorë këtë vend epitropi dhe mendohej domosdo ta mbante si qeni kockën, duke qenë një spiun i përkryer. Në këto çaste ai pristë shpërthimin e peshkopit kundër Davidit, prandaj njëherë i bëri shenjë me dorë peshkopit duke i treguar afreskun e diakon Stefanit. Emanueli dukej që u mbush me vrer dhe vijonte të kafshonte buzën e poshtme:

«Këtij palaço bojaxhiu i duket vetja kushedi kush është! Ky është ai që nuk do të vishet murg, ky është ai heretik që ka shkelur me të dyja këm-

bët kanunet e kishës, ai bandilli që i ka shkrepur të martohet. Do mbledh parinë sa për sy e faqe dhe po nuk e degdisa syrgjyn në ndonjë qoshe, Emanuel mos më thëncin...»

Në ato çaste, gati pa u ndier, në bazilikë hyri edhe Kolin Stringari. U vështrua sy më sy me Davidin dhe i bëri atij shenjë të mos ndihej.

Pa u kthyer nga të tre priftërinjtë që e shoqëronin, peshkopi tha:

— Njoftoni ku duhet... nesër mbrëma të mbli-dhet paria e qytetit, kemi për të biseduar për këtë bazilikë...

Kolin Stringari, me të dëgjuar, mendoi se duhej të shkonte e të takonte shokët e vet, duhej të fliste me Haxhi Jorgjin e me ndonjë tjetër.

Kur peshkopi, pa i folur fare Davidit, ngjiti të pesë shkallaret dhe bëri të dilte përjashta, e ndoqën këmba-këmbës të tre priftërinjtë, pastaj edhe vetë Bane Lica. Davidi me Stringarin hipën në dy skelëza dhe vështronin atë peshkop të ndër-kryer, që i dridheshin bulçitë nga inati.

* * *

Bane Lica e parandjeu mbledhjen e fshehtë të Kolin Stringarit me shokë. Ajo do të bëhej asaj nate në sallën e madhe prapa depos së shtypshkronjës. Salla përdorej si depo letre, që asaj kohe sillej me karvanë nga Vjena.

Spiuni zelltar e nuhati që mbledhja do të bëhej për të shpëtuar Davidin nga «zemërimi» i etërve të kishës, kështu që qysh në mbrëmje hyri vjedhurazi në depo, u kacavjerr pas shkallës dhe, meqenëse atje nuk kishte fare tavan, u shtri mbi tri copë dërrasa që ishin hedhur mbi trarë. Atje u

nxi dhe u bë blazë i tëri nga retë e tymit të pish-tarëve që kishin ngritur jatak një gisht të trashë. Fytyra i mbush me zhul e me pëlhura meriman-gash, por atë e mbante në qejf çasti kur, pas mble-dhjes do të rendte e do të shtrohej të shkruante raportin për ato që do të shihte e do të dëgjonte.

Por, kur salla dalngadalë u mbush me shkollarë të shoqërisë «Vëllezërit e Ndëriturisë», kur i pa dhë i njohu një për një gjithë ata burra që i nde-ronte qyteti i tërë, kur vërejti se në mbledhje ishin edhe tre punëtorë, djem të shtypshkronjës, kur dëgjoi edhe zërin e Kolin Stringarit që hapi mbledhjen, Bane Licën e zunë së pari disa të the-rura e ca dridhëma të çuditshme. Diku nga e djathta e tij iu bë se dëgjoi ca zhurma të frikshme. Më pas i dha zemër vetes sepse dëgjoi një krakavitje të mbytur. Ishin kukuvaikat që ishin strukur në hatulla. Megjithatë ai nuk përqëndrohej e të dë-gjonte kurrgjë nga ato që fliteshin poshtë. Po si-kur ta zbulonin që përgjonte, i ziu ai, ata tre djem-të viganë të tipografisë do ta shqepnin në dru.

Por... sidoqoftë ai diçka dëgjoi dhe, nga ana tjetër, do të arsyetohej para peshkopit, se në mble-dhje folësit, përveç arbërishtes dhe aromunishtes përdornin edhe ca fjalë latine e ca «arqea elenika», nga të cilat ai s'merrte vesh fare. Por fjalët e David Selenicasit, kur tha: «Idheologjia jonë kër-kon që t'i nxjerrim në gjyqin e arsyes patrikët e të dy patrikanave dhe Bane Licat me shokë», i nguli fort në mendje.

Pas tri orësh aty mbi trarët e depos së madhe Bania doli me vrap nga hajati i Shënkollit dhe u nis për nga shtëpia e Mitrove, ku kishte bujtur peshkopi. Kishte kaluar mesnata. Njëpër kryet e

udhëve, poçat prej mermeri të kuq, ku për ndriçim digjej rrëshirë, e dyllë blete, ishin gati në të shuar. Qyteti flinte dhe vetëm pazvanët kërcitnin raketrakët e tyre, duke u vërtitur pas qosheve të tregut. Kapërceu urën e madhe, hyri në një zigzage të monopateve dhe trokiti në portën e Mitrove. Asnjë përgjigje. Errësira ishte e plotë. Papritur, diku nga shtëpia e madhe erdhën gjer jashtë zhurmat e maceve që ziheshin e grindeshin për kockat e darkës dhe një erë e fortë vere, prerë me sinap.

Më në fund portën e çeli përgjysmë një dhjak që pyeti:

— Kush troket në këtë orë?

— Jam unë, Bane Lica, pret hirësia e tij një fjalë nga unë...

— Po ai po bën gjumin e parë!

— Le të bëjë edhe të dytin... mua kështu më ka porositur, ti thuaji, se e di vetë ai.

Më në fund, në një korridor të ngushtë, ku ndezën një pishtar, doli peshkopi me benevrekë të gjata të bardha. Me dorën e djathtë mbante të çarën e këmishës në gjoks, kurse me dorën e majtë shtrëngonte mjekrën. Me të parë Banen, ai i foli:

— Hë, si dole?

— Po... ja, ashtu.

— Ç'është kjo ashtu.

— Po ja, ashtu, hirësi... rrumbullak e plot me qoshe... ja, ku të kam sjellë raportin me shkrim... Unë e di sa kam hequr sonte...

* * *

Në mbrëmjen e tretë pas ardhjes së peshkopit në Voskopojë, në sallën e madhe anash katedrales së Shën Marisë u bë mbledhja e parisë së qytetit.

Salla ishte fare e re dhe mbante erë gëlqere. Edhe nuk kishte hyrë era e temjanit dhe e qirinjve të djegur. Mbi tryezën e madhe para peshkopit kishin vendosur një saksi me lule shëngjini.

Kur zunë vend në frona burrat, kur edhe Kolin Stringari i pashëm e sqimatar i ra mes për mes sallës dhe u ul në vendin e vet, mbledhjen e hapi një sekretar i pleqësisë, i cili shpejt e shpejt hyri në temë dhe nisi të lexonte përmbledhtas akuzat kundër David Selenicasit.

Peshkopi Emanuel shtihej si i qetë e hodhi një sy rreth e qark. Në sytë dhe fytyrat e shumë shkolllarëve të qytetit ai lexonte urrejtje dhe mëri kundër tij. Këtë e kuptonte. Dhe kishte menduar se nuk do të linte të çanin shumë dërrasa. Në fund të fundit, David Selenicasi ishte zograf, ai i takonte pushtetit kishtar, buka dhe ngjyrat për të paguheshin nga arkat kishtare. Dhe, nëse ndonjëri e ngrinte zërin si shumë... peshkopi mendonte se kishte fjalën e fundit. Ai ishte i vendosur që ta dënonte dhe ta dërgonte syrgjyn Davidin.

Peshkopi priste që fjalën ta merrte i pari Kolin Stringari. Por u gabua. Së pari u çua ktitori i bazilikës së Shënkollit Haxhi Jorgji, të cilit Davidi i kishte bërë portretin mu në hyrje të kishës, nga ana e majtë. Një portret me madhësi natyrale që e kishte zili gjithë qyteti. Haxhi Jorgji fërkoj lehtë mjekrën dhe foli:

«Ata që kanë dërguar kartëra me kallëzime kundër zografit tonë, zotit David, kuptohet se kush janë. I pari është një faqezi, që nuk i takon të mbahet, as si besnik kishë e jo më pastaj si epitrop, ai është një pijanec e kurvar e shpifës. Kaq për këtë turp të qytetit tonë, se nuk ia vlen të

merremi më të. Sa u takon vlerave të surratëve të tjerë... cilin të zëmë në gojë!? Psalltin e dështuar, këtë faqezi e të pazot? Apo pazvanin e zvetënuar që na ngatërron qytetin e tërë? Apo të përmendim Miltiadh Gopën maskara? Në çdo gjyq duhet të kemi parasysh sa u vlen lëkura shahitëve e... këta nuk janë shahitë, por jallan shahitë! Por sa i takon zografit, unë kam të them shumë. Së pari dua të zë në gojë se këtu unë flas në emër edhe të shokëve dhe të miqve të mi. Dhe të gjithë ne, hirësi epishkop, jemi të mendimit se zografi e ka zbukuruar shumë qytetin tonë, ai u ka dhënë dhe po u jep «gërshërë» edhe djemve të rinj që të shkojnë pas gjurmëve të tij. Po përse ta fshehim!? Të gjithë e dimë se republika e Venetikut derdhi shuma të majme që Davidi të shkonte në Itali, por ai ua hodhi turinjve. Se Davidi është patriot dhe mëmëdhetar, ai nuk bën kabull ta marrë nën kundrat e veta baltën e Voskopojës dhe të shkojë t'u shërbejë të huajve. Unë nuk marr vesh shumë nga hollësitat e punës së tij, por edhe fare i leshtë nuk jam... Kur pashë punët e zotit David në bazilikën tonë e pastaj i përqasa me ato që na erdhën nga Agjionorosi... si dita me natën. Paraja kallp është para kallp, njihet që atje tutje...»

Peshkopit Emanuel i përvëloi përbrenda. Haxhi Jorgji po krahasonte punën e Davidit me ikonat që dërgoi ai vetë.

Nuk pati kohë të mendohej më tutje se u ngrit Kolin Stringari. Ai u çua me një kërcim djaloshtar. Fytyrëmprehtë, flokëzi dhe i pashëm.

— Zotërinj të nderuar! Hirësi! Me ndihmën e punëtorisë së qytetit tonë, shkova dhe mësova nëpër shkollat e Evropës e pastaj shëtita gjithandej;

pashë kisha e monumente në Lindje, por në të gjitha kishat që kalova, një bazilikë të tillë, me një zbukurim kaq të përsosur, me një art kaq të hollë nuk e pashë asgjëkundi. Unë po flas në emër të gjithë shkollarëve të qytetit tonë. Ne së shpejti këtu do të ngremë akademinë e re dhe Davidi këtu do të japë mësimë... Ky do të jetë një nder shumë i madh për Voskopojën...

Deri këtu dhe peshkopi nuk duroi dot. Ai tashmë kishte një urrejtje të tërbuar për Davidin. Urdhrin që ai të vishej murg e kishte firmosur vetë, por piktori e kishte pështyrë. U ngrit rëndë-rëndë dhe foli:

— Ne e kemi përkrahur lulëzimin e Voskopojës, por nuk duam kurrsesi që në emër të kësaj përkrahjeje t'i vëmë kazmën ikonografisë sonë. Ju pyes ju, zoti Stringari... Në emër të kujt e hedh farën ai «Farëmbjellësi» i bazilikës së Shënkollit?

Stringari kërcëu:

— Në emër të dashurisë për jetën, hirësi, për ata që jetojnë dhe për ata që do të vijnë...

Emanuelin sikur e kafshoi grerëza. U ngrit dhe përplasi grushtin mbi tryezë.

— Jo. Jo. Përgjigjen do ta jap unë vetë. Ai farëmbjellës është një ateos sa kohë që s'ka asnjë shenjë kryqi as në rroba, as në ballë e askurrkund. Ai është një heretik kokë e këmbë. Me ata sy prej pirati ai nuk sheh nga qielli, por sheh nga malet, andej nga mërzejnë kaçakët dhe hajdutët, sytë i ka prej rebeli, vështrimin prej vrasësi, këmbët prej maloku ngjeshur në baltë dhe Davidi juaj e ka vendosur me shpinën kthyer Ohrit...

— Kostandinopolit, hirësi, — ndërhyri Stringari.

— Re vetë brenda, Stringar. Domethënë edhe vendosja është bërë me qëllim. Kujt kërkon t'ia shkojë Davidi ujin nën rrogos? Mua? Me këtë farëmbjellës pirat që edhe mjekrën e ka si drizë dhe ka përveshur mëngët e këmishës si ndonjë kasap e ka lidhur belin me litar si hajdut kuajsh! Pyes, zoti Stringari, ç'është ky «Farëmbjellës»? Ta them unë vetë: ky është një gjakësor që na paska mbytur një ujk... ua... çudi e madhe!

— Hirësi! — foli sërish Stringari, i vendosur të mos e lëshonte fjalën, — ju i keni marrë së prapi gjërat, ju kanë yshtur njerëz të pazotë e të papërgjegjshëm. Kur flasim për art nuk kemi parasysh njollat me bojë. Le ta shtrojmë çështjen më arsye...

— «E drejta e arsyes, e drejta e arsyes», — përqeshi peshkopi. Mos vallë kjo e drejta e arsyes, për të cilën ju vunë drunë nga Janina, kërkon që David Selenicasi të mbetet zograf këtu, apo edhe të martohet këtu? Ai është zograf, janë derdhur flori për ta mësuar dhe ai është shërbëtor i kishës... Unë, bir i parësisë së Durrësit, e kam veshur rason e zezë për t'i shërbyer zotit, një kolonjar kokëmushkë s'e pranon, e ku është parë kjo?

Kolin Stringari u skuq gjer në rrënjë të flokëve.

— Hirësi, nuk duhet të humbasim, të mendojmë e të marrim nëpër këmbë një njeri të tillë. Voskopoja ka nevojë për të...

— Më mirë djepi bosh, sesa djalli në të, — ulëriu peshkopi.

Kolin Stringari u ngrit vrik e më këmbë. Kacurrelat e hijshëm i nxinin mbi ballin e bukur e të ngritur lart.

— Së pari, t'i kemi llogaritë në vend. Paret që

janë derdhur për Davidin, nuk i ka derdhur askush, përveçse ata që i kanë derdhur edhe për mua. Për-
sa i përket përzënies sime nga Janina, jua them
troç: e kam për nder, ika nga temjani i mykur i
kokëboshëve dhe erdha në Voskopojë, këtu ku
shkëlqen ndrituria. Sa i takon David Selenicasit, ai
ka vendin e vet të nderit në këtë qytet dhe brezat
që vijjnë kanë për të ngrohur shpirtin me veprën
e tij. Çfarë keni ndër mend të bëni, bëjeni, edhe ne
duarkryq nuk do qëndrojmë...

Peshkopi përsëri kërcëu përpjetë.

— Mos harroni ju, Stringar, se Davidi është
djalli vetë...

Kolin Stringari u tërbua më keq. Duke i më-
shuar gjer në fund zërit, bërtiti:

— Davidi nuk është djall, zotëri. Ai është një
yll në qiellin e ndritur të Voskopojës, dhe këtë
qiell një re e zezë kërkon ta errësojë...

— Si guxon?! — bërtiti Emanueli — ti je një
njeri i padenjë dhe për këto që nxore nga goja,
në goftë se unë nuk do të të shkishëroj ty, kam
për ta shkukur vetë mjekrën time...

— Ti mund të shkulësh çfarë të të dojë qejfi!

Sytë e peshkopit u çakarritën, u vengëruan; të
dyja nofullat ia kapën dridhma ethesh dhe desh
iu shkopsitën.

— Je i mallkuar, je i shkishëruar, ti je një i pa-
turp, je një pinjoll i padenjë. Edhe ti e nxit Da-
vidin në rrugën e djallit, me ato shoqëria, me ato
eterira, me ato fitet e gjyqet e ndriturisë nën rro-
goz, ju i jepni kishës munxat dhe e zvetëtoni, po
i jepni Voskopojës helmin e katolikëve...

Kur e pa Emanuelin të tërbuar nga inati, Kolin
Stringari nënqeshi dhe ngriti lart të dyja duart.

tjetër. Ai deshi medoemos një rrugëzgjdhje, por pa rënduar krenarinë dhe postin e vet. Vetëm për një gjë ishte i bindur gjer në fund: që David Selenicasi ishte një heretik dhe nuk duhej falur në asnjë mënyrë.

Qytetarët nuk po u besonin syve kur panë peshkopin me gjithë atë mjekër, me gjithë atë raso e mitër, me atë skeptër në dorë tek ikte si i shkalluar nëpër rrugën e gjerë të tregut. Ikte i vetëm, ashtu si nuk i kishte hije një peshkopi, duke përplasur skeptrin në kalldrëm, pa vështruar anash, po vetëm duke dihatur e shfryrë. Shkoi drejt e në Shënkoll.

Kur hyri në oborrin e bazilikës, Emanuelit i doli përpara një pamje e pabesueshme... Mu te hyrja e kishës ai pa një hoxhë me sarëk të bardhë në kokë. «A jam në Voskopoje, apo në Gallata të Kostandinopolit, ku hoxhët zbresin tatëpjetë për nga sarajet e padishahut.

Kur u afrua edhe më, i përhumbur pas asaj pamjeje, u pengua në rrasat e rënda të dala për-pjetë të oborrit dhe u përplas përtokë... Shau me inat. Ai e dinte se nuk ishin të paktë të gjithë ata që e shihnin tek ikte ashtu turravrap, i egërsuar si ujku në shkurt.

Sakaq dy duar i dhanë ndihmë të ngrihej. Kur e vështroi njeriun që e ndihua... ishte hoxha dora vetë. Koka e mbështjellë ishte vërtet e hoxhës, po fytyra ishte e Bane Licës!

Epitropi, duke rënkuar, sa për hesap të vet, sa edhe për hesap të peshkopit, i vuri në duar skeptrin, i tha fjalë ngushëllimi e, gjithnjë duke u ankuar, shtoi:

— Hirësi, mbrëmë disa të panjohur më rrahën.

Trupin dhe kokën i kam të pllakosur me qepë e kripë. Nuk i njoha dot, hirësi... por që i ka shtyrë, është...

— Kush është? — pyeti tërë inat peshkopi.

— Më duket se është vetë Haxhi Jorgji, sepse ky më doli përpara dhe, në vend që të më ndihte, më kapi për fyti e më kërcënoi se do të më tridhte.

— Mirë, mirë, por edhe ti je kokëbosh. Por pse, or, nuk e ndreqe oborrin si të thashë, sapo erdha këtu? Hë, më thuj, pse? M'u dërrmuan gjunjët dhe, po të mos e kisha barkun të ngjallmë, do kisha përsheshur edhe hundët.

— Si urdhëron, hirësia juaj, por... fajin e kanë ata vidhat, jemi në maj dhe u janë harbuar rrënjët nga lëngu i tepërt.

— Brenda është zografi? — pyeti peshkopi.

— Si urdhëron, hirësi.

Kur Emanueli hyri në bazilikë, pasi Bane Lica kishte shtyrë me gisht kllapën e drunjtë të derës, Davidi ishte përsëri lart në skela. Peshkopi urdhëroi:

— Vëri llozin portës!

Më në fund peshkopi u ul rëndë-rëndë në fronin e dhespótit dhe kapi me duar të dy kolonëzat e holla prej dru qershie që ishin punuar me aq shije e aq hollë prej gdhendësve vendas. U koll fort si për t'i dhënë shenjë Davidit të afrohej. Piktori u çapit qetë-qetë, duke pasur në dorën e djathtë një penel. Emanueli foli:

— Ti e tregon vetë urrejtjen ndaj etërve të kishës, nuk ke as nderimin më të vogël...

— Pas gjithë atyre britmave tua ja në mbledhje... Peshkopi i vari edhe më poshtë vetullat dhe e

kuptoi se nuk do të merrej dot vesh me këtë njeri. Ky s'kishte për t'u përkulur. Me gjithë këtë ia filloi:

— Dëgjo këtu, «Farëmbjellësin» do ta heqësh fare, do ta prishësh; Kostandinin e Madh do ta vendosësh më të djathtë, ashtu si i ka hije Kostandinin të Madh. «Kush s'ka mëkatuar ndonjëherë...» do ta prishësh gjithashtu. Edhe «Vajtimin». Kurse atë «kryediakon Stefanin» shkule dhe shitja atij kosovarit që e ke marrë për sqedhjo dhe mos bëj pehlivanllëqe. Atë fytyrën e djallit me brirë atje hiqe...

Davidi e dëgjo qetë dhe vuri duart kryq mbi kraharor, si shenjë se s'kishte për të bërë asgjë nga ato që i kërkoheshin.

— Hirësi! Le ta nisim nga fundi. Nëse e heq fytyrën që mban sot djalli, më duhet që mbi supet e tij të bëj fytyrën e një dialli tjetër.

Emanuelit iu drodhën bulçitë.

— E ç'kërkon të thuash me këtë?

— Vetëm atë që thashë. Por ju mos u nxitoni, më dëgjoni edhe mua. Kam tre vjet e ca që punoj në këtë bazilikë, kam derdhur këtu djersën dhe punën time, «Farëmbjellësit» unë nuk i heq asnjë qime.

— Si guxon e flet kështu?

— Se jam në qytetin tim, hirësi, nuk jam në Ohër.

— Kurse këto që thua tregojnë rebelim.

— Unë kam vetëm një penel në dorë, hirësi, s'kam as shpatë, as pushtet, as para e as hafije...

Epitropi Bane kërceu e hyri në bisedë:

— Me lejen tuaj, hirësi, dua t'ju kujtoj se ai

«kryediakon Stefani» është një njeri i një feje tjetër...

— Dhe nuk ngjan aspak si shenjtor, por si një dhëndër, — plotësoi peshkopi.

— Shpif, o Bane Lica, — ia ktheu Davidi. — Në këtë punë më ka ndihmuar ai djaloshi kosovar, që është një vlastar i mrekullueshëm i racës sonë. Një ditë, kur ky epitropi ma solli shpirtin në majë të hundës dhe isha tepër i mërzitur, ai djaloshi gjeti kohë dhe më tha: «Mos u ligsho, hej burrë, ne jena të fortë, ne jena nga ai farë guri që thyejmë edhe çekanin». Jua them këto, hirësi, që të merrni një masë për mendimet dhe bindjet e mia. Sa i takon mospranimin të punës sime nga ana juaj, kjo vjen sepse ju jeni mësuar me punë të trasha. Unë kam dashur që me punën time t'u lëmë trashëgim diçka të bukur brezave që vijnë, mos ndihen të varfër përpara Evropës dhe kam merak se vallë kam bërë sa duhet dhe si duhet? Ja, prandaj më dërguan në shkollë punëtorët dhe esnafët e këtij qyteti.. Po ti nuk kupton, hirësi! Ajo është puna ime më e mirë!

— Ashtu... ashtu... se Kolini yt e quajti kryevepër, por ç'më duhen mua kryeveprat me një fytyrë prej pagani! Dhe ta dish, ti je tinzar... përse atë «Farëmbjellës» nuk e ke vendosur në mes të bazilikës, por e ke zografisur fshehur në një qosh të altarit?

— Dëgjo, hirësi...

— Nuk kam dëshirë të dëgjoj llogot e tua, unë do të të flas qartë dhe shkurt. Së pari, nis dhe hiq atë djallin atje...

— Nëse unë e heq atë djall, në këto çaste kur

ju po më mbushni me inat, duhet ta zëvendësoj me një kryedjall.

Peshkopi Emanuel e kuptoi se ishte e kotë të merrej me Davidin. «Ky njeri i krisur ta bën të keqen. Në mos këtu, në një kishë tjetër, merr fytyrën time dhe ia ngjit një lugati... hej ç'gjeta belanë.»

— Kam sjellë në këtë bazilikë fytyrat e njerëzve tanë ashtu si janë e ashtu si dua unë të jenë. S'kam këtu meshkuj si të tredhur apo të mallëngjyer e të përdëlyer, që qajnë dhe i kanë në prag të syve mëshikëzat mbushur me lot. Do t'u lëmë stërnipërve që vijnë fytyra të kthjellëta, vajza faqekuqe e djem sqimatarë. Kjo është raca jonë dhe arti ynë. Dhe unë kam brengën se vallë kam bërë sa duhet...

Peshkopit iu mbush koka plot:

«Me këtë njeri nuk merrem dot vesh. Ky me shkollarët e Voskopojës qenkan bërë një e një. Patriku le të vendosë si të dojë. «Qëroi gurmazin e dhjamur e tha:

- Kisha të mos hapet!
- Po ju pardje e bekuat!
- Bekova kishën e jo shkarravinat e tua. Kisha të mos hapet!

* *

Vetëm një javë më vonë Kolin Stringari e bëri qytetin të habitej.

— Vëllezër, — kishite thënë, — bazilika e Shënkollit do të hapet të dielën e ardhshme. Shoqëria jonë «Vëllezërit e Ndriturisë», ka marrë vendim për këtë. Në qoftë se prifti i lagjes «Sarza» ose ai

i Lagjes së Shën Janit nuk do të vijnë të meshojnë, do të vishem prift vetë dhe do të meshoj.

Të gjithë vështruan njëri-tjetrin, pastaj Stringarin, se mos asaj dite e kishte përzier ujin me gjësend tjetër. Por Kolini nuk bënte shaka: «Bazilika e Shënkollit do të hapet ditën e diel».

Dhe bazilika u hap. Hajati i bukur i bazilikës, mbushur plot me qytetarë, me ato kolonat e gemit elegante prej mermeri ndriste e shkëlqente. Populli ngazëllehej tek shihte veten në fytyrat e vizatuara, e gëzohej tinëzisht që Miltiadh Gopa, Bane Lica e nja dy të tjerë ishin bërë si shejtanë, si dhelpra e si lugetër. Prifti i lagjes «Sarza», që ishte edhe anëtar i shoqërisë «Vëllezërit e Ndriturisë», drejtoi meshën. Pastaj bazilika mbeti hapur ditë e natë, sepse nuk mbeti njeri i gjallë në qytet pa hyrë dhe pa vështruar më nge punën e piktorit David. Lajmi u përhap shpejt e shpejt dhe qyteti priste me ankth se ç'do të bënte patrikana buzë liqenit sa edhe patrikana buzë detit për këtë guxim të papritur. Bane Lica i hodhi kyçet e bazilikës dhe ia mbathi vrapit për në Ohër.

* * *

Ishte muaji tetor i vitit 1726. Kishin filluar shirat e mëdha dhe ishin nisur karvanët e fundit që çonin rrëshirë në Trieste. Një llandon i zi hyri një natë në Voskopojë dhe qëndroi te banesa e kryearhondit. Njeriu që doli nga llandoni, nuk ishte veshur me petk fetar, por atë e kishin veshur me disa fuqi dhe me disa urdhra të prera e të rrepta. Patrikana e Ohrit deshi t'i hidhte gunën çështjes së bazilikës së Shënkollit. Jerarkët e Ohrit ishin tre-

mbur nga kërcënimet e Fanarit. Urdhri ishte i prerë: «Me hir ose me pahir, David Selenicasi duhet të largohet nga Voskopoja dhe të shkojë për të merretuar afresket e kishës së Maligradit në ishullin e liqenit të Prespës. Nëse kundërshton, të përdoret dhuna... Kemi dërguar edhe njerëz të tjerë për këtë punë... Këto ditë vjen në Voskopoje edhe peshkop Nikolla, shok shkolle i Davidit...

Dhe vërtet, të nesërmen erdhi peshkop Nikolla në Voskopoje.

Kolin Stringari shkoi te Davidi dhe biseduan gjatë. Kur nuk gjetën ndonjë rrugë tjetër, Davidi tha:

— Të pata thënë, Kolin, jetojmë nën shpatën e Demokleut. Mirë e parashikova... Helmin e ka në bisht...

— Unë mendoj, — tha Stringari, — me këtë gjendje që u krijua, të tregohemi të matur. Në përmbytje ose në tërmet duhet t'i ruhesh valës së parë, pastaj....

— Pastaj? — pyeti ethshëm Davidi.

— Pastaj shohim e bëjmë. Ki besim tek unë. Ti do të japësh mësim në Akademinë tonë, kjo është punë e vendosur.

* * *

Davidi e priti Nikollën në kohën që ishte duke pastruar penelat. Ishin moshatarë dhe Nikolla ishte peshkopi më i ri në oborin e Ohrit. Me ta përqaftuar Davidin si shok, ai hoqi nga qafa kryqin dhe nuk e la të mendohej:

— Shoku dhe mjeshtri im David! Ne jemi vëllezër që në vogëli. Bashkë kemi kullotur delët në

Vallamarë të Gramozit. Puna jote këtu është e shkëlqyer, e tundëm edhe në kolonjarët njëherë! Dale të të puth... Ama ia kishe thyer hundët atij Emanuelit... Tri ditë e tri net s'doli nga qelia. U pë e u bë tapë e thërriste si i çmendur: «Të digjet Voskopoja, të vritet David Selenicasi dhe Kolin Stringari!» Por ti, David, mos ki frikë nga kërcënimet e një kokëviçi. Dhe që t'i lëmë shakatë: Të dy patrikëve, sa dhe sulltanit vetë, u kanë futur fite dhe, pse ta fsheh... na erdhi valiu i Manastirit në Ohër dhe iu kërcënua sy për sy patrikut. Gjithë këto ngjarje, kjo hapje kishe pa leje, ky Stringar, një patriku, që deshi të vishej prift për ty... e... ç'të të them, zien dynjaja me emrin tënd në gojë. Prandaj, për të mirë e për shëndet, ti do të më dëgjosh mua, që të kam vëlla dhe shok zemre. Një vajtje e shkurtër në Maligrad e në Glloboko të Bezmishtit nuk është ndonjë punë e madhe... Dhe këtë kërkesë ta bëj që të më shpëtosh edhe mua nga hataja, edhe kishën nga djalli. Patriku desh ma qethi mjekrën me thikë. Dhe përse pa! David, o vëlla... Në Prespë, në kishën e Maligradit, atje ku asketon cipëplasuri Lithan, ka hyrë dhe banon djalli!

Sytë e Davidit xixëlluan, nënqeshi, po Nikolla nuk pushonte:

— David, o mëkatar! Mos qesh, se, që kur u ktheve nga Evropa, e humbe shoqërinë e vjetër që kemi pasur. Ej, David, e si të mos bënte vend djalli në Maligrad? Ikonat janë nxirosur, afresket janë prishur dhe, ç'është më keq... O mëkat i tmerruar, e kapa Lithanin me presh në duar. Kishim njoftim të saktë: «Asketi ndez zjarr e ha mish brenda në kishën e nëndheshme». Kështu që i shkova vetë një mesnatë, me varkë. Ishte një natë e zezë sterrë, sa, ra-soja ime dukej ngjyrë hiri, kurse mjekra e zezë më

zbardhëllente si shkumë. Një të zënë varka breg, kërcëva fluturimthi dhe u vërsula brenda në guvën e nëndheshme të kishës. E ç'të shoh?! Dritë zjarri dhe nën hundë më vjen era e mishit të pjekur. Bastardi Lithan, ky asket kokëviç, që ma ka mje krën sa një lopatë, përplasi kurrizin pas murit dhe hapi gojën sa një kamare. Ai mund të besonte që maçoku të binte në shpinë, por kurrë që unë t'i veja për kolendritje në mesnatë. Iu vërvita ta kapja për mjekre, por u kruspullos... Ashtu e kapa për zverku e në dritën e zjarrit e vërtita nëpër të gjithë katakombën. E zvarrita gjer te zjarri. Mbi thëngjijtë s'kishte asgjë, por era e mishit të pjekur munxoste ikonat e sakatuara. Mbi gur të vatrës nuk kishte mish, as në kllanik. Te hiri mbi shpuzë ishte masha e hekurt dhe përmbi të ngrohej një copë presh. E rrëmbej preshin e desh m'u përvëlua dora. Brenda në fletën e rrumbullakosur të preshit fshihej një copë mish derri. Atëherë më e më s'u përmbajta dot. Ia përshesha hundët me grusht dhe i bërtita si në ditën e gjyqit të madh: O shkelës i fesë, o i biri i satanajt, kush të ka mësuar të fshehësh mishin në fletë të preshit?! Lithani ma ktheu:

— Hirësi, më fal, ashtu më mësoi qoftëlargu, ashtu më mësoi...

Peshkop Nikolla u lodh nga shpërthimi prej përralltari që e kreu me një frymë dhe u mbështet pas një kolone të bazilikës. Davidi nënqeshi hidhur, mblodhi buzët, tundi kryet dhe mendoi: «Kjo është parathënia e nisjes sime të detyruar...»

Davidi e njihte Nikollën me dhëmbë e dhëmballë. E dinte se disa herë ky kishte ndonjë shpërthim zemre prej njeriu të vërtetë, por më shpesh ishte mësallë me dy faqe, dinte gjithashtu që Ni-

kolla e urrente për vdekje Emanuelin, por që ta-
shti e kishin urdhëruar të vepronte me Davidin
pikërisht kështu.

— Si i ke marrëdhëniet me Emanuelin? — e
pyeti Davidi Nikollën, enkas për të shfrytëzuar
urrejtjen e tij për peshkopin.

— Pëllëmbë e tym, o David. Ai është tepër i
trashë, ta bën gjëmën për një qime mjekre dhe
veç ta shohësh, se sa fodull mbahet. Dhe përse pa...
Po nejse, t'i lëmë këto, ti, David, mund të vono-
hesh edhe dy-tri ditë këtu, mund të kesh ndonjë
punë, — dhe i shkau një nënqeshje e lehtë. — Da-
vid, dëgjomë mua, s'ke ç'i bën, kështu janë ka-
nunet e kishës. Pa mendo njëherë se ka edhe më
keq! Ne në Agjionoros kemi një ushtri të tërë me
zografë e jo vetëm që janë murgj, por ti e di se ku
janë e si jetojnë.. Të ishte në dorën time, unë do
të të lejoja të ngrije shtëpi e të krijoje familje, por
nuk të ndihmoj dot. Me kë të bisedosh? Me kë të
merresh vësh? Me peshkop Emanuelin? Ai është një
gomar!

— Po atëherë përse mbahet në një shkallë hie-
rarkike të tillë një gomar?!

Nikolla vështroi me druajtje anëmbanë, ktheu
shpinën nga altari i bazilikës e, duke ulur zërin, ia
ktheu:

— Mos harro, David, mos harro se gomari është
nip i kalit! Emanueli e ka xhaxha kryezografin e
Agjionoros. Dhe ky kryezograf është një kokë-
shkëmb! Na ka në dorë. Se ne mund të ngremë
kisha sa të duam, por ai, po t'i shkrepet, të lë pa
ikona e pa pajime. Por kuptomë, David, ti mos më
fut mua në një kallëp me Emanuelin.

— Jo, — tha Davidi.

— Ta di për nder. Sepse unë të çmoj dhe e di fare mirë kush je, sa vlen e sa rëndon dhe... dashtë zoti, të vijë dita që t'i ndjesh shërbimet e mia. Tashiti të hyjmë në thelbin e një pune tjetër... Më kanë urdhëruar që të heq disa ikona dhe afreske nga bazilika, po dale, dale, mos u nxeh... për nderin tënd dhe për inat të Emanuelit ne ta gjejmë bashkë.

— Nuk tërhiqem këtu, ju e keni dorën të gjatë, bëni ç'të doni, kurse unë nuk heq as të zezën e një thoi!

— Mirë, David, po dëgjomë edhe mua, sepse edhe unë duhet të vete në Ohër dhe diçka të them.

— Jo, — tha Davidi, — asgjë nuk heq.

— Por duhet, David, duhet. Unë do të shkoj në Ohër, pa do flas me të tjerë, do t'u flas për zemërimin e qytetarëve të Voskopojës që kanë të drejtë, sepse Emanueli i ka fyer, se ai ka një karakter të rrëmbyer... do t'ia bëj surratin blozë Emanuelit, ta dish. Se ç'ndodhi këtu, unë e di për fije e për pe. Kam edhe unë miqtë e mi në Voskopojë. Po nuk më thua, të shoh se s'e ke mendjen këtu, çfarë po mendon?

Davidi ngriti kryet. Balli i ishte zverdhur dhe me ata sytë e zinj e zhbirues desh e përpiu Nikollën.

Pasi psherëtiu thellë, i tha:

— Si shpatë e Demokleut na rri mbi kokë osmanlliu. Ariut të Bosforit sot s'kam ç'ti bëj, pa sa për bajgat e ariut, as bëhem merak fare.

Jashtë shiu binte me të madhe. Që nga majat e maleve po zbritnin drejt qytetit re të zeza plot me shtrëngatë. Davidi vuri re se kishte njerëz në

oborr të kishës dhe herë pas here ndonjë palë sy vështronin nga dritaret. Nikolla nisi të shëtiste duke vërejtur afresket, kurse Davidi hodhi sytë anembanë. Do të ndahej kaq shpejt nga krijimet e tij më të dashura. Këtu kishte punuar plot tre vjet e njëzet e një ditë dhe tashti do të ikte për të mos u kthyer kurrë më. Davidi mendonte se askush nuk do t'ia dinte më as emrin e as fytyrën.

* * *

Erdhi dita e nisjes së Davidit me përdhunë. Ai hyri edhe një herë në bazilikë dhe vuri re se disa ikona i kishin hequr. Dy nxënësit e tij flitnin ngadalë, duke pëshpëritur.

Hyri edhe Kolin Stringari me të shoqen. Ajo nusia aq e hijshme e aq krenare me të tre çunat pas. Këta, si të ishin të rritur, bënë toka me Davidin. Piktorit iu kujtua ajo ditë kur u bë dëshmitar i shpirtit të dëlirë e të qashtë të Kolinit. Ai çast kur Kolini i tha gruas: «Lëri petullat e ngreji vetullat».

Jashtë në oborr kishte ardhur llandoni. Dera u hap dhe nëpër të pesë shkallinat e mermerta zbriti Haxhi Jorgji. Ktitorit të bazilikës i dalloheshin më fort të tetë rrudhat e thella të ballit.

Nëpër qytet po ndiheshin zhurma e thirrje. Rreth kishës po grumbulloheshin njerëz. Po vinin atje qytetarë nga të gjitha moshat. Më tej, nën strehët e azilit të pleqve, tre njerëz, krejt të panjohur në Voskopojë, me duart në xhepa, me jakat e tallaganeve të ngritura, jepnin e merrnin midis tyre. Pastaj në shoqëri të tyre hynë edhe Bane Lica, Kostë Eshi e Zatlan Lugati.

Papritur njëra nga kambanat e bazilikës tingëlloi ngadalë, si në zi, ashtu si i binin kur varroset njeri. Davidi u zverdh në fytyrë, por, kur ia nisën gjëmimit edhe të dyzet e tetë kambanat e njëzetë katër kishave të qytetit, ai u zbeh edhe më.

— Kolin, po më varrosni?

Kolini u lëshua turravrap përjashta dhe bërtiti:

— Jo ashtu, more... bjeruni kambanave për festë, për fitore, për gëzim!

Dhe me t'ia nisur gjëmimit të nxituar kambanat e bazilikës së Shënkollit, edhe të gjitha të tjerat ia kthyen ashtu menjëherë.

Tashti Voskopoja e tërë ishte ngritur më këmbë. Qyteti u derdh rrugëve për të përcjellë Davidin. Haxhi Jorgji fshinte sytë e përlotur, kurse Kolin Stringari hipi mbi shkallën e pestë të kambanores dhe priti sa të vendosej qetësia. Ashtu hodhi sytë përmbi turmën që dukej e egërsuar. Turma lëvizte sa andej - këtej, si dallgë.

— Vëllezër dhe motra! Përcjellim David Selenicasin, piktorin e ndritur të Voskopojës. Po e përcjellim, sepse po na e gjurmojnë, po na e ndjekin, po na e syrgjynosin! Qytetarë! Kjo ndarje na djeg në shpirt dhe na përvëlon në zemër dhe unë mund t'ju flas këtu gjatë e më gjatë por... kam shpërthime të përmbytura përbrenda ashtu si keni edhe ju. Ne po e përcjellim Davidin tonë të madh ashtu si i ka hije atij dhe i lutemi që ai të kthehet shpejt e shëndoshë e mirë këtu, në Akademinë e Voskopojës, që ne do ta çelim së shpejti.

Turma brohoriti më të madhe: «Do ta çelim!» Dhe atëherë Kolini shtoi:

— Akademinë do ta ngremë ne që jemi këtu dhe vellezërit e motrat tona të mërgimit, që na ndihin dhe që janë shpërndarë nëpër gjithë Evropën. Ata të tjerët që rrahin gjokset se gjoja na ndihin, ata gënjëjnë dhe na bëjnë prapësira si kjo që po bëjnë sot!

Një punëtor rendi në hajat të bazilikës, atje mblodhi e rrotulloi si lidhurak atë jatakun e varfër me rrogos të Davidit, e shtrëngoi me një kulpër, e hodhi në krah dhe pastaj vajti dhe e ngarkoi në anën e pasme të llandonit.

Davidi u nis. Në krah kishte Stringarin dhe Haxhi Jorgjin. Pas tyre vinin tërë ata njerëz. Në qiellin që vesonte ngadalë, dëgjoheshin si me tërbim të dyzet e tetë kambanat e kishave.

Në xhepin e vogël të xhaketës prej shajaku Davidi kishte futur një letër, një degëz borziloku dhe një penel të hollë që ishte pasuria e vetme e tij. Në atë letër Ana, për t'i treguar se kishte shkuar përpara në gjuhët e huaja që mësonte në bibliotekë, i shkruante ca fraza të përziëra e jo fort të sakta në gramatikë, herë latinisht, herë gjermanisht e herë greqisht: *Carissimus meus David...¹⁾ ja tin agapi pu ehōme i mis i dhio qe...²⁾*

Kolin Stringari iu afrua dhe i pëshpëriti në vesh:

— Si të porosita, vëlla! Mos ki asnjë dyshim. Botën të tërë kam për të tundur, Akademinë do ta hapim dhe ti ke për të ardhur këtu, veçse, atje ku po shkon, lër gjurmët e tua me punë.

1) lat. Shumë i dashur Davidi im.

2) greq. Për dashurinë që kemi ne të dy dhe...

Davidi u përçafua së pari me Stringarin. Pastaj edhe me të tjerët. Diku nga e majta e turmës i zunë sytë Anën. Ajo u drodh dhe filloi të përkëdhente flokët e vet me dorë. Ishte shenja e tyre e fshehtë e përshëndetjes. Fytyra e saj kishte marrë një pamje të tillë që ai nuk e kishte parë kurrë ndonjëherë. Ishte fytyra e «Mos më prek».

Ana nuk e përballoi dot vështrimin e tij dhe uli sytë.

Pastaj Davidi hipi në llandon. Kamxhiku fishkëllloi ashpër, kuajt hingëllinë e kërcyen kas përpjetë, rrotat u sollën me vërtik nëpër xhade. Ai vështroi edhe një herë nga majat e Shënprodhomit dhe ashtu Voskopoja iu zhduk nga sytë.

* * *

Llandoni me katër kuaj zbriste tatëpjetë rrugës që të çon për në Manastir. Davidi ishte kredhur në një qoshe dhe dëgjonte llocoçitjet e bojërave të lëngëta. Penelat, në një kuti tjetër, fërkonin kryet me njëra-tjetrën, sikur bisedonin e sikur ziheshin.

Jashtë nëpër ara bujqit mblidhnin kërpin, të tjerë prisnin misërishte me drapër, ca fëmijë kullojnë bagëtinë nëpër sternishtat e melit.

Davidi mendohej. Nëpër mend i kalonin gjithë krijimet e veta.

Llandoni gjithnjë zhurmonte fort e rëndë, kamxhikët fishkëllenin në erë, të katër kuajt dihatnin ashpër, kurse mendja e piktorit harbonte poshtë e përpjetë: «Vallë si do të vejë filli i jetës sime? Si do bëjë Ana?» Orët kalonin. Me këto mendime në kokë, nëpër xhamin e llandonit, ai vështroi lart nga qielli. Hapësira ishte pus e errët dhe e lagësht. Nëpër the-

llësitë e saj ulërinte furtuna dhe gunëzat, këta zogj të mjerë të liqenit të Prespës, dukej sikur kishin dalë të prisnin mikun e tyre më të ri. Tufat e gunëzave krakavitnin e prireshin diku, pas maleve shkëmbore.

Në të përpjetën e Selasforit papritur karrocieri tërhoqi frerët dhe u thirri kuajve të qëndronin. Para tyre ishte një rresht i gjatë me talike e araba. Një koshadhe turke po kontrollonte udhëtarët dhe teshat e tyre. Xhandarët turq venin e vinin sa andej-këtej, dukeshin me inat, të mërzitur, gojëprishur dhe bërtitnin. Dera e llandonit u hap. Një bashçaush kërkoi dokumentet. Davidi, pa i ngritur sytë, i zgjati të huajit ç'kërkonte. Ky e mori në duar, futi hundët në letër, siç duket do të ishte dritëshkurtër (cepat e mustaqeve të tij çiknin letrën dhe fërfërinin mërziqshëm në të), dhe papritur ngriti kokën, çapëloi sytë e u tërhoq dy çape prapa. Iku më tej dhe, duke treguar me dorë nga llandoni, nisi të fliste me të vetët.

Davidi e kuptoi fijen e padukshme midis atyre që e kishin dëbuar dhe atyre që e prisnin.

Bashçaushi e urdhëroi Davidin të zbriste nga llandoni. Ai doli përjashta dhe vuri duart kryq mbi kraharor. Penelin e kishte gjithnjë në xhepin e vogël të xhaketës, bashkë me degëzën e borzilokut që lëshonte aromë.

Ndërkaq nisi të vështronte poshtë, atje tek shtrihet qyteti i Selasforit, ku dukeshin shumë gërmadha e shenja të tjera zjarresh. Më lart ngrihej i ashpër dhe krenar Shkëmbi i Madh i Selasforit.

Bashçaushi, pa asnjë shkak, e mbajti Davidin mbërthyer atje gjer natën vonë. Ai shtihej si i shkujdesur, vërente majën e malit Ivan, ngrinte kryet nga

qielli dhe nëpër gjiret e reve të zeza, herë pas here shihte yjet që xixëllonin ftohtë larg, shumë larg.

Dikur e lejuan të nisej. Pas e ndoqën ca fjalë turqisht; gjaur, pis arnaut, domus.

Kur u ngjitën në majën e Bigllës, shiu pushoi dhe retë nisën të përhapeshin. Këtej vinte era dëllinjë dhe shavar. Ngriti kryet nga qielli; prapë dukej i trazuar e me pak re. Ai përqendroi vështrimin më mirë. Ishin dhe s'ishin re. Këtej një qiell krejt ndryshe, sikur merrte pasqyrimet e liqenit. Ato re i ngjnin si ca pezaulë peshkatarësh të Prespës, që ishin ndehur lart në qiell për t'u terur dhe që, kur i kishin ngritur, kishin marrë me vete edhe rërë nga bregu. Tashti hëna trazonte me rrezë kokrrizat e argjendta të rërës.

Llandoni mbërriti në një fshat të Prespës aty në të aguar. Ishte një fshat i varfër, me shtëpi të ulëta, ndërtuar me mure të thata. Një varg fshatarësh me një xhandar në krye po shkonin në punë angari nga maja e Bigllës. Brenda në fshat ndiheshin blegërimat e deleve. Dëgjohej qartë llokoçitja e disa lopatave që remonin poshtë në ujërat e liqenit. Peshkatarët dukeshin vetëm si silueta nëpër ca sandalle të vogla tek hidhnin rrjetat.

Pastaj filloi një kor i tërë... Gratë po tundnin bulmetin në mëti. Në çdo oborr e në çdo shtëpi plot zhurma të tilla. Në krye të një shkalle të gurtë, Davidi dalloi qartë një femër me mëti në duar. Nga lëvizjet e befta e të zhdërvjellëta të saj, e kuptoi që ishte një vajzë e re. Ajo kishte një trup të derdhur e lëvizje të hijshme. Ktheu kryet dhe vështroi nga Davidi. Hapi sytë fort kur dalloi një njeri të huaj e, me një lëvizje të papritur, ngriti dorën dhe e mbështeti në një direk. Davidit i mbeti në mendje drita

e syve të saj të mëdhenj. Ndërkaq, dikush e thirri vajzën që brenda shtëpisë:

— Oni!

Më në fund mbërriti në Maligrad, në atë ishull të vogël, krejt shkëmbor, nja dyqind e sa çape larg nga bregu.

Ishulli dukej si një samar mushke mbi Prespë. Në njëfarë vendi ishte zgërbonja e një kumbulle të egër që e kishte çarë rrufeja. Anëmbanë ujë, pëllumba të egër, lakuriqë nate, kërmij dhe gjarpërinj që vareshin nëpër honet e spilesë, shkitnin nga hyrja, vërviteshin në liqen dhe përsëri ktheheshin.

Më ta përballur, asketi Lithan u përkul duke rrahur me duar gjunjët e vet. Kur Davidi e pyeti përse asketonte këtu, ai hungëroi si qen e iku thellë zgavrave, duke kafshuar gishtat dhe mollëzat e duarve.

«Në mos është fare i çmendur, me siguri që një dërrasë të krisur e ka.»

Davidi kontrolloi shpellën e nëndheshme. Poshhtë e lart kishte ca guma të vjetra, copëra litarësh kërpi, disa kazma e pastaj njëfarë shtrati prej druri, që e kishin ngritur për të. Ai ndjeu përbrenda një hon dhe psherëtiu.

Ky ishte shpërblimi për punën e tij! Të shijonte bukën e thatë nëpër hajatet e kishave, nëpër zgavrat e asketëve, të thithte ditë e natë erën e tharmë të temjanit dhe të qirinjve të djegur, të kishte të bën-te me hierarkë xhahilë, të rronte si asket në këtë guvë të Maligradit, në mes të gjarpërinjve, nëpër klithmat e bufëve, nën përpelitjet e lakuriqëve të

natës dhe t'ia dërrmonin shpirtin vetmia e mendimet. Pa një shok pranë, pa një mik, pa një libër, me një të çmendur te koka.

Në ditën e parë të punës ishte mot i mirë. Nja katër orë ndenji duke punuar e meremetuar mbi afresket e ca piktorëve të shekullit të katërbëdhjetë. Ishte një punë që nuk e kënaqte por ai ndiente ngushëllim, sepse kishte mundur të merrte me vete edhe disa copa dërrasa rrobulli për punët e veta.

Në një çast gati iu zu fryma dhe doli përjashta. Në malet shkëmbore mbi Zaroshkë zverdhonin korijet me lajthishta. Atij i qante zemra për atë natyrë të artë. Ai ishte piktor dhe atje në Maligrad askush s'mund ta kuptonte atë brengën e tmerrshme. Ishte mëkat, krim, ishte më shumë se vrasje që piktori të merrej me natyrën, me njerëzit, me jetën. Por, edhe sikur të pikturonte diçka që i pëlqente, kush do t'ia shihte? Ku do ta mbante këtu? Kujt mund t'ia besonte?

Hodhi sytë pas. Kishte edhe nja dy orë ditë. Nga malet po vareshin poshtë kopetë e deleve. Vështroi në breg dhe u vrenjt. Nja dhjetë xhandarë turq me ca kapele të rënda kapur nën mjekër, kishin ndezur zjarr e po piqnin mbi prush peshq të gjallë që sapo i nxirrnin nga pezauli.

Mendoj se atë pamje dhe ata njerëz kishte për t'i parë çdo ditë.

Pastaj mori një copë letër dhe i shkroi Kolin Stringarit për të gjitha, një për një, për asketin Litan, për kumbullën e goditur nga rrufeja, për pëllumbat e egër dhe për gjarpërinjtë e shumtë.

Po binte mbrëmja dhe që nga shkrepat e malit nga ana e veriperëndimit po zbritnin një tufë grash, vajza e nuse të reja, me linja të bardha në kokë

dhe me bulira në krah. E gjithë ajo trevë ishte krejt e thatë dhe banorët mbushnin ujë vetëm në liqen.

Nuset dhe vajzat zhurmuan dhe u lanë në breg me duar e këmbë e fytyrë, pastaj dikush nga ato tregoi me dorë nga Maligradi, në bregun ku rrinte Davidi. Ai e kuptoi që ato flitnin për të. Pastaj ato mbushën bulirat, i hodhën supeve dhe bënë përpjetë. Te një vend përsëri qëndruan dhe përsëri shihnin nga Maligradi, pastaj morën shpatin përpjetë dhe u zhdukën. Davidi hyri në spile dhe ndezi zjarr. Lithani i tha:

— Peshkopi më urdhëroi të mos ndez...

— Do ndezim dy zjarre, edhe tri po të më duhen!

Lithani u kënaq dhe fytyra e tij e zverdhur qeshi nën ato leshra të gjata që i mbulonin krejt pamjen.

Dhe u bë zakon. Përditë, kur vajzat e nuset zbritnin në liqen, ai ulej buzë ishullit dhe vërente se si ato qeshnin, nganjëherë edhe këndonin, mbushnin ujë e bënin përpjetë.

Një ditë, ndërsa gjithë gratë kishin ikur, nga ana e jugut, duke zgjedhur rrugën nëpër shkëmbinj, zbriti një vajzë. Ajo qëndroi ballë për ballë tij, drejt më këmbë. Dy bulirat i lëshoi përtokë, hoqi nga koka linjën e bardhë dhe e tundi në erë...

Davidi ishte gati të betohej se ajo ishte vajza me emrin Oni, ajo që kishte parë në fshat, që ditën e parë të ardhjes së tij.

Edhe Davidi ngriti dorën dhe e përshëndeti. Por vajza u përkul, mbushi dorën me ujë dhe bëri ta hidhte drejt tij. Davidi vëshitroi anembanë. Asketi

nuk dukej gjekund. Shtrëngoi njëherë fort nofullat dhe ia bëri asaj me shenjë.

— Ti je ajo vajza që tundje në mëti?!

Vajza pohoi me kokë. Ai atëherë u çua në majë të gishtave dhe me pëllëmbët rreth gojës i thirri:

— Emrin, si e ke emrin?

Zëri nuk i ngjau si i tij. Siç duket, vajza nuk dëgjoi, se nuk i ktheu përgjigje aty për aty. Bregu ishte larg e valët zhurmonin.

Pas pak edhe vajza vuri duart rreth gojës dhe u çua edhe ajo në majë të gishtave dhe thirri:

— Oni më quajnë...!

Më në fund po njihte një njeri. U gëlltit i mallëngjyer dhe i shkuan lot. Ishte larg dhe fytyrën nuk ia dallonte dot mirë.

Fryu era e mbrëmjes dhe u rritën valët. Kresh-tat e tyre u shkumbëzuan. Dielli u prir, lëshoi pasqyrimet e veta dhe vala ia kaloi valës, kreshta kreshtës, shkuma shkumës, dhe gjer te këmbët e tij erdhi një valëz kaltëroshe plot ylbere e pasqyrëza... Dhe piktori pa atje fytyrën e saj të gjallë!

— Oni, Oni më quajnë.

Befas iu ngjall një dëshirë e marrë. Donte ta takonte atë, si të vetmin njeri të gjallë që iu afrua, t'i fliste diçka, t'i tregonte brengën e tij, t'i thoshte se edhe ai kishte një vashëz të mirë si ajo, se edhe ajo vashëza endëse kishte një emër të bukur... Por vajza e përhëndeti edhe një herë, mbushi bulirat me ujë dhe u nis pas shtegut me shkëmbinj.

Edhe dita që pasoi i ngjau së parës. Në mbrëmje Oni doli përsëri në breg. Por këtë herë ajo u për-

kul mbi liqen aq shumë, sa gërsheti i vetëm i ra nën ujë. Atje ajo lëshoi dy ftonj të verdhë.

«Ah, të kisha mundësinë ta hidhja në dërrasë borige këtë vegim të jetës.»

Valët u nanurisën e u lëkundën, i rrëmbyen të dy ftonjtë dhe po i sillnin këtej. Davidi nuk dinte ç'të bënte. Hoqi xhaketën, flaku tej kundrat dhe çorapët, flakëriu kapelën dhe u zhyt në ujë. Kur notoi një copë herë, në kreshtën e një valëzë i kapí të dy ftonjtë. Ai vuri re se ata ishin në një degë të vetme. Dhe me atë degë në dorë deshi të notonte edhe më tej, të dilte në breg, tek ajo, por nga bregu i tij po hungronte asketi. ndërsa matanë xhandarët e turkut e përgjonin. Zemërvrarë, i ngriti lart të dy ftonjtë, ia bëri asaj me dorë e u kthye mbrapa.

Vetëm tashti e ndjeu se uji kishte cenë shumë i ftonjtë. I shkuan të njëjthura pjer në fund të këmbëve dhe nisi të fërkonte krahët e shpatullat me mëngët e gunës së dhirtë. Pastaj u vesh dhe hodhi një sy nga buza e liqenit. Mbi valëzat e tij pa ca boca bredhi që nanuriseshin. E nguli vështrimin mbi ato dhe përfytyrimi i tij iku larg...

«Sa kohë që është pranverë, boçat e bredhit janë të nioma e të freskëta atje në majë të drurit. Fryn filladi, i përkëdhel e ato lëshojnë fije të holla rrëshire. Por, duke u lëkundur përmbi majat e pyjeve, boçat kur e kur lektusen me njëra-tjetrën, afrohen, sikur pëshpërijnë... Por koha kalon. Vjeshta vjen. Boçat rrëzohen. Njëra këputet e rrokulliset në një përrua, tjetra ikën në fund të një lëndine. Ndahen. Dhe ndarja është e keqe. Pastaj nis e

fryn era. Dhe era kalon edhe nëpër trup të tyre, ua përkëdhel dhëmbëzat e thata e ato fishkëllejnë lehtë e ngadalë. Lëshojnë ca tinguj që ngjajnë si jehona të largëta kujtimesh.

Kur u kthye përsëri atje në guvë, e ndjeu veten tamam skllav. Lëshoi kryet mbi pëllëmbë dhe e kuptoi se do ta përfshinte dëshpërimi e lodhja. U mbush me frymë dhe, kur nisi ta zbrazte kraharorin, psherëtima iu kthye në një rënkim. Iu kujtua ai gurgdhëndësi kosovar, që i kishte thënë: «Ne jemi nga ai gur që thyen çekanin».

Hyri thellë në spile duke pasur një bosh të madh në zemër. Po jetonte si qen, në atë vend të shkretë, pinte ujë liqeni që mbante një erë të rëndë rrogozi të kalbur.» Voskopoja është larg, atje janë miqtë e shokët e mi, atje është Ana... Ç'po bën ajo? Por unë nuk do t'u përkulem as Emanuelëve e as Bane Licave, rrugën e nisur do ta çoj gjer në fund, gjer ku të dalë.

Zuri të vërtitej nëpër guvë gjithë inat e maraz, pastaj qëndroi te blloku shkëmbor nga ana e perëndimit. Masivi ishte i zi, plot me rripa e gunga. Davidi vuri llërën mbi shkëmb dhe e mbështeti ballin në të.

Liqeni rënkonte. Davidi dëgjoi që nga gryka e Ivanit po frynte stuhia. Ajo sa vinte afrohej.

Atë natë ishte shumë ftohtë. Ai nuk ndihej mirë. U mbështoll fort me gunat e dhirta. Gjumi e kapi menjëherë...

Në ëndërr iu bë sikur shkoi sërish në Voskopoje. Ja, qyteti i madh ku kreu mësimet. Oborri i madh,

muret e avllitë, shatërvanet, pyjet me pisha dhe kullat e larta të dritave. Ai ngriti kryet të shihte tabelën e madhe të Akademisë dhe... u shtang! Atje ishte një tabelë tjetër, shkruar ndryshe, me shkronja krejt të kuqe dhe mbi çdo shkronjë nga një pelikan dhe mbi çdo pelikan qe ulur një më i vogël me ato puplat bardheroze.

«Pa dale... këta janë shpeshët e Prespës!»

Në tabelën e madhe shkruhej: Akademia e Arteve të Bukura «David Selenicasi», Voskopojë, Arbëri. Davidit i erdhi si turp dhe mbuloi sytë me duar. Pastaj vështroi anembanë e, kur ngriti kryet, pas tij po i buzëqeshte një vajzë bardhoshe, mollëzat e faqeve të së cilës kishin marrë ngjyrën e puplave të pelikanëve të vegjël. Dhe mbante dy vedra në duar... Davidi sikur kërceu përjetë...

— Oj, dale, vajzë, kush je ti?

— Jam Oni, mjeshtër, a nuk më njeh?! Unë që të hodha ftonjtë e verdhë te liqeni i kaltër i Prespës!

— Aaa!... ti je, Oni? E ku shkon kështu?

— Vij të mësoj artet e bukura, mjeshtër David!

— Po përse qan, Oni?!

— Jo, nuk qaj, mjeshtër, lotët i kam nga gëzimi.

— Ashtu?! Mirë... po këto vedra? Përsëri nuk keni ujë dhe vini ë merrni nga Voskopoja?

— Jo, mjeshtri ynë David, tashti marrim nga ai shatërvani shkëmbor i Zorashkës.

— E këto që ke në duar?...

— A nuk i njeh? Këto nuk janë vedra. Janë zgjoje bletësh, mjeshtri David.

Piktori ndiente një si tingull të mallëngjyer

në zërin e Onit, një tingull si të njomë, si të lëngët, sikur kishte marrë diçka nga valët e liqenit të Prespës.

Fryu një fllad e solli një pështjellim ngjyrash, ashtu si e donte vetë Davidi. Dhe në atë vërshim të flladit anembanë u derdhën petale bajamesh; petalet ranë edhe përmbi qerpikët e gjatë të Onit, por ajo nuk i rrëzonte me dorë. Ajo përpëliste qerpikët dhe, në vend që t'i binin petalet, i shtoheshin lotët...

— ...dale, po ti pse qan, Oni?

— Nuk qaj, veç kam droje se mos nuk më ronitin bletët...

— Ato ronitin në pranverë, Oni.

— Pranvera erdhi, David, pa shih anembanë, gjithë këto petale...

— Po këto janë lule bajamesh, Oni, çelin në prag të pranverës, se bajamja gënjehet lehtë, Oni...

— E atëherë!

— Edhe pak, Oni, sa të lulëzojnë qershitë...

Por që nga vedrat e Onit zukatën bletët dhe kopshti me bajame u mbush me zëra të bukur. Ishte një melodi e ëmbël, që vinte fshëhtazi.

Kur u përmend, kokën e ndjeu shumë të rëndë. Mbi krye i rrinte asketi. Davidit iu bë se ishte ende në ëndërr... Lithani ia kishte marrë kokën në prehërin që mbante erë temjan, dhe flokët e tij i vareshin gjer në ballë. Lithani me të dy duart hante bukë si i babëzitur, ndërsa shihte piktorin me frikë...

— Ç'ke kështu? — e pyeti Davidi. Koka i ziente dhe balli i digjte fort.

— Ti ke shumë ethe, flitje përçart dhe qeshje si budalla... Erdhën prifti i fshatit dhe psallti dy herë radhazi.

— Dy herë!... E përse?
— Sollën pesë bukë thekre... — e tregoi atë copë që hante.

— Po ne kemi bukë.

— Sollën... pastaj për herë të dytë sollën edhe një poç me uthull e një vandak me driza për zjarr. Të shkundën për supesh, të kënduan edhe aleluia, po ti nuk zgjoheshe. Na... ha bukë, kemi edhe cironka të kripura...

Davidi ndjeu se asketi i kishte vënë mbi ballë një leckë me uthull. Trupin e kishte të lodhur dhe zemra i rrihte fort. Gojën e kishte të hidhur farmak, i pihej ujë, kurse për bukë as i shkonte ndër mend. Jashtë binte shi me rrëshekë. Ndiheshin gjer brenda piklat e mëdha që përplaseshin mbi liqen. Duke mos gjetur kohë të fliste, sepse bukën e hante nxituar e me shije, asketi përsëri i foli:

— Me varkë erdhi edhe një tjetër...

— Kush ishte ai?

— Një udhëtar, shkonte për në Manastir. Më tha se, kur të kthehet, kërkon përgjigje...

— E çfarë solli ai?

Asketi hungëroi e vështroi anembanë. Kapi diçka në errësirën e spilesë dhe ia zgjati Davidit.

— Na... solli një kartë dhe një bisk...

Piktori kërceu përpjetë, rrëmbeu letrën dhe e lexoi. I shkruante Kolin Stringari. Ai e pëmpiu letrën me një sy.

Kolini, midis të tjerash, i shkruante se po i dërgonte një bisk mani që ta mbillte në vend të kumbullës së çarë nga rrufeja e të tjera e të tjera...

Piktori brofi më këmbë dhe, duke e kapur me inat leckën me uthull që kishte në ballë, e përplasi pas shkëmbit. Pastaj futi kokën në mes të dy duar-

ve dhe, duke shtrënguar ballin, shtrëngoi edhe dhëmbët dhe përplasi këmbët pas shtrojës së gurtë të spilesë. Nuk dinte ç'të bënte e nga t'ia mbante. Rrëmbeu biskun e manit e një copë kazmë dhe u vër-sul përjashta.

— Ku shkon kështu? — i foli Lithani. — Po bëhet kataklizmoja përjashta.

Jashtë shiu binte me stomna dhe nisën të dë-gjoheshin bubullima.

— Po lëre manin në këtë batërdi, — tha sërish asketi.

— Në stuhi mbillet më mirë, — tha dhe u zhduk nëpër natë.

Ai nisi të qëllonte tokën e gurtë me majën e kazmës e, megjithëse shiu binte i dendur, kërce-nin xixa kur hekuri hahej me gurët. Vazhdoi kë-shtu për një kohë e as e kishte mendjen fare se u lag e u qull i tëri. Kur ende s'i kishte mbuluar rrë-njët e biskut me dhé, veshi i kapi ca thirrje të largëta. Përgjoi. Vetëtimat nisën të grisnin qiellin me gër-sheta zjarri dhe ai mundi të dallonte qartë, thellë nga ana e lindjes, njëfarë nuance që lëkundej nëpër dall-gë e ishte në rrezik të mbytej. Pastaj, kur shkrep-i përsëri, ai dalloj qartë se si njerëzit në mauna nxi-tonin, kërruseshin, ngriheshin, diçka drejtonin e diç-ka zvarritnin dhe lopatat herë rrihnin ujin e herë erën. Një zë burri, i plotë dhe i fuqishëm jepte urdhra:

— Majtas, djathtas! Rëndoni këtej, rëndoni an-dej!

Dhe përsëri e përsëri nëpër gërshetat e vetëti-mave Davidi vështronte se si një grusht njerëzish luftonin me valët për jetë a për vdekje.

Më në fund mauna u afrua dhe Davidi dalloi dhjetë burra që zbritën prej saj. U doli përpara.

— Ejani në guvë, vëllezër, kam zjarr!

I udhëhoqi brenda.

— Çudi, në gjithë këtë batërdi nuk ju dëgjova të thërritnit për ndihmë. Ju desh u mbytet!

Kapedani nënqeshi.

— E kush të jep ndihmë në mies të tallazeve! Kur të përfshin rreziku, dili zot vetes, përndryshe e ke davanë të humbur. Po ti çfarë bën këtu?

— Jam zograf.

— Dhe zografis kishën?

— Më mirë duhet thënë: shkruaj jetën time.

Kapedani vështroi anembanë nëpër guvë dhe sytë i qëndruan te qoshja e Lithanit.

— Po atje kush është shtrirë?

— Është një fatkeq, njëfarë asketi...

— Foli të ngrihet edhe ai.

— Lëre, kapedan, nga të zezat e jetës nuk është në rregull nga mendtë... lëre!

Ndërsa burrat e maunës po ngroheshin rreth zjarrit, atij iu duk se Lithani nuk ishte mbuluar si duhej me gunë dhe iu afrua të kujdesej. Por... sa iu avit, shtangu. Trupi iu ngjeth, nuk donte t'u besonte syve...

Asketi fatzi, që sapo kishte ngrënë pa të keq bukën e thekrit, kishte vdekur me atë copë krodhë në duar. Nëpërmjet dhëmbëve të shtrënguar fort, nga cepi i buzës i varej një lëng i gjelbër.

«Qenka helmuar me bukën që kishin nisur për mua. Këto janë punë të Emanuelit. Dërgoi helm në Voskopojë, na dhe tani në Maligrad... Mirë e tha Kolini: «E ka helmën në bisht».

Fare papritur diçka i lëvriu në tru:

«Do iki me këtë maunë! E përse të qëndrojmë këtu? Të pres ndonjë thikë pas helmmit që më dërguan? Nisem me këtë maunë dhe ku të dalë... Pas ca ditësh mal më mal dhe dal në Voskopoje...»

Atij iu kujtua bujku nga Gjonomadhi që i kishte pozuar për «Farëmbjellësin». Ai burrë vigan e shalëgjatë, me atë shtatin e hedhur, me atë zemrën e madhe, kishte fjetur afër tij në hajatin e bazilikës kaq net me radhë. Dhe i kishte treguar gjithë ato ngjarje luftërash e përpjekjesh. Dhe, kur kishte ardhur fjala për të treguar se si e pati mbytur ujkun, ai i kishte rënë shkurt: Ia shkula nga thonjtë dashin që më rrëmbeu dhe... dy duar për një kokë... tek të më çapëlonte, iu vërsula dhe e mbyta.

Dhe, kur Davidi mbaroi «Farëmbjellësin», bujku nga Gjonomadhi nuk dinte ç'ti thoshte. Nxori nga brezi një masat e një gur stralli e ia dhuroi.

Piktori u habit e i tha:

— Po pse ma jep, ty të duhet, kurse mua...

— Jo, jo. Merre. Ku i dihet jetës. Mbaje ta kesh kujtim nga unë. Dhe ta dish, gjithnjë shtëpia ime është jotja, se shumë më nderove, mjeshtër David!

«Dhe vërtet, nuk iu ditka jetës... Dashur pada-shur kam për të bërë jetë kaçaku dhe ndonjë natë edhe në Gjonomadh mund të kaloj...»

U foli miqve:

— Nga vozitni ju?

— Njëpër brigjet e Prespës sonë. Mbartim rrush e mollë.

— A të vij edhe unë me ju?

— Ne shokë duam!

— Dhe trima i duam, — u hodh e tha kapeda-
ni.

Ky hapi krahun e tij të gjatë dhe i rrahu su-
pin Davidit.

Mauna e stisur me trungje lisi çau përsëri nëpër
ujërat e liqenit...

Ishte tetor i vitit 1726.

DHIMITËR VIGANI DHE KAVALIOTI

Dhimitër Vigani, lindur dhe rritur në Voskopojë, tipograf në shtypshkronjën e vendit, ishte një burrë nja gjashtëdhjetë vjeç me një trup të plotë e të ngjeshur, që nga kishte marrë edhe mbiemrin.

Për tridhjetë vjet me radhë ai punoi si radhitës shkronjash në shtypshkronjë. Nga duart e tij kishin dalë gjithë ata libra dhe nga puna e gjatë me plumbin e shkronjave një ditë i ndodhi një e papritur. Ishte duke radhitur një tekst filozofie të Kostë Çekanit, kur ndjeu një të therur, një si sëmbim në ballë, pastaj i shkuan djersë të ftohta nëpër trup, ndjeu ngjethje e... thirri:

— Pse u shua pishtari?!

Shokët e punës e rrethuan, e vështruan, i folën, i dhanë të kapërdinte një lugë me kafë të hollë, por më kot; i ishte shuar përgjithnjë drita e syve.

Pas kësaj goditjeje të rëndë punëtori Dhimitër nuk e lëshoi veten. Miq e shokë e nisën me një karvan kuajsh që shkante për në Vjenë.

Në kryeqytetin e Perandorisë Austro-Hungareze, Dhimitri u end plot gjashtë muaj, por sytë e tij e kishin humbur dritën përgjithnjë. Dhe u kthye në vendlindje me mendje se s'kishte për ta parë më dritën e diellit!

Duke u kthyer në mëmëdhe hipur në kalë, me ata karvanët e mëdhenj që sillnin mallra nga Tries-tja në Voskopojë, Dhimitri kishte një brengë të madhe: «Si do të jetoj pa punë?»

Duke rrahur mendjen mbarë e prapë, plaku kishte ngritur një plan. Dhe që të nesërmen e mbërritjes mori një çunak për udhëheqës dhe, duke trokitur majën e shkopit nëpër rrugët e ngushta të qytetit, doli te Livadhi i Skolive. Ishte pasdite dhe dielli ishte prirur tatëpjetë. Kishte ardhur vjeshta e plotë dhe pelini, aq i dendur në Voskopojë, që rritur fasha-fasha dhe lëshonte një erë që të rëndonte kokën.

Vigani shkoi drejt e në zyrën e drejtorit, që ishte një nga të pesë pronarët e shtypshkronjës. Ky quhej Simon Rrëshira, një burrë nja pesëdhjetë vjeç, me një fytyrë të mprehtë. Të ftohtët e ndiente shumë, aq sa edhe në verë mbante veshur një xhybe të zezë me një mostër të ngushtë, fund e majë me gëzof dhelprë.

Dhimitri e la çunakun të priste përjashta dhe, si njeri që njihte çdo skutë të shtypshkronjës, foli drejt tryezës së Simon Rrëshirës.

— Mirëndajnatë, zoti Simeon!

— ...tris pende, dhekapende, tris dheka, trianda... — bënte llogari zoti Simon, — e... po... mirëndajnatë... ti, Dhimitër, je? Erdhe kë? E mora vesh, më thanë, domethënë dynja kjo... s'ke ç't'i bësh... e... si e ke punën?

Plakut nuk i pëlqeu kjo pritje e megjithatë i foli ngadalë:

— Unë, zoti Simo, kam ardhur të punoj, të bëj ndonjë punë...

Rrëshira u thartua në fytyrë. Përkuli zverkun dhe surratin e mjekrën i futi pas kokës së xhybes:

— Zoti Dhimitër, ç'flet kështu! E si mund të punohet në tipografi pa sy?! Këtu e kanë zor edhe ata që i kanë sytë të saktë. Unë ta kuptoj hallin, por kështu ishte fati. Sidoqoftë, ti je njeri i vetëm, familje e detyrime nuk ke, pa më mendo mua që kam shtatë kalamaj. Kë? Voskopoja ka njëzet e katër kisha... askush nuk do të ta kursejë lëmoshën...

Dhimitër Viganit iu bë sikur dikush e goditi me një kopan të plumbtë në kokë. Kërceu përprjetë dhe ngriti duart, sa tallagania e vjetër që kishte supeve i ra poshtë... dhe iu dukën muskujt e kraheve të fuqishëm nën një këmbë liri të grisur copa-copa. Viganit qëlloi dyshtemenë me këmbë, ndëhu duart përpara për të kapur Simon Rrëshirën e as vetë s'e kuptoi kur thirri:

— Qen, o qen bir qeni, do të të shtrydh e do të ta shkul kokën nga zverku... — dhe u përplas pas tryezës. Tryeza u përmbys, kallamarët me bojë u derdhën e u thyen, pendët u përhapën gjithandej...

Simoni u tërhoq dhe u vërsul të fshihej nga salla e radhitjes...

Kur u shtruan gjakrat, Dhimitër Viganin kërkoi një punë, për të cilën askujt nuk i shkente ndër mend. Simon Rrëshira, deshi s'deshi, u përunj, dhe Viganin do të zëvendësonte njërin nga kuajt që tërhiqte shulin për t'u vërtitur rrotativa e madhe e tipografisë. Hoqën kalin që kishte radhën, dhe në çast Dhimitri filloi nga puna.

Që atë mbrëmje fjala mori dhenë në gjithë Voskopojën. Rektori i Akademisë, Teodor Kavalioti, me ta marrë vesh, u nis menjëherë për në shtypshkronjë.

Kavalioti takoi në hyrje Simon Rrëshirën:

— Zoti Simo, ç'pasje bërë kështu?

— Nuk të kuptoj, i nderuari rektor!

— Ti je njeri i kënduar, kurse Dhimitrin e ka vrarë fati...

— Kavaliot, o rektor i nderuar! Ç't'u bëja punëtorëve, pa unë s'e pranoja të bëhej kalë, sikur sa të kalit ta bënte dhëmbin, se firma jonë humbet shumë. Se, në fund të fundit, kali punon, dhe nja gjashtë muaj në vit e lëshon të kullotë livadheve badihava, kurse Viganin s'e lëshon dot të hajë bar, ai duhet paguar... e, po t'i biem kalemmit hollë-hollë, firma jonë humbet gjysmë mexhite në muaj! Aaaa, të lutem shumë, rektori im, miqësia miqësi e hesapi hesap!

— Këtë panginjësi për para, nuk e kuptoj dot, zoti Simeon!

— Ti s'e kupton, sepse nuk të djeg xhepi...

Ishte e kotë të bisedonte me Rrëshirën. Kavalioti hyri në sallën e punëtorëve dhe, me të hedhur

sytë, u drodh... Përballë tij po shihte atë plak trupmadh, të kërrusur mbi shulin e rëndë. Djersët i shkonin tatëpjetë dhe kraharori i frynte e i shfrynte me duf. Te kreu i sallës u duk Grigor Kostandini, kryemjeshtri. U vështruan sy më sy me rektorin dhe ky i bëri një shenjë. Sollën sërish kalin te shuli i madh i rrotativës dhe Grigori i foli plakut:

— Në sallën e madhe ka ardhur Kavalioti e të kërkon.

Sytë e të verbrit u ngritën lart nga tavani. Ai fshiu djersët me mëngë të xhaketës, shkoi mbi fytyrë duart e ashpra dhe doli në sallën e madhe. Rektori nisi ta ngushëllonte, t'i kujtonte shërbimet që Dhimitri i kishte bërë qytetit... Por të gjitha këto punëtori plak i dëgjonte gati pa e pasur mendjen aty. Dhe, kur Teodori mbaroi së ngushëlluari, Dhimitri i tha:

— Këto që më thua, o Kavaliot, më ngjajnë si ato fjalimet që u mbahen të vdekurve mbi varr. Ti je shumë më i ri dhe do të kesh kohë të m'i thuash një ditë... Unë brengën e kam te puna e te jeta.

— Dëgjova, Dhimitër, se sot në mbrëmje ke bërë fjalë me zotin Simon... E përse nuk erdhe tek unë, të më thoshe...

Plaku u mbush fort me frymë dhe pastaj u zbraz duke shtrënguar nofullat:

— Kot të vija te ti, Kavaliot! Unë të vija për hallin tim, kurse ti, siç më thonë, po shkruan ca libra. Po shkruan për trupat e qiellit, për yjet e për Hënë, për filozofët e mëdhenj, për idherat e ndriturisë... Shkruan e shkruan, Kavaliot, po askush nuk të merr vesh...

— E shoh, Dhimitër, je shumë i ashpër sot, po ke të drejtë. Sa i takon Rrëshirës...

— Ta kisha vrarë më mirë! Tridhjetë vjet punë, sa humba dritën e syve, dhe më nis për të lypur në dyert e kishave! Ta kisha çapëluar më dysh!

Kavalioti kishte porositur dy filxhanë kafe dhe çiraku i kafexhiut Koça, një djalë nja pesëmbëdhjetë vjeç, me një mësallë të bardhë përpara dhe me atë farë disku si fener në duar, u duk në sallën e madhe:

— Urdhëroni kafet, zotëria juaj...

— Vigani ngriti gishtin tregues drejt djalit:

— Ti, djalë, thuaji ustait që këto dy kafe të m'i shkruajë mua në defter, përndryshe i derdh e...

— Mirë, Dhimitër, mirë, nuk prishemi!

Sërish plaku tha:

— Që kur humba sytë, Kavaliot, më është mprehur veshi dhe përkitja. Ja, kafen që la djali mbi tryezë, do të ta jap unë vetë. — Zgjati krahun dhe dora e tij qëndroi pikërisht te filxhani i kafes. — Urdhëro, merre. Unë po ta jap drejt e në dorë. Është një zakon i lashtë andej nga Opari ynë: Atij që ka borxhe për të larë, ia japin kafen që prapa kurrizit, kurse unë kam shpresë se Kavalioti do t'i lajë vetë borxhet!

Kavalioti u befasua.

— Për çfarë borxhesh e ke fjalën?

— Isha në Raguzë, zbrita në Trieste, në Venedik, qëndrova dhe në Vjenë. Gjithë njerëzia flitnin dhe shkruanin në gjuhën e vet, ne...

— Ne?!

— Shkruani libra ti dhe shokët e tu, po qytetarët s'i lexojnë dot. Ti e di, të dërgoi në shkollë esnafi

i bakërxhinjve, paguan për ty. Po ti a e ke larë borxhin ndaj tyre? Ti shkruan libra e ata s'i lëcitin dot.

Kavalioti mendohej...

Ata u ndanë atë natë dhe që atëherë filloi pjesa e dytë e jetës së atij punëtori tipograf. Kalin e hoqën nga puna dhe tani llozin e madh të drunjtë e shtynte me duar e me kraharor Dhimitër Vigani.

Një ditë Teodor Kavalioti qëndronte në sallën e madhe të shtypshkronjës dhe merrej me bocat e një teksti të filozofisë, që e kishte përgatitur për studentët e Akademisë.

Duke gjetur rrugën me dorë pas parvazevë të sallës, u duk Dhimitër Vigani, që, sapo ndjeu frymëmarrje atje pranë, pyeti:

— Ti, Kavaliot, je?

Rektori ngriti kryet i habitur...

— Që ka njëri këtu, ti e di, por si e merr vesh që jam pikërisht unë?

— E marr vesh, Teodor, nga frymëmarrja, sepse ti ke një frymëmarrje më të thellë nga të tjerët. E... çfarë po shkruan?

— Edhe që shkruaj, nga frymëmarrja e kupton, Dhimitër?... Ulu, ulu...

— Nxitohem të shkoj e të bie në gjumë.

— Atëherë je i lodhur...

— Jo, por kam gëzimin e ëndrrave!

— Të ëndrrave?!

— Gëzimi i të verbrit kështu na qenka. Sapo bie në gjumë, më vërsulën ëndrrat! Mbase është dëshira e jetës, është ëndrra e ëndrrave. Në gjumë, jo

si në jetë, unë ju shoh ju sikur kam sy, shoh botën, ngjyrat, fytyrat! Ky gëzim më ka mbetur.

Kavalioti nisi të mbante shënim.

— Po shkruan? — pyeti plaku dhe me një zë ankues e qortues vijoi: — Mësoni edhe nga unë, Kavalioti. Gjithnjë keni mësuar nga unë, po s'u kujtuat një herë për dëshirat e mia dhe të të gjithë qytetarëve. Eh, Kavalioti...

— Për se e ke fjalën, Dhimitër?

— E si për se e kam fjalën, Teodor?! Keni mbledhur nga unë gjithë ato përralla të vjetra, keni mbledhur gjithë ato këngë, gjithë ato fjalë të arta e nianana, keni mbledhur... ku i keni? Por më fal, vetëm këngët jua kam dëgjuar që i këndonin...

— Për nuk shkruhet gjuha jonë, Dhimitër...

Kavalioti kishte vënë lapsin mbi buzë dhe ashtu i përhumbur vështronte ballin e menduar të plakut.

— E ke dëgjuar gjuhën tonë për herë të parë dhe e ke dëgjuar të ashpër, ankuese, e ke dëgjuar plot me dhembka e plot me rënkim... Kështu e ke dëgjuar nga nëna jote e ndjerë, se, kur të lindi ty, të kishte fëmijë të vetëm dhe të parë!

Kavalioti u kthye rrëmbimthi nga plaku dhe vështroi me ngulm në sytë e tij të verbër!

— Me gjuhën tonë na lindin me rënkime e dhembka, me gjuhën tonë na këndojnë në djep dhe përsëri me këtë gjuhë na qajnë kur na varrosin, o Teodor...

— Ti ke të drejtë, Dhimitër, po ja që gjuha jonë ka mbetur e pashkruar dhe kështu ka ngelur prej shekujsh.

Plaku psherëtiu thellë dhe ra në mendime.

— Dukesh i lodhur...

— Lodhur jam, Teodor, por ti nuk do që të më çlodhësh. Mos harro se, falë gjuhës sonë, për shkak të gjuhës dhe të gjakut tonë u bëre rektor, Kavaliot, se, përndryshe, të mos ishe biri i kësaj gjuhe, do të kishe mbetur çoban duke kullotur delet nga pyjet e Shënprodhomit... mos e harro Eugjen Vulgarin...

* * *

Djalë i ri, Kavalioti, nxënës i shkëlqyer në shkollën fillore të Voskopojës, merrte nga dy klasë në vit. Dhimitër Vigani, qiraxhi asaj kohe, një mëngjes gushti e mori atë djalosh dhe me të u nis për në Janinë. Kavalioti ishte gjithë gëzim që do të shkonte në shkollë dhe kapardisej atje mbi samar të mushkës. Anash kishte dy dengje me shajak, nja katër torba në kocaqet e nja dhjetë lugë druri futur në litarët e kaptellit.

Tri ditë e tri net rrugë nëpër pyjet e mëdha të Pindit, kaluan nga hani i madh i Grebenesë, morën tatëpjetë nga Samarina dhe sosën në Janinë. Teodorin e regjistruan në Kolegjin Marusian. Shkollë ishte një godinë tepër e madhe për atë kohë, me tri kate e një kullë anash. Esnafi i bakërxhinjve kishte nxjerrë bursën e Teodorit të ri, kur i ati ishte vetëm një bari i thjeshtë. Por vetëm tri ditë u strehua Teodori te një mik peshkatar, sepse ditën e katërt, papritur peshkatarin u mbyt. Nxënësi nga Voskopojë ngeli në rrugë të madhe. Pasi fjeti tri net me radhë buzë liqenit të Janinës, e pa që nuk kishte rrugë tjetër, veçse të kthehej në vendlindje.

Ditën e katërt, kur dielli po prirej nga majat

e maleve të Nemërçkës, Kavalioti po gatitej t'i linte shëndetin asaj strofke në mes të gurëve buzë liqenit. Peshkatarët po mblidhnin pezaulet, Teodori po arnonte opingën e shqyer, kur fare papritur e pakujuar, që tej një shkëmbi dëgjoji zërin e një burri që këndonte ngadalë:

*Stefo, kapidan,
t'u bëfsha kurban,
vetull-o merxhan...*

Burri që këndonte, ishte profesori i tij i kolegjit, Eugjen Vulgari.

Kavalioti brofi në këmbë dhe, i habitur, e kuptoi se Eugjeni duhej të ishte arbër: Rendi tek ai dhe i foli shqip:

— Mësuesi im, ti mund të më shpëtosh, jemi nga një farë e nga një fis!

Eugjen Vulgari e mori djalin në shtëpi të vet. E rriti, e mësoi dhe, kur Vulgari iluminist e ndoqën nga Janina, ky u kthye në Akademinë e Voskopjës bashkë me nxënësit e vet.

Gjithë Voskopoja e dinte këtë ngjarje që sot ia kujtoi Kavaliotit punëtori Dhimitër Vigan.

— Apo s'kam të drejtë, Kavaliot?

— Po, Dhimitër, ke të drejtë, veçse, për të shkruar gjuhën tonë, duhen shkronja, duhet një alfabet, duhet...

— Të gjitha kombet në krye nuk i kanë pasur, vetë i kanë bërë... Mos ke frikë, Kavaliot? Unë e di, kaq kokë ka prerë turku që të mos shkruhej gjuha jonë.

Zhurma e shtypshkronjës herë dëgjohej e fortë e herë e dobët. Kjo ndodhte sa herë hapej e mbyllej porta e saj. Që andej vinte edhe era e katranit dhe e bojës, por të dy as e kishin mendjen atje. Kur kaloi aty afër, Grigor Kostandini deshi t'u fliste, po, kur i vështroi ashtu të përhumbur pas bisedës, ngriti supet dhe s'foli.

— E, si thua, — deshi ta mbyllte bisedën Kavalioti, — do të shkosh t'ia marrësh me gjumë?

Plaku u mbush përsëri thellë me frymë, fërkoj me të dyja duart mjekrën dhe ia ktheu:

— Jo, pa ta thënë një ngjarje që ma kanë parë sytë këtu e shumë vjet më parë, nuk iki...

— Thuaje, Dhimitër, të dëgjoj.

— E kam dëgjuar një natë gjuhën tonë, o Teodor, e kam dëgjuar aq të bukur, aq të ëmbël, sa nuk ka gjuhë tjetër në botë!

Ulur si ishte në fron, ai u kthye i tëri nga Kavalioti:

— Ka qenë një e diel gushti, natë. Voskopoja e tërë ishte më këmbë, ishte në festë. Dasmë në oxhakun e madh të Sinajve. Gjergj Sina martonte djalin dhe patën ardhur miq e krushq që nga Himara e nga Preveza, nga Durrësi e nga Raguza, nga Vjena e nga Venediku, miq e krushq nga Ulqini e gjer larg nga arbrët e Atikës. Mbaj mend se atë të diel është pirë raki mani e është hedhur vallja, si të të them, si rrallëherë. Edhe unë fukaraja prisja të vinte nata e të shkoja në dasmë, si gjithë shokët e mi që shërbenin në derën e Sinajve. Se asaj kohe, Teodor, isha çirak te Sinajt. Domosdo, në odat e dasmës s'kishin për t'u shtruar, por do të shërbeja nëpër sobat e nëpër kuzhinat, nëpër furrat ku piqej buka e në-

për oborret ku piqeshin deshtë dhe... tamam, asaj kohë, o Teodor, e kisha mendjen dhe syrin te një flokëzë, që shërbente edhe ajo në shtëpinë e madhe të Sinajve. Por... sa hyj në oborrin e madh... më heq mënjane vetë Gjergj Sina dhe më flet: Ore Dhimitër, dasma është për të ngëshmit e për miqtë e kamur, po... se ç'janë disa malukatër, që, duke përfutuar nga dasma, më hyjnë natën në fund të bahçes prapa shtëpisë dhe më vjedhin mjaltin e zgjojeve që kemi andej... Ndaj, merr një copë gunë krahëve dhe rri e ruaj andej...

Sa shumë m'u prish gjaku, o Kavaliot! Gjithë jetën kam qenë i varfër dhe të pasurit më kanë urdhëruar. Desha s'desha, mora një tallaganë, u mbështolla me të dhe u nisa për atje ku më urdhëroi afendikoi. Nata ishte e vakur, natë gushti, bahçja ishte plot me bar të njomë, se atje qan dheu, mbi kokë kisha arra të mëdha e drurët ca më të mëdhenj të vidhave. Dhe këta vidhat, nga lagështia, ishin veshur me myshk gjer në mes e dukeshin si ndoca dhëndurë me jelekë jeshilë. U shtriva mbi ca vandakë me bar dhe u vura syrin yjeve. Por... papritur shkelën këmbë përmbi bar, u dëgjua një pëshpërimë, pastaj edhe një fërfëllimë mëndafshi. Medet! Ç'do jenë vallë këta hajdutë, me të cilët do përfytem!? Dy hije-erdhën fare pranë meje, i shihja e s'më shihnin...

— Të rrëmbyen ndonjë zgjua?!

— Jo, Kavaliot, s'ishin për këtë mjaltë zgjoresh ata, për tjetër mjaltë erdhën gjer atje. Ishin vajzë e djalë... Tashti dëgjoja zërin e djalit që, si i përhumbur, si i dehur, vështronte nga yjet dhe pëshpëriste. I thoshte asaj: Ti më je si rrush i kuq mbi fik të bardhë...

Papritur Teodor Kavaliotit i ra nga dora dorëshkrimi i madh i Traktatit të Logjikës, fytyra i mori zjarr dhe kapi kokën me të dy duart. U gëlltit, një dell i lëvriu aq fort në grykë, sa iu zu fryma, u mallëngjye, i erdhën lot. Kujtime të vjetra, të dashura, të ëmbla, të papërsëritshme erdhën dhe e sulmuan... Dorëshkrimi iu përhap nëpër këmbë...

— E pastaj, Dhimitër, pastaj?

— Lëre, Teodor, ç'do më shumë...

— Jo, jo. Meqë e nise, shko gjer në fund. Çfarë u tha tjetër atje? A e mban mend? Thuaje!

— Ai i lutej vajzës, por ajo e përmbante larg, ai ra gjunjazi dhe ajo i shtynte ballin me duart e saj. Djali, si i dalldisur, i fliste: «Më dogje për ujë, nepërk' e shullërit!» Të më ndjesh, Kavaliot, unë s'kisha vajtur të përgjoja, isha veç një çoban bletësh e asgjë më shumë. E kuptoja që bëja mëkat që dëgjoja, po ç'të bëja?! Të flitja? S'do të ma falte njeri një marrëzi të tillë... Kur ajo i foli me një zë që m'u duk se nuk ishte i saj. I tha: Gënjeshtar. Ai sikur u pre e u zmbraps, por pastaj sesi mori zemër e përsëri... Nuk e di, Teodor, në ishin fjalët e tij zefir i ngrohtë, apo fillad i vakët, në ishin veri i tërbuar apo valë deti që ankohet pas shkëmbit, por mua m'u duk se ai derdhi atje një lavë të nxehtë, përvëluese fjalësh e lutjesh e përgjërimesh... Unë isha i ri vetë dhe i ndieja gjer në thelb të zemrës të gjitha sa thuheshin atje.

— E pastaj, Dhimitër, ç'u tha tjetër?

— Ajo më nuk foli, zë njeriu s'u ndie, veçse që nga vidhat ku kishin foletë pëllumbat, guiste një pëllumbeshë...

— Dhe ti, Dhimitër, ke kaq vjet që nuk m'i thoshe këto fjalë?!

Këtu Kavalioti u hap dhe Dhimitër Vigani e kuptoi. Dhe haptazi ia ktheu:

— S'kam dashur të të lëndoj, Teodor. Ajo atëherë të tha «gënjeshtar», dhe unë nuk dija si të gjykoja. Sot, kur unë të kërkoj të shkruash gjuhën tonë, ti më hedh tra më tra. Ti sot po shkruan për logjikën, shtroji këto që të them në gjyqin e ndriturisë dhe më jep një përgjigje...

— Dhimitër, më je shumë i hidhur sonte...

— Po, Kavaliot, e vërteta gjithnjë na është e hidhur. Ti atëherë përse nuk i flitje asaj në gjuhën që shkruan sot Traktatin e Logjikës? Ajo fare mirë të kuptonte, ishte vajzë e Nelkove, shkolluar në Voskopoje, në Vjenë, në Venedik... Dhe në qoftë se do t'i flitje në gjuhë të huaj, ta them unë që u ndodha atje, një vërë në ujë kishe për të bërë!

Brenda në shtypshkronjë rrotat gërvinin me të madhe, punëtorët nxitonin radhitjen, boca të tjera kishin ardhur, po rektori as i prekte me dorë. E kishin sulmuar kujtime të vjetra e të mallshme. Punëtori tipograf sikur i kishte vënë një thëngjill të ndezur mu në zemër. Zjarr në zemër i pati kallur me kujtimet dhe zjarr në kokë me ato që i kërkonte. Dhimitër Vigani përsëri nisi fjalën:

— Asaj nate, Kavaliot, e bëre për vete vajzën e Nelkove, sepse i fole në gjuhën e saj, në gjuhën tonë dhe... kurrë, Teodor, kurrë s'më është dukur gjuha jonë aq e bukur, aq e ëmbël dhe aq e begatë, sa atë natë!

Rektorit iu lëkund koka e rrudhat e ballit iu mblodhën edhe më, sytë i shkanë përdhe, atje ku i pati

rënë dorëshkrimi. U përku, e përmbloodhi në duar, e afroi, nisi t'ia rregullonte fletët, por ato i qenë ngatërruar e atij i shpëtoi një ofshamë, sikur qortoi veten. I verbri e pyeti:

— Ç'pate ashtu, Teodor?

Kavalioti, i turbulluar, u përgjigj aty për aty:

— Më ka rënë përdhë Traktati i Londrës dhe faqet e tij më janë kthyer mbrapsht...

Në fytyrën e punëtorit u ravijëzua një nënqeshje dhe qerpikët e syve të tij rrahën nxituar.

...në vitin 1768, një mot para katastrofës së Voskopojes, shoqëria italiane e armëve «Carlo e figlio» dërgoi në Voskopoje dy armë gjahu, prodhim i saj me i fundit. Çiftet mbusheshin nga gryka dhe çarku godiste një gur stralli që lëshonte xixat në brimën e barutit.

GJAHU TE MBARE

Ato armë kishin mbërritur me dy adresa të sakta: «Rektorit të Akademisë, Teodor Kavaliotit, dhe profesorit të fizikës, Kostandin Oparakut.» Këta të dy, me të marrë njoftimin, u habitën. As dinin e as kishin porositur dhe as kishin qenë ndonjëherë për gjah. Për ishte koha kur pati filluar

nxitja dhe reklama tregtare dhe shoqëria italiane mendonte kështu që të siguronte porosi të tjera nga qyteti tregtar i Voskopojës.

Dhe, prej ngazëllimit që shkaktoi ardhja e papritur e armëve, të dy «gjahtarët» vendosën të dilnin për gjah... Ishte muaji tetor.

Kavalioti, që atëherë ishte rreth pesëdhjetë vjeç burrë, i tha Kostandin Oparakut, që ishte gjashtëdhjetë:

— Shkëputemi një ditë nga ishulli ynë...

U veshën e u ngjeshën sipas porosive të shokëve të tyre gjahtarë (që përbënin një trupë prej nja dymbëdhjetë vetash në akademi), morën dylbinë teke të Grigor Voskopojarit si dhe zagarin e kolegut Haxhifilipi, i ndoqi pas si rojë edhe një djalosh punëtor që shërbente në Akademi. Ishte ditë e diel, herët në agim. Ata dolën nga qyteti dhe morën udhën e Beratit.

Gryka e rrugës përpjetë, plot me burime e ujëvara, uturonte nga filladi, që atje s'pushon as dimër, as verë e sjell në Voskopojë aromata e pishave, të xhumbriçës e të dëllinjave.

Nëpër këtë rrugë të shtruar me kalldrëm për karroca e talike ata ecën vetëm ndonjë orë e pastaj u futën në pyje, nga ana e djathtë, dhe humbën nëpër to.

Vjeshta ishte shpalosur e tëra me krejt bukuri në vet nëpër pyje e zabele. Dielli ishte i ngrohtë, si i vakur, qielli fare i pastër, ajri i freskët dhe, nëse mund të thuhet kështu... ishte fare voskopojar.

Nëpër livadhe që rritur bari i dendur vjeshtor e urithët, kishin ngritur kukumale me dhé të thërrmuar, të freskët e të shkrifët.

Kushdo që do t'i shihte, do ta kuptonte menjë-

herë që ata nuk ishin fare gjahtarë... Mëgjithëse dolen për qejf e për t'u shkëputur një ditë prej Akademisë, prej punëve dhe brengave që përballonin ditë për ditë, ata as vetë nuk e morën vesh se si bisedat e tyre rrodhën fare vetiu nëpër disa rrugë që i nxori pikërisht të një shqetësim që Kavaliotin e brente fort.

Ata u ulën në një zabel për t'u çlodhur, u mbështetën në një hendek dhe nuk vunë re fare se zagarin nuk po dukej më. Ishin të përhumbur pas bisedës. Shoqëruesi i tyre doli të kërkonte zagarin.

Ata të dy ishin të një mendimi se populli që në padituri, nën zgjedhje të huaj e në një varfëri të tmerrshme e se Turqia duhej shkullur më rrënjë nga gjithë Gadishulli Ballkanik.

Kavalioti thoshte se duhej menduar që të shkruhej e të përdorej gjuhë shqipe në shkollat... Nuk është e mundur, — i thoshte Kostandin Oparaku, — nuk është e mundur që të shkruhet gjuhë jonë, ka vështirësi praktike, përveç të tjerash. Ti, Kavaliot, e shkrove dhe e rishkrove një fjalor ku futë edhe arbërishten, çfarë nxore?

— Ai ishte një fillim, — ia ktheu rektori, — sepse duhet të shqiptosh së pari tingullin A, që të vijosh me krejt alfabetin.

— Por, — vijoi Kostandin Oparaku, — popullin tonë e kanë katandisur në një shkallë të tillë paditurie, sa s'kemi për ta nxjerrë kurrë...

— Po ti, profesor, ç'propozon? — pyeti Teodori.
— Ne i kemi dy gjuhë të gatshme, latinishten e greqishten, të shkruara, të punuara... Me njërin nga këto të dyja duhet punuar dhe mësuara.

— Kjo është krejt e pamundur, Kostandin, ky

është një krim që neve nuk mund të na e mbajë as shpirti e as ndërgjegjja. Kjo nuk mund të bëhet. Një shembull të shkëlqyer e kemi te Eugjeni¹⁾ e te të gjithë arbëreshët që kanë qindra vjet që jetojnë larg trungut arbëror dhe përsëri e përsëri flasin, urojnë dhe këndojnë vetëm arbërisht!

— Po, kjo është e vërtetë! Por a e di se sa pengesa e sa rreziqe do të përballosh?

— Jam i ndërgjegjshëm për ato.

Biseda do të vijonte edhe më, por u duk një i panjohur që u afrua. Ata të dy shtrënguan armët. I porsaardhuri ishte një djalosh nja njëzet vjeç, veshur me shajak. Dukej se edhe ai kishte dalë për gjah. Dukej tepër i shkathët. I vështroi Kavaliotin e Oparakun dhe uroi:

— Gjah të mbarë, zotërisë suaj!

— Nga të kemi? — e pyeti Kavalioti.

— Nga Gjonomadhi. Kam dëgjuar për ju dhe për armët e reja të gjahut, jam shumë i dëshiruar t'i shoh.

Ai iu afrua Kostandin Oparakut dhe po ia vërente armën i rrehabitur. Profesori e shtrëngoi fort çiften dhe vështroi nga Kavalioti. I panjohuri nuk vuri re asgjë të pazakontë tek ata, ishte i përhumbur pas armës.

Teodori e sajdisi djalin, e bëri të ulej dhe atë herë erdhj edhe shoqëruesi i tyre dhe tha se zagarin nuk e kishte gjetur dot.

Përballë vendit ku ata ishin ulur, matanë pllajës, dukej e shtrirë si pasqyrë një misërore. Bima ishte zverdhur dhe dukej se priste draprin. — Fare

1) Eugjen Vulgariš, profesor në Akademinë e Voskópojës, arbëresh nga Moreja.

pakuvija të hollasi vetulla - gjelbëroshe dukeshin aty-këtu nëpër të. Në një çast, duke vështruar anë-dej, djaloshi i huaj kërceu përpjetë:

— Dicka lëvizi atje tek ara me misër!

Kavalioti vuri dylbinë në sy dhe u përqëndrua atje. Pastaj, fare pa habitur dhe me emocion, pa hoqi atë nga syri e tha:

Duket fare qartë, në mes të misërores është një egërsirë.

Do të jetë e butë, përderisa nuk e shqetësojnë zhurmët tona.

Mundet...

Po djaloshi nga Gjonomadhi nuk ishte i atij mendimi. Ai tha se mund të ishte derr i egër. Atëherë Teodori i zgjati atij dylbinë. Djaloshi bëri të shihte me të, por nuk mundi. Rektori u ngrit pas tij dhe ia mësoi ta përdorte:

Ti je i ri i ke sytë xixë. A sheh tash?

Shoh.
Djaloshi hoqi syrin nga dylbia dhe tha:

— Është derr i egër, — tha dhe, pa e zgjatur, u lëshua me vrap tatepjetë. Pas disa çastesh ai u humbi fare nga sytë, pastaj ata e panë se si doli te mezhda e misërores.

Derr i egër
Derr i uritur e vazhdohte të hante misër i babëzitur.

Vetëm kur djali iu afrua mu në hundë, derri kërriti egër, kërceu përpjetë duke treguar dhembët e tij të frikshëm, por atëherë djali e goditi me një shtizë. Nëpër lentin e dylbisë Kavalioti e pa se si derri u tërhoq praptazi dhe, duke u zhgërryer, ra në hendek. Ata të tre u lëshuan vrap për anëdej.

Kur mbërritën në vend, e gjetën djaloshim me

thikë në dorë tek po e rripte derrin. Dukej fare i qetë.

— Ja tri pjesët tuaja, zotërinj, — u tha.

Kostandin Oparaku nënqeshi:

— Djalë, ti je nevojtar, mos na shih ne, kemi dalë për qejf! Ne nuk marrim gjë e as na takon gjë... Ti e vrave, ti...

Djaloshi nga Gjonomadhi u prek dhe sikur u pre:

— Ju lutem, zotërisë suaj, këto janë kanunet e pashkruara të gjahut, ju jeni pjesëtarë të barabartë. Mua që e vrava më takon më shumë vetëm lëkurat.

Dhe lëkurën bashkë me pjesën që i përkiste, djaloshi i hodhi në krahë. U uroi atyre gjah të mbare dhe vetë ia mori vrapit në drejtim të Gjonomadhit.

Deshën s'deshën, ata e nisën djalin e tyre të çonte në Voskopojë mishin e derrit, e porositën të kërkonte edhe zagarin dhe vetë ia morën rrugës për gjah... Kostandini i thirri djalit:

— Mos thuaj gjë në qytet, ose thuaj që...

— Jo, jo. Thuaj, — thirri Kavalioti, — thuaj që derrin e vrau Kostandin Oparaku, me një të shtë-në!

Të dy «gjahtarët» morën një udhishte përpjetë pyllit. Aty-këtu thërritnin nganjëherë zagarin, por ky s'dukej gjëkund.

— Zagari është mësuar të shkojë pas gjahtarësh, — tha Oparaku, — e jo pas nesh që s'kemi haber fare... Çlodhemi edhe një herë.

— Të dija më të fortë, zoti Kostandin, — tha Kavalioti.

— Kam qenë, — ia ktheu profesori, — por më preu malarja vitin e kaluar, pastaj, arrita të gjashtëdhjetat, Teodor, po plakem, që të mos them u plaka:

Kur isha i ri, nga katër i merrnja shkallët, tashti që u plaka, në çdo shkallë kërkon të çlodhet pleqëria...

recitoi ngadalë Kostandin Oparaku, pa e thënë se të kujt ishin vargjet. Kavallioti sodiste pyjet.

— Duhet ta pranojmë, koleg, jemi mbyllur në ishullin tonë dhe nuk e njohim parajsën njerëzore e këtë tokësoren... shih se çfarë bukurie!

— Në këto zabele, mbaj mend, rendja kur isha i vogël, por atëherë nuk i çmoja. Këtë burimin këtu e kam dashur shumë, shih si gurgullon.

Pylli që kishin mbi kokë ishte me panja; ishte zverdhur dhe vezullonte nga një dritë verdhosie në të kuqe. Frynte flladi dhe këputeshin gjethet e mëdha të panjave. Kur këputeshin ato, degëzat e tyre të trasha e me nyje lëshonin një «gub-gub-gub» ashtu si bëjnë edhe gjethet e arrës, ose ashtu si dëgjohet kur godasim me gisht mbi një pëlthurë të tendosur fort.

— Më duket se Stradivariusi, — tha Oparaku, — violinat do t'i ketë sajuar me dru panje.

— Ka të ngjarë, — tha Teodori.

Mbi panjat kishte turtuj, por papritur në qiell uturinë një tufë thëllëzash mali, dhe turtujt, si të turpëruar, fluturuan gati mbi tokë dhe u zhdukën tatëpjetë.

— Më duket, — tha sërish Oparaku, — sikur çdo

panjë është një violinë më vete, — e papritur ngriti çiften. — Do qëlloj njëherë mbi thëllëzat...

— Mos, — tha Kavalioti duke ia kapur me dorë tytën e çiftes, — mos, lëri, se tashti do të këndojnë...

— E ku e di ti se do të këndojnë, Kavalioti?

— Këtu edhe mua më vjen për të kënduar!

U ngritën dhe bënë më tej, pa rrugë, pa drejtim, pa e pasur mendjen se ku kalonin dhe ku do të mbërrinin. Udhën ua pritnin përrenj me blerim tepër të gjallë; ata përrenj kishin shumë lulekaçe e salëp, nëpër gëmushat me bar të butë kishte luleshtrydhe aq të shumta, aq të dendura, por që tashti ishin djegur nga dielli. Kur mbërritën në një majole me shumë fier dhe boriga, Kavalioti vuri dyllbinë në sy. Tej, matanë në një shpat, dallohej një varg me vreshta. Dukeshin edhe njerëz që vërtiteshin gjithandej. Si dukej, vilej rrushi. Por ndonjë fshat s'dukej gjëkund.

Ata shihnin anakënd se mos dukej zagari, se mos ndofta kthehej dhe djali nga Voskopoja, por më kot. S'dukej as njëri e as tjetri.

— Zagari e pa tragën tonë, Kavalioti, ka ikur të gjejë gjahtar.

Afër mbrëmjes ata u siguruan se e kishin humbur rrugën. Shkurret e pyllit tashmë lëshonin aromat e veta që përziheshin dhe e mbanin njeriun rob.

— Si po duken bathët, Kavalioti, do ngelet Akademia pa rektor.

— Edhe pa profesorin e fizikës.

— Sidoqoftë do ta kalojmë natën në pyll, push-

kët i kemi, zjarr nuk do ndezim, se kohë hajdutësh është. Ushqim po kemi marrë me vete..

— Do dalin të na kërkojnë.

— Punë boshe, në këto pyje..

Ata fitnin ë bënin shaka dhe nganjëherë u dukeshin çudi se si ishin veshur ashtu, si kurrë ndonjëherë më parë.

Gjetën një lërishtë mu në mes të pyllit, që nuk ishte më e gjërë se dy rrogoza bashkë; dukej tamam si një limer i fshehur pylli dhe ata ishin të një mendimi ta kalonin natën atje.

Ndërkohë larg e larg degjoheshin këmborët e kopevë të delëve që zbritnin nga malet. Ato këmborë herë degjoheshin fort e herë mbyturazi e dukej sikur tingulli i tyre mekej ose humbiste nëpër pyjet e pafund të Gorës apo të Oparit.

Një kope e vogël delesh po u kalonte pranë. Ata heshtën. Nuk donin t'i zbulonte kurrkush. Por në këtë kohë qeni i kopësë ia nisi të lehte me të madhe. Ai rendte shkurre me shkurre, nuhaste dhe përsëri lehte.

— Hej bela, ç'na gjeti me këtë djall!

Pas qenit capitej një njeri dhe ata, të habitur, panë se mu të lërishta e tyre u duk një bari. Ai, sapo i dalloj, ngriti dorën mbi krye dhe hoqi kapelën në shenjë nderimi. Kishte një qeleshe të bardhë, të lërosur në fëhët e saj.

— Tungjatjetani!

— Njatieta! — belbezoj Kostandini, i mërztur.

Bariu në dorën e djathtë kishte njëfarë muslluku prej druri; ata dalluan se ai që sajuar me dru të bardhë panje të gdhendur me thike.

— C'e mirë ju ka sjellë këtej?

— Kemi dalë për gjah, po na humbi zëgari.

— Dhe keni gjetur kohën të shkoni natën në pyll?

— S'është ndonjë gjë e madhe.

— A... jo. Nata bën ftohtë, do të sëmureni, pastaj ka edhe hajdutë, ka edhe ujqër... Unë s'mund t'ju lë këtu, do të vini me mua në shtëpinë time, nësër shohim e bëjmë.

— Nga cili fshat je ti? — pyeti Kavalioti.

— Unë nuk jam nga asnjë fshat, banoj në një shtëpi të vetmuar këtu në mes të pyllit.

Kostandini e vështroi me ngulm bariun dhe i pëshpëriti nëpër dhëmbë shokut të vet:

— Shtëpitë e vetmuara janë shtëpi hajdutësh.

— Sido që të thoni, zotërinj, — ndërhyri bariu, — unë s'do t'ju lë këtu, do t'ju marr në shtëpi, veçse kam frikë... vallë do t'ju kënaq dot... Kam një të sëmurë në shtëpi dhe...

Ai tha kështu dhe nënqeshi, fytyra e tij e patëkeq mbulohej nga njëfarë gazi të çuditshëm, që ata nuk dinin si ta shpjegonin.

Ai edhe i ftonte në shtëpi, edhe u thoshte se atje kishte një të sëmurë...

— Unë jam i vdekur për njerëz, lavdi zotit që erdhët, ejani, se do t'ju nderoj si ju ka hije!

— Nga se vuan i sëmuri yt, — pyeti Kavalioti.

— Ka shumë zjarrmi dhe qan, — tha bariu, — vetëm kur sheh miq në derë, bëhet më mirë dhe nis e qesh, pa edhe këndon...

— Po atë vegël në dorë çfarë e ke? Fyell?

— Jo, nuk është fyell, por nganjëherë bëhet fyell, pa zë edhe këndon...

Përsëri Kostandin Oparaku i pëshpëriti shokut të vet:

— Ky njeri nuk më pëlqen...

Më në fund ata u nisën pas bariut, gjithnjë duke shtrënguar armët. Bariu nuk kishte më shumë se njëzet dele. Ato u dukën të një shteg i pyllit dhe pas tyre ecte qeni, që tashti ishte qetësuar ca dhe vetëm hungëronte. Pastaj, te kthesa e shtegut, u duk shtëpia e bariut. Ajo vërtet ishte krejt e vetmuar dhe në mes të pishave të larta. Ishte një shtëpi e vjetër, me pullaze shumë të pjerrëta, shenjë se në ato pyje binte shumë dëborë. Ata u habitën se si mund t'i mbante ajo çati gjithë ato rrasa prej guri në një pjerrësi aq të madhe. Dukej sikur rrjeta e dëndur e pullave me myshk i kishte lidhur plloçat me njëra-tjetrën, dhe i mbante të mos rrëshqitnin. Pak më tej shtëpisë pylli vinte larushan; kishte pisha, pastaj edhe ahe e lisa.

— E paske pyllin të përzier, — vërejti Kostandin Oparaku.

— Ashtu e kam, edhe për pak vjet, — u përgjigj çobani.

— Pse? Do t'i vësh sëpatën?!

— Jo, jo. Sëpatën e fut vetë pisha, se kështu e ka kjo bukuroshja e pyllit. Po bëri vend dhe futi rrënjët afër lisit ose ahut, i zhduk shpejt e shpejt, këtë duhet ta dini, zotëria juaj...

— Jo, nuk e dimë, — tha Kavalioti duke nënqeshur.

Bariu ia ktheu pa djallëzi:

— Mua kështu më kanë mësuar pleqtë, më kanë mësuar se pisha është grykëse e madhe, nuk fle as dimër as verë. Lisi e ahu ia marrin me gjumë gjithë dimrit dhe pisha gjen kohë e ua bën gropën. Kështu na ndodh edhe neve në mal... Kemi ndonjë shok gjumash që i lëshon delet në kullotë dhe vetë

ia merr me gjumë e ashtu i ikin dhentë dhe i futen në të mbjellat.

Ata u dhanë te shtëpia. Ai i la miqtë te strehët dhe shkoi të mbyllte delet në një strungë më tej. Lidhi edhe qenin pas një huri dhe vajti sërish pranë miqve.

Hynë në shtëpi. Ajo që një kthinë e vetme për dhëse, e shtruar me rrasa të trasha, me katër dritare të vogla mbyllur me kanate dërrase dhe, më shumë se kaq, as dukej gjë tjetër. Bariu u foli të ulëshin, por ata nuk dinin se ku. Ishte një errësirë gatë e plotë, disa shtiza të holla drite binin përmbi trarët, atje ku fishkëllente era e mbrëmjes, por ata druhashin të ulëshin nga frika se mos përplasheshin me të sëmurin e panjohur, që duhej të ishte struktur atje diku. Më në fund ata u ulën mbi diçka që dukej se ishte rrogos dhe pritën. Përsëri bariu rëndi përjashta i shqetësuar, i nxituar.

Në kthinë heshtje e plotë, errësirë.

Pastaj u ndie një pikëz që dëgjohej qartë tek binte: «Pik... pik... pik...»

Binte nga çatia, a nga gjetiu, nuk kuptohej. Bariu u kthye me një frymë. Lëshoi diku një varë-dak me karthje të thata, pastaj trazoi diçka në vatrë, sa u dukën shenja shpuzë. Ai hodhi kashtë mbi shpuzë, përmbi kashtën vuri karthje të thata dhe u fryu... Flaka ia dha menjëherë. Dhe vetëm atëherë u duk kthina tejendane, por të sëmurin nuk e dalluan dot asgjëkund. Pyeti Kostandin Oparaku:

— Ku e ke të sëmurin, ne mund ta ndihim...

Bariu bëri shenjë me gisht nga një but i madh, që ndodhej në fund të kthinës:

— Ja, ai është i sëmuri...
Ata u vështruan sy më sy.

Bëra shaka me zotërinë tuaj, të më ndjeni, desha t'ju sjell medoemos në shtëpi, kam gezim të madh, më ngrohet zemra kur më vijë njëzëz...

— Po ti na the se i sëmuri ka zjarrmi e loton!
Edhe një herë ju kërkoi ndjesë, mendova se do më kuptonit përse e kisha fjalëniq. Buti më musht është i sëmuri im; dhe muslluku më është prishur (e pikon) domethënë qan. Prandaj sajova një muslluk të ri në pyll. Tashti, me lejen e zotërisë suaj, do t'ju bëj darkën, me atë që më ndodhet...

— Ne kemi bukë e gjellë më vete, përse harxhohesh kot...
Ai bëri përjashta, kurse ata mbetën si të hutuar.

Bariu duk përseri dhe nisi të ndërronte musllukun e vjetër me të riun. Pastaj mbushi dy mash-trapav më musht e ua vura përparat —
Rini, zotëria juaj, i sa të imbarojca punë —
Ai doli përjashta duke marrë më vete një çen-geli hekuri, tashig për tashig? Pastaj për butin me mash?

— Dó këtë t'herun ndonjë dengj? —
Kava-
lioti. —
Ashtu duket kot që harxhohet.

Pas pak bariu rendi edhe një herë këtej. Në për duar i dalloheshin shenja gjaku. —
Më duket se po harxhohesh shumë, bari...
Përse?

— Aaa! Kjo është mikspritja e shqiptarit, mos më hynë në hak.

— Po ti, i vetëm je këtu?

— Si urdhëron, si më shihni.

— E përse nuk je martuar?

— E kush vjen këtu në vetminë time!

— Atëherë përse nuk ke shkuar ti në ndonjë fshat?

Ai hapi krahët anash, vështroi zjarrin me një nderim të thellë e tha:

— Nuk mund të largohem prej këtej, këtu kam varret e prindërve, ku t'i lë ata?

— Po pse, për hir të të vdekurve të vuash ti!?

— Kush nderon të vdekurit, di të jetojë me të gjallët, njeriu për një nder jeton!

Ata ulën kryet si të shastisur.

* * *

Të nesërmen ai i përcolli gjer larg. U përshëndoshën dhe u ndanë.

— Njeri i mirë, i zgjuar, zemërbardhë.

— Dhe shumë i thjeshtë.

— Nëse do të ishte i shkolluar, — tha Kavalioti, — do të ishte një dijetar i vërtetë. Çfarë zemre që kish... Fliste si një mendimtar, e dëgjove atë lojën për butin me musht? Pastaj për pishat, për lisat, për ahet, për të vdekurit e për të gjallët?

— Ç'e do, u kthyem duarbosh. Kavaliot, nuk vramë asgjë, — e hodhi fjalën gjetiu Kostandin Oparaku.

— Jo, Kostandin, vramë...

Oparaku qëndroi në mes të rrugës dhe e pa Kavaliotin si i topitur:

— E çfarë vramë, rektori im?

— Vramë një pjesë të paditurisë sonë, profesor.

shin shuar. Ditë e natë zhurmë çatish që rrëzohe-
shin, kërcitje rrasash që thyheshin e gjëmime mu-
resh që përmbyseshin.

Nëpër këtë prishje e shkreti dukeshin karvanë
të tërë njerëzish, që iknin e iknin gjithnjë e për-
gjithnjë me nga një thes lecka mbi shpinë, me nga
një karvan fëmijësh e grash, duke hedhur pas sytë
e përlotur mbi mëmëdhenë që ndoshta s'kishin për
ta parë kurrë më.

Nëpër sheshet e qytetit dhe gjatë rrugëve krye-
sore të tregut, të Akademisë dhe të shtypshkronjës,
mjeshtrit skalitës oparakë kishin ngritur kolona me
gur mermeri të marrë nga Polena dhe me nga një
poç prej gur stralli në krye, ku çdo mbrëmje der-
dhej rrëshirë, katran e dyllë dhe i vihej flaka. Dri-
ta që lëshonin, mbante gjer vonë natën. Tashti këto
kolona ishin shembur përtokë e ishin thyer, ishin
mbuluar me shkumb e ishin bërë pjesë e kësaj rrë-
noje gjigante.

U dogj biblioteka, u shkumbua azili, u sheshua
tregu, punishtet e argjendarëve u plackitën e u do-
gjën, depoja e letrës lëshoi flakët gjer në qiell, tipog-
rafia u shkatërrua.

Tashti, pas dhjetë ditësh, vrasësi rikthehet të
shohë viktimën. Kanë ardhur bimbashi me një mi-
jë veta pas, spahinj e bejlerë, jeniçerë, kadilerë e
hafije.

I pari i tyre ka në xhep një urdhër nga pashai
i Manastirit. Ia dha në dorë një tellalli, i cili i ra
daulles me kërbaç dhe nisi të bërtiste:
«Hej, millet e kallaballëk raja, habër nga padi-
shahu ynë, kalif i ndritur i profetit Muhamet... Kjo
kasaba u batërdis se u bë limer i firarëve dhe qafit»

rëve, kjo kasaba lëshoi brezin dhe dërgoi gjonglinj¹⁾ e para në kaçakët e Himarës që bënë kryengritje. Në këtë kasaba po shtypen libra në gjuhën e gjaurit... Me urdhër të padishahut do të japin hesap të gjithë dhaskalët e mejtepeve të kësaj kasabaje... Hej, milët e kallaballëk, vini vesh e dëgjoni! Kjo kasaba ka zgjyruar për të larë! Shkollarët kanë vjete që flasin vesh më vesh me bajlozët e Evropës që bëjnë allasup²⁾ këtu. Hej, milët e kallaballëk, vini vesh e dëgjoni! Kush fsheh mësonjësit dhe profesorët e Akademisë, ngre dorën kundër padishahut. ...

Tëllalli shpërveshi një lëverë tjetër dhe e shkundti në erë, si ta kishte shami hundësh, dhe ia nisi përsëri rulërimës së tij.

«Kërkohet domosdo të dalë përpara: kadiu dhaskali Teodor Kavalioti! Koka e tij i zigjaset me flori!...»

Dhe Teodor Kavalioti ndodhej i fshehur në shtëpinë e punëtorit plak e të verbër Dhimitër Viganit. Bashkë me të ishin edhe dy djem studentë të Akademisë, Josif Thana nga Vithkuqi dhe Anastas Píluri nga Himara.

Anastasi ishte një djalosh zeshkan nga Bregdeti, me ca lehra kokoridhe, të zeza pis dhe të ngritura përpijetë. Ai ishte tepër i shkathët dhe, kur vëreie lëvizjet e tij, të dukej sikur ky njeri nuk kishte fare kocka, por ishte krejt prej llastiku. Kurrë nuk mund të merrej me mend se si ky Tasi mund të bëhej prift. Kalon nëpër odën e vogël e zoti i shtëpisë me duart ndehur përpara si i verbër dhe padashur

- 1) gjongli — vullnetar (turqisht) / up i fort i blin
 2) allasup (= pushim) (turqisht)

duart i përkasin në kokën e Anastasit. Plaku habitet, i pëshpërit:

— E si mund të hyjë kamillafi i priftit në këtë kokë?

— Studenti nga Himara gjatë katër vjetve në Akademi gjithnjë ka qenë kokë më vete. Të gjithë e kujtonin se si një mëngjes, që nga kati i tretë i konviktit qenë varur pesë raso të zeza, lidhur komb njëra pas tjetrës. Ato i kishin shërbyer Anastas Pilurit të zbriste tinës nga konvikti dhe të ikte nga e dinte ai.

— Me këto që ndodhën dhe që na i panë sytë...

— flet Anastasi, — unë nuk e tret dot... Kur shoh vrasje e zjarre e kur shoh që digjet një qytet i tërë, unë duhet të rrëmbej shpatën...

Anastasi kërkon ta shtrojë në bisedë, por plaku ndërhyri:

— Mua më duket se Anastasi ka lindur për kryengritës dhe aspak për prift.

Josif Thana ishte një djalë kokukur... Koka e tij tani ziente nga mendimet e të dukej sikur ai po përçapte mësimet e shkollës ose përsëriste psallmet. Të dukej sikur ky vithkuqar edhe natën flinte me temjanicën pranë, sikur xhepat i kishte të mbushur me temjan dhe s'bënte punë tjetër veçse numëron-te kokrrat e temjanit një për një.

— O zot, falna fajet tona, siç ua falim edhe ne fajtorëve tanë dhe mos na shtjer në ngasje, po shoë-tona nga i ligu! — dëgjohej zëri i tij i ngadaltë. Dhe, duke dëgjuar fjalët gjithë vrer të Anastasit, ai përsëri falej: — O zot, fali ata që s'dinë ç'bëjnë!

Anastasi kokëkrisur u kthye nga ai me inat:

— Ata na vrasin e ne t'i falim! Ik, more gjizani! Ti je njeri i qullët!

Josifi e vështroi me ca sy të përdëllyer.

Shtëpia e Dhimitër Viganit ishte një karakatinë e ulët, me një gjysmë oborri të mbyllur me avlli të vjetra. Oborri ishte i shtruar me rrasa të trasha e të shtrembra. Shtëpia vocërrake i ka muret të lyera me dhé të kuq, dhe balta e lyerjes, përsëri si sherbet i kuq, ishte aty në një vorbë të vjetër, mbi të cilën çlodhej një poste ca më e vjetër. Shtëpiza kërciste nën çap të njeriut, sa edhe të inaces. Shkalla e vogël tundej e lëkundej, krimbat e brenin aq shumë shtëpinë, sa dëgjoheshin kërcëllitjet e holla nëpër trarë. E brenin krimbat, e brenin minjtë, e endnin merimangat dhe nga brerjet e shumta shtëpiza kundërmonte erë pishë dhe ah të kalbur.

I vetëm gjithë jetën, punëtori i verbër banonte atje. Por, edhe se i verbuar, ai nuk iu dorëzua fatkeqësisë së tij. Punonte gjithnjë në tipografi duke vërtitur rrotën e madhe. Me këmbëngulje ai e bindi Kavaliotin dhe i mori një fletore me këngë e ninnulla «në gjuhën epirote», si shprehej ai vetë. Plaku thërriste edhe një nip të tij e ia lexonte. Me vullnet të hekurt dhe me ndihmën e shqisës së të prekurit, plaku radhiste shkronjat në po atë mënyrë si atëherë kur qe botuar fjalori trigjuhësh me «epiroten» brenda. Plaku i kujtonte gjithnjë ato vargjet e para...

Tak e tuk e ç'bën atje?

Bëj lakruar me arme!

Voskopoja me Oparë

Jemi fis e jemi farë;

Kemi gjak e një zakon,

Shën Prodhomë na mpron!

Në zjarrin e vatrës ishte një vorbë balte me fasule, që gurgullonte. Mbi grykën e saj, si kapak, ishte vënë një latuar-i vjetër. Flakët e zjarrit uturonin dhe bënin që zinxhiri që varej në kllanik, të tundej e të lëkundej si slaverësi i një sahati të madh. Këtu Anastasi gjeti rastin dhe kërkoi të thumbonte:

— Ky zinxhir zjarri më kujton temjanicën e ardhmë të Josifit!

Në sobën vocërrake rishin mbledhur katër burra kokë me kokë, flitnin ngadalë e mendonin se në qytetin e tyre askujt s'do t'i shkonte mendja se ata ndodheshin aty. Dëgjuan tellallin që kaloi aty dhe Josifi pyeti:

— I nderuari rektori im, a janë të vërteta të gjitha këto?

— Në kemi pasur leje të botonim vetëm libra fetarë, por kemi shtypur edhe libra shkolle.

Papritur një trokitje në portë. Ata shtangën. Doli Anastasi në tremë dhe përgjoi. Pastaj ai pa një dorë që u fut nëpër të çarën e kështjës mundohëj të mënjanonte llozin për të hyrë brenda. Vështroi me ngulm. U afrua dhe e kapli atë dorë me forcë. Një e dridhur e huaj i hyri në mish. Pas tij u afrua plaku Dhimitër. Që jashtë u ndie një zëri ngadalte vajze:

— Baba Dhimitër, jam unë, Jela!

— Hape, — i tha plaku Anastasit, — është çupa e të ndjerit Trajan. Vjen gjithnjë e më ndih për punët e shtëpisë.

Anastasi tashti e kuptoi që kishte ndër duar një dorë vajze dhe e lëshoi fare ngadalë.

Ajo ishte një vajzë në moshë fare të re. Mbante në krye një shami të zezë dhe një gërshet i vetëm

i varej poshtë. Njiheshin ende gjurmët e lotve në sytë e saj. Foli ngadalë: — Paskë njerëz, baba Dhimitër. Të më ndjesh, se u vonova, ndofta e di, varrosa babanë.

Plaku e dinte. Me dorën të shtrirë përpara nga vinte zëri i asaj, ai i përkthi supet, pastaj i mori kryet e ia shtrëngoi në gjoksin e tij të gjerë. I përkëdheli flokët:

— Behu e fortë, bija ime, robëria kështu e kaloi. Plaku e futi vajzën brenda. Ata të tre kurrë s'e kishin vënë re këtë vajzë, kurse ajo i njihte një për një. Jela u përkul dhe i puthi dorën Kavaliotit.

— Jam vajza e Trajanit, — tha ngadalë, — dhe e varrosëm. Unë jam rendëse. Trajani kishte pasë qenë bakërxhi. Nga esnafi i tyre, Kavalioti pati marrë bursën. Babanë e vajzës ai e kishte njohur fare mirë. Por këtu nuk ishte vendi për t'u lëshuar rrugë ndjenjave. Ndërkohë që ai po mendohej, Anastasi Piluri, që përgjonte ç'ndodhte jashtë, tha: — Në fund të sokakut të ngushtë po vijen vërdallë Bane Lica, spiuni, me siguri përgjoh dhe nihat.

Teodori pas Anastasit dhe Josifi pas tyre ngadalë zbritën shkallët. Në bodrumin e vogël ishte gjysmerrësirë. Diku duhej të ishte një but i vjetër, sepse ndihej një erë e largët vere. Dritarja e vogël nuk ishte më shumë se një pëlëmbë dhe e kryqëzuar me hekura. Në fund të sokakut dukej tek hiqte këmbët zvarrë shtrigu. Bane Lica. Kafshonte me dhëmbë buzët ose mustaqet e veta, por me bisht të syrit ai përgjonte këtej. Për habi të të gjithëve, Bane Lica ishte veshur me rroba të reja! Kjo nuk kishte ndodhur kurrë. S'mbahej mend ta kishte parë

njeri të veshur për të qenë. Njeri i kafeneve dhe i tavernave, i rakisë dhe i verës, pijanik i zvetënuar dhe spiun i regjur, që në kohë të rinisë së tij pinte ç'të shtinte në dorë. Vishej si mundej, por sot paraqitja e tij me rroba të reja dukej si e çuditshme.

— Do ta kenë veshur turqit për shërbimet që u ka bërë, — tha Teodori, po Josifi i urtë nuk ishte i atij mendimi. Ai zakonisht fliste pak dhe shkurt, po tashti më shumë i flitnin sytë, që ishin zmadhuar e habitur. Druhej të thoshte ç'kishte ndër mend, kishte frikë mos gabonte, po nuk mund të përmbahej. Dukej se ishte i sigurt për ato që do të thoshte.

— Unë nuk betohem kurrë, po sot jam gati të shtie në bast dhe të betohem... Rrobat prej shajaku të bardhë që ka veshur Bane Lica... Po ju shihini vetë ato rroba!

Ata të tre ngulën sytë në dritarezën e ngushtë e të shtrembër që ishte rrafsh me tokën dhe dalluan qartë: pantallonat e reja të Banes dhe xhaketat kishin njolla të errëta përpara.

— Do t'i ketë blerë së liri të çifuti Joakim, — tha Kavalioti.

— Thuaj se do t'i ketë bërë plaçkë te çifuti Joakim...

Po këtu Josifi nuk pajtohej.

— I nderuari rektori im, gjithë këto ditë ka pasur kaq të vrarë, sa peshkopi më ngarkoi edhe mua të bëja varrime, megjithëse akoma nuk jam shunguruar prift. Dhe betohem, i nderuari rektori im, këto rroba të bardha prej shajaku ia pashë të veshura pardje një punëtori të vdekur, që e kishin vrarë asqerët e turkut. Pardje aq të vdekur pati, sa na u mbarua vaji në kishë, me të cilin mirosnim të vdekurit. Atëherë nxorëm vaj të djegur nga kândilet

e vjetra, një vaj të trashë si zgjyrë e tërë zhul. Vetë derdha vaj të tillë mbi trupin e atij punëtori të vrarë, vetë e bekova dhe i këndova...

Anastas Piluri, duke shtrënguar dhëmbët, tha:
— E besoj, ky krimb edhe të vdekurin e nxjerr nga varri. Ky maskara ka spiunuar David Selenicasin. Të më vijë në dorë, i punoj qindin.

Anastasit as i binte ndër mend se vetëm pas disa minutash do të kishte të bënte me atë njeri.

Porta e Dhimitër Viganit u tund e u lëkund nga një trokitje e fortë. Anastasi u derdh për andej, pas tij vente i zoti i shtëpisë. Me të ndier çape në tremë, Bane Lica thirri:

— Ti, ore Dhimitër qorri, hap derën!

Me t'u hequr llozi i rëndë, hyri brenda Bane Lica, i pasuar nga një zaptije me hutën në dorë.

— Ç'kërkoni nga unë, — tha plaku, — unë jam një i verbër.

— Një i verbër që ke sy më shumë sesa të duhen, — tha Bane Lica, — dhe këta sy s'është çudi të t'i shkulum fare, tepër i ke. Dhe, pa nisur nga bastisja na thuaj shpejt, çfarë gjë të ndaluar ke në shtëpi?...

Dhimitër Viganit ishte njeri i regjur. Me fjalët e tij ai iu përgjigj njëherësh edhe atyre që sapo i hynë në shtëpi, u foli edhe miqve që kishte në sobë:

— Zoti Bane, thuaji këtij turkut se në qilar të shtëpisë më kanë dhënë për të ruajtur disa libra, ejani dhe merrini... të shpëtoj unë.

I udhëhoqi nëpër shkallëzën shkatërraqe që tundej e lëkundej. Si hije i ndiqte Anastas Piluri, besëplotë se do të kishte rastin të shpërthente. Por ai nuk e mori dot me mend krejt mendimin e Viganit, sepse ky, me të ndier afër frymëmarrjen e tur-

kujt të armatosur, e shtiu atë midis krahëve të vet dhe e shtrëngoi aq fort, sa lë që iu zu fryma, por i kërcitën kokat sikur t'ia kishin shtrënguar me mengënë.

Në po atë çast Anastasi u hodh mbi Bane Licën, i cili pas disa përpelitjesh dhe shpirt shpejt e shpejt në duart e hekurta të labit që për këso punësh as falte e as bënte shaka.

Teodor Kavalioti u habit. Kurrë në jetën e tij nuk e kishte parë vdekjen kaq afër.

Në patozin e lagësht të bodrumit që mbante erë myk e batak, ata i shtrinë të dy kufomat. U afërua edhe Josif Thana dhe në atë heshtjen e çuditshme që zotëronte atje, u fall Anastas Piluri u xhindos:

— Pusho, more katran, se më nxore shpirtin! Për kë falesh ti? Për hesap të kujt? Në emër të kujt? Pusho, se besa-besën do të të bëj atë që s'dua të bëj.

Dhimitër Vigani u ngjit lart. Atje mori një kazmë dhe një kandilë dhe zbriti me to në durr. Ai lëshoi vizte aq lirshëm nëpër shtëpi, sikur të kishte dy palë sy. I foli Teodorit:

— Eja me mua, biri im, tregomë se ku duhet të dëlloj për të hapur gropën dhe pastaj, se si duhet qëlluar, e di unë vetë.

Plaku nisi të rremonte tokën. Goditjet e tij ishin aq të forta, sa shtëpiza lëkundej, kurse tabani i tokës lëshonte disa gjëmime të pasura me jehonë. Ai pëshpëriste:

— Kështu ia hapsha gropën edhe sulltanit, edhe atij mjekërcianit tonë, që i pëshpërit sulltanit në vesh tek pinë kafe tok.

Jela, me lopatë në dorë, nisi të largonte dheun

mënjane. Anastasi gjeti në xhep të turkut pesë copë unaza ari. Ia tregoi Teodorit. Ky i mori në duar dhe nën dritën e kandilit nisi të vështronte atje ku ishin shënuar emra dhe data martesash.

— Edhe sa vrasje, edhe sa zjarre, edhe sa qyteste duhet të shkatërrohen, gjersa njerëzit t'i shtrohen arsyes? — tha ai i menduar.

Duke qëlluar token me ngulm, Viganit ia ktheu: — Që të arrihet ajo, o Teodor, duhet që unë të bëj këtë që po bëj dhe ti të bësh atë që po bën... Unë më kazmë të hap varre, blic me kandile të na ndriçosh.

Teodor Kavalioti uli kryet dhe i shkoi ndër mend një themie e Eugjen Vulgarit. «Sikur të ishte i shkolluar Dhimitër Vigan, në s'do të ishim të denjë të mbanim as divitin».

Jela! — u dëgjua zëri i Viganit.

— Urdhëro, baba!

Shko lart, o bije, dhe më sill atë pocen me piper çjegës.

Teodori rrudhi ballin. «Plaku kërkon piper! Ndonjë zakon, ndonjë rit, ndonjë...»

Por plaku Dhimitër ishte njeri i regjuri. Ai u hodhi kufomave nga një dorë piper sipër trupit, pastaj përsëri mbushi dorën dhe me të spërkati token e rremthur, truallin, shkallët e gjer te porta. Teodor Kavalioti habitej.

— Baba Dhimitër, ç'bën kështu?

— Turqit do t'i kërkojnë njerëzit e tyre, — tha plaku, — e tashti që u mungon edhe Bane Lica si nuhatës, do të lëshojnë edhe qentë, por, më të nuhatur nga larg erën e mprehtë të piperit, qentë ikin e nuk afrohen.

Punëtori plak gjithnjë e kish habitur rektorin me përvojën e me zgjuarsinë e tij. Por, duke vështruar këtë varrim të çuditshëm, i zverdhur në fytyrë e me dinjitet prej dijetari, Teodor Kavalioti pëshpëriti:

— Voskopoja e madhërishtme, me akademi e biblioteka, me fabrika dhe esnafe punëtorësh, qyteti i madh i Voskopojës me gjithë këto vepra arti nëpër kisha, me gjithë këta kodikë historikë kishash që peshojnë më shumë se njëzet okë njëri, Voskopoja e ndritur nga iderat e iluministëve nuk i shpëtoi dot as tiranisë së turkut, as prishjes...

Anastas Piluri kishte mbledhur grushtet nën mjekër dhe ndoshta ishte hera e parë që fliste me rektorin e vet fare pa droje, si të qenë të barabartë, një e një...

— Rektor... Nga sa na ke mësuar në katër vjet me radhë, unë nuk di nga historia e botës që ndonjë truall ose ndonjë popull të jetë çliruar nga tirania duke psallur e duke tundur temjanicën. Këtu nuk bëhet më fjalë për të kthyer faqen tjetër e as për të shtruar çështjen në gjyqin e arsyes... Prandaj, rektori im, unë më e më prift s'kam për t'u veshur!

— E ç'ke ndër mend, Anastas?

— Do të iki në Labërinë time dhe do të bashkohem me ndonjë çetë kaçakësh... E, të kisha libra në gjuhën time...

Dhimitër Vigani gjeti rast të ndërhynte:

— Të kam thënë me kohë, Kavalioti im, duhet nxituar për të botuar libra në gjuhën epirote.

Kavalioti psherëtiu:

— Nuk është e lehtë, baba Dhimitër, a nuk shihni

e a nuk dëgjoni? Nuk na lënë të shkruajmë në gjurhën tonë dhe, ngaqë s'u bindemi, duan të na presin kokën dhe na mallkojnë, na shkishërojnë, na vrasin e na ndjegin qytetet.

Heshtje te bodrumi ku sapo u varrosën vrasësit. Kavalioti mendohej me dy duart në fytyrë. I foli Anastasit:

— Biri im, unë jam për rrugë, nuk e di se nga do të shkoj e do të mbaroj dhe nuk dihet nëse do të kthehem më në vendlindje. Por kam disa dorëshkrime, t'i marrim atje ku ndodhen e do të t'i jap ty... — Pastaj iu kthye Josifit: — Pëntu, o Josif i urtë, kam një porosi tjetër. Do të të jap të më ruash në Vithkuq një tekst filozofie, mbaje në vend të sigurt dhe mos ia trego askujt.

— Si urdhëron, rektori im.

Dhimitër Vigani, me sytë e shuar që drejtohe-shin herë këtej e herë andej, u mendua e pastaj tha:

— Po mendohem, Kavaliot, yjet e vendit po na ikin... E pa mendo si mbetet nata pa yje...

— Prandaj rënkove ashtu, o Dhimitër?

— Kjo është për të ulëritur e jo më për të rënkuar... Më shkoi mendja se, kur i vërej më yjet tek shkasin nëpër qiell, i shohim e ato xixëllojnë, drita e tyre na pëlqen, se natën e zezë na e zbukurojnë... Le të shpresojmë se do ta dëgjojmë sërish zërin tënd, Kavaliot. Unë jam i verbër dhe nuk mundem ta ndih më këtë vajzë që mbeti jetime... po pate mundësi, merre me vete dhe Jelën... ajo...

Por vajza u përngrit në çast:

— Jo, baba Dhimitër, unë nuk iki që këtej.

Kavalioti nisi të bluante në kokë atë që sapo dëgjoi. U kujtua së edhe një herë tjetër e pat dëgjuar këtë arsyetim nga njerëz të popullit dhe fare

të paditur. Këto janë gjurmë të një qytetërimi tepër të lashtë, mendoi ai.

Ishte thelluar nata. Ndihej zhurma e qytetit që digjej, e mureve që rrëzoheshin, e dyshemeve që kërcitnin nga zjarri, e ujërave që rridhnin e vërshonin nëpër rrugët, ndiheshin çapet e xhandarëve dhe të derebejve. I tretur në mendime dhe i dërrmuat prej gjithë atyre ndodhive, Kavalioti gjithnjë përfytyronte me ngulm. I dukej se akoma do të rridhnin ngjarje të tjera, të ashpra, të përgjakura e plot tmerr. Dhe përmbi të gjitha këto ai kishte vendosmërinë se duhej të lëvizte, të bënte diçka, të reagoonte apo të largohej. Mendja i thoshte se duhej të mos rrinte në vend, përndryshe do ta kapnin dhe do t'i prisnin kokën.

Vonë pas mesnate ata u nisën. Dolën për t'i përcjellë edhe Dhimitër Viganin me Jelën. Kalonin në varg andej nga nuk ndiheshin çape e nuk dukeshin hije. Jela çante përpara. Dolën te «Luadhi i Skolive». Këtu po rrëzoheshin muret e depos së letrës dhe. Në krye u dëgjuan ca si çapitje dhish nëpër errësirë, pastaj një tog rrasash u shkëputën nga një mur i lartë, u përplasën mbi ta dhe ranë në tokë. Prej tyre u godit në kokë Dhimitër Viganin. Më kot Kavalioti e tundti e i pëshpëriti në vesh... Plaku kishte vdekur.

Kavaliotit i theri në zemër humbja e Dhimitër Viganit. Ai që nisur për një ndarje të përkohshme me të, kurse u ndanë përgjithnjë. Ishin tashti të gjithë në oborrin e kishës së shën Thanasit, në mes të kryqeve prej guri e mermeri, në mes të vanre,

zës. Atje pranë ishin vidhat e mëdhenj të oborrit dhe pas tyre zgjojët e bletëve. Kavalioti ngriti kryet lart! Gjer në kufi të qelshit sulmonin miliona e miliona xixa zjarrë. Tyti që e nxinte me fort natën, të digjte në grykë. Poli Anastas Plluri dashur rektori im, na u vra. Dhimitri Kavalioti nuk u përgjigj. Anastasi iku varrezave, tutje, nga ana tjetër e oborrit, ku ndiheshin zëra. Edhe andej varrosnin njëzë të vrarë ose të djegur nëpër gërmadhët e qytetit. Anastasi u kthye me një kazmë dhe nisi të hapte varrin për plakun! Jela qante, kurse Josifi psallte ngadalë, sa mezi dëgjohej. Kavaliotin e sulmonin mendimet. U ul në ledh dhe kapi kokën me duar.

Dëgjohej kazma që hapte varrin dhe lopata e Jelës tek largonte dheun, pastaj Kavalioti u ngrit i dërrmuar dhe shkoi e i dha lamtumirën e fundit atij plaku të moçëm që i detyrohej aq shumë. Mbi varrin e tij të mbuluar ata ndenjën gjatë dhe pa folur fare. Vetëm Josifi vijonte të këndonte të gjitha e gjer në fund psallmet e tij prej prifti të pashunguar.

«Kohë e varreve, por duhet të nisemi.»

Jela e nderi dorën për ndarje dhe kërkoi një thikë që ta kishte me vete. Anastasi i dha të tijën dhe nëpër errësirën e dendur u mundua të shihte sytë dhe fytyrën e saj. Por ndërkaq ajo u shkëput prej tyre dhe çau nëpër errësirë.

Papritur Kavaliotit iu ndez në kokë një mendim: Ikjen e vet në fillim ai e pati menduar si një «ik të ikim për të shpëtuar kokën» por... «Tashti kjo nuk më shkon për shtat mua, as moshës sime, as kulturës sime e as ideve të mia. Një ikje e tillë

nxitet nga një gjendje shpirtërore e ekzaltuar, e rrëmbyer. Që kur isha i ri, kaq herë isha gatitur të shkoja për haxhillëk në Jerusalem e Betlehem. Por, pas gjithë kësaj prishjeje, pas gjithë kësaj shembjeje e pas gjithë këtyre varreve, ai shtegtim nuk ka më asnjë kuptim. Sikur ta shtroj problemin në gjykimin e arsyes sime, sikur të përqas haxhillëkun e djeshëm me bindjet e mia të ndriturisë, edhe kësh-tu nuk shkon... Pas kësaj, drejt lindjes, çdo haxhi-llëk është i pafryt dhe i pavlerë. Por unë do të shkoj për një haxhillëk tjetër. Dhe këtë radhë do të nisem në emër të mëmëdheut të mbajtur në zgjedhë nga otomanët. Ne i kemi shërbyer Evropës, tashti ajo le të na e lajë borxhin që na ka.

PASQYRË E LËNDËS

Rrefimi i një ndërlidhësi partizan	3
Njeriu me dy shtata	18
Krugës anës lumit	27
Kur pikonin mollët	41
Copëza jete	67
Fara e mbjellë nga Naimi	127
TREGIME NGA VOSKOPOJA	
1. David Selenicasi	137
2. Dhimitër Vigani dhe Kavalioti	218
3. Gjah të mbarë	233
4. Djegia	247